



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT**

**RAPORTI I DYMBËDHJETË VJETOR**  
**1 janar – 31 dhjetor 2012**

**drejtuar**

**Kuvendit të Kosovës**

Publikuar nga:  
**Institucioni i Avokatit të Popullit**

Prishtinë, 2013

Z. Jakup Krasniqi

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Prishtinë

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 135 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes *Raportin e dymbëdhjetë vjetor* të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, Ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen e këtij raporti në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe hapjen e diskutimit në lidhje me këtë raport.

Me nderime,

Sami Kurteshi



Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 3 tetor 2013



## PËRMBAJTJA

Fjala e Avokatit të Popullit .....	9
1. Hyrje .....	15
1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit .....	15
1.2. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit.....	15
1.3. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit .....	17
2. Të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës .....	19
2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.....	19
2.2. Dinjiteti i njeriut .....	21
2.3. Barazia gjinore .....	22
2.3.1. Vendimmarrja dhe e drejta në punë .....	23
2.3.2. E drejta e pronës.....	24
2.3.3. Mbrojtja shëndetësore .....	24
2.3.4. E drejta për arsimim.....	25
2.3.5. Dhuna në familje.....	26
2.3.6. Gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.....	26
2.4. E drejta për jetën .....	27
2.4.1. Zvarritja e procedurave hetimore dhe profesionale .....	27
2.4.2. Gjaktmarrja dhe moszbatimi i ligjshmërisë .....	28
2.5. E drejta e integritetit personal .....	29
2.6. Të drejtat e të akuzuarit.....	30
2.7. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër.....	33
2.8. E drejta për mjete juridike .....	34
2.9. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në raste penale .....	36
2.10. Liria e lëvizjes .....	37
2.10.1. Transporti humanitar.....	39
2.10.2. Udhëtimi në vendet e BE-së .....	40
2.11. E drejta e privatësisë .....	41
2.11.1. Pacenueshmëria e banesës .....	42
2.11.2. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit .....	43
2.12. E drejta e martesës dhe familjes.....	44
2.12.1. Zvarritja e procedurave gjyqësore në raste të shkurorëzimit .....	45
2.13. Liria e fesë, besimit dhe ndërgjegjes.....	47
2.13.1. Bashkësitë fetare .....	48

2.13.2.	Gjendja në terren.....	48
2.13.3.	Bashkësia Fetare Islame.....	48
2.13.4.	Kisha Ortodokse Serbe .....	49
2.13.5.	Kisha Katolike në Kosovë .....	51
2.13.6.	Kisha Protestante Evangjeliste e Kosovës .....	51
2.13.7.	Bashkësia Hebraike në Kosovë.....	51
2.14.	Liria e shprehjes .....	52
2.15.	E drejta e qasjes në dokumente publike .....	53
2.16.	Liria e medias .....	57
2.17.	Liria e tubimit.....	58
2.18.	Liria e asociimit.....	64
2.19.	E drejta për zgjedhje dhe pjesëmarrje .....	66
2.20.	E drejta e pronës.....	69
2.21.	E drejta për arsimin .....	72
2.21.1.	Edukimi parashkollor.....	72
2.21.2.	Arsimi parauniversitar .....	72
2.21.3.	Nxënësit me nevoja të veçanta.....	73
2.21.4.	Arsimi i lartë .....	75
2.21.5.	Sistemi arsimor për komunitetet.....	76
2.22.	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.....	77
2.22.1.	Puna e ndaluar e fëmijëve .....	78
2.22.2.	Rastet e shkeljes së të drejtës në punë apo për punë.....	79
2.23.	Të drejtat e fëmijëve në Kosovë.....	80
2.23.1.	Zbatimi i Strategjisë dhe Planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve.....	81
2.23.2.	E drejta e fëmijëve për shkollim .....	81
2.23.3.	Parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla.....	82
2.24.	Përgjegjësia për mjedisin jetësor.....	83
2.24.1.	Ndotja e ajrit .....	84
2.24.2.	Dëmtimi i burimeve dhe ndotja e ujit .....	85
2.24.3.	Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve.....	86
2.24.4.	Sigurimi i vendpunishteve – rrezik i drejtpërdrejtë për jetën .....	87
2.24.5.	Mosmbrojtja nga zhurma .....	88
2.24.6.	Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë .....	89
2.25.	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave.....	90
2.25.1.	Ankesat për lëndët gjyqësore të pazgjidhura për shkak të mosushtrimit të pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit.....	91

2.25.2.	Ankesat për lëndët gjyqësore të pazgjidhura dhe zbatimi i Strategjisë Shtetërore “Reduktimi i lëndëve të vjetra” .....	92
2.25.3.	Ankesat për lëndët gjyqësore panele të përziera me gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it.....	93
2.25.4.	Ankesat për lëndët gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme .....	95
2.25.5.	Ankesat e qytetarëve për lëndët gjyqësore ndaj gjykatave të rregullta.....	96
2.25.6.	Zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve .....	97
2.25.7.	Parashkrimi i lëndëve gjyqësore nga gjykata.....	98
2.25.8.	Mosekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore .....	99
2.25.9.	Rastet e tjera të ankesave të qytetarëve.....	99
2.25.10.	Raportet me rekomandime të Avokatit të Popullit.....	101
2.25.11.	Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë .....	101
2.25.12.	Zvarritjet e procedurave hetimore në rastet e lëndëve penale .....	102
2.25.13.	Kallëzimet penale të trashëguara nga viti paraprak .....	103
2.26.	Përdorimi i gjuhëve .....	106
2.26.1.	Përdorimi i gjuhëve në nivel komunal .....	106
2.26.2.	Përdorimi i gjuhëve zyrtare në shkolla .....	107
2.26.3.	Politika shtetërore për zbatimin e Ligjit për gjuhët .....	107
2.26.4.	Paraqitja e ankesave që kanë arritur në IAP lidhur me përdorimin e gjuhëve.....	108
2.26.5.	Përdorimi i gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare në komunat e Kosovës.....	109
2.27.	Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre .....	110
2.27.1.	Kthimi i të zhvendosurve dhe refugjatëve në Kosovë .....	111
2.27.2.	Ripranimi dhe riatdhesimi nga Evropa Perëndimore.....	113
2.27.3.	Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas .....	114
2.27.4.	Arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë .....	116
2.27.5.	Kultura .....	117
2.27.6.	Mediet .....	118
3.	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës .....	121
3.1.	Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese .....	122
3.2.	Rastet e ngritura në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit.....	123
3.3.	Amendamentet mbi ndryshimet kushtetuese të dërguara nga Gjykata Kushtetuese....	125
4.	Komunikimi me mediat .....	127
5.	Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit .....	129
5.1.	Bashkëpunimi me institucionet vendore .....	129
5.2.	Bashkëpunimi me OJQ-të vendore .....	130
5.3.	Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare .....	131

5.4.	Ngritja e kapaciteteve të IAP-së.....	133
6.	Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit.....	135
6.1.	Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve.....	135
6.2.	Aktivitetet e Grupit për Mosdiskriminim.....	137
7.	Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit.....	141
7.1.	Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës .....	141
7.1.1.	Rishikimi gjashtëmujor i buxhetit dhe implikimet në funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit.....	142
7.1.2.	Buxheti i domosdoshëm për kategorinë mallra dhe shërbime - qira .....	142
7.1.3.	Buxheti i domosdoshëm për paga dhe mëditje .....	142
7.1.4.	Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2012 .....	143
7.2.	Financimi nga donatorët.....	144
8.	Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2012.....	145
9.	Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit .....	161
9.1.	Gjendja e personelit.....	161
9.2.	Lëvizjet e personelit .....	162
10.	Shkurtesat.....	163



## Fjala e Avokatit të Popullit

*Shpërfaqja e punës njëvjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit përfshin të gjitha hallkat vepruese të tij dhe të paraqitura sipas një renditjeje logjike të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit: mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Paraqitja e gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të arkivuara në IAP, por edhe në informatat dhe dëshmitë e mbledhura nga burime të tjera primare dhe sekondare, është postulati kryesor që shpërfaq ky raport.*



*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*

*Drejtësia ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë individët pa asnjë dallim, në të gjithë territorin e shtetit, përbën bazën e shtetit ligjor. Fatkeqësisht në Kosovë këto shtylla qenësore të shtetit ligjor cenohen në vazhdimësi dhe vazhdojnë të jenë të brishta në secilën fushë të jetës.*

*Pasojë e drejtpërdrejtë e mosangazhimit të mekanizmave shtetërorë në fushën e zbatimit të drejtësisë, është besimi i humbur në shtetin ligjor. Ky mosbesim shtrihet që nga shtresat më të varfra dhe më të pafuqishme të shoqërisë, deri tek zyrtarët më të lartë të shtetit. Edhe më tutje, në Republikën e Kosovës, drejtësia e shtetit është përzgjedhëse. Në vend se ta sheshojë, ajo gjithnjë e më tepër po e thellon hendekun ndërmjet qytetarit të pambrojtur dhe shtetit, që për detyrë themelore dhe të vetme e ka ta mbrojë qytetarin.*

*Humbja e besimit në shtetin ligjor dhe mungesa e angazhimit të mekanizmave shtetërorë për përmirësimin e kësaj gjendjeje, dëshmon mungesën e një ndërgjegjësimi për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Kjo gjendje forcon pozitat e kastës shkelëse të të drejtave dhe lirive të njeriut, përballë qytetarit gjithnjë e më të pafuqishëm.*

*Mungesa e ndërgjegjësimit institucional për zbatimin e ligjit dhe për krijimin e shtetit ligjor, po shoqërohet me një tronditje që po prekë të gjitha poret e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës. Humbja gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë, po shkakton pasojat e tjera shumëfish më të mëdha dhe më të rrezikshme - tentimet gjithnjë e më të shumta të marrjes së ligjit në duar të veta nga ana e qytetarëve. Fatkeqësisht, kjo gjendje po shpie në anarki ligjore, e cila po kaplon të gjitha fushat e shoqërisë sonë. Ndërkaq, si pasojë vërejmë një përkeqësim në rritje të raporteve ndërshoqërore dhe ndërnjerëzore.*

*Avokati i Popullit, vazhdimisht ka dhënë dhe jep rekomandime për përmirësimin e lëshimeve dhe mangësive të vërejtura. Mirëpo, fatkeqësisht edhe më tutje është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore, një pjesë e madhe e të cilave mjerisht, nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për të përmirësuar gjendjen.*

*Moszbatimi dhe injorimi i këtyre rekomandimeve, pikërisht nga institucionet të cilat janë të thirrura të zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për të zgjidhur problemet e tyre, është tejet shqetësues.*

*Institucioni i Avokatit të Popullit, me të gjeturat e shkeljeve të ndryshme dhe rekomandimet për mënjanimin e tyre, me komunikimin e pandërprerë me institucionet përkatëse dhe ndërmjetësimet midis tyre dhe qytetarëve, në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Madje, këtë vazhdon ta bëjë me gjithë neglizhencën e institucioneve për të krijuar një klimë më të mirë për drejtat dhe liritë e njeriut.*

*Jashtëzakonisht shqetësuese është tendenca e institucioneve të ndryshme shtetërore për minimizimin e rolit të institucioneve të pavarura kombëtare përgjithësisht: qoftë duke shpërfillur të gjeturat e tyre, qoftë duke mos zbatuar rekomandimet e tyre, apo qoftë edhe duke bërë përpjekje kundërligjore për cenimin e pavarësisë së tyre kushtetuese.*

*Ky fat po e përcjellë edhe Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili angazhohet për krijimin e një klime në të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës do të kishin mundësi t'i zgjidhnin problemet e tyre, bazuar në kushtetutë dhe në ligj. Por, fatkeqësisht, me gjithë arritjen e disa rezultateve modeste, shumëçka mbetet në sfondin e të dëshiruarës.*

*IAP, me gjithë pengesat e shumta, ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe personave të tjerë në nevojë. Përveç, mundësisë për paraqitjen e ankesave me të gjitha format e komunikimit, drejtpërdrejt në zyrat e Avokatit të Popullit, çdo ditë pune, me postë, me postë elektronike, përmes familjarëve apo avokatit dhe me telefon, IAP ka organizuar Ditët e Hapura, duke ofruar takime të drejtpërdrejta një herë në muaj, për të gjithë personat në nevojë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, kryesisht në ndërtesat e kuvendeve komunale. Po ashtu, me qëllim të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve dhe të gjithë ankuesve, Avokati i Popullit, çdo kërkesë të drejtuar atij, i përgjigjet me shkrim.*

*Megjithëse të gjitha këto veprime përcillen me një ngarkesë dukshëm më të madhe për bashkëpunëtorët e IAP-së, satisfaksion për IAP-në vazhdon të mbetet rritja e besimit të qytetarëve dhe e disa institucioneve shtetërore në punën e IAP-së.*

*Nga 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2012, në IAP janë paraqitur 1670 raste, në selinë e tij në Prishtinë dhe në zyrat rajonale, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. Prej tyre në 377 raste këta persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit, gjatë "Ditëve të hapura" të mbajtura në periudhën raportuese.*

*Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht lidhur me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, barazinë para ligjit etj.*

*Fatkeqësisht, një numër i ankesave ka të bëjë edhe me vendimet e padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet të vënë drejtësinë në vend. Me gjithë ndërmarrjen e veprimeve për luftimin e kësaj dukurie nga vetë gjyqësori, bazuar në të dhënat e IAP-së, në përgjithësi, në këtë drejtim, nuk kemi ndonjë përmirësim në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese.*

*Një numër i konsiderueshëm i ankesave, gjithnjë në rritje, kanë të bëjnë me mosrregullimin ligjor të pensioneve, të sigurimit shëndetësor, mbrojtjen jo të duhur shëndetësore, mungesën e barnave nga e ashtuquajtura lista esenciale në institucionet publike shëndetësore.*

*Një fushë e ankesave që përcillet me pasoja serioze për marrëdhëniet ndërnjerëzore, ku vërehet edhe dështimi më serioz i sistemit të drejtësisë, qoftë për shkak të zvarritjeve të mëdha, qoftë për shkak të moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, apo qoftë edhe të falsifikimeve të dëshmuara, është cenimi i të drejtës së pronës. Në këto raste, kur drejtësia shtetërore i mbështet njerëzit për murin e padrejtësisë, ata marrin drejtësinë në duart e tyre.*

*Një fushë tjetër ku vërehet një tendencë rritjeje të numrit të ankesave, është dështimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor. Qoftë për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjes në këtë fushë, qoftë për shkak të vetëdijesimit të një numri të madh të qytetarëve për gjendjen e patolerueshme, kemi një reagim gjithnjë e më të shpeshtë të qytetarëve, që përbën një shqetësim të qytetarit gjithnjë e më të ndërgjegjësuar dhe kurajoz.*

*Një shqetësim për Avokatin e Popullit mbetet gjendja e sigurisë në Republikën e Kosovës. Një rritje të numrit të rasteve të vrasjeve me armë është e evidente.*

*Liria e lëvizjes në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, si dhe në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan vazhdon të mbetet gati tërësisht e kufizuar për qytetarët, sidomos për personat e përkatësisë etnike jo-serbe, por dhe për autoritetet publike të Republikës së Kosovës si dhe për institucionet ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për sigurinë fizike.*

*Një gjendje shumë e rëndë sa i përket lirisë së lëvizjes vërehet edhe në trafikun rrugor. Në qendrat urbane, përveç zënies së trotuareve nga parkimi i pandërgjegjshëm i automjeteve, vërehet edhe një papërgjegjësi dhe kaos i patolerueshëm në ngasjen e automjeteve si në qendrat urbane ashtu edhe në rrugë të hapura. Përveç rrezikimit të drejtpërdrejtë të jetës së njerëzve nga aksidentet fatale, shpeshherë kufizohet liria e lëvizjes së këmbësorëve, sidomos e fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.*

*Gjendja e rëndë ekonomike në vend, prek shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejtë në kualitetin e tyre jetësor. Shqetësuese në këtë drejtim është mungesa e perspektivës për të rinjtë, si dhe gjendja e pensionistëve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit*

sërisht kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor, si dhe Ligjit për sigurimin invalidor e pensional. Po ashtu, ripërsërit kërkesën për përfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si një ndër instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet edhe izolimi strukturor nga jeta publike dhe si pasojë vetizolimi shoqëror i komuniteteve ashkali, egjiptas dhe rom. Përprjekjet e deritanishme të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe vetë Institucionin e Avokatit të Popullit, për integrimin e mirëfilltë të këtyre komuniteteve në jetën publike dhe shoqërore, përveç disa përmirësimeve modeste në fushën e banimit dhe të arsimit, nuk kanë dhënë rezultate të lakmueshme.

Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjitha rastet e veçanta kur ka konstatuar shkelje të të drejtave, në raportet e tij vjetore dhe të veçanta, ka bërë rekomandimet e duhura për të gjitha autoritet publike – ministritë, komunat si dhe agjencitë e tjera publike përgjegjëse. Por, fatkeqësisht, në këtë drejtim kemi të bëjmë me një dështim të institucioneve publike. Deri më tani, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë informatë apo njoftim nga ndonjë institucion, nëse janë zbatuar rekomandimet e tij sistemore. Një praktikë e tillë vazhdon të përcillet nga viti në vit dhe si e tillë është mjaft shqetësuese.

Meqenëse zbatimi i ligjit është premisa kryesore për funksionim e shtetit ligjor, në Republikën e Kosovës, disave disa përpjekjeve modeste, moszbatimi i ligjit është plaga më e rëndë institucionale. Ky është indikator kryesor për humbjen e besimit të qytetarit në institucionet shtetërore, të cilat zbatimin e ligjit e kanë detyrim ligjor dhe kushtetues. Ndërkaq, kjo humbje e besimit Avokatin e Popullit e vë në pozicionin drejt të cilit shtrohen kërkesa për të vënë drejtësinë në vend. Kjo ndodhë pikërisht për shkak të moszbatimit të ligjit në të shumtën e rasteve, e edhe të shkeljes së ligjit në raste të veçanta, nga pjesa dërrmuese e institucioneve shtetërore.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të evidentojë dhe të nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për të forcuar rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit. Por, me gjithë këto veprime dhe përpjekje për përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, duhet theksuar qartë se Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi. Janë institucionet shtetërore – gjykatat - që ndajnë dhe zbatojnë drejtësinë. Janë pikërisht institucionet shtetërore ato të cilat nuk do të duhej të shkelnin mbi parimet e drejtësisë ligjore, sepse po qe se shkelin mbi to, atëherë kanë dëmtuar thelbin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kjo nuk duhet lejuar!

Shpresa për një të ardhme më të mirë, edhe pse e fashitur dhe e nëpërkëmbur, nuk ka humbur ende krejtësisht. Ka edhe përpjekje shpresëdhënëse për vendosjen e rendit dhe të ligjit. Por, Avokati i Popullit, përveç përkushtimit dhe përgjegjësisë individuale e shoqërore, kërkon

*sidomos përkushtim dhe përgjegjësi institucionale dhe ligjore të autoriteteve publike për veprimet apo mosveprimet e tyre.*

*Duke qenë mbikëqyrës i zbatimit kushtetues dhe ligjor i të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit njëkohësisht është edhe ndriçues i rasteve kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, si dhe këshilltar qortues i institucioneve publike, kur ato shprehen mospërfillëse në zbatimin kushtetues dhe ligjor të të drejtave dhe lirive të tyre.*

*Avokati i Popullit shpreson por edhe kërkon me ngulm, që të gjitha autoritetet publike dhe organizatat që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, të marrin në konsideratë të gjeturat e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e rekomandimeve, të bëra qoftë në raportin vjetor apo edhe në raportet e veçanta.*

*Avokat i Popullit vazhdon t'i mbetet besnik parimit se qeverisja e mirë është e drejtë e qytetarëve dhe obligim i autoriteteve të zgjedhura publike, prandaj vazhdon të mbetet i përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për një qeverisje të mirë.*



# 1. Hyrje

## 1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 132-135, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) u përcaktua si kategori kushtetuese. Avokati i Popullit mbikëqyr, mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, por edhe të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

## 1.2. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit kanë përcaktuar kompetencat e Avokatit të Popullit për të marrë dhe për të hetuar ankesa nga çdo person i Kosovës, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Të gjitha organet, institucionet dhe autoritetet tjera që ushtrojnë pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në punën e vet IAP udhëhiqet nga parimet e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe aktet tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë ndërmjetësimin dhe pajtimin, por mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit.

Avokati i Popullit nuk ndërhyr në rastet që zhvillohen në gjykata, përveç kur ka zvarritje të paarsyeshme apo keqpërdorim të dukshëm të pushtetit. Ai po ashtu nuk merret me hetimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privatë. Nga ana

tjetër, ai mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në pajtim me kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, por edhe të angazhohet për zgjedhjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe të njoftojë Kuvendin, Qeverinë dhe institucionet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përpilojë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ndër objektivat kryesore të Avokatit të Popullit është krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, e cila kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike karshi qytetarëve dhe forcim e zhvillim të sundimit të ligjit. E tëra kjo vlen edhe për sistemin gjyqësor dhe institucionet e organet e tjera të pushtetit.

Avokati i Popullit angazhohet për përmirësimin e imazhit të administratës publike, sistemit gjyqësor dhe të institucioneve dhe organeve tjera të pushtetit. Ky angazhim bën që qytetarët të kuptojnë se ata mund të llogarisin në këtë institucion dhe se mund t'i parashtrajnë ankesat e tyre kundër administratës, sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me dhënien e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore. Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme të menjëhershme.

Nëse letrat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen, Kuvendit të Kosovës, si dhe organizatave të tjera relevante.

Tash sa vite, në IAP, me qëllim të mbulimit të fushave që përfshijnë çështje të veçanta të disa grupeve të njerëzve, të drejtat e të cilëve konsiderohen më të cenueshme në Kosovë,



funksionojnë Njësia për të drejtat e fëmijëve, Njësia për barazi gjinore dhe Grupi për mosdiskriminim.

Pas zgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit, janë krijuar departamente të veçanta sipas fushave të caktuara, të cilat udhëhiqen nga zëvendësit. Në kuadër të këtyre departamenteve funksionojnë njësi të specializuara. Në kuadër të departamentit kundër diskriminimit funksionojnë këto njësi: për të drejtat e fëmijëve, për barazi gjinore (përfshirë trafikimin me qenie njerëzore dhe dhunën), për personat me aftësi të kufizuara, për të drejtat e komuniteteve, çështjet sociale dhe njësi për të drejtat e personave LGBT.

Departamenti i Legjislativit përbëhet nga: Njësia për koordinim e punës lidhur me Kuvendin e Republikës së Kosovës, Njësia për koordinimin e ngritjes së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Njësia për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore, Njësia për hetimin e ankesave për qasjen në dokumente publike dhe Njësia për raportimin vjetor e periodik.

Departamenti i Ekzekutivit përfshinë njësitë: hetimi i ankesave kundër presidencës, hetimi i ankesave kundër qeverisë, hetimi i ankesave kundër agjencive të pavarura, hetimi i ankesave kundër ndërmarrjeve publike, mbrojtja e mjedisit dhe Mekanizmi Nacional për Parandalimin e Torturës, ndërkohë që planifikohet edhe krijimi i njësisë Biznesi dhe të drejtat e njeriut.

Njësitë në Departamentin e Gjyqësorit janë: hetimi i ankesave kundër gjyqësorit, hetimi i ankesave kundër prokurorisë, hetimi i ankesave kundër Këshillit Gjyqësor, hetimi i ankesave kundër Këshillit Prokurorial dhe hetimi i ankesave kundër Institutit Gjyqësor. Ndërsa, në Departamentin e marrëdhënieve me publikun veprojnë këto njësi: bashkëpunimi me shoqërinë civile, bashkëpunimi me organizatat e huaja në Kosovë, bashkëpunimi me donatorë, materialet dhe publikimet si dhe konferencat dhe trajnimet.

### **1.3. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit**

Institucioni i Avokatit të Popullit çdo ditë pune pranon ankesa nga qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm.

Me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP ka themeluar zyra rajonale në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe në Graçanicë. Po ashtu Zyra Rajonale e IAP-së në Mitrovicë ka themeluar edhe nën-zyrën e saj në veri të qytetit. Zyrat e IAP-së përbëhen nga një staf profesional për t'i shërbyer qytetarëve, për t'u përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre, si dhe për t'i mbrojtur të drejtat, për të cilat ata pretendojnë se u janë shkelur. IAP planifikon hapjen e zyrave tjera rajonale edhe në Ferizaj e Gjakovë.

Ankesat e qytetarëve në zyrat e IAP-së pranohen çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:30 - 16.00. Për raste urgjente, qytetarët mund të paraqiten edhe jashtë orarit të punës.

Formë tjetër e qasjes më të afërt ndaj qytetarëve është edhe organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë (dy herë në muaj) dhe në komunat e tjera të Kosovës (nga një herë në muaj). Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e vendeve përkatëse për ditët e hapura me anë të publikimit të datave nëpër komunat përkatëse, nëpërmjet mediave lokale dhe nëpërmjet faqes zyrtare të IAP-së në internet.

Një qasje tjetër e lehtë në IAP është edhe me postë elektronike, e cila të shumtën e rasteve përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Ekziston edhe linja telefonike falas në Zyrën Qendrore të IAP-së për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Duke pasur parasysh se të gjithë personat me liri të kufizuar të lëvizjes dhe veprimit kanë qasje të kufizuar në institucione, zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet e ndalimit të personave në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme dhe të qasshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Praktika e këtillë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në qendra të paraburgimit, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në Institucionin e Avokatit të Popullit. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e Institucionit.

## 2. Të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës

### 2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Obligim i çdo shteti, aq më tepër i atyre që pretendojnë të jenë demokratike, është mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Prandaj, shtetet duhet t'iu përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, çka nënkupton edhe ratifikimin dhe zbatimin e tyre.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë përfshirë disa nga marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Në rast konflikti, ato kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre instrumenteve ndërkombëtare: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.<sup>1</sup>

Rëndësia e veçantë e këtyre instrumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut qëndron edhe në faktin se ato do të mund të zbatohen drejtpërdrejt edhe në raste kur ka mangësi apo zbrazëti të shprehura në legjislacionin e brendshëm.

Edhe gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vërejtur shkelje serioze të këtyre instrumenteve në disa raste të caktuara. Në bazë të ankesave të paraqitura në IAP vërehet se ato kryesisht kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt gjyqësor.<sup>2</sup> Ndër çështjet që tash e sa vite rëndojnë mbi gjyqësorin në Kosovë janë: mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjidhura, vonesa në trajtimin e lëndëve të reja dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë. Në këtë mënyrë qytetarëve të Kosovës po u cenohet e drejta për proces të drejtë, të rregullt dhe të paanshëm.

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

<sup>2</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), neni 6, paragrafi 1. "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."

Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krahas funksionalizimit të Shërbimit të Noterisë si dhe fillimi i aplikimit të ndërmjetësimit, krahas riorganizimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës, që do të startojë nga 1 janari i vitit 2013 me fillimin e zbatimit të plotë të Ligjit për Gjykatat, pritet të ndikojë në ngritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të punës në gjyqësor, përkatësisht në zgjidhjen e lëndëve në gjykata.

Për të mundësuar realizimin e monitorimit më të plotë, efektiv dhe efikas të institucioneve ku mbahen personat e ndaluar, Avokati i Popullit e sheh të nevojshme zbatimin e dispozitave të Protokollit Opcional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Në këtë aspekt kanë vijuar aktivitetet e grupit punues.<sup>3</sup> Ky grup punues po vepron si pararendës i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, krijimi i të cilit parashihet me këtë protokoll.<sup>4</sup> Gjithsesi, ky mekanizëm do të mundësojë qasjen më të mirë në institucionet e ndalimit dhe mbrojtjen më efektive dhe efikase të të drejtave të njeriut të personave të ndaluar. Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Protokollit, por me Kushtetutë ka për obligim të zbatojë drejtpërdrejtë Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, aq më parë që zbatimi i Protokollit Opcional është një nga veprimet përgatitore të Kosovës për integritet evropian.

Në këtë raport, Avokati i Popullit, përsëri shpreh shqetësimin e tij për mospërfshirjen në Kushtetutën e Kosovës edhe të Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si dhe të Kartës Sociale Evropiane. Disa nga të drejtat që përmban kjo Konventë, siç janë: e drejta për strehim adekuat, e drejta në punë dhe ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, e drejta për sigurim shëndetësor dhe një sërë të drejtash tjera sociale dhe ekonomike, vazhdojnë të mos kenë mbrojtjen e duhur ligjore në Kosovë. Përfshirja e kësaj Konvente, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është e domosdoshme dhe do të ishte një garanci shtesë për qytetarët e Kosovës dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale.

Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon që, në vazhden e përpjekjeve për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në Kushtetutën e Kosovës të përfshihen Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si dhe Karta Sociale Evropiane, përkatësisht që Kushtetuta të garantoj zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, Avokati i Popullit rekomandon Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës që në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës të përfshihen të gjitha instrumentet e tjera relevante ndërkombëtare universale dhe regjionale, sidomos ato evropiane për të drejtat e njeriut, të cilat nuk janë përfshirë deri më tani në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

---

<sup>3</sup> Në maj të vitit 2011, si fryt i bashkëpunimit të IAP-së me disa OJQ vendore (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut - KMDLNI dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT) me të cilat është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit, është krijuar Grupi Punues i përbashkët.

<sup>4</sup> *Protokollin Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese*, neni 3 „Çdo Shtet Palë krijon, projektton ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruës“.

## 2.2. Dinjiteti i njeriut

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, mbron *dinjitetin e njeriut*, duke e përcaktuar atë si të pacenueshëm dhe bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.<sup>5</sup> Të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i tij janë të pandashme nga njëra tjetra.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në preambulën e saj pohon se “*Dinjiteti i lindur i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, i drejtësisë dhe i paqes në botë*”,<sup>6</sup> duke qartësuar lidhshmërinë embrionale midis të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të njeriut.

Dinjiteti i njeriut është vlera e brendshme dhe njëkohësisht e drejtë sociale. Dinjiteti i njeriut i takon çdonjërit, madje edhe të pa lindurit edhe të vdekurit. Respektimi i tij obligon shtetin të heqë dorë nga çdo gjë që rrezikon atë. Shteti duhet ta respektojë njeriun si person, nuk guxon t’ a bëjë atë objekt posedues të veprimit të shtetit dhe nuk guxon ta keqpërdorë për asnjë qëllim. Mbrojtja e dinjitetit të njeriut do të thotë, se shteti ka për obligim të ndërmarrë çdo gjë për t’u kundërvënë cenimit të dinjitetit të njeriut.

Shkelja e të drejtave të njeriut dhe cenimi i dinjitetit ndodh në situata kryesisht të pafavorshme për individin, kur ai është i pafuqishëm që t’i kërkojë apo të luftojë për to, qoftë për shkak rrethanave arbitrare apo shoqërore, për shkak të pa aftësisë mendore dhe aftësisë së kufizuar në përgjithësi. Avokati i Popullit, vëmendje të posaçme iu ka kushtuar personave me sëmundje mendore në Republikën e Kosovës. Me qëllim të parandalimit të shkeljes së dinjitetit dhe të drejtave të njeriut në situata të tilla, është i përkushtuar të ketë qasje sa më aktive në këtë fushë. Në vizitat periodike në qendrat e shëndetit mendor në Shtime dhe në qendrat tjera të shëndetit mendor nëpër qytete të Kosovës, gjatë këtij viti në të gjitha këto qendra janë vendosur kutitë e ankesave, për t’u siguruar nëse në ato vende mbrohet dhe respektohet dinjiteti i njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit po ashtu ka trajtuar ankesa për shkeljet e pohuara të dinjitetit të njeriut, ndër to është rasti i disa të punësuarve në Ansamblin “Shota”.<sup>7</sup> Punëtorët në vazhdimësi pa dijen e tyre janë vëzhguar me kamerat e vendosura nga drejtori në hapësirat e punës dhe vendet ku rreptësisht është i ndaluar vëzhgimi me kamera, dhe me këto veprime cenohet dinjiteti i njeriut. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, me anë të takimeve me përfaqësuesit e ansamblit dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka kërkuar të ndërmerren masa ndaj personave përgjegjës të këtij institucioni në mënyrë që në të ardhmen mos të përsëriten këto vepra.

<sup>5</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 23.

<sup>6</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Preambula.

<sup>7</sup> IAP, Rasti A. nr. 184/2012.

Avokati i Popullit edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me vizitat e rregullta mujore në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria. Trajtimi i tyre në këto institucione, mbrojtja nga keqtrajtimi, është në një vijë të drejtë me mbrojtjen e dinjitetit të njeriut.

Përfaqësuesit e IAP dhe vetë Avokati i Popullit po ashtu ka pasur takime të shpeshta me përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, si dhe me qytetarët në pjesën veriore të Kosovës. Ndër të tjera, edhe për shkak të angazhimit të vazhdueshëm të Avokatit të Popullit, pas mbylljes së kampeve në Osterode dhe në Çesmin Lug, edhe kampi në Leposaviq është në mbyllje e sipër sepse ka filluar ndërtimi i disa shtëpive në pjesën jugore të Mitrovicës. Shumë familje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas mendojnë të kthehen në Mitrovicë, dhe të fillojë vendosja e tyre nëpër shtëpitë e ndërtuara enkas për ta.

Megjithatë, sfidë e përhershme me cilën ende ballafaqohen institucionet e Republikës së Kosovës është mbrojtja e dinjitetit të njeriut, si e drejtë elementare dhe me karakter të përgjithshëm. Avokati i Popullit konsideron se është e domosdoshme të ngrihet përgjegjshmëria autoriteteve publike, që e përbën frontin e parë të mbrojtjes së ligjit dhe e cila në rend të parë duhet të jetë në mbrojtje të kësaj të drejte themelore.

### **2.3. Barazia gjinore**

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit është dhe barazi e së drejtës se tyre në mbrojtjen nga diskriminimi pa marre parasysh përkatësinë gjinore, gjuhësore, religjioze, etnike, orientimin seksual apo statusin ekonomik-social. Në këtë kuptim, barazia gjinore definohet si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë e cila ofron mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt, me rastin e pjesëmarrjes në jetën politike, ekonomik-social, kulture dhe fusha të tjera të jetës shoqërore.<sup>8</sup>

Barazia gjinore është po ashtu e garantuar edhe me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas (CEDAW), si një nga instrumentet drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë. Kjo konventë definon diskriminimin e grave si "Çfarëdo dallimi, përjashtimi dhe kufizimi të kryer në bazë të gjinisë, që ka ndikim apo ka synim të cenojë apo pamundësojë njohjen, arritjen apo zbatimin nga ana e gruas, pa marre parasysh gjendjen e saj martesore, të të drejtave dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulture, civile dhe në çdo fushe tjetër."<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7.2 "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulture dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore."

<sup>9</sup> CEDAW, neni 1 të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), e miratuar në vitin 1980 dhe hyrë në fuqi në vitin 1981. "Për qëllimet e kësaj Konvente, termi „diskriminim ndaj grave” nënkupton çdo dallim, përjashtim, ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtoj ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën

Kërkesë e vazhdueshme e Avokatit të Popullit, ashtu sikurse me rekomandimet për vitin 2011, është ndryshimi i Ligjit për Barazinë Gjinore,<sup>10</sup> ku në mënyre të qartë dhe shprehimisht do të përcaktohej kompetenca gjyqësore apo administrative e organit kompetent të përcaktuar, në rastet kur ndonjë individ i shkelen të drejtat e garantuara me ligj, për të vetmen arsye se i takon gjinisë së caktuar. Ky ndryshim është i domosdoshëm, në mënyre që ky ligj të mos mbetet edhe më tej vetëm një shkronjë e vdekur në letër dhe në mënyrë që të sigurojë mos diskriminimin në bazë të gjinisë.

### **2.3.1. Vendimmarrja dhe e drejta në punë**

Roli i gruas në tregun e punës ka domethënie të madhe nga aspekti i barazisë gjinore. Eliminimi i pabarazisë që shpërfaqet në fushën e përfaqësimit, ndërmjet femrës dhe mashkullit, është evituar pjesërisht me futjen e kuotës në Kuvendin e Kosovës. Kjo reflektohet pozitivisht në pozitën e gruas, prandaj deri në një zgjidhje tjetër më të favorshme, kuota edhe më tej duhet të ruhet si model i barazisë së gjinore.

Por, një dobësi e theksuar sistemore është pjesëmarrja joadekuate e grave në organet udhëheqëse.<sup>11</sup> Gratë vazhdojnë të mbeten vetëm simbolikisht të përfaqësuara në strukturat udhëheqëse. Ende në Kosovë mbisundojnë stereotipat, sipas të cilëve vetëm mashkulli është i aftë të jetë i zgjedhur në pozitat udhëheqëse. Kjo vlen sidomos për nivelin komunal të udhëheqjes. Kuota, si model afirmativ i barazisë gjinore duhet të jetë e mbrojtur me ligj dhe të jetë e zbatueshme. Kjo do të ndihmonte që të krijohet një kulturë të pjesëmarrjes së grave në pozitat udhëheqëse, e cila pas një periudhe të caktuar kohore do të zëvendësohej me konkurrencën reale.

Kriza e rëndë ekonomike reflektohet në mënyre të ndryshme tek femrat dhe meshkujt. Edhe pse shoqëria në tërësi është e varfër, kriza në mënyrë jo të barabartë ndikon në përkeqësimin e pozitës së gruas në tregun e punës. Kjo shprehet qartazi në numrin në rritje të grave të papunë, në largimin më të madh nga puna dhe në cenimin e fshehtë, e herë-herë edhe të hapur, të të drejtave të lehonave.<sup>12</sup> Gratë përbëjnë shumicën e atyre të cilët presin për punë më gjatë se një vit. Edhe parimi i pagës së barabartë për punën e barabartë nuk po zbatohet sipas kuptimit ligjor, sidomos në ekonominë private.

---

e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civilizuese në çdo fushë tjetër.

<sup>10</sup> Ligji për barazinë gjinore, nr. 2004/2, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 19 shkurt 2004, Raporti i 11 vjetor i IAP-së, Prishtinë, 2012, f. 24.

<sup>11</sup> Lidhur me këtë është regjistruar rasti në IAP, A. nr. 550/2012.

<sup>12</sup> IAP, rasti A. nr. 313/2012.

Edhe situata e pafavorshme financiare në shoqëri ndikon në kualitetin e mbrojtjes shëndetësore të grave, para së gjithash të shëndetit riprodhues.<sup>13</sup> Diskriminimi në fushën e punës fillon nga momenti i shpalljes së konkursit për punë, ku gjinia përmendet si një nga kriteret kryesore për punësim.

### **2.3.2. E drejta e pronës**

Diskriminimi dhe shkelja e parimit të barazisë gjinore më së shpeshti shprehet në fushën e të drejtave pronësore. Gratë në përgjithësi, në përqindje shumë të vogël, janë pronare të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë, vetëm rreth 7 %. Shumica dërmuese e grave është e ngarkuar me punën e pa pranuar dhe pa pagesë, të cilën e bëjnë në shtëpi.

Gratë e moshuara, nënat vetushqyese, amviset, gratë e komuniteteve ashkali, egjiptase dhe rome, gratë e paarsimuar, të sëmura dhe gratë me invaliditet, si dhe gratë viktime të dhunës, i takojnë kategorisë më të cenueshme të popullsisë.

Për sa i përket legjislacionit vendor, gratë janë të barabarta me meshkujt sipas Ligjit për Trashëgimi.<sup>14</sup> Ky ligj, në parim, pjesërisht është në përputhje me normat ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë. Por, kur kihet parasysh praktika dhe tradita e shoqërisë Kosovare, ky ligj zbatohet shumë pak, për të mos thënë në mënyrë të papërfillshme. Është i madh numri i grave të cilat keqtrajtohen në mënyra të ndryshme, e madje edhe përjashtohen (leçiten) nga familja, nga vetë anëtarët e familjes, në rast se kërkojnë apo dëshirojnë të realizojnë të drejtën e tyre ligjore në pronësi.<sup>15</sup>

### **2.3.3. Mbrojtja shëndetësore**

Ndër rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit në raportet vjetore 2010 dhe 2011 ishte dhe vazhdon të mbetet miratimi i Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore dhe Sigurinë Sociale.<sup>16</sup> Kosova është i vetmi vend në Evropë i cili nuk ka një ligj të tillë. Mbrojtja shëndetësore dhe siguria sociale, sidomos e grave, janë të drejta të mbrojtura dhe të garantuara me Kushtetutë dhe

---

<sup>13</sup> IAP, A. nr. 44/2012. Ankesa kishte të bënte me shkëputjen e kontratës së punës nga një organizatë joqeveritare pas lindjes. Pas dështimit të përpjekjes për ndërmjetësim nga Avokati i Popullit, ankuesja u udhëzua të shfrytëzojë mjetet ligjore, përkatësisht të parashtrijë ankesë në Inspektoratin e Punës.

<sup>14</sup> Ligji nr. 2004/26, Ligji për trashëgiminë, neni 3.

<sup>15</sup> IAP, A .nr. 316/2011. Kjo është një ankesë e ripërsëritur për monitorim gjyqësor në vitin 2012. Parashtruesja e ankesës ka përsëritur të njëjtën ankesë, sepse xhaxhai i saj e pamundësoi që të bëhet pronare e shtëpisë të cilën babai i saj, derisa ishte gjallë e kishte ndërtuar në të njëjtin oborr me xhaxhain. Procedura është duke u zhvilluar në gjykatë, ndërsa IAP është duke e monitoruar rastin.

<sup>16</sup> IAP, Raporti i njëmbëdhjetë vjetor, Barazia gjinore, f. 26.



me të gjitha instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë. Pa marrë parasysh të gjitha arsyetimet e mundshme të Qeverisë së Kosovës, mosekzistimi i këtij ligji përbën ndër shkeljet më serioze të të drejtave të njeriut. Mos ekzistimi i këtij ligji rëndon veçanërisht gjendjen shëndetësore të gruas dhe të fëmijës në Kosovë.

#### **2.3.4. E drejta për arsimim**

Diskriminimi i gruas në fushën e arsimit reflektohet edhe në politikat e arsimit, përmbajtjen e programeve shkollore, librat shkollorë, si dhe në statusin profesional të gruas.

Edhe pse ligji nuk bën dallim për sa i përket arsimit në bazë të gjinisë,<sup>17</sup> dukuri shqetësuese vazhdon të mbetet braktisja e shkollës nga ana e vajzave. Nga kjo dukuri më së shpeshti janë të cenuara vajzat në disa zona rurale në Kosovë si dhe vajzat nga pakicat etnike ashkali, rom dhe egjiptas. Arsyet më të shpeshta të braktisjes janë varfëria, mungesa e sigurisë si dhe martesat e hershme e vajzave, jo rrallëherë edhe nën moshën e lejuar me ligj.

Një problem tjetër shqetësues që vazhdon për disa vite, është edhe çështja e bartjes së shamisë si simbol fetar në arsimin para universitar të vajzave myslimane. Në Kosovë ende nuk ekziston një praktikë e përgjithshme për trajtimin e kësaj çështje të ndjeshme. Qeveria e Kosovës dhe në veçanti Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), edhe pas disa vitesh të ballafaqimit me këtë problem, nuk ka arritur të konsolidojë aspektin ligjor për trajtimin unik të kësaj dukurie në gjithë territorin e Kosovës. Laramania e trajtimit të këtyre vajzave, moslejimit të përcjelljes së mësimin, varësisht nga komuna dhe shkolla përkatëse, përbën një diskriminim të palejueshëm dhe të pajustificueshëm në një shtet ligjor.

Në të gjitha rastet, ankuese/it janë udhëzuar të shfrytëzojnë mjetet juridike pranë institucioneve kompetente administrative dhe gjyqësore<sup>18</sup>. Përfaqësuesit e institucioneve arsimore vazhdimisht thirren në faktin se Kosova është shtet laik dhe se legjislacioni në fuqi përbën bazën ligjore që ndalon bartjen e simboleve fetare në shkollat publike. Në anën tjetër, prindërit e këtyre vajzave, vajzat por edhe disa organizata joqeveritare fetare, bartjen e shamisë edhe në shkollat publike nuk e konsiderojnë si bartje e simboleve fetare, por e konsiderojnë si obligim fetar, për të cilin nuk mund të diskutohet.

Avokati i Popullit konsideron dhe rekomandon Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës që urgjentisht të rregullojnë bazën ligjore të qartë për çështjen e bartjes së simboleve fetare, në këtë rast të shamisë, në arsimin publik para universitar në Kosovë. Kjo duhet të jetë një zgjidhje fatlume e atillë që këtyre vajzave do t'u mundësonte vijimin e mësimin dhe të shkollimit në përgjithësi, pa cenuar karakterin laik të shtetit të Kosovës.

---

<sup>17</sup> Ligji nr. 2004/3 Ligji Kundër Diskriminimit, neni 2.

<sup>18</sup> Rastet të regjistruara në IAP A. nr. 421/2012 dhe A. nr. 155/2012.

### 2.3.5. Dhuna në familje

Dhuna në familje është një problem kompleks i shoqërisë kosovare që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas dhe ajo mund të jetë fizike, psikike, ekonomike dhe etj.<sup>19</sup>

Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, të cila e plotëson CEDAW-in, jep një përkufizim për dhunën kundër grave, ku në nenin e parë thotë se “Çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton në dëmtim fizik, seksual, psikologjik apo vuajtje për gratë, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, detyrimin apo privim i arbitrar të lirisë, të cilat ndodhin në jetën private dhe atë publike”.

Një nga format më të zakonshme të dhunës ndaj grave është ajo e ushtruar nga bashkëshorti i tyre. Fakti që gratë janë shpesh të përfshira emocionalisht dhe të varura ekonomikisht ndaj atyre që i viktimizojnë ka ndikime të mëdha si në dinamikën e abuzimit dhe në qasjet për ta trajtuar atë.

Në shumicën e rasteve dhuna në familje trajtohet si problem i brendshëm i një familjeje, i cili nuk guxon të dalë në shesh. Në shumicën e rasteve të dhunës në familje ndodhë që raportimi i saj te organi kompetent e tërheq pas vetës hakmarrjen e kryesit ose ndodhë që gruaja bëhet objekt i gjykimit moral të rrethit në të cilin jeton.

Sipas Raportit të Policisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012<sup>20</sup> për rastet të dhunës në familje në komunën e Prishtinës për vitin 2012 janë regjistruar 306 raste, komuna e Gjilanit ka pasur 94 raste, në komunën e Ferizajit janë shënuar 120 raste, komuna e Pejës 191, komuna e Prizrenit 139 raste dhe në komunën e Mitrovicës janë regjistruar 182 raste.

### 2.3.6. Gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

Për të gjitha viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe për familjet e tyre lufta ende nuk ka përfunduar, për shkak mosnjohjes ligjore e kësaj kategorie. Dhunimi është armë e luftës dhe kjo është e përcaktuar edhe me konventa ndërkombëtare. Krimet e luftës të kryera ndaj grave janë çështje të dhimbshme dhe kërkohet një mirëkuptim shoqëror që këto trauma të tejkalohen dhe të raportohen rastet. Në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2012, është polemizuar shumë rreth përfshirjes së të gjitha viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në vitin 1999 në një kategori të njëjtë me viktimat civile të luftës, në kuadër të Ligjit për veteranet e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por rekomandimet u hidhen poshtë. Gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës, duhet të përfshihen në ligj, qoftë me ligj veçantë, qoftë në kuadër të ndonjë ligji të tjetër i cili do të rregullojë statusin e viktimave dhe emërtimin i tyre si viktima civile të luftës. Gjithashtu, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë i duhet edhe mbështetje,

<sup>19</sup> Rasti i regjistruar në IAP A. nr. 326/2012.

<sup>20</sup> Raporti i Policisë së Republikës së Kosovës për rastet të dhunës në familje në Kosovë për vitin 2012.

jo vetëm nga ana ligjore, por edhe nga ana psikologjike, shëndetësore, si dhe nga ana e mirëqenies sociale. Duhet të theksohet se ato pas luftës më së shumti vuajnë nga paragjykimet që u bëhen nga shoqëria.

Grave dhe vajzave, viktimave të luftës në Kosovë, duhet të sigurohet infrastrukturë ligjore dhe përkrahja institucionale, me fokus të veçantë në heqjen e paragjyqimeve dhe në krijimin e një ambienti të barabartë në shoqërinë tonë.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit, për periudhën për të cilën raportohet, janë paraqitur vetëm dy ankesa lidhur me këtë çështje. Institucioni i Avokatit të Popullit, duke mbështetur sundimin e ligjit në Kosovë, njëkohësisht mbështet edhe çështjen e grave viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, që të gëzojnë të drejtat e tyre si viktima civile të luftës.

## **2.4. E drejta për jetën**

Secili individ gëzon të drejtën për jetë. Jeta e njeriut mbrohet me ligj. Respektimi i të drejtës për jetë dhe mbrojtja e saj absolute dhe pa kusht, përbën bazën e konceptit juridik të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Jeta është një e drejtë, atribut fundamental i qenies njerëzore dhe kur kjo hiqet ose merret në çfarëdo mënyre, njeriu eliminohet si bartës i të drejtave dhe detyrimeve.

### **2.4.1. Zvarritja e procedurave hetimore dhe profesionale**

Vetëm në nëntë muajt e parë të këtij viti në territorin e Republikës së Kosovës kanë ndodhur 24 vrasje: 3 në Prishtinë, 3 në Mitrovicë, 3 në Gjilan, 1 në Ferizaj, 7 në Prizren dhe 7 në Pejë. Motivet më të shpeshta të vrasjeve janë: fajdeja, haraçi, borxhi, pronat në kontest etj. Edhe pse jo si në përmasat e dikurshme, si motiv vrasjeje nuk përjashtohet as dukuria e gjakmarrjes.

E drejta e parë substanciale e shpallur nga KEDNJ është e drejta për jetën. KEDNJ parasheh detyrimin pozitiv të shteteve për të hetuar rastet e vdekjeve, që kanë elemente të shkeljes së këtij neni.<sup>21</sup> Avokati i Popullit, edhe këtë vit është i shqetësuar për mungesën e hetimeve të rasteve të paraqitura, lidhur me shkeljen e të drejtës së jetës. Në periudhën raportuese, IAP, ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me cenimin e kësaj të drejte dhe mungesën e hetimeve nga organet përgjegjëse, lidhur me gjetjen, zbulimin dhe identifikimin e kryerësve të vrasjes dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë.

Ankuesi është ankuar ndaj Prokurorisë së Qarkut në Prizren për zvarritje procedurale në ngritjen e aktakuzës që ka të bëjë me vdekjen e bijës së tij, si të dyshimtë vetëm tri ditë pas martesës së saj. Ai ishte i zhgënjyer nga Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, për zvarritjen e procedurës

---

<sup>21</sup> KEDNJ, neni 2.

së hetimeve. Kjo prokurori, edhe një vit pas vdekjes së vajzës, nuk ka siguruar raportin e autopsisë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore që vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, dhe të kryejë hetimet përkitazi me rastin i cili mbetet i dyshimtë për ankuesin.<sup>22</sup>

Nga shqyrtimi i pretendimeve të ankuesit dhe hetimeve të bëra nga IAP, si dhe pas bisedës së zhvilluar me prokurorin e rastit, rezultoi se ishin ndërruar disa prokurorë dhe çështja akoma nuk kishte përfunduar nga prokuroria. Në ndërkohë, prokurori i çështjes ende nuk ka pranuar rezultatet e autopsisë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, për të zhvilluar hetimet dhe ngritur aktakuzën. Përkitazi me këtë prokurori e kishte njoftuar edhe Ministrinë e Drejtësisë.

Lidhur me rastin, Avokati i Popullit, më 15.10.2012, kërkoi nga Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, që rasti të procedohet pa zvarritje të mëtejme. Nga përgjigja e datës 12.11.2012, Avokati i Popullit informohet se Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë ia ka dërguar prokurorisë raportin e autopsisë për rastin konkret, dhe prokurori i çështjes ka caktuar menjëherë që të vazhdohet procedura e mëtejme.

IAP, vitin e kaluar pas raportimit të mediave për rastet e lëndimeve të qytetarëve nga përdorimi i mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit, në bazë të nenit 15.3 të Ligjit për AP, hapi hetime zyrtare (*ex officio*), duke e parë si shumë të rrezikshëm përdorimin e mjeteve piroteknike, të cilat drejtpërdrejtë e cenojnë të drejtën për jetë. Përkitazi me këtë Avokati i Popullit, hartoi një raport me rekomandime për Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, nga e cila ende nuk ka pranuar asnjë përgjigje.<sup>23</sup>

#### **2.4.2. Gjaktmarrja dhe moszbatimi i ligjshmërisë**

Avokati i Popullit e konsideron të papranueshme që individët e pafajshëm, të cilët pa të drejtë kanë rënë “*në gjak*”, papritur detyrohen të shpëputen prej shoqërisë e edhe nga jeta e tyre, duke u privuar nga gëzimi dhe ushtrimi i këtyre të drejtave të garantuara me ligj dhe kushtetutë. Për Avokatin e Popullit është absolutisht e papranueshme që këta persona, të privohen nga ushtrimi i të drejtave dhe lirive të tyre themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këto raste, Avokati i Popullit rithekson dështimin e plotë të veprimit të organeve të rendit dhe të drejtësisë.

Përmasat që kanë marrë vrasjet në përgjithësi, si edhe ato për hakmarrje, kërkojnë një veprim kolektiv të bashkërenduar të gjithë shoqërisë, por në plan të parë të autoriteteve shtetërore. Në këtë drejtim rol të pamohueshëm ka zbatimi i përpiktë i ligjit, sidomos nga ana e policisë kriminale, prokurorisë dhe gjykatës, të cilat janë organe kompetente shtetërore të specializuara dhe me kualifikime përkatëse. Policia të reagojë me kohë për zbulimin dhe identifikimin konflikteve të mundshme, që mund të çojnë në vrasje. Prokuroria të zhvillojë hetime të plota, të

---

<sup>22</sup> IAP; Rasti nr. 343/2012.

<sup>23</sup> IAP, Raporti *ex-officio*, nr. 4/2011.

gjithanshme, të shpejta dhe objektive. Zbatimi i ligjeve me përpikëri nga gjykata kundër kryerësve të këtyre veprave, do të ketë edhe efekt parandalues për të tjerët.

Avokati i Popullit, sikurse në raportet e kaluara, përsërit kërkesën për zbatimin efikas të ligjit, për një sistem gjyqësor efikas, për një sistem efikas të hetimeve, brenda një afati të arsyeshëm ligjor, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëshuara nga AP. Në këtë aspekt në Kosovë, vazhdon mos mospërputhshmëri me Kushtetutën, ligjin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare që garantojnë këtë të drejtë.

### **Rekomandime:**

- *Policia e Kosovës të jetë më efektive në zbulimin e kryesve të veprave penale që cenojnë të drejtën për jetë.*
- *Instituti i Mjekësisë Ligjore të kryejë pa zvarritje veprimet e parapara ligjore për përfundimin e autopsisë për rastet e vrasjeve në afat të arsyeshëm ligjor.*
- *Prokuroria të zhvillojë hetime të plota, të gjithanshme, efikase dhe pa zvarritje, brenda afatit të paraparë me ligj.*
- *Instituti Gjyqësor i Kosovës, të vazhdojë me mbajtjen e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, në lëmin penal, në veçanti të fushave që kanë të bëjnë me të drejtën për jetë.*
- *KGJK të përshpejtojë emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, në mënyrë që të evitohen zvarritjet e procedurave, për shkak të numrit të vogël të tyre.*
- *MPB të zbatojë rekomandimet e Avokatit të Popullit në lidhje me përdorimin e mjeteve piroteknike.*

## **2.5. E drejta e integritetit personal**

Integriteti personal nënkupton tërësinë e një organizmi, dukurie apo formave të tjera të kombinuara që paraqesin një tërësi dhe reagojnë si një organizëm.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, garantohet e Drejta e Integritetit Personal duke mbrojtur “*të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të secilit person*”,<sup>24</sup> përfshirë të drejtën për të marrë vendime për riprodhim, të drejtën për të pasur kontroll mbi trupin, të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij, dhe të drejtën për të mos qenë pjesë e eksperimenteve mjekësore ose shkencore pa pëlqimin e tij.

---

<sup>24</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 26.

Koncepti i integritetit personal definohet si pacenueshmëri ose paprekshmëri e qenies së njeriut, në kuptim të respektimit të vlerave të tij fizike dhe psikike. Bazuar në këtë definicion, e Drejta e Integritetit Personal përveç që mbrohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kjo e drejtë në vendin tonë rregullohet edhe me një sërë ligjesh që ndërlidhen me paragrafët 1, 2, 3, 4 të nenit 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>25</sup>

IAP në këtë periudhë raportuese nuk ka marrë asnjë ankesë për shkeljet e bëra lidhur me të Drejtën e Integritetit Personal,

## **2.6. Të drejtat e të akuzuarit**

Termet *arrestim* dhe *ndalim* përdoren në mënyrë të ndërthurur gati në gjitha klauzolat e nenit 5 të KEDNJ dhe ato duhet të konsiderohen se kanë kryesisht lidhje me ndonjë masë – për çfarëdo qëllimi që përdoren - me efektin e heqjes së lirisë së një personi. Arrestimi dhe ndalimi duhet të jenë në përputhje me ligjin vendës dhe me KEDNJ<sup>26</sup> dhe nuk duhet të jenë arbitrare.

Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet. Ai/Ajo duhet të informohet për tri të drejtat themelore të tij/saj: të drejtën për t'u ekzaminuar nga mjeku; të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës dhe të drejtën për të njoftuar familjen apo miqtë. Këto të drejta themelore duhet t'i ofrohen sa më shpejtë që të jetë e mundur – menjëherë pas arrestimit. Këto tri të drejta themelore respektohen në masë të kënaqshme nga autoritetet e vendit.

IAP ka vazhduar monitorimin, në disa raste edhe pa paralajmërim, të qendrave të ndalimit, paraburgimit dhe të burgjeve, duke realizuar vizita të rregullta mujore, në këto qendra, si në Burgun e Dubravës, Lipjanit dhe Smrekonicës, si dhe qendrat e paraburgimit (QP) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë. Gjatë vizitave IAP ka realizuar intervista personale me të ndaluarit, ndër të tjera edhe lidhur me tri të drejtat themelore që u përmendën më lartë, por nuk ka pranuar ankesa.

Nga vizitat e realizuara dhe nga informatat e marra në këto vende, është vërejtur se këto qendra janë të mbipopulluara dhe kushtet e mbajtjes në disa prej tyre vazhdojnë të jenë në nivel jo të kënaqshëm. Këto kushte janë të rënda edhe për stafin përgjegjës. Hapësira të ngushta, ajrosje e pamjaftueshme, lagështira dhe errësira i karakterizojnë disa prej ambienteve të punës së stafit dhe mbajtjes së të ndaluarve.

Për sanimin e kësaj situate, sipas informacioneve të marra nga Komisarri i Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK), punimet kanë filluar për ndërtimin e QP Gjilan, si dhe pritjet shumë shpejtë edhe për QP në Prishtinë. Gjithashtu, edhe disa renovime në Burgun e Dubravës, janë në

<sup>25</sup> Ligji për të Drejtat dhe për Përgjegjësitë e Qytetarëve për Kujdesin Shëndetësor, nr. 2004/38; Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 02 /L-76 dhe Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent, nr. 02/L-50.

<sup>26</sup> KEDNJ, neni 5

përfundim. Rindërtimi i tyre do të mundësojë krijim të kushteve më të dinjitetshme për punë dhe mbajtje.

Këto qendra gjatë kësaj periudhe raportuese, kanë qenë të mbipopulluara kryesisht me të paraburgosur: Në QK Dubravë, 215 të paraburgosur; në QK Lipjan kanë qenë 19 femra dhe 11 të mitur; në QP Prizren kanë qenë 87 të paraburgosur; në QP Prishtinë, kanë qenë 56 të paraburgosur; në QP Lipjan, kanë qenë 155 të paraburgosur; në QP Pejë, kanë qenë 70 të paraburgosur; në QP Mitrovicë, kanë qenë 5 të paraburgosur; dhe në QP Gjilan, kanë qenë 55 të paraburgosur. Këto shifra janë të lëvizshme dhe ndryshojnë nga dita në ditë, si p.sh. në QP Gjilan, sipas drejtorit të qendrës, ky numër ka ndodhur brenda vitit që të jetë dyfish më i lartë.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e shqiptimit të dënimit me paraburgim duke mos aplikuar asnjë masë tjetër që parashihet në nenin 3 të KPPK.<sup>27</sup> Shqiptimi i masës së paraburgimit mund të rezultojë pastaj me kompensimin e të ndaluarve pa arsye. Pikërisht për këtë arsye, gjatë periudhës raportuese janë parashtruar 104 kërkesa për kompensim, prej të cilave 92 janë shqyrtuar dhe paguar.<sup>28</sup>

Neni 5 (3) i KEDNJ, përcakton një zgjidhje midis lirimit ose gjykimit të personit brenda një afati të arsyeshëm, por edhe zgjatja e masës së ndalimit që të justifikohet duhet të jepen arsye të pranueshme e të mjaftueshme për të, si për shembull: rreziku i largimit, ndërhyrja në procesin e drejtësisë, kryerjen përsëri të veprave penale ose prishjen e qetësisë publike, etj. Megjithëse një ose më shumë nga këto arsye mund të ekzistojnë kur personi ndalohet fillimisht, ato mund të bëhen më pak të rëndësishme me kalimin e kohës dhe në rrethana të tilla personi në fjalë duhet të lirohet.<sup>29</sup> GJENDJ madje ka konstatuar shkelje të nenit 6 për gjykim brenda një kohe të shkurtër, pasi kishin kaluar 15 ditë ndërmjet afatit kur i akuzuari ishte mbajtur nën arrest dhe herës së parë që ai ishte quar para një gjykate.<sup>30</sup>

Gjithashtu, edhe kur ka një arsye të justifikueshme për të vazhduar masën e ndalimit të personit, gjithësesi mbetet një kusht i përgjithshëm që periudha e ndalimit para gjykimit nuk duhet të mbetet e pajustificuar. Kjo duhet gjykuar nga kompleksiteti i proceseve penale, por gjithashtu edhe nga shkalla e përgatitjes së çështjes. Pasiviteti i zgjatur pashmangshmërisht do të çojë në konstatimin e një shkelje. Nuk është e mjaftueshme që të pretendohet si arsye frika se mos personi i akuzuar arratiset ose ndërhyr tek dëshmitarët. Kjo nuk përbën ndonjë arsye të besueshme kur janë marrë deklaratat nën betim. Arsyetimi i dhënë duhet të jetë real dhe jo një citim ritual i formulës së përhershme, duke treguar se nuk u morën në konsideratë deklaratat e

---

<sup>27</sup> KPPK, Neni 3 parasheh që “Sanksionet penale janë: dënimet kryesore, dënimet alterantive; dënimet plotësuese dhe vërejtja gjyqësore.”

<sup>28</sup> Statistika është marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të të cilit është i formuar komisioni prej tre anëtarësh dhe që vendos duke u bazuar në “Kriteret e përgjithshme për kompensimin e dëmit të personave të dënur ose arrestuar pa arsye”, të datës 25 gusht 2008.

<sup>29</sup> IAP, *rasti A. 191/2012*. Pala ankohet për vazhdim të paraburgimit pa arsyetim bindës edhe pse të gjitha dëshmitë janë marrë nga prokuroria.

<sup>30</sup> GJEDNJ, *rasti McGoff v. Sweden* (Application no. 9017/80), Judgement 13.10.1982, Strasbourg.

aplikimit për lirim. Vazhdimësia e ndalimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar, vetëm kur ka indikatorë të qartë se ekziston një interes i vërtetë publik i cili, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, vlen më shumë se e drejta për lirimin e personit.

Është e rëndësishme që arsyetimi për masën e ndalimit të jetë i formuluar në një gjuhë jo teknike, pasi që shumica e njerëzve që kanë përjetuar heqjen e lirisë nuk mund të kenë kapacitetin intelektual ose eksperiencën profesionale për të kuptuar kompleksitetin e së drejtës. Ideja e përgjithshme është që personi i përfshirë të kuptojë se çfarë po ndodh me të.

Në rastet kur nuk është i mundur komunikimi për shkak të moshës së personit apo gjendjes së tij mendore, arsyeja duhet t'i jepet personit që e ka në ngarkim atë. Kur personit që i hiqet liria nuk e kupton gjuhën zyrtare, arsyeja për masën e ndalimit duhet të jepet në një gjuhë që ai e kupton (kjo mund të përfshijë edhe sistemin Braille ose gjuhën e shenjave).

Të drejtën për t'u mbrojtur personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së tij/saj, ose nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore, duhet t'i jepet pa pagesë kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.<sup>31</sup> Kur i akuzuari ka të drejtën e asistencës ligjore pa pagesë, ai/ajo ka të drejtë për ndihmë ligjore e cila është praktike dhe efektive e jo thjesht teorike dhe e gënjeshtërt.<sup>32</sup>

E drejta për ndihmë ligjore për një të akuzuar varet nga dy rrethana. Së pari, fakti që i akuzuari ka mungesë të mjeteve të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore dhe, së dyti, kur kjo është në interesat e drejtësisë që të kërkojnë të sigurohet ndihma ligjore. Kur përfshihen çështje komplekse dhe kur i pandehuri nuk ka kualifikimin e duhur ligjor për të paraqitur e zhvilluar argumentet e duhura dhe vetëm kur një avokat me eksperiencë do të kishte aftësinë për të përgatitur çështjen, interesat e drejtësisë kërkojnë që t'i caktohet të pandehurit zyrtarisht një avokat për çështjen në fjalë. Gjykata duhet të ketë parasysh gjithashtu edhe kompleksitetin e çështjes.<sup>33</sup>

Është evidente se e drejta për ndihmë ligjore në çështjet civile nuk parashtrohet shprehimisht në Konventë por Gjykata është shprehur se duhet të jetë e disponueshme nëse e kërkojnë interesat e drejtësisë.<sup>34</sup>

Nevoja për asistencë shkon përtej përgatitjes për një pretendim dhe përfshin përfaqësimin në procedurat para gjykatës. Këto procedura gjithashtu duhet të jenë të hapura dhe t'i referohen kërkesave të barazisë në mjete, midis palëve, palës akuzuese dhe personit të ndaluar. Është tërësisht e papranueshme që gjykata të dëgjonte vetëm palën akuzuese në mungesë të palës së

---

<sup>31</sup> *GJEDNJ*, rasti *Woukam Moudefo v. France*, (Application no. 10868/84), Judgement 21.01.1987, Strasbourg. Në rastet kur i ndaluarit nuk e përballon dot shpenzimet për një avokat, këtë duhet ta bëjë shteti, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 5 (4) *KEDNJ*, sepse të akuzuarit nuk i ishte caktuar një avokat për lirimin e tij.

<sup>32</sup> *GJEDNJ*, rasti *Artico v. Italy*, (Application no. 6694/74), Judgement 13.05.1980, Strasbourg.

<sup>33</sup> *GJENDJ*, rasti *Pham Hoang v. France*, (Application no. 13191/87), Judgement 25.09.1992, Strasbourg.

<sup>34</sup> *GJENDJ*, rasti *Airey v. Ireland*, (Application no. 6289/73), Judgement 09.10.1979. Strasbourg.



ndaluar,<sup>35</sup> ose si në rastin ku prokurori kishte qasje në dosjen zyrtare në përgatitjen e çështjes por i ndaluar nuk e kishte këtë qasje.<sup>36</sup>

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka vazhduar të marrë ankesa sa i përket vështirësive që paraqet largësia e vendeve ku mbahen personat e ndaluar me vendbanimin e familjeve të tyre. Për këto arsye vizitat nga familjarët janë të rralla dhe të kushtueshme, e shumë shpesh të papërballueshme.

### **Rekomandime:**

- *Të shqiptohen masa tjera alternative, e jo vetëm paraburgimi, si mjet për sigurimin e të akuzuarit.*
- *Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial të ushtrojnë mbikëqyrje më të madhe në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të ndërmarrin masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në raste të zvarritjeve të paarsyetueshme dhe kundërligjore në rastet e paraburgimeve.*
- *Oda e Avokatëve të Kosovës, gjithashtu, të ushtrojë mbikëqyrje më të shtuar ndaj avokatëve dhe të shqiptoj masa ndaj atyre që shkelin Ligjin për Avokatinë dhe Kodin e Etikës profesionale të Avokatit.*

## **2.7. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër**

Parimi *Ne bis in idem*, përkatësisht parimi se asnjë person nuk duhet të gjykohet dy herë për të njëjtën vepër është parim i përgjithshëm dhe themelor në një shtet ligjor. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>37</sup> dhe me KEDNJ.<sup>38</sup> Ky parim është i përfshirë edhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.<sup>39</sup>

---

<sup>35</sup> *GJEDNJ*, rasti *Toth v. Austria*, (Application no. 11894/85), Judgement 12.12.1991, Strasbourg.

<sup>36</sup> *IAP*, rasti *A. 309/2011*. Shih po ashtu, *GJEDNJ*, rasti *Lamy v. Belgium*, (Application no. 10444/83), Judgement 30.03.1989, Strasbourg.

<sup>37</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 34.

<sup>38</sup> *KEDNJ*, i protokollit nr. 7, neni 4.1 “Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit shtet, për një vepër për të cilën ai është deklaruar më parë i pafajshëm ose dënuar, me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të po atij shteti”.

<sup>39</sup> *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 14.7, “Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet për një vepër për të cilën ai është dënuar ose liruar njëherë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi”.

Qëllimi i parimit *Ne bis in idem* është që të mbrojë personin nga pushteti arbitrar i shtetit dhe për të parandaluar shtetin që të dënojë personat dy herë për të njëjtën vepër.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës për të cilën raportohet, nuk ka konstatuar ndonjë shkelje përkitazi me cenimin e këtij parimi. Prandaj, Avokati i Popullit është i inkurajuar me faktin se parimi *Ne bis in idem*, është trajtuar në mënyrë të drejtë në sistemin ligjor dhe në zbatimin e tij në praktikë.

## **2.8. E drejta për mjete juridike**

Çdo subjekt i të drejtës kontestimore ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Këtë të drejtë, qytetarët e shfrytëzojnë nëse u cenohen të drejtat dhe interesat e tyre, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

E drejta për mjete juridike, qytetarëve u është garantuar më Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>40</sup> dhe me legjislacionin penal, civil dhe administrativ si dhe me marrëveshjet dhe instrumentet juridike ndërkombëtare.

Kundër çdo vendimi të nxjerrë nga autoritetet publike shtetërore dhe gjyqësore, qytetarët mund të shfrytëzojnë mjetet juridike. Shfrytëzimi i mjeteve juridike është mundësi e mirë që autoritetet publike shtetërore të rishqyrtojnë vendimet e tyre, të përmirësojnë lëshimet eventuale, të cilat mund të ndodhin gjatë zhvillimit të procedurave të ndryshme. Kjo e mundëson edhe parandalimin e padrejtësive, shpërdorimin e pushtetit dhe ofron vendim të drejtë dhe të bazuar me ligj. Po ashtu garanton parimin e sundimit të ligjit.

Kërkesën për mbrojtje juridike, qytetarët mund të ia dërgojnë edhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, por vetëm pasi paraprakisht të shterojnë të gjitha mjetet ligjore, të përcaktuara me legjislacionin përkatës të Kosovës.

Në procedurat gjyqësore penale, mjetet juridike dhe afatet kohore për shfrytëzimin e ankesave, si ato kundër ndalimit, caktimit ose vazhdimit të paraburgimit, ankimimit të vendimeve gjyqësore si dhe ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, janë të përcaktuara me ligj<sup>41</sup> Përcaktimi i mjeteve juridike për kundërshtimin e paraburgimit, parashihet edhe me instrumente ndërkombëtare.<sup>42</sup>

E drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme, është e garantuar me nenin 6 të KEDNJ<sup>43</sup> dhe nenin 10.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Republikës së Kosovës<sup>44</sup> dhe si e tillë

---

<sup>40</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

<sup>41</sup> Kodi i Procedurës Penale (2003 dhe 2008).

<sup>42</sup> KEDNJ, neni 5.4.

<sup>43</sup> KEDNJ, neni 6.1.

duhet të sigurohet nga ana e gjykatave në çdo procedurë gjyqësore, në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

Edhe në këtë vit, shkaqet më të shpeshta të ankesave të paraqitura në IAP janë kundër sistemit gjyqësor, pastaj komunave, ministrive si dhe kompanive publike. Ankesat paraqiten për shkak të joefektivitetit të mjetit juridik përkatësisht të mos shqyrtimit të ankesave në afatet ligjore dhe mos zbatimit të vendimeve administrative.

Ankesat e paraqitura kundër gjyqësorit, lidhur me mjetet juridike, kryesisht janë të paraqitura kundër gjykatave të të gjitha niveleve, si dhe Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesat e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me zvarritjet e tepruara të procedurave gjyqësore deri në marrjen e vendimit gjyqësor pas ushtrimit të mjeteve juridike. Gjithashtu kjo ndikon në jo efektivitetin e mjeteve juridike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuara me dispozitat ligjore

Ankesat e paraqitura tek Avokati i Popullit, si në procedurat administrative edhe ato gjyqësore, kur janë konstatuar shkelje të së drejtës për mjete juridike, për shkak të veprimeve ose mos veprimeve të paligjshme të autoriteteve publike, Avokati i Popullit ka hapur hetime dhe ka kërkuar informata nga organet e administratës dhe gjykatat e niveleve të ndryshme, lidhur me shkaqet e vonesave.

Një pjesë e ankesave të qytetarëve të paraqitura janë kërkesa që IAP të hartojë mjete juridike si kërkesa, ankesa dhe padi, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre për të cilat ankuesit pretendonin se u ishin shkelur. Po ashtu ka pasur kërkesa edhe për përfaqësimin e tyre në kontestet pranë institucioneve kompetente, kjo është si rezultat i mosnjohjes së kompetencave të Avokatit të Popullit dhe si rezultat i besimit të qytetarëve ndaj këtij institucioni. Mirëpo, shqetësuese për Avokatin e Popullit është mosbesimi i qytetarëve në punën dhe drejtësinë e ofruar nga institucionet kompetente, sidomos të gjyqësorit dhe avokatëve në Kosovë.

Avokati i Popullit konstaton se, për të qenë mjetet juridike efikase dhe efektive, si dhe për të evituar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet të respektohen afatet ligjore nga institucionet kompetente, lidhur me lëndën, ose përndryshe të bëhet sigurimi i kompensimit përkatës, kur këto të drejta shkelen. Prandaj, Avokati i Popullit u rekomandon institucioneve të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal, organeve administrative dhe gjykatave, të bëjnë zbatimin konsekuent të ligjeve vendore dhe instrumenteve ndërkombëtare për ushtrimin e mjeteve juridike nga autoritetet publike.

---

<sup>44</sup> Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 10.1.

## 2.9. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në raste penale

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, në raste penale, është i garantuar me nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>45</sup> Ky parim është një nga parimet fundamentale të të drejtës penale sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).<sup>46</sup> Në këtë mënyrë të gjithë personave në territorin e Republikës së Kosovës u garantohet siguria ligjore dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.

Parimi i ligjshmërisë *Nullum crimen sine lege, nulla poene sine lege* kërkon që krimi të jetë i përshkruar sipas ligjit. Asnjë i pandehur nuk mund të ndëshkohet në mënyrë arbitrare ose retroaktive, për veprimin i cili nuk ka qenë i përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat në kohën e kryerjes së tyre, sipas të drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. KEDNJ në nenin 7.1 ka përcaktuar qartë se “*Nuk ka dënim pa ligj.*”<sup>47</sup> Në këtë drejtim, në përputhje të plotë me frymën e KEDNJ-së, edhe legjislacionin kosovar garanton të njëjtën gjë.

Pjesa e parë e parimit *nullum crimen sine lege (nuk ka dënim pa krim)*, ndalon dënimin e personit për veprën e cila në kohën e kryerjes nuk përbente vepër penale. Prandaj, dispozita penale juridike nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive. Pjesa e dytë *nulla poena sine lege (nuk ka dënim pa ligj)*, mbron kryesin e veprës nga marrja e dënimit më të rëndë se ajo që është paraparë me ligj. Madje në këtë aspekt, legjislacioni kosovar në fuqi është më i favorshëm për të akuzuarit, sepse në rast të ndryshimit të legjislacionit, edhe në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, ndaj kryesit të veprës penale, do të zbatohet ligji i cili është më i favorshëm.<sup>48</sup>

Gjatë periudhës së raportimit, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka regjistruar raste të veçanta në lidhje me nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Avokati i popullit, në të gjitha rastet e ankesave përkitazi me cenimin e parimit të proporcionalitetit, duke pasur kompetenca të kufizuara në gjyqësor, qytetarët i ka udhëzuar për shfrytëzim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit, ka konstatuar se edhe në këtë vit është vazhduar me cenimin e parimit të proporcionalitetit me rastin e dënimeve të shqiptuara nga gjyqësori ndaj abuzuesve me votat e qytetarëve në zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2010.

---

<sup>45</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 33.

<sup>46</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/Rregullore /2003/25, Neni 1 “Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.”

<sup>47</sup> KEDNJ, neni 7.1. “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbente vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”

<sup>48</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), UNMIK/Rregullore/2003/25, Neni 2. “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm.”

Gjykatat komunale kanë vazhduar me shqiptime të dënimeve me gjobë, me kusht, ndërsa dënimi me burg efektiv ishte shqiptuar në raste të rralla. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se, përveç zvarritjeve të pajustificueshme të procedurave nëpër gjykata, edhe dënimet e shqiptuara nga gjykatat komunale për manipuluesit e zgjedhjeve në Kosovë ishin të ulëta, joproporcionale dhe krejtësisht të pamjaftueshme dhe në krahasim me peshën dhe natyrën e veprës së kryer.<sup>49</sup>

Sjellja e tillë e gjykatave, duke shkelur parimin e proporcionalitetit në rastet e tilla, kur është cenuar një e drejtë elementare e garantuar me kushtetutë dhe e sanksionuar qartë me ligjet në fuqi, rrënon bazën e ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe minon themelet e shoqërisë demokratike.

## 2.10. Liria e lëvizjes

Rregullativa Kushtetuese<sup>50</sup> dhe ligjore, e cila ka të bëj me lirinë e lëvizjes në Republikën e Kosovës,<sup>51</sup> është në nivelin më të lartë, në pajtim me standardet ndërkombëtare.<sup>52</sup> Qeveria e Kosovës dhe institucionet shtetërore që janë kompetente për zbatimin e plotë të këtyre normave, duhet t'i sigurojnë këto të drejta dhe kanë detyrim eksplicit që qytetarëve në Kosovë, pa kurrfarë diskriminimi dhe kufizimi, t'ua mundësojnë sigurinë e lëvizjes së lirë. Institucionet kompetente kanë detyrim që t'i ndërmarrin të gjitha masat, në mënyrë që liria e plotë e lëvizjes të sigurohet për të gjithë banorët e Kosovës.

<sup>49</sup> *Gazeta ditore "Koha ditore", 1 shtator 2012, faqe 42.* Deri më 31 gusht 2012, vetëm një person është dënuar nga Gjykata Komunale në Gjakovë, si i dyshuar për manipulim votash në zgjedhjet e fundit. Ndërsa, procesi për gjykimin e të tjerëve është duke vazhduar edhe pse kanë kaluar gati 2 vite që kur prokuroria ka ngritur aktakuzë. Prosesi i gjykimin të të akuzuarve është në vazhdim. Që nga gjysmëvjetori i parë i vitit 2011, kur Prokuroria komunale ka ngritur dhe dërguar në Gjykatë rreth 100 aktakuza, Gjykata Komunale në Gjakovë, deri tashti ka nxjerrë vetëm një vendim përfundimtar. Një person është shpallur fajtor dhe është dënuar me 3 muaj burg. Në fakt personi nga Gjykata Komunale është gjobitur në fillim me 250 euro gjobë, por pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Qarkut më pas ia ka shqiptuar dënimin me burgim prej 3 muajsh.

<sup>50</sup> Neni 35 i Kushtetutës së Kosovës, [Liria e lëvizjes]: "1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë për lëvizje të lire dhe zgjedhje të vendbanimit në Republikën e Kosovës. 2. Çdo person ka të drejtë ta lëshoj vendin. Kufizimet e të njëjtës mund të rregullohen me ligj, nëse të njëjtat janë të domosdoshme për sigurimin e procedurës ligjore, zbatimin e vendimit gjyqësor ose për t'u siguruar obligimi i mbrojtjes së vendit. 3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u mohohet e drejta e hyrjes në Kosovë. 4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen kundër dëshirës së vet, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare. 5. E drejta e hyrjes dhe qëndrimit së të huajve në Republikën e Kosovës rregullohet me ligj."

<sup>51</sup> Me Ligjin për shtetësi nr. 03/L-034; Ligjin për vendbanim dhe vendqëndrim nr. 02/L-121; Ligjin për të huajt nr.03/L-126; Ligjin për dokumentet e udhëtimit nr. 03/L-037, të dt. 19 qershor 2008, në versionin e ndryshuar me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet, për dokumentet personale, nr. 03/L-217, dt. 11 dhjetor 2010.

<sup>52</sup> Neni 13 i deklaratës Universale për të drejtat e njeriut "Secili ka të drejtë për liri të lëvizjes dhe zgjedhje të banimit në kufijtë e shtetit të caktuar." Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, Protokollin 4, neni. 2: „Secili që në mënyrë të ligjshme gjendet të territorin e një shteti ka, në atë territor, të drejtë për liri të lëvizjes dhe të drejtë për zgjedhje të qëndrimit, e nuk mund të vihen kurrfarë kufizime sa u përket realizimit të këtyre të drejtave“.

Si edhe gjatë raporteve paraprake vjetore, ashtu edhe në këtë periudhë raportuese, siguria dhe liria e lëvizjes të komuniteteve të caktuara etnike brenda Kosovës, ka qenë e ndryshueshme në rajone të caktuara.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese, ka marrë disa ankesa nga Serbët, për shkak të mospërfitimit të MPB të Kosovës që në procedurën e reregjistrimit të automjeteve, t'ua jap reregjistrimet e përhershme. Pa tabela nuk mund të kalojnë vendkalimet kufitare me Serbinë, kështu që lëvizja me automjete në këtë mënyrë iu është kufizuar.

Po ashtu ka pasur ankesa për urdhëresën e MPB-së, sipas të cilës, Policia e Kosovës i ka konfiskuar tabelat e lëshuara nga MPB-ja e Serbisë, me shenjat e qyteteve në Kosovë. Policia e Kosovës, me rastin e kontrolleve të automjeteve i ka marrë këto tabela, që pronarët e automjeteve i kanë shfrytëzuar në territorin e Serbisë, ngase tabelat me shenjat RKS për pushtetin në Serbi janë të papranueshme,, ndërsa i pranojnë vetëm ato tabela me shenjë KS.

Përkritazi me këto probleme, zëvendës ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, në muajin nëntor të vitit të kaluar, ka theksuar se Serbëve të cilët ende presin tabelat kosovare me shenjë "KS" apo "RKS" duhet aktualisht t'iu lëshohen tabela të përkohshme.<sup>53</sup>

Me atë rast po ashtu është thënë që afati për reregjistrim ka qenë 1 qershori, e pas kësaj serbëve, në periudhën shtesë iu është mundësuar të paraqesin kërkesa për reregjistrim prej tabelave të MPB së Serbisë, në tabela me shenjë "KS" dhe "RKS".<sup>54</sup>

Qeveria e Kosovës, në bazë të konkluzioneve nga Brukseli, gjatë tetorit të vitit 2011, ka marrë vendim për reregjistrimin nga tabelat e vjetra jugosllave në tabelat kosovare RKS ose KS, për të gjitha automjetet që janë në Kosovë deri më 1 nëntor, ndërsa automjetet që janë importuar pas kësaj date i nënshtrohen pagesës së tarifave.<sup>55</sup>

Me aplikimin e marrëveshjes së arritur për lirinë e lëvizjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që kishte të bënte me çështjet e udhëtimit jashtë kufirit, në bazë të letërnjoftimeve, e po ashtu edhe për çështjen e tabelave të regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve, nga 02.07.2011, kur, ndërmjet tjerash u arrit marrëveshja që të gjitha automjetet që hyjnë në Serbi me tabela kosovare

---

<sup>53</sup> Deklarata e zëvendës ministrit të punëve të brendshme, për radio KIM, e botuar më 13.11. 2012. "gjithsej në Kosovë janë parashtruar 2.066 kërkesa të tilla. Sipas tij, serbët e Kosovës, automjetet me tabela të përkohshme mund t'i ngasin deri atëherë kur Prishtina të merr dëshmi për validitetin e tyre nga Beogradi. Po ashtu, qytetarët që paguajnë taksë të rregullt për tabelat e përkohshme të regjistrimit, nuk do të paguajnë përsëri, kur pas verifikimit të përmendur, pas reregjistrimit të automjeteve, i tërheqin tabelat e përhershme të regjistrimit me shenjat KS dhe RKS." Në <http://www.info-ks.net> (25.12.2012, 14.h.)

<sup>54</sup> Po aty, " Për shkak të nevojave të njerëzve në terren, para së gjithash njerëzve nga rrethina e Gjilanit, Qeveria ka vendosur që ta shtyjë deri më tutje. Edhe sot e kësaj dite këtë mund ta bëjnë të zhvendosurit apo të kthyerit të cilët nuk kanë pasur qasje në informata ose fizikisht nuk kanë qenë në gjendje që t'i reregjistrojnë automjetet e veta", por procedura rreth reregjistrimit të automjeteve, pas 1 qershorit, është ashpërsuar ngase ekzistojnë arsytet të besohet se një numër i automjeteve dhe patentë shoferëve janë të falsifikuar, për ç'arsye MPB-ja e Kosovës ka vendosur që të bëjë verifikimin tek lëshuesi i këtyre dokumenteve. Për këtë arsye Policia e Kosovës nuk u lejon automjeteve pa shenja përkatëse regjistruese pjesëmarrje në trafik."

<sup>55</sup> Po aty.

dhe nga Serbia me tabela serbe, të paguhet kompensim për sigurim,<sup>56</sup> ka bërë vështirësi shtesë, gjatë periudhës raportuese dhe ka vështirësuar lëvizjen e qytetarëve nga Kosova dhe Serbia. Çmimet e sigurimit të automjeteve janë mjaft të larta, që edhe në situatën ashtu veç të rëndë ekonomike në të cilën gjenden qytetarët në këtë rajon, mund të çojnë në izolim. Bashkë me vështirësitë administrative janë futur edhe ngarkesa financiare, për shumë persona të papërballueshme, me çka iu kufizohet liria e lëvizjes.

Njerëzit në Luginën e Preshevës janë të goditur me këtë vendim, sepse lartësia e kompensimit për sigurim i pengon që të mbajnë marrëdhëniet familjare, tregtare dhe ekonomike me Kosovën. Përfaqësuesit politik të tri komunave në jug të Serbisë, në të cilat Shqiptarët përbëjnë shumicën, shprehën pakënaqësinë e tyre me situatën e krijuar, në takimin me nënkryetarin e Qeverisë së Kosovës dhe, me atë rast u është premtuar se Qeveria do të shqyrtojë mundësinë e zvogëlimit të kompensimit për sigurim të automjeteve.<sup>57</sup> Rreth kësaj çështjeje Qeveria deri më sot nuk ka ndërmarrë masa konkrete, lartësia e kompensimit për sigurimin e automjeteve ka mbetur e pandryshuar.

Rreth zbatimit të marrëveshjeve të arritura të pushtetarëve kosovar dhe serb, lidhur me lirinë e lëvizjes, ka vështirësi të mëdha në veri të Kosovës. Misioni i EULEX-it ndihmon në implementimin e këtyre marrëveshjeve edhe në veri të vendit.

### **2.10.1. Transporti humanitar**

Kur flasim për transportin humanitar, ai për komunitetet dhe grupet e rrezikuara që jetojnë në viset e izoluar në Kosovë, ende është mjaft i domosdoshëm, për qasje të sigurt shërbimeve dhe mallrave kyçe dhe lidhje me rajonet më të mëdha të qyteteve. Mirëpo, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve në nivelin qendror dhe lokal, si dhe mbikëqyrja procedurale, kanë bërë që gjatë kësaj periudhe, transporti humanitar, në mënyrë përkatëse dhe në tërësi mos t'i përmbush nevojat e shfrytëzuesve.

Edhe pse, gjatë viteve të kaluara është zvogëluar numri i incidenteve të paraqitura të sigurisë, zgjerimi i linjës ekzistuese dhe futja e linjave plotësuese, kufizimi i buxhetit dhe reformat e propozuara të karakterit administrativ, mund të rezultojnë në zvogëlimin e dukshëm të këtij shërbimi, që do t'i godas shfrytëzuesit. Njerëzit që e shfrytëzojnë këtë formë të transportit ende mbështeten në transportin humanitar dhe me rëndësi është që ai të vazhdojë, për qasje të drejtave dhe shërbimeve, siç janë shkollimi, kujdesi shëndetësor dhe ndihma sociale, punësimi etj.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa të pjesëtarëve të komunitetit serb, të cilët u ankuan se që nga maji i vitit 2012, u është ndërprerë transporti humanitar në relacionin Prishtinë – Graçanicë - Lapllasellë – Preoc – Livagje – Gushtericë - Dobrotin, që është

<sup>56</sup> Komunikatë për shtyp e EU, 225, 12410/11, 2 korrik 2011, Bruksel, Në <http://www.consilium.europa.eu>.

<sup>57</sup> <http://www.koha.net/?page=1,13,95221>, Mbledhja e Qeverisë së Kosovës 11.4.2012.

forma e vetme e transportit në relacionin e përmendur, sepse në relacionin e përmendur nuk ka transport publik. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, lidhur me këtë rast kanë mbajtur disa takime me personat përgjegjës të Ministrisë së Infrastrukturës, si ministri kompetente për çështje të transportit humanitar. Në të gjitha takimet me palën përgjegjëse, përfaqësuesit e Avokatit të popullit kërkuan vendosjen sa më urgjente të kësaj linje. Mirëpo, deri në fund të periudhës raportuese, linja nuk është bërë operative edhe pse ndërprerja e saj ka ndodhur para tetë muajve, kur operatori i përzgjedhur me vetëdëshirë e ka ndërprerë transportin. Përveç linjës së përmendur, gjatë periudhës raportuese janë ndërprerë edhe tri relacione, prej tyre dy në relacionin LOT 1 (Milloshevë-Graçanicë dhe Bërnice-Graçanicë, janë ndërprerë nga shtatori i vitit 2012) dhe në relacionin LOT 10 (Gorazhdec-Zveçan, është ndërprerë nga janari i vitit 2012.)

Procedura e tenderimit, lidhur me këtë problem është në vazhdim e sipër, ndërsa është filluar vetëm pas intervenimit të Avokatit të Popullit. I qartë është mospuksesi i Ministrisë së Infrastrukturës që në pajtim me dispozitat administrative, në mënyrë efikase t'i përgjigjet obligimit të besuar të menaxhimit të transportit humanitar.

Liria e lëvizjes në tërë territorin e Kosovës duhet të jetë e përhershme dhe pakushtëzuar. Ekzistojnë shenja që tregojnë se gjërat po përmirësohen, por mjerisht, ende ekzistojnë vise në të cilat liria e lëvizjes nuk është e plotë.

### **2.10.2. Udhëtimi në vendet e BE-së**

Për territorin e Kosovës ende vlen regjimi i vizave i BE-së ndaj vendeve të treta. Qytetarët e Kosovës ende nuk mund të udhëtojnë në vendet e BE-së pa viza, kjo është e mundur nëse posedojnë vizën e vlefshme të Shengenit.

Mundësia e të gjithë personave të kenë dhe mbajnë dokumente udhëtimi ka ndikim të madh në realizimin e të drejtave që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes, duke përfshirë edhe të drejtën e kthimit, të drejtën për të udhëtuar lirshëm, (p.sh. hyrja dhe dalja nga Kosova) dhe e drejta e zgjedhjes së vendbanimit. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre çështjeve për të gjithë qytetarët dhe komunitetet e Kosovës, Ligji për dokumentet e udhëtimit në Kosovës,<sup>58</sup> parasheh dukjen dhe klasifikimin e tyre dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, si dhe afatin e vlefshmërisë.

---

<sup>58</sup> Shih nenin 7, të Ligjit për dokumentet e udhëtimit, nr. 03/L-037.



## Rekomandime

- *Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që në afat sa më të shkurtër të zgjidhë të gjitha kërkesat e paraqitura për reregjistrimin e automjeteve dhe lëshimin e shenjave të përhershme regjistruese.*
- *Qeveria e Kosovës të ndërmerr të gjitha masat përkatëse rreth çështjes së sigurimit të automjeteve dhe heqjes së pengesave administrative, për qarkullimin sa më efikas të mallrave e shërbimeve dhe lëvizjes së lirë të njerëzve.*
- *Qeveria e Kosovës, përkatësisht ministria e Infrastrukturës, të ndërmerr masat e domosdoshme që të vazhdohet zhvillimi i papenguar i transportit humanitar.*

### 2.11. E drejta e privatësisë

E drejta e privatësisë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNJ.<sup>59</sup> Sipas Kushtetutës dhe KEDNJ, në të drejtën e privatësisë përfshihen e drejta në mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën private të njeriut, në familje, në shtëpi ose letërkëmbim, të telefonisë dhe komunikimeve të tjera, mbrojtja e nderit dhe reputacionit etj.

Sikurse edhe në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit vazhdon të shprehë shqetësimin në lidhje me zhurmën e shkaktuar nga mjete, persona me veprimtari të ndryshme në vendet publike. Në shumicën e vendbanimeve në Kosovës, sidomos në qytetet e mëdha, çështja e zhurmës së krijuar nga muzika me zë të lartë, që emetohet nga restorantet, kafiteritë por edhe lokalet ku organizohen dasma dhe ahengje të ndryshme private, përbën jo vetëm shqetësim por edhe një shkelje drastike të së drejtës së privatësisë. Në këtë drejtim, para pronarëve të pandërgjegjshëm të këtyre lokaleve dhe veprimtarive, të cilët synojnë vetëm përfitime materiale dhe financiare sa më të mëdha, duke torturuar të gjithë banorët që jetojnë përreth lokaleve të tyre, në të shumtën e rasteve kanë dështuar të gjitha autoritetet përgjegjëse dhe kompetente, organet e rendit dhe inspeksionet komunale.<sup>60</sup>

<sup>59</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 36; KEDNJ, neni 8.

<sup>60</sup> IAP, Rasti Ex officio 333/2012. Raport lidhur me zhurmën që shkaktojnë pronarët e kafiterive duke lëshuar muzikë prej orës 20:00h deri pas orës 24:00h gjatë vikendeve, të shtunave dhe të dielave. Më 12 korrik 2012, përfaqësuesit e IAP janë takuar me Kryetarin e Komunës së Gjilanit. Në takim është vendosë që, nëpërmjet Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës në bashkëpunim me policinë të ndalohej zhurma. Për shkak të reagimeve të mëvonshme të IAP, më 16 korrik 2012, 3 tetor 2012 dhe 7 nëntor 2012, Drejtoria e Inspeksionit ka urdhëruar edhe heqjen e konstruksionit të tipit montues të kafiterive. Ky rast është zgjidhur pozitivisht, por vetëm përkohësisht.

Organet kompetente i obligon sikurse ligji<sup>61</sup> ashtu edhe KEDNJ, të mbrojnë privatësinë e qytetarëve. Ky obligim nuk përmbushet sot në asnjë vendbanim të Kosovës, sidomos në qytetet e Kosovës. Përveç veprimtarive të lartcekura, lejohen edhe veprimtari të tjera në vendbanime (punishte metalesh, sharra, shitore të zhurmshme, punë të ndryshme ku shkaktohet zhurmë e madhe nga vibrimet e makinave thyese, prerëse, gërryese, shpimi etj.), pa u penguar fare nga Policia e Kosovës dhe inspeksionet komunale.

### **2.11.1. Pacenueshmëria e banesës**

Sipas nenit 8 të KENDJ, në përgjithësi, shtëpia është identifikuar si vend ku personi jeton në mënyrë të përhershme apo me të cilin personi ka lidhje të mjaftueshme e të vazhdueshme. Gjykata për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ka vendosur të bëjë një interpretim më fleksibil, duke e definuar konceptin e banesës si në vijim:

- *Shtëpitë e pushimit, shtëpitë e dyta dhe hotelet që ofrojnë akomodim afatgjatë; shtëpinë në pronësi të personit tjetër, e cila banohet nga dikush tjetër gjatë një periudhe domethënëse të vitit;*
- *Vendbanimet sociale, ku paditësi banon me qira, edhe pse e drejta e banimit mund të përfundohet sipas ligjit vendor;*
- *Mjediset afariste, kur nuk ekziston ndarje e qartë mes zyrës së personit dhe rezidencës private apo mes veprimtarive private;*
- *Zyra e regjistruar e kompanisë, degët apo mjediset e tjera të biznesit;*
- *Vendbanimet jotradicionale, siç janë karvanët dhe vendbanimet e tjera të pafiksuar.*

Gjatë vitit 2012 Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash të qytetarëve për shkeljen e privatësisë. Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimet pa leje, ose me tejkalime të dukshme dhe të dëmshme të përcaktimeve fizike në lejet e nxjerra, të ndërtesave shumëkatëshe. Po ashtu, një shqetësim të veçantë përbën edhe rreziku i drejtpërdrejtë që paraqitet në rastin e gropimeve të thella për objektet shumëkatëshe në afërsi të shtëpive private, duke rrezikuar dëmtimin dhe

---

Sikurse edhe në qendrat tjera, edhe në Gjilan zhurma vazhdon të shurdhojë banorët e qyteteve të Kosovës pa ndërprerë, me intensitet jashtëzakonisht të shtuar ditëve të verës, shpeshherë deri në orët e hershme të mëngjesit.

*IAP, Rasti nr. 485/2012.* Ankesa e disa qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Ata paraqesin shqetësimin për shkak se në lagjen e tyre, u shkaktohet zhurmë në orët e vona të natës, prej pronarëve të kafiterive. Më 7 shkurt 2013, 6 mars 2013 dhe 30 maj 2013, përfaqësuesi i IAP ka takuar drejtorin e Drejtorisë Komunale të Inspeksionit dhe inspektorin kompetent. Pasi që IAP, ka ndërmarrë veprime, është konstatuar se kjo drejtori i ka gjobitur të gjithë pronarët e kafiterive dhe rasti është proceduar në gjykatë. Ky rast ka përfunduar pozitivisht.

<sup>61</sup> *Ligji nr. 02./L- 102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 2.*

rrëzimin e shtëpive apo dëmtimin e shtëpive.<sup>62</sup> Po ashtu, në shumë raste paraqiten ankesa për shkak të afërsisë së madhe të ndërtesave tek shtëpitë private, apo zënien e hapësirave publike, kryesisht të trotuareve dhe rrugëve, pa respektuar normat ligjore.

### **2.11.2. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit**

Në Republikën e Kosovës, akoma nuk ka ligj që rregullon çështjen e përgjimit të komunikimeve. Në disa raste të zbuluara viteve dhe kohëve të fundit të përgjimit të bisedave dhe mesazheve telefonike, dëshkohet se menaxhimi i materies së përgjimit nga përgjegjësit dhe paligjshmëria e abuzimi janë vënë në raporte mirëkuptimi. Ligji aktual në fuqi për telekomunikimet në Kosovë, ka mangësi të shumta për sa i përket përgjimit të telefonave, regjistrimit të thirrjeve telefonike, përgjimit të mesazheve përmes telefonit dhe përgjimi përmes rrjetit kompjuterik. Ky boshllëk ligjor hap krah më krah dyert për keqpërdorime të gjithanshme nga të gjithë personat përgjegjës dhe “kompetent” për sa i përket përgjimeve.

Nisur nga rastet e përgjimeve në Kosovë, të bëra të njohura për publikun si afera, vetëm në dy vitet e fundit, në të cilat si viktime deklarohen vetë personat udhëheqës të qeverisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, deputetë, si dhe persona të tjerë në pozita udhëheqëse të institucioneve më të larta shtetërore, Avokati i Popullit konstaton se siguria nga keqpërdorimet sa i përket përgjimit të paligjshëm të komunikimeve në Kosovë, e drejtë e garantuar me Kushtetutë, është baras me zero. Në Kosovë nuk ka as siguri minimale nga përgjimet abuzive të komunikimit! Sikurse autoritetet vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare përgjegjëse në Kosovë, kanë dështuar plotësisht në ofrimin e sigurisë së komunikimeve të të gjitha llojeve në Kosovë.

---

<sup>62</sup> *IAP, Rasti nr. 457/2012.* Ankesa e qytetares në Prizren për shkak të plasaritjes së shtëpisë private nga punimet në një objekt për restorant. Drejtoria për Emergjencë dhe Shpëtim, kishte dalë në vend të ngjarjes dhe kishte përpiluar një raport, duke konstatuar dëmtimet e dukshme të shtëpisë.

Më 15 tetor 2012, përfaqësues të IAP kanë takuar Inspektorin e ndërtimit të komunës së Prizrenit. Sipas informatave të inspektorit, ai ka vërejtur plasaritjet, mirëpo nuk ka mund të konstatojë shkaktarin e dëmtimeve të shtëpisë së ankueses dhe nëse mund të jetojë ankuesja në atë shtëpi. Ai deklaroi po ashtu se nuk ka ekspertizë të ndërtimit, për arsye se nuk ka ekspert të ndërtimit në Komunë, për të konstatuar sigurinë. Inspektori po ashtu njoftoi se, ndërtuesi i objektit në fjalë – restorantit, ka leje ndërtimi dhe mbikëqyret nga Inspektorati i ndërtimit. Ankuesja ka njoftuar se, nëpërmjet avokates së saj, ka paraqitur padinë në gjykatë. Ky rast ka përfunduar, pasi që ankuesja është në shfrytëzim të mjeteve juridike dhe pret zgjidhjen e ankesës nëpërmjet gjykatës.

*IAP, Rasti 539/2012.* Ankesa e qytetarit në Prizren, lidhur me vendosjen e trafos për energji elektrike në pronën e ankuesit. Më 16 janar 2013, Avokati i Popullit i ka dërguar letër Drejtorit menaxhues të KEK-ut. Por, lidhur me këtë ankuesi ka njoftuar se ka paraqitur padi në gjykatë. Ky rast ka përfunduar, pasi që ankuesi është në shfrytëzim të mjeteve juridike dhe pret zgjidhjen e ankesës nëpërmjet gjykatës.

## Avokati i Popullit rekomandon që:

- *Policia e Kosovës dhe inspeksionet komunale të veprojnë në mënyrë të vendosur bazuar në ligj për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë në të gjitha format e shprehura të saj.*
- *Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, ta procedojnë për miratim Ligjin për përgjim të telekomunikimeve në Republikën e Kosovës, i cili duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me kriteret dhe normat e përcaktuara nga instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës.*

### 2.12. E drejta e martesës dhe familjes

Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.<sup>63</sup> Marrëdhëniet martesore midis bashkëshortëve themelohen me vendim të lirë të tyre për të lidhur martesë, dhe mbështeten në barazinë ndërmjet tyre, respektin të ndërsjellët dhe ndihmën reciproke.<sup>64</sup> Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohet edhe me Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, si dhe me KEDNJ, të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.

Parimet bazë që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të bashkëshortëve janë barazia e bashkëshortëve në përfitimin e të drejtave dhe marrje të detyrimeve gjatë martesës, respektimi i të drejtave të njeriut brenda lidhjes martesore, si dhe bashkëpunimi në interes të familjes dhe të bashkëjetesës. Në kuadër të këtij parimi hyn edhe Shkurorëzimi si institucion i së drejtës familjare i cili mundëson zgjidhjen e martesës së plotfuqishme.<sup>65</sup>

Sipas KEDNJ-së, bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësive me karakter civil midis tyre edhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre gjatë lidhjes bashkëshortore dhe pas zgjidhjes së saj. Kjo e drejtë përfshinë edhe detyrimin e shtetit për të respektuar këtë të drejtë dhe të sigurojë mekanizma për mbrojtje të saj.<sup>66</sup>

Edhe në periudhën raportuese 2012, Avokati i Popullit ka pranuar numër të ankesave sa i përket cenimit të kësaj të drejte. Rastet më të shpeshta kanë të bëjnë me zvarritjen e proceduarve të shkurorëzimit, procedurat për të vendosur rreth kujdestarisë së fëmijëve të mitur, pagesës së alimentacionit dhe mosekzekutimit të vendimeve. Brengosëse për Avokatin e Popullit, janë

<sup>63</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 37.

<sup>64</sup> Ligji për familjen i Kosovës Nr. 2004/32.

<sup>65</sup> Po aty, neni 68.

<sup>66</sup> KEDNJ, neni 5 i Protokollit nr. 7.

shkurorëzimet sepse në këto raste viktimat janë fëmijët (të mitur), të cilët pas zgjidhjes së martesës detyrohen të ndahen nga njëri prind. Ka raste madje kur fëmijët ndahen edhe nga të dy prindërit dhe kujdestarinë e fiton një i personi i tretë. E kjo ndikon negativisht në rritjen, zhvillimin dhe edukimin e tyre.

Në të gjitha rastet e shkurorëzimit, vendimet e autoriteteve publike duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës.<sup>67</sup> Fëmija nuk do të ndahet nga prindërit kundër vullnetit të vet, përveç në raste kur autoritetet kompetente përcaktojnë në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme, se ndarja e tillë është e domosdoshme për interesin më të mirë të fëmijës.<sup>68</sup>

Nga informatat e pranuar nga Departamenti i Mirëqenies Sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), rezulton se këtë vit, në të shumtën e rasteve, kujdestarinë për fëmijët e kanë fituar prindërit e gjinisë mashkullore, derisa nga statistikat e vitit të kaluar kanë qenë nënat ato që më shumë e kanë fituar kujdestarinë pas zgjidhjes së martesës.<sup>69</sup>

### **2.12.1. Zvarritja e procedurave gjyqësore në raste të shkurorëzimit**

Në rastin e ankueses nga Prizreni, ende vazhdon të mbetet e pazgjidhur e drejta për pagesën e alimentacionit për fëmijën e mitur, për shkak të zvarritjes së procedurës së ekzekutimit të aktvendimit nga Gjykata Komunale në Suharekë.<sup>70</sup> Edhe pas letrës së dytë të dërguar nga Avokati i Popullit, nuk është pranuar asnjë përgjigje. Dështimi i tillë i gjykatave është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ, i cili bën thirrje për një procedim gjyqësor efektiv brenda një afati të arsyeshëm kohor.<sup>71</sup>

Ankuesja nga Peja, pas zgjidhjes së martesës dhe aktgjykimit të gjykatës për ruajtjen dhe besimin e fëmijëve asaj, ende se ka realizuar këtë të drejtë. Ajo ka kërkuar ekzekutimin e aktvendimit nga gjykata komunale në Pejë. Pas kërkesës së ankueses, IAP ka monitoruar gati të gjitha seancat gjyqësore dhe ka biseduar edhe me gjyqtarë të çështjes lidhur me rastin, pasi rasti ka kaluar te gjyqtarë të ndryshëm.<sup>72</sup>

Pas hetimit dhe shumë veprimeve të ndërmarra nga IAP, ankuesja ka takuar fëmijët për herë të parë pas zgjidhjes së martesës. Avokati i Popullit vazhdon me ngulm të kërkojë ekzekutimin aktvendimit të gjykatës për realizimin e të drejtës prindërore për kujdestarinë e fëmijëve të mitur të saj.

---

<sup>67</sup> *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve* (KDF) neni 3 (1).

<sup>68</sup> *Po aty*, neni 9 (1).

<sup>69</sup> Informata nga Departamenti i Mirëqenies Sociale të MPMS, 1 nëntor 2012. Statistikat për nëntë muaj, janar-shtator 2012. Numri i shkurorëzimeve 118, numri i fëmijëve, nga rastet e shkurorëzuara 223. Besuar babait 107, nënës 90, të përziera 24 dhe 2 të përcaktuar.

<sup>70</sup> *IAP, Rasti A. Nr. 266/2011.*

<sup>71</sup> *KEDNJ*, neni 6.

<sup>72</sup> *IAP, Rasti nr. 90/2012.*

Mirëpo ka edhe raste ku gjykata vepron me efektivitet më të madh, si në rastin e ankueses nga Komuna e Deçanit. Ankuesja ka kërkuar nga IAP që të hetohet arsyeja e zvarritjes së procedurës gjyqësore për pagimin e alimentacionit nga Gjykata Komunale në Deçan, pas zgjidhjes së martesës. Rasti është përcjellë nga IAP. Avokati i Popullit ka kërkuar sqarime nga autoritetet kompetente për rastin në Gjykatën Komunale në Deçan dhe falë angazhimit të IAP, gjykata komunale në Deçan, ka vendosur për pagimin e alimentacionit.<sup>73</sup>

Një aspekt i veçantë i të drejtës martesore dhe familjare është edhe çështja e adoptimit (birësimit). Edhe pse IAP gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pranuar ankesa lidhur me këtë çështje, sipas të dhënave nga Departamenti i Mirëqenës Sociale të MPMS, në Kosovë janë gjithsej 1.245 fëmijë pa përkujdesje prindërore, të cilët janë të vënë nën kujdestari. Prej tyre 1.153 janë raste të bartura nga viti 2011, ndërsa 92 janë raste të reja të vitit 2012. Nga këta fëmijë të braktisur 24 janë adoptuar nga familje të ndryshme.<sup>74</sup>

Qendrat për punë sociale (QPS) luajnë rol të rëndësishëm në çështjet e ndryshme familjare si p.sh., gjatë procedurave të shkurorëzimit, përcaktimit të kujdestarisë dhe adoptimit. Avokati i Popullit kërkon nga QPS-të ta kryejnë detyrën e vet me përkushtim dhe në mënyrë profesionale, pa ndikime nga jashtë dhe pa anime, bazuar në ligj, sepse mendimi i tyre profesional luan rol të rëndësishëm në marrjen e vendimeve nga gjykatat, që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve, si dhe me procedurat e pajtimit të bashkëshortëve.

Roli vendimtar në vendosjen e çështjeve familjare i takon gjyqësorit. Prandaj, Avokati i Popullit kërkon përkushtimin më të madh profesional për marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre, në kohë të arsyeshme dhe pa zvarritje procedurale.

### **Rekomandime:**

- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës të vazhdojë me emërimin e gjyqtarëve të rinj, në mënyrë që të rritet efektiviteti në gjykata dhe të shmangen zvarritjet e ndryshme.*
- *Instituti Gjyqësor i Kosovës të organizojë edhe më tutje trajnime për gjyqtarë që gjykojnë çështje familjare.*
- *Gjykatat të jenë të paanshme në marrjen e vendimeve, sidomos në aspektin e diskriminimit gjinor, në rastet përcaktimit të kujdestarisë prindërore për fëmijët.*
- *QPS-ët të kryejnë detyrat e tyre profesionale dhe t'u përgjigjen gjykatave lidhur me vlerësimet e rasteve në cilësinë e ekspertëve.*

---

<sup>73</sup> IAP, Rasti nr. 13/2012.

<sup>74</sup> Informata nga Departamenti i Mirëqenies Sociale të MPMS, më 1 nëntor 2012.

### 2.13. Liria e fesë, besimit dhe ndërgjegjes

Pas vërejtjeve të shumta të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës<sup>75</sup> dhe organizatave tjera për ekzistimin e nevojës që statusi juridik i bashkësive fetare në Kosovë të rregullohet me ligj, mund të thuhet se gjatë kësaj periudhe raportuese ka ardhur deri te lëvizja për zgjidhjen e këtij problemi. Qeveria e Kosovës, nga fundi i vitit 2011, Kuvendit të Kosovës ia ka dërguar Draftligjin për liritë fetare, që sjell propozime për zgjidhjen e çështjes së pozitës juridike të bashkësive fetare. Me ndryshimet e propozuara ligjore, pozita juridike do të duhej rregulluar në mënyrë institucionale.

Nxjerrja e këtij ligji i jep kontribut respektimit të lirive fetare, besimit dhe ndërgjegjes, që garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>76</sup> dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut KEDNJ.<sup>77</sup>

Me ndryshimet ligjore që duhet bërë, me miratimin e Draftligjit për liritë fetare, parashihet rregullimi i mënyrës dhe kushteve të regjistrimit të bashkësive fetare, e po ashtu caktohet edhe organi kompetent për regjistrimin e bashkësive fetare në Kosovë.<sup>78</sup> Me miratimin e risive ligjore duhet të rregullohet edhe mënyra e pagesës së tatimit në të ardhura të personelit klerik dhe laik, të cilët punojnë për organizatat fetare dhe nga ta marrin paga.

Po ashtu, neni 4A i Draftligjit sjellë risi qenësore. Në paragrafin 1 të këtij neni të draftligjit, në mënyrë eksplicite përmenden bashkësitë fetare të cilat i njeh ligji, e ato janë Bashkësia Islame e Kosovës, Kisha Ortodokse Serbe, Kisha Katolike, Bashkësia e Fesë Hebreje dhe Kisha Evangjeliste. Në paragrafët pasues të këtij neni theksohen obligimet që i kanë bashkësitë fetare si persona juridik ndaj Ministrisë së Drejtësisë, e cila do të jetë kompetente për çështje të bashkësive fetare.<sup>79</sup>

Neni 7 i këtij Draftligji sjellë në hollësi rregullat për mënyrën e regjistrimit të bashkësive fetare, ndërsa paragrafi 2 i nenit 7 parasheh rregullën që bashkësitë fetare kanë obligim që të

---

<sup>75</sup> *Ex officio* raporti i IAP, nr. 145/2010, IAP, Lidhur me mosekzistimin e akteve normative për zgjidhjen e pozitës juridike dhe statusit të bashkësive fetare në Kosovë, dërguar Kuvendit të R. së Kosovës, më 30.7.2010.

<sup>76</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës - neni 38 [Liria fetare, e besimit dhe ndërgjegjes] garanton: “2. Liria e fesë, besimit dhe ndërgjegjes përfshinë të drejtën për pranimin dhe shprehjen e fesë së vet, të drejtën për shprehjen e besimit personal dhe të drejtën e pranimit apo mospranimit të anëtarësisë në ndonjë bashkësi apo grup fetare.”

<sup>77</sup> KEDNJ, neni 9, [Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë]: “1. Secili ka të drejtë në lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, kjo e drejtë përfshinë të drejtën e lirisë së ndërrimit të fesë apo besimit dhe lirinë e njeriut që, vetë apo së bashku me të tjerët, publikisht apo privatisht, të shprehë fenë apo besimin përmes lutjes, predikimit, praktikës dhe respektimit. 2 Liria e predikimit të fesë apo besimit mund t’i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, apo mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

<sup>78</sup> Kuvendi i Kosovës, draftligjet, Draftligji për ndryshimin e Ligjit për liritë fetare, faqja 2 neni 1A, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/pdf> ( 2. 11. 2012.)

<sup>79</sup> Po aty, fq. 3 e 4, neni 4A.

respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe rendin kushtetues dhe se, në të kundërtën, mund t'iu refuzohet regjistrimi.<sup>80</sup>

### **2.13.1. Bashkësitë fetare**

Liritë dhe të drejtat e bashkësive fetare që janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>81</sup> dhe Ligjin për bashkësitë fetare në Kosovë,<sup>82</sup> do të duhej në tërësi të rregullohen dhe mbrohen me miratimin e ndryshimeve të propozuara të ligjit ekzistues për liritë fetare.

### **2.13.2. Gjendja në terren**

Problemet me të cilat janë ballafaquar bashkësitë fetare në Kosovë janë të ngjashme si ato të viteve të mëparshme, në masë më të vogël apo më të madhe. Numri i besimtarëve është i njëjtë, në të vërtetë, numri më i madh, rreth 90 % të popullsisë janë besimtarë të Bashkësisë Islame në Kosovë, rreth 7 % të popullsisë janë besimtarë të Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa bashkësitë e tjera fetare së bashku plotësojnë përqindjen tjetër të mbetur. Gjatë kësaj periudhe raportuese, vërehet aktiviteti i shtuar i Bashkësisë Hebraike, për çka do të bëhet fjalë më tutje në tekst.

### **2.13.3. Bashkësia Fetare Islame**

Një nga problemet më të mëdha, që viteve të kaluara i ka theksuar Bashkësia Fetare Islame dhe që, disa herë ka nxitur protesta dhe tubime masive publike të besimtarëve të Bashkësisë Fetare Islame, e për të cilin IAP ka tërhequr vëmendjen në periudhat e kaluara raportuese, ka qenë nevoja e ndërtimit të xhamisë së re në pjesën qendrore të qytetit.<sup>83</sup> Autoritetet e qytetit të Prishtinës i kanë dalë në përkrahje kësaj kërkesë të Bashkësisë Fetare Islame dhe i kanë lejuar hapësirë në qendër të qytetit, në të cilën në tetor të vitit 2012 filloi ndërtimi i xhamisë së re.<sup>84</sup>

---

<sup>80</sup> Po aty, fq. 6, neni 7 paragrafi 2.

<sup>81</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 39, [Bashkësitë fetare]: „1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë e të gjitha bashkësive fetare dhe monumenteve brenda territorit të vet. 2. Bashkësitë fetare janë të lira që në mënyrë të pavarur rregullojnë organizimin e vet të brendshëm, veprimtarinë fetare dhe ritualet fetare. 3. Bashkësitë fetare kanë të drejtë në themelimin e shkollave fetare dhe organizatave humanitare, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe ligj.“

<sup>82</sup> Ligji nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 13. 7. 2006, dhe i botuar nga SPGS 24. 8. 2006.

<sup>83</sup> Raporti vjetor i IAP për vitin 2011, fq. 48.

<sup>84</sup> *Ka filluar ndërtimi i xhamisë së madhe në Prishtinë*, Evropa e Lirë, (8.10.2012) <http://www.slobodnaevropa.org/archive/news/20121008/> (13.11.2012.).



Po ashtu, një nga ngjarjet më të rëndësishme për Bashkësinë Fetare Islame është kyçja e Fakultetit për Studime Islamike në sistemin e universitetit publik. Përfaqësuesit e këtij fakulteti konsiderojnë se bashkimi me universitetin ia mundëson fakultetit financimin publik, që nënkupton se në këtë mënyrë, nga buxheti i shtetit do të paguhen pagat për 23 profesorë, si dhe për personelin plotësues administrativ të fakultetit. Përveç përkrahjes financiare që do ta marrin, bashkëngjitja universitetit për përfaqësuesit e këtij fakulteti është me rëndësi edhe për shkak të lehtësimit të pranimit të diplomave të studentëve, sepse më herët ka ndodhur që Ministria e Arsimit këtë nuk e ka lejuar përherë.<sup>85</sup>

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur edhe protesta për shkak të pakënaqësisë lidhur me bartjen e shamive në shkollat publike fillore dhe të mesme në Kosovë. Me rëndësi është protesta që u mbajt më 23 shkurt 2012, kur në rrugët e Prishtinës u tubuan rreth 5000 njerëz. Ata arsye kryesore për tubim dhe organizim të protestës e kishin vendimin e Ministrisë së Arsimit për të ndaluar bartjen e shamive për nxënëset dhe arsimtaret nëpër shkolla në Kosovë. Kjo ndalesë ka hasur në mosmiratim nga një pjesë e organizatave joqeveritare dhe pjesëmarrëse të protestës, të cilët kanë vlerësuar se me këtë vihen në pikëpyetje të drejtat e tyre të njeriut. Në këtë protestë kanë marrë pjesë demonstrues nga mbarë Kosova.<sup>86</sup>

Problemi i bartjes së shamive në shkollat fillore dhe të mesme publike në Kosovë, nuk është zgjidhur në mënyrë unike në mbarë territorin e Kosovës. Në disa komuna në Kosovë, kjo çështje është zgjidhur varësisht nga vullneti i kryetarëve, drejtorëve komunalë për arsim, apo drejtorëve të shkollave të caktuara. Thjesht, për shkak të pavendosmërisë së institucioneve publike kompetente në nivel kombëtar, vjen edhe deri te qëndrimet e ndryshme në mjedise të ndryshme në Kosovë, për sa i përket këtij problemi ende të pazgjidhur. Për shkak të situatës kështu të krijuar, është e kuptueshme se vjen deri te diskriminimi ndërmjet vetë nxënësve në shkolla dhe mjedise të ndryshme në Kosovë krahasuar me të tjerët. Avokati i Popullit pret nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës që të hapin debat institucional për këtë problem dhe të gjejnë zgjidhje më të volitshme definitive për fëmijët në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë.

#### **2.13.4. Kisha Ortodokse Serbe**

Problemet me të cilat është ballafaquar Kisha Ortodokse Serbe gjatë vitit 2012, janë të ngjashëm si edhe në periudhat e mëparshme raportuese. Më të theksuar janë rastet e dëmtimit të kishave dhe varrezave lokale, me gjithë që në këtë periudhë raportuese kishte dukshëm më pak raste të tilla se sa më parë.

---

<sup>85</sup> Muhamet Brajšhori, Universiteti i Prishtinës integron programin e studimeve islamike, *SETimes.com*, (22.10.2012). [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sr\\_Latn/features/setimes/features/2012/10/22](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sr_Latn/features/setimes/features/2012/10/22), (13.11.2012.).

<sup>86</sup> Rreth 5000 njerëz kanë protestuar për bartjen e shamive, *Sanxhak Europe*, (23.2.2012) <http://sandzak.eu/?p=366>, 13.11.2012.

Dëmtime serioze ka pasur Kisha e Shën Arhangjellit Mihajlit në Shtime, nga e cila në korrik të vitit 2012, është marrë i tërë kulmi me plumb, ndërsa kisha është dëmtuar dukshëm. Përndryshe kjo kishë në disa vite të kaluara është rinovuar disa herë.<sup>87</sup> Po ashtu, deri te hyrja dhe vjedhja ka ardhur edhe më 10 shkurt 2012, në kishën e Shën Nikollajit në Kamenicë<sup>88</sup> dhe, më 3 mars 2012, në fshatin Stanishor, po ashtu është vjedhur kisha e Shën Gjergjit. Sipas fjalëve të zëdhënësit të Policisë së Kosovës për Rajonin e Gjilanit, pas vlerësimit të kryer, policia ka ardhur në konkludim se motivet e dëmtimit dhe vjedhjes në kishë nuk janë të natyrës etnike, por fjala është për vjedhje dhe përfitim të dobisë materiale.<sup>89</sup>

Me rastin e vizitës së varrezave lokale në fshatin Zhaç, banorët e këtij fshati kanë hasur në dëmtime të shumta të pllakave të varrezave, ndërsa një pjesë e rrethojës rreth varrezave është shkukur dhe vjedhur.<sup>90</sup> Gjatë vitit 2011, me qëllim të zgjidhjes së problemit të rikonstruktimit të varrezave, Ministria e Administrimit Lokal ka nisur iniciativën e pastrimit të varrezave në Prishtinë. Pjesa e parë e aksionit ka përfunduar, ndërsa tash fillohet me pjesën e dytë që do të duhej të përfshijë kryerjen e punëve për rregullimin e varrezave dhe rikonstruktimin e objektit të kapelës së vjetër dhe të re.<sup>91</sup>

Vëmendje të posaçme mbrojtjes së përmendoreve dhe objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe po i kushton Zyra për çështje të komuniteteve që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Nga informatat që mund të merren nga faqja zyrtare e Zyrës së Kryeministrit është parashikuar formimi i “zonave speciale mbrojtëse” (ZSM) rreth përmendoreve dhe ndërtesave që janë të rëndësishme për komunitetin serb, apo qendrave historike të qyteteve, e që do të kontrollohen nga Këshilli për zbatim dhe përcjellje (KZP). Sipas informatave nga ueb faqja zyrtare e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, nëse ndonjë zonë është caktuar si zonë e mbrojtur speciale, ajo është e siguruar nga çfarëdo ndodhi apo aktivitete që mund ta dëmtoj kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik, mjedisin natyror apo rrethimin estetik.<sup>92</sup>

---

<sup>87</sup> Është shkatërruar tempulli i Shën Arkangjelit Mihajlo, *KIM radio* (19.07.2012),

<http://www.radiokim.net/vesti/stimlje-devastiran-hram-svetog-arhangela-mihaila.html>, 13.11.2012.

<sup>88</sup> Është përdhosur dhe plaçkitur kisha në Kamenicë *Tanjug* (10.02.2012),

<http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/306500/Oskrnavljena-i-opljackana-crkva-u-Kosovskoj-Kamenici>, 13.11.2012.

<sup>89</sup> Është vjedhur kisha në Stanishor, *KIM RTV PLUS*, (03.03. 2012) <http://www.radiokim.net/vesti/objijena-crkva-u-stanisoru.html>, 13.11.2012.

<sup>90</sup> Janë përdhosur varrezat serbe në Zhaç *net*, (6.10.2012) <http://www.naslovi.net/2012-10-06/b92/oskrnavljeno-srpsko-groblje-u-zacu/3933574>, 13.11.2012.

<sup>91</sup> Ftesë të zhvendosurve që të kthehen, *B92 Lajme*, (3.11.2012), 13.11.2012.

<sup>92</sup> Zyra e Kryeministrit të Kosovës, zyra për komunitete, Kultura dhe religjioni, trashëgimia fetare dhe kulturore <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,82>, 13.11.2012.

### **2.13.5. Kisha Katolike në Kosovë**

Problemet e Kishës Katolike në Kosovë në këtë periudhë raportuese nuk dallojnë shumë nga ato që janë përmendur në raportet paraprake të IAP. Poashtu, edhe pjesëtarët e Kishës Katolike viteve të mëparshme kanë theksuar nevojën e rregullimit të pozitës juridike të bashkësive fetare. Struktura kombëtare e besimtarëve është e njëjtë si edhe vitet paraprake, kryesisht janë Shqiptarë, por ka edhe Kroatë, që më së shumti janë të vendosur në vendbanimet Janjevë dhe Letnicë. Te Kroatët kryesisht fjala është për popullatë të moshuar, njerëz të rinj ka relativisht pak. Për personat e moshuar më së shumti kujdeset Kisha Katolike përmes priftërinjve të vet.<sup>93</sup>

Problemi i popullatës gjithnjë e më të moshuar në këto vende për çdo ditë është më i madh, e si tregojnë priftërinjtë e Kishës Katolike nga ky vend, arsye e kësaj është zhvendosja konstante e popullatës, që është e kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm por ata shpresojnë në ndihmën e përzemërt të institucioneve shtetërore.<sup>94</sup>

### **2.13.6. Kisha Protestante Evangjeliste e Kosovës**

Kisha Protestante Evangjeliste e Kosovës, edhe këtë vit, si dhe viteve të mëparshme, është ndër më të interesuarit për zgjidhjen e pozitës juridike të bashkësive fetare në Kosovë. Pozita juridike e bashkësive fetare, e cila për ta, me mënyrën e deritashme të rregullimit ka qenë plotësisht e pakënaqshme, do të duhej të rregullohet me nxjerrjen e ligjit të ri. Lidhur me këtë përfaqësuesit e kësaj kisha kanë potencuar këtë gjë edhe më herët.<sup>95</sup> Për rastet e dëmtimit të objekteve të Kishës Protestante sivjet nuk ka pasur informata.

### **2.13.7. Bashkësia Hebraike në Kosovë**

Për dallim nga vitet e mëparshme kur nuk ka pasur informata për punën dhe aktivitetet e Bashkësisë Hebraike në Kosovë, gjatë vitit 2012, kemi shënime për aktivitetin e tyre.. Pjesa më e madhe e informatave Pjesa më e madhe e informatave për aktivitetet aktuale të Hebrenjve në Kosovë mund të gjendet në ueb faqen e organizatës së Miqësisë kosovare-izraelite, që mbanë

---

<sup>93</sup> Raport për jetën e Kroatëve të Kosovës në Viti, OSCE (tetor 2011), <http://www.osce.org/kosovo/83789>, 19.12.2012.

<sup>94</sup> Beta, Jahjaga: Bashkësia Kroate pjesë e Kushtetutës së Kosovës, *Blic Rs.* (20.5. 2012), <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/324567/Jahjaga-Hrvatska-zajednica-deo-u-Ustavu-Kosova>, 18.11.2012.

<sup>95</sup> Nga debati publik i Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe persona të zhdukur dhe peticione, (1.11.2011) <http://www.assembly-kosova.org/?cid=3,128,4162>, 18.11.2012.

emrin “Dr. Haim Abravanel”, i cili ka qenë mjek i njohur dhe një nga personalitetet më të njohura në shpëtimin e hebrenjve në territorin e Kosovës gjatë holokaustit.<sup>96</sup>

Mirëpo, informata tek të cilat nuk kemi ardhur më herët, por edhe tani, janë të lidhura me kultet hebraike të lutjeve, në të vërtetë, nuk ka informata të qarta se a ekzistojnë dhe, nëse ekzistojnë, si funksionojnë ato në Kosovë. Nuk kemi arritur të gjejmë informata se a i praktikojnë dhe si i praktikojnë në Kosovë hebrenjtë traditat e tyre religjioze.

## 2.14. Liria e shprehjes

Mendimi i lirë, si dhe kërkimi, marrja dhe dhënia e informacionit dhe ideve, pa marrë parasysh kufijtë, është thelbi i asaj që quhet liri e shprehjes, e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 40), Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 19) dhe KEDNJ (neni10).

Pasqyra e përgjithshme e shpërfaqur nga opinionet publike, qoftë përmes mediave, debateve publike apo në ndonjë mënyre tjetër, si dhe nga raportimet e organizatave ndërkombëtare, reflekton një gjendje jo të kënaqshme të lirisë së shprehjes në Kosovë.<sup>97</sup>

Pikëtakimi i të drejtës së lirisë së shprehjes me të drejta të tjera shpeshherë bëhet objekt debatesh, por gjithashtu e bën më komplekse ndarjen e drejtësisë. Autoritetet kanë prirje që ta trajtojnë këtë të drejtë si çështje të kompetencës së tyre dhe jo si një të drejtë themelore.

Tendenca e cenimit të lirisë së shprehjes duke u thirrur në mbrojtje të privatësisë për çështje që mund të jenë në interes të publikut, vërehet si një çështje që kërkon vëmendje të shtuar. Pjesa e informacionit dhe dokumenteve që lidhet me personalitete dhe autoritete që kryejnë funksione publike me punën dhe interesin e vendit dhe qytetarëve të saj, duhet të jetë publike dhe objekt i informacionit që mund të jetë i qasshëm.

Avancimi teknologjik e ka vënë para sfidave lirinë e shprehjes. Në njërin anë bota e internetit dhe telekomunikimit ofron mundësi për ta realizuar këtë të drejtë me mënyra të reja të të shprehurit, ndërkaq në anën tjetër rrjedha e lirë e informacionit paraqet nevojën për ta rregulluar ligjërisht aspektin e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së saj.

Mekanizmat ligjorë në fuqi në Republikën e Kosovës, në shumicën e rasteve nuk përmbajnë dispozita ndëshkuese për mosrespektimin e të drejtave në fushën e lirisë së shprehjes. Avokimi dhe promovimi i lirisë së shprehjes nuk duhet të shihet kurrë si i tepërt dhe i panevojshëm. Kjo do të mund të bëhej edhe përmes ndonjë instrumenti të veçantë ligjor që do t'i jepte mbrojtje shtesë lirisë së shprehjes.

---

<sup>96</sup>Me rëndësi është se erdhën të gjallë, <http://www.e-novine.com/feljton/45926-Vano-stigli-ivi.html>, 19.11.2012

<sup>97</sup> Shih në: <http://www.freedomhouse.org/sites/default/files.pdf> (13.02.2013).

Në IAP gjatë vitit 2012, janë trajtuar gjithsej 25 ankesa për cenim të lirisë së shprehjes. Numri më i madh i tyre ka të bëjë me përdorimin e dygjuhësisë nëpër qendra të ndryshme komunale nëpër Kosovë, si një element i rëndësishëm dhe qenësor për të marrë dhe dhënë informacionin e nevojshëm, që hap rrugën për të realizuar të drejta të tjera individuale dhe shoqërore.

Rast flagrant i shkeljes së lirisë së shprehjes është ai i sulmit në Pallatin e Rinisë kundrejt organizatorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në promovimin e një prej numrave të Revistës *Kosovo 2.0*. Sulmi ka sinjalizuar se liria e shprehjes është e predispozuar të jetë shënjestër e fërkimeve të natyrave të ndryshme në shoqëritë me diversitet kulturor, fetar e në tranzicion, siç është kjo në Kosovë.

Avokati i Popullit ka përcjellë nga afër ngjarjet që kanë ndodhur me këtë rast, si dhe dhunën që ka pasuar ndaj organizatës “Libertas”. Në reagimin e tij publik, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin për “sulmet fizike dhe verbale, kërcënimet e drejtpërdrejta”. Pikërisht për shkak të deklarimeve publike për këtë rast, Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë cak i sulmeve verbale, mediale dhe elektronike nga individë dhe grupe të caktuara me orientime fetare ekstreme.

Në paragrafin 2 të nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shtetit i legjitimohet e drejta në kufizimin e ushtrimit të lirisë së shprehjes kur një gjë e tillë është e domosdoshme “[...] për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”<sup>98</sup>

Neni 10 i KEDNJ, mbron jo vetëm mendimet dhe informacionet të cilat pranohen qetësisht, por edhe mendimet e informacionet që mund të jenë shqetësuese dhe ofenduese, por që janë në funksion të një vlere demokratike. Ky nen mbron jo vetëm fjalën e folur ose të shkruar, por edhe imazhet, veprimet, apo edhe veshjet, nëse qëllimi është informacioni. Gjithashtu, neni 10 i kësaj Konvente mbron jo vetëm aspektin përmbajtësor të informacionit, por edhe formën përmes së cilës shprehen ato.

## **2.15. E drejta e qasjes në dokumente publike**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41) garanton të drejtën për qasje në dokumente publike. Kjo përfshin të drejtën që ka çdo person për të njohur përmbajtjen e dokumenteve që mbahen nga autoritetet publike si dhe të drejtën e qasjes në informacione publike me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Kjo e drejtë përcakton dhe vendosë rregulla për mirëfunksionimin dhe transparencën e administratës publike në raport me publikun në lidhje me veprimtarinë e përditshme të saj.

---

<sup>98</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40, paragrafi 2.

Rrjedhja e lirë e informacionit është mjet i rëndësishëm për të ndërtuar besimin mes institucioneve dhe qytetarëve, për të krijuar transparencë të veprimeve, për të ndikuar gjithashtu në efikasitet dhe efektivitet të administratës publike. Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) parasheh një procedurë gjithëpërfshirëse të qasjes në dokumente publike dhe është i rëndësishëm për faktin se përmes zbatimit të tij qytetari ndërgjegjësohet për shërbimet që i pret nga administrata, sikur që administrata ndërgjegjësohet për detyrimin që t'i ofrojë shërbime qytetarit.

Zbatimi i LQDP në Kosovë, në praktikë përcillet me vështirësi të natyrave të ndryshme. Numri i rasteve të paraqitura në IAP sa i përket mohimit të së drejtës për qasje në dokumente publike në vitin 2012 është 17. Krahasuar me vitin paraprak 2011, ka një rritje të lehtë të rasteve të paraqitura. Kësaj rritje sigurisht i kanë kontribuar një varg aktivitete të IAP qoftë gjatë takimit me qytetarë, qoftë nëpërmjet organizimeve të tryezave të rrumbullakëta, qëllimi i të cilave ka qenë ngritja e vetëdijes te qytetarët për të drejtat e tyre për t'u njohur me përmbajtjen e dokumenteve që hartohen dhe mbahen nga institucionet publike.

Më 30 janar 2012, në mbështetje të OSBE-së misioni në Kosovë, Avokati i Popullit organizoi tryezën me temën *“Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike”* qëllimi i të cilës ishte diskutimi i hapur i çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjit dhe identifikimin e sfidave që dalin gjatë zbatimit të tij në praktikë, së bashku me akterët e tjerë si komisionin parlamentar për Administratë Publike, Zyrën e Kryeministrit, shoqërinë civile dhe mediat.

Disa nga rekomandimet që dolën nga ky takim ishin se klasifikimi i dokumenteve dhe hartimi i listave të dokumenteve sipas klasifikimit nëpër secilin institucion publik duhet të bëhet për të shmangur arbitraritetin në qasjen apo refuzimin e dokumenteve zyrtare; caktimi i personave përgjegjës për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike edhe në ato institucione ku kjo nuk është bërë; organizimi i fushatave informuese për qytetarët lidhur me mundësitë që ofron ligji si dhe trajtimi i koordinuar i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe ankesave për mohim apo refuzim të qasjes në dokumente publike me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Po ashtu edhe më 19 nëntor 2012, në mbështetje të OSBE-së misioni në Kosovë dhe në organizimi të Avokatit të Popullit u mbajt tryeza e rrumbullakët me temën *“Qytetari në udhëkryq”* që për qëllim në fokus kishte diskutimin në lidhje me sfidat në zbatimin e LQPD, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë nga këndvështrimi i institucioneve të pavarura dhe nga shoqëria civile. Si konkluzion i përbashkët i pjesëmarrësve të këtij diskutimi ishte domosdoshmëria e sensibilizimit të opinionit publik për të realizuar të drejtën e qasjes në dokumente publike, si dhe ngritjen e vetëdijes së institucioneve dhe autoriteteve publike për obligimet që kanë për të respektuar këtë të drejtë.

Neni 12 dhe 13 i LQPD përcakton interesat që mund të arsyetojnë refuzimin e qasjes në dokumente publike. Sipas kësaj, personat kanë të drejtë qasje në dokumentet publike, mirëpo kjo

qasje mund t'iu nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve dhe kushteve të cilat parashikohen me ligj dhe të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesave që përmenden edhe në KEDNJ.<sup>99</sup>

LQDP gjatë zbatimit të tij duhet të harmonizohet edhe me ligjet tjera sidomos me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Dhe, siç është vërejtur në praktikë, këtu qëndron problemi më i madh tek organet e administratës. Klasifikimi i dokumenteve është një nga çështjet më komplekse në gjithë këtë proces. Klasifikimi i dokumenteve do të krijonte ndarjen e qartë të dokumenteve të qasshme dhe të atyre jo të qasshme për publikun, si dhe nuk do të linte hapësirë për shkelje të ligjit mbi bazën e supozimeve nëse një dokument është apo nuk është i qasshëm. Ka ende shumë dilema në lidhje me atë se çka konsiderohet si dokument i cili nuk mund të publikohet.

Avokati i Popullit e luan në një masë rolin e arbitrit në konfliktet që lidhen me të drejtën për t'u informuar, por pa atributet e nevojshme për ta bërë këtë në mënyrë efektive. Avokati i Popullit nuk është organ ekzekutues. Prandaj, jo rrallë herë, rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk respektohen.

Duke pasur si alternativë të vetme ankimin gjyqësor, shumë kërkues të dokumenteve publike vendosin të tërhiqen nga beteja për lirinë e informimit. Sigurisht duke pasur parasysh ngarkesën me lëndë në gjykata, vonesat në shqyrtimin e rasteve të kësaj natyre do të jenë të pashmangshme. Edhe pse në raportin vjetor të vitit të kaluar është dhënë rekomandim se duhet të krijohet një procedurë e përsheptuar gjyqësore për trajtimin e këtyre rasteve, duket që kjo në praktikë është e pamundur. Në këtë drejtim ndoshta do të duhet të mendohet seriozisht në ndryshimin e kësaj praktike, që në realitet është shumë dekurajuese për qytetarët. Në Kosovë është e domosdoshme të krijohet një mekanizëm ekzekutues, i cili do të garantonte zbatimin efikas të LQPD.

Avokati i Popullit është angazhuar në vazhdimësi që LQP të zbatohet në tërësi dhe pa zvarritje, ngase ky është kusht për transparencën e organeve të administratës të cilat duhet të jenë të hapura ndaj publikut, duke i bërë të ditura të drejtat, detyrimet dhe shërbimet e institucioneve publike ndaj tij, mënyrën se si merren ato, si dhe çka është e nevojshme për zgjidhjen e problemeve që ata kanë, në përputhje me ligjin.

Gjatë vitit 2012, Avokati i Popullit ka publikuar tri raporte me rekomandime në të cilat është evidentuar mohimi i kësaj të drejte, janë evidentuar mangësitë e shprehura si dhe janë dhënë rekomandimet. Vetëm njëri nga rekomandimet e Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve publike për mohimin e qasjes në dokumente publike, është zbatuar,<sup>100</sup> ndërsa në dy nga këto

---

<sup>99</sup> *KEDNJ Neni 10, paragrafi 2.* “Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, Sistemi i klasifikimit të Informacioneve në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

<sup>100</sup> IAP, *Raport me Rekomandime A.nr. 354/2011* në lidhje me mohimin e të së drejtës së qasjes në dokumente publike nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Agjencia pas publikimit të raportit ka vepruar në përputhje me

raporte Avokati i Popullit ose nuk ka pranuar fare përgjigje nga institucionet përgjegjëse, ose rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë zbatuar.

#### **Rekomandime:**

- *Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht për Ministrinë e Administratës Publike (MAP) të ndërmarrë veprime konkrete, për rritjen e transparencës së organeve të administratës publike, e cila duhet të jetë e hapur ndaj publikut, duke i bërë të ditura të drejtat, detyrimet dhe shërbimet e institucioneve publike ndaj tij, mënyrën se si merren ato, si dhe çka është e nevojshme për zgjidhjen e problemeve që ata kanë, në përputhje me ligjin.*
- *Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë veprime konkrete, për sensibilizimit të opinionit publik për të realizuar të drejtën e qasjes në dokumente publike, si dhe ngritjen e vetëdijes së institucioneve dhe autoriteteve publike për obligimet që kanë për të respektuar këtë të drejtë.*
- *Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë veprime konkrete për klasifikimin e dokumenteve dhe hartimin e listave të dokumenteve sipas klasifikimit nëpër secilin institucion publik, si një domosdoshmëri për të shmangur arbitraritetin në qasjen apo refuzimin e dokumenteve zyrtare;*
- *Për çdo institucion publik në Republikën e Kosovës, caktimi i personave përgjegjës për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike edhe në ato institucione ku kjo nuk është bërë.*
- *Për Kuvendin dhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë veprime konkrete që, harmonizimin e LQDP me ligjet tjera, sidomos me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë si dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të mundësuar zbatimin të tij në praktikë dhe shmangien e problemeve me të cilat ballafaqohen organet e administratës publike.*
- *Për Kuvendin e Republikës së Kosovës, për krijimin e një mekanizmi ekzekutues, i cili do të garantonte zbatimin efikas të Ligjit për qasje në dokumente publike.*
- *Zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për qasje në dokumentet publike, nga të gjitha organet në institucionet publike.*

---

rekomandimet megjithëse ankuesit nuk kanë qenë të interesuar më tutje për rastin e tyre. Po ashtu edhe rastet në IAP A.354/2011, A.502/2011, 520/2011.



## 2.16. Liria e medias

Liria dhe pluralizmi i mediave është garantuar me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në po këtë nen ndalohet censura e mediave, por në të njëjtën kohë përcaktohet se në cilat raste pengimi i shpërndarjes së informacionit bëhet i domosdoshëm.<sup>101</sup> Ndërkaq, pika 3 e po këtij neni pohon të drejtën e korrigjimit të informacionit, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar.

Në tërësinë e asaj që quhet liri e medias, e cila pashmangshmërisht është e lidhur me lirinë e shprehjes, mediat mund të pozicionohen me dy role. Sa herë informacioni përçohet saktë dhe duke respektuar standardet e profesionalizmit, media i ka shërbyer kauzës së drejtë për liri të informimit dhe interesit të përgjithshëm. Në të kundërtën, nga prijatare dhe avokuese, mediat shndërrohen në instrumente që cenojnë bazamentin e lirisë së shprehjes, apo në raste më të skajshme ato bëhen edhe shkelëse të asaj çfarë nënkupton liria e mediave dhe e shprehjes.

Mediat janë burimi kyç i informacionit. Por, në rastet kur mungon pavarësia e tyre ekonomike, në raste paqartësish a vakumesh ligjore, apo edhe në raste mosrespektimi të ligjeve përkatëse, liria e medias me qëllim informacionin e publikut, vihet në dilemë. Vetëm garantimi ligjor nuk zvogëlon dilemat e vazhdueshme nëse mediat vërtetë janë të lira në transmetimin e informacionit të saktë, në mënyrë të besueshme e të pavarur.

Pavarësia e mediave dhe infrastruktura ligjore e lirisë së tyre mbetet çështje që në vazhdimësi theksohet në raportet e ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për Kosovën. Organizatat ndërkombëtare, në raportet e tyre, në mënyrë të veçantë e evidentojnë mungesën e lirisë së mediave.<sup>102</sup>

Përkundër vërejtjeve dhe rekomandimeve që Avokati i Popullit i ka paraqitur në Raportin vjetor të vitit të kaluar lidhur me nenet kontestuese 37 dhe 38, Kuvendi i Kosovës e miratoi Kodin Penal. Këto dy nene ishin në mospërputhje me Ligjin mbi Shpifjen dhe Fyerjen dhe në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës së vendit që garanton lirinë e mediave. Pas miratimit të Kodit Penal nga Kuvendi i Kosovës me këto dy nene, Avokati i Popullit ka hapur rast *ex officio*. Pas reagimit të ashpër të mediave, shoqërisë civile por dhe opinionit, pas rikthimit në rishqyrtim dhe rivotim të këtij Kodi në Kuvend, janë hequr nga Ligji nenet kontestuese dhe rasti në IAP është mbyllur.<sup>103</sup>

Në IAP janë paraqitur edhe dy raste të tjera që kanë pretenduar për shkelje të lirisë së medias. Njëri për lirinë e shpërndarjes së informacionit, por është vërtetuar se në rastin në fjalë nuk ka pasur shkelje të kësaj natyre.

---

<sup>101</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 42, pika 2.

<sup>102</sup> *Freedom House*, Raportet, Liria e shtypit 2012, Radhitja globale dhe regjionale.

[http://www.freedomhouse.org/sites/default/files/\(13.03.2013\)](http://www.freedomhouse.org/sites/default/files/(13.03.2013)).

<sup>103</sup> *IAP, Rasti 338/2012*, Institucioni i Avokatit të Popullit kundër Kuvendit të Kosovës.

Rasti i dytë ka pasur të bëjë me konkurrencë jolojale me hapësirën operuese mediale. Ky rast është shpallur i papranueshëm për shkak se pala ka qenë në proces të shfrytëzimit të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit është i shqetësuar me rastet e ushtrimit të dhunës dhe presionit, shantazhet, kërcënimet apo format e tjera të ndryshme të pengimit të punës së gazetarëve në Kosovë. Por po aq brengosës është vetë fakti se edhe vetë gazetarët dhe mediat nuk i lajmërojnë në IAP rastet që kanë të bëjnë me cenimin e lirisë dhe të drejtave të tyre, përkundër deklarameteve publike, të shoqëruara edhe me storie dhe me pamje të sjelljeve të papranueshme ndaj gazetarëve. Paraqitja e rasteve të tilla do të ofronte një pamje të qartë dhe të dhëna shumë më të sakta se sa dhe si, nga kush dhe në cilat momente cenohet dhe shënjestrohet liria e mediave në Kosovë.

Avokati i Popullit vlerëson si shumë pozitiv dhe të rëndësishëm faktin se RTK 2 ka ofruar platformë të mirë për hapësirë mediale në gjuhën serbe. Por ende mungon hapësirë mediale dhe ka nevojë për ngritje kapacitetesh të kuadrove, qoftë në mediat elektronike, qoftë në mediat e shkruara, për komunitetin turk, boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptas.

Çështja e pavarësisë financiare dhe profesionale të transmetuesit publik RTK, vazhdon të jetë një çështje e ndjeshme dhe kërkon zgjidhje ligjore të pranueshme për natyrën e mediave të lira. Respektimi i plotë i lirisë së mediave është thelbësor për funksionimin e demokracisë, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Liria e mediave është gjithashtu çështje kyçe për të siguruar që qytetarët të kenë rol aktiv në jetën publike dhe në proceset demokratike.

Avokati i Popullit kërkon nga institucionet relevante, që në bashkëpunim me gazetarët të përgatisin një strategji për krijimin e hapësirës së nevojshme, për përmirësimin e lirisë së mediave. Në anën tjetër, respektimi i Ligjit të punës, në mënyrë të veçantë sa i përket kontratave të punës, do të ndihmonte në mbrojtjen e gazetarëve nga presionet brenda medimeve dhe do të ndikonte në kushte më të mira pune. Gjithsesi, situata e përgjithshme ekonomike, reflekton edhe në situatën e përgjithshme të mediave, prandaj përkrahja institucionale është e domosdoshme.

## 2.17. Liria e tubimit

E drejta e Lirisë së tubimit paqësor, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<sup>104</sup> Duke qenë një nga të drejtat themelore të njeriut, kjo e drejtë është përcaktuar qartë në instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme në Kosovë.<sup>105</sup>

---

<sup>104</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 43. "Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to".

<sup>105</sup> *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, neni 20, par. 1; *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike*, neni 21; *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, neni 11. "Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit

Kjo e drejtë në Republikën e Kosovës, si kategori kushtetuese, me gjithë kufizimet e domosdoshme ligjore, asnjëherë dhe në asnjë mënyrë, në kushtet e gjendjes së zakonshme, nuk guxon të privohet nga substanca e saj. Kufizimet ligjore të kësaj të drejte, zbatohen vetëm nëse *“është e domosdoshme për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.”*<sup>106</sup>

Në përgjithësi mund të themi se kjo e drejtë gjatë viti 2012 është ushtruar në masë të konsiderueshme nga ana e qytetarëve të cilët, përmes organizimeve, tubimeve dhe protestave të tyre, kanë shprehur kërkesat, pakënaqësitë dhe kundërshtimet lidhur me çështje të ndryshme.

IAP gjatë vitit 2012 ka monitoruar disa nga protestat e organizuara në Kosovë, me qëllim të vëzhgimit nga afër të ecurisë së këtyre ngjarjeve si dhe mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë. IAP në përgjithësi ka vërejtur se angazhimi dhe sjelljet e pjesëtarëve të policisë në shumicën e rasteve kanë qenë korrekte. Po ashtu, në shumicën e këtyre protestave është vërejtur se organizatorët e protestave kanë ftuar për protesta paqësore dhe kanë bërë përpjekjeve të vazhdueshme që protestat të jenë paqësore. Mirëpo, me gjithë përpjekjet e dyanshme, ka pasur raste kur situata në protesta ka eskaluar.

Avokati i Popullit në bazë të kompetencave dhe misionit të tij ligjor, pas deklaratave dhe tensionimit të gjendjes në lidhje me mbajtjen e protestës së paralajmëruar nga Lëvizja Vetëvendosje, më 14 janar dhe 22 janar 2012, angazhoi 4 ekipe për të vëzhguar situatën në vendet ku po zhvilloheshin protestat në pikat kufitare Dheu i Bardhë dhe Merdare, me qëllim të mbikëqyrjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.<sup>107</sup>

Avokati i Popullit, gjatë këtij monitorimi ka vërejtur se, intervenimi i policisë, përfshirë përzgjedhjen e mjeteve dhe të metodave, si dhe përdorimi i forcës, gjatë protestave më 14 janar 2012 në Podujevë dhe tek Dheu i Bardhë, ka qenë i panevojshëm, i pajustificueshëm dhe joproportional.

Gjatë monitorimit të protestës të datës 14 janar 2012, Avokati i Popullit ka vërejtur se, përveç në vendin e protestës, dhuna e pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës është përdorur edhe gjatë transportimit të të arrestuarve dhe është përcjellë me veprime degraduese e poshtëruese, duke mos e kursyer edhe një përfaqësues të mediave, i cili ishte në krye të detyrës.

---

paqësor [...], ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike [...].”

<sup>106</sup> *Ligji për tubimet publike*, Nr. 03/L-118, neni 5, par. 3: “Organet kompetente për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë e sigurisë mund të ndërmarrin masa të përdorimit të dhunës vetëm atëherë kur tubimi publik përkatësisht protesta rrezikon të prish ose shkatërroj të mirat e përgjithshme”.

<sup>107</sup> Deklaratë për media e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje: “*Ne do të qëndrojmë aty derisa Qeveria të mos fillojë ta zbatojë vendimin e Kuvendit të Kosovës*”; Deklaratë për media e Ministrit të MPB: “*Të gjithë ata që e përkrahin Lëvizjen Vetëvendosje të shtunën mund të përballen me përdorim të forcës nga ana e Policisë së Kosovës*”. Në: <http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/rubrika/C21/C6/?cid=1,15,71429> (10.02.2012) dhe <http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/rubrika/C21/C6/?cid=1,15,71429> (10.02.2012).

Avokati i Popullit konsideron se, në kryerjen e rolit të saj, policia është e obliguar dhe duhet të ketë synim parësor mbrojtjen të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për këtë e obligon ligji vendor dhe obligimet e marra ndërkombëtare.<sup>108</sup> Këtu sidomos theksohet mbrojtja e të drejtave të njeriut sipas parimeve të KEDNJ-së, e cila jo vetëm obligon për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive, por njëkohësisht vendos edhe kufijtë e veprimit policor, duke udhëzuar se deri ku mund të shkojë policia për të arritur “objektivat e ligjshëm policorë”.<sup>109</sup>

Çfarëdo lloj demonstrimi në vend publik, qofshin ato protesta, manifestime apo forma të ndryshme të shprehjes së pakënaqësisë, mund të shkaktojë nivel të caktuar të shqetësimit në jetën e rëndomtë, përfshirë ndërprerje në trafik apo edhe të ndonjë shërbimi publik. Mirëpo kur demonstruesit nuk përfshihen në akte të dhunës, “për autoritetet publike është e rëndësishme të tregojnë shkallë të lartë të tolerancës kundrejt tubimeve paqësore nëse liria e tubimit, e garantuar nga neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, nuk është për t’u privuar nga substanca e saj.”<sup>110</sup>

GJEDNJ ka vërejtur se “një individ nuk pushon së gëzuarit të drejtën e lirisë së tubimit si rezultat i dhunës sporadike apo veprimeve tjera të ndëshkueshme, të kryera nga të tjerët gjatë zhvillimit të demonstratës, nëse individ i pyetje mbetet paqësor në synimet apo sjelljen e tij/saj”.<sup>111</sup>

Avokati i Popullit pas shqyrtimit të fakteve që kishte mbledhur nga terreni dhe analizës ligjore të ngjarjeve të protestave të lartpërmendura, me datë 21 shkurt 2012 i ka drejtuar një raport Ministrisë të Punëve të Brendshme. Rekomandimet e dala nga ky raport ishin:

1. Të bëhet hetim gjyqësor i sjelljes së pjesëtarëve të policisë, të cilët kanë përdorur forcë ndaj protestuesve dhe qytetarëve të rastit, në protestën e datës 14 janar 2012 në Podujevë dhe në pikën kufitare Dheu i Bardhë.
2. Të identifikohen dhe të nxirren para drejtësisë të gjithë ata individë nga forcat e policisë, që kanë përdorur forcë dhe/ose urdhëruar përdorimin e forcës policore ndaj protestuesve më 14 janar 2012.
3. Të identifikohen dhe të nxirren para drejtësisë të gjithë personat që kanë përdorur forcë gjatë protestës kundër Policisë së Kosovës.
4. Të rishqyrtohet roli dhe misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës, të hetohen nga një institucion i pavarur dhe të ballafaqohen me përgjegjësinë ligjore, zyrtarët e këtij

<sup>108</sup> Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 2, pika b. Shih, po ashtu, *The European Code of Police Ethics*, I. Objektivat e policisë– “të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve, të parapara, sidomos në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

<sup>109</sup> Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 3: Përkufizimet – “Objektivi i ligjshëm i Policisë – nënkupton synimin të cilin e ndjek Policia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me ligjin në fuqi;”.

<sup>110</sup> *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, shih rastin *Balçik and Others v. Turkey* (Application no. 25/02) paragrafi 52 dhe *Ashughyan v. Armenia* (Application no. 33268/03), paragrafi 90.

<sup>111</sup> *Po aty*, shih rastin *Ezelin v. France* (Application no. 11800/85) dhe rastin *Ziliberberg v. Moldova* (Application no. 61821/00).

*inspektorati që kanë shkelur kodin e etikës dhe rregulloren e veprimit të Inspektoratit Policor të Kosovës, më 14 janar 2012.*

*5. Të ndërmerren masat disiplinore dhe ligjore ndaj pjesëtarit të Njesisë Speciale të policisë, i cili ka penguar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ka kërcënuar përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit.*

*6. Që për Njesisë Speciale të policisë së Kosovës të organizohen trajnime të veçanta, në lidhje me menaxhimin e situatave gjatë ballafaqimit me turmat e mëdha të njerëzve në organizimet e ndryshme publike, të organizuara sipas udhëzimeve të Komisionit të Venedikut për protestat, me theks të veçantë për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.*

*7. Nga Ministria e Punëve të Brendshme kërkohet që të gjithë pjesëtarët e policisë së Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh formën, mënyrën dhe situatën e angazhimit dhe njësitë në të cilat operojnë, të pajisen me numër identifikues.*

*8. Policia e Kosovës, si institucion kushtetues për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, e shëndetit publik, e sigurisë nacionale, e të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet medoemos të kërkojë kontaktin me organizatorët e tubimeve publike për planifikim paraprak të tyre, kur kjo është e nevojshme, për shkak të vendit, kohës dhe numrit të pjesëmarrësve dhe nëse ato nuk janë të ndaluara shprehimisht, me vendim të veçantë.<sup>112</sup>*

Avokati i Popullit asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) në lidhje me raportin e lartpërmendur, në të cilin janë dhënë rekomandime të cilat do të duhej ta zbatoheshin nga ana e MPB.

Avokati i Popullit pranoi një raport nga ana e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), me të cilin u informua se pas analizës së ngjarjeve, IPK kishte trajtuar disa raste të sjelljes së policëve.<sup>113</sup>

Avokati i Popullit është njoftuar nga IPK, se sa i përket rastit të iniciuar me kallëzim penal në Prokurorinë Komunale në Gjilan, IPK nuk ka pranuar ndonjë informatë shtesë lidhur me ecurinë e rastit dhe fazën në të cilën ndodhen hetimet në këtë rast.

Sipas informatave që ka siguruar Avokati i Popullit nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme rezulton se kjo drejtori nga IPK ka pranuar disa raste të ankesave të qytetarëve lidhur me ngjarjet

---

<sup>112</sup>IAP, *Raport Ex-officio nr. 28/2012*, Lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012.

Në: [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/82060\\_Ex-officio%20nr.%2028 \(19.01.2013\)](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/82060_Ex-officio%20nr.%2028%20(19.01.2013)).

<sup>113</sup> *Raporti i Inspektoratit Policor të Kosovës*, datë 7 Mars 2012. Faqe 27: Në raport thuhet se IPK në bashkëpunim me prokurorin publik në një rast kanë vlerësuar se ekziston dyshimi i bazuar që zyrtari policor ka kryer veprë penale dhe për këtë është ngritur kallëzim penal në Prokurorinë Komunale në Gjilan. Ndërsa në tri raste të tjera gjithnjë sipas raportit të IPK thuhet se pas zhvillimit të hetimeve IPK ka ardhur në përfundim se nuk ka elemente të veprës penale por ka elemente të shkeljes disiplinore dhe këto raste i janë proceduar për hetime disiplinore në Drejtorinë për Hetime të Brendshme në Policinë e Kosovës.

e protestave të datës 14 janar 2012, mirëpo pas zhvillimit të hetimeve kanë ardhur në përfundim se nuk ka elemente të shkeljeve disiplinore nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës.<sup>114</sup>

Ky rezultat i hetimeve nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme lë mjaft hapësirë për dyshime në pavarësinë e këtij institucioni sa i përket shpërfaqjes së gjendjes reale. Duke lënë anash metodat, format dhe mënyrën e hetimit nga kjo drejtori, vetëm shprehja se “nuk ka elemente të shkeljeve disiplinore nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës” në këtë rast, me gjithë dëshmitë e ofruara nga vetë individët, mediat dhe IAP, dëshmon ose për rezultate të falsifikuara të hetimit, ose për mungesë guximi të ballafaqimit me eprorët, që domosdoshmërisht shtron çështjen e pavarësisë së kësaj drejtorie për hetime të mirëfillta. Ky rezultat e bën të ligjshme dhe të domosdoshme kërkesën për pavarësimin e institucioneve të tilla në Republikën e Kosovës.

Një ngjarje tjetër të cilën Avokati i Popullit e ka vëzhguar nga afër është edhe protesta e datës 17 tetor 2012, ku Lëvizja Vetëvendosje organizoi një protestë në afërsi të ndërtesës së Qeverisë së Kosovës dhe me këtë rast pasoi intervenimi i Policisë së Kosovës, gjë e cila rezultoi me disa persona të lënduar dhe disa të arrestuar.<sup>115</sup> Në mesin e protestuesve kishin qenë edhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës të cilët kishin dashur të hynë në ndërtesën e Qeverisë, mirëpo ata ishin penguar nga ana e Policisë së Kosovës.

Edhe pse numri i të lënduarve dhe të arrestuarve nuk ishte i vogël, Ministri i MPB deklaroi publikisht në Kuvend se “*Po është e vërtetë, unë kam dhënë urdhrin dhe urdhri është dashur të zbatohet edhe në mënyrë pak më rigoroze*”, duke aluduar në atë se Kushtetuta dhe ligji ia lejon që të ndalojë “*deputetët, Kryesinë e Kuvendit, Qeverinë dhe Presidencën*” nëse bllokojnë institucionet publike,<sup>116</sup> edhe pse këto institucione përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve.

Më 22 tetor 2012, Lëvizja Vetëvendosje kishte organizuar një protestë tjetër. Pas tentimit të disa protestuesve që të bllokojnë hyrje daljet e zyrtarëve në objektin e qeverisë, kishte intervenuar policia dhe kishte arrestuar një numër të protestuesve, në mesin e të cilëve ishin edhe disa deputetë, të cilët gjatë arrestimit nga ana e Policisë kishin pësuar lëndime të rënda.

Protesta e 22 tetorit 2012 vazhdoi deri në orët e pasdites, kur edhe pasoi ndërhyrja e pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë, të cilët përdorën gaz lotsjellës përgjatë gjithë sheshit “Nëna Terezë”. Gjatë këtij intervenimi policia nuk ka kursye nga arrestimi as kalimtarët e rastit të cilët në ato momente ishin duke lëvizur në sheshin “Nëna Terezë”.<sup>117</sup> Nga kjo situatë e krijuar, një shtetase Gjermane, sipas pohimeve të familjarëve të saj, si kalimtare rasti, pësoi lëndime të rënda (alivanosje), dhe më pas u dërgua në gjendje kome në QKUK.<sup>118</sup>

---

<sup>114</sup> Njoftim zyrtar nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme në PK drejtuar IAP, datë 26 dhjetor 2012.

<sup>115</sup> Raporti zyrtar i brendshëm i IAP nga protesta e 17 tetorit 2012.

<sup>116</sup> Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 17 tetor 2012 – faqe 16.

<sup>117</sup> Raportet zyrtare të brendshëm të IAP nga protesta e 17 dhe 22 tetorit 2012, deklaratat e të arrestuarve në Qendrat e Ndalimit në Polici.

<sup>118</sup> Raporti i brendshëm i IAP nga protesta e 22 tetorit 2012, deklarata e familjarëve të të lënduarës në QKUK.

Avokati i Popullit konsideron se intervenimi i policisë dhe përdorimi i forcës ndaj protestuesve si dhe përdorimi i pakontrolluar i gazit lotsjellës gjatë protestave të 17 dhe 22 tetorit 2012, ka qenë i panevojshëm, i pajustificueshëm dhe joproportional.

Avokati i Popullit konsideron se kësaj situate i ka kontribuar edhe vet Ministri i MPB, i cili publikisht në Kuvendin e Kosovës pohoi se, ka dhënë urdhër që të ndërmerren veprimet e lartpërmendura, duke shtuar se urdhri i tij *kërkonte veprime edhe më të ashpra* kundër protestuesve. Dhe kjo vërtet është vërejtur në veprimet e policisë të datës 22 tetor 2012 ndaj protestuesve, përfshirë edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit konsideron se *“Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të policisë”*,<sup>119</sup> ndërsa është kreu e natyrshme dhe e drejtë që policia të pengojë protestuesit që të hyjnë në hapësirat e punës së Qeverisë. Por, pengimi i përfaqësuesve të popullit bie ndesh me nenin 70 të Kushtetutës i cili përcakton se *“Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.”*

Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se, sado qofshin të ashpra kontradiktat dhe qëndrimet politike në mes subjekteve politike, policia nuk guxon të keqpërdoret për qëllime politike. Instrumentalizimi i policisë për qëllime politike është i papranueshëm dhe tepër i rrezikshëm për demokracinë, stabilitetin dhe shpie pashmangshëm në rrënimin parimit të ndarjes së pushteteve dhe rrjedhimisht shpie edhe drejt shkeljes së të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit po ashtu ka përcjell me vëmendje ngjarjet që kishin ndodhur në një organizim të OJQ “Libertas” më 14 dhjetor 2012 në Pallatin e Rinisë në Prishtinë ku disa persona kishin sulmuar fizikisht dhe kishin demoluar sallën ku organizatorët e kësaj ngjarje kishin planifikuar tubimin e tyre dhe promovimin e një reviste e cila trajtonte çështjet e komunitetit LGBT.

Avokati i Popullit konsideron se pa marrë parasysh se cilave grupe u takojnë personat që sulmuan, ata duhet të dalin para drejtësisë dhe të ballafaqohen me ligjin, pasi veprimet e tyre paraqesin jotolerancë, veprim të papranueshëm dhe cenim të rendit kushtetues dhe demokratik. Në veprimet e personave që kanë sulmuar organizatorët e tubimit, ka elemente të cenimit të së drejtës për shprehje të lirë, liri të asociimit dhe të drejtën e tubimit, të drejta këto të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit fton publikisht institucionet kompetente, organet e rendit dhe të drejtësisë, që në raste të tilla të veprojnë në pajtim me përgjegjësitë që kanë dhe të hetojnë rastet e sulmeve të tilla. Përndryshe, parandalimi i veprimeve të tilla të kundërligjshme është detyrë e gjithë institucioneve të vendit.

Avokati i Popullit në raportet e kaluara ka tërhequr vërejtjen se pika 3 e nenit 12 të Ligjit për Tubimet Publike, sipas së cilës detyrimi ligjor që ligjvënësi ia delegon “kujdestarit” të një tubimi *“Ta kapë dhe ta dorëzojë te policët pjesëmarrësin ose personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik, nëse i prish rendin, qetësinë, nëse mban armë ose objekte të rrezikshme, ose*

---

<sup>119</sup> Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 5.1.

*shenja të ndaluara*” janë detyrim ekskluziv i organeve shtetërore të rendit, dhe nuk mund të delegohet tek asnjë person tjetër juridik ose fizik. Duke qenë se deri më tani nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për ndryshimin e këtij neni, Avokati i Popullit rekomandon ndryshimin dhe plotësimin e nenit të lartpërmendur të Ligjit për Tubimet Publike në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm dhe në harmoni me standardet evropiane.

Edhe praktika e GJEDNJ tërheq vërejtjen se liria efektive për një tubim paqësor nuk mund të pretendohet vetëm nëse shteti i ka përmbushur detyrimet e tij duke mos ndërhyrë, por në rast nevojë kërkon të merren masa pozitive, qoftë edhe në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet individëve.<sup>120</sup>

Avokati i Popullit fton dhe kërkon sërish nga institucionet përgjegjëse, që të zbatojnë të gjitha rekomandimet e deritashme nga raportet e mëparshme dhe të ardhshme, qofshin ato raporte të veçanta apo vjetore, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e tubimit.

## **2.18. Liria e asociimit**

Liria e asociimit në Republikën e Kosovës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (KRK),<sup>121</sup> si dhe me KEDNJ,<sup>122</sup> ndërsa është e rregulluar me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.<sup>123</sup>

Mirëpo një çështje e cila e rrezikon sektorin joqeveritar në Kosovë është miratimi i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nga ana e Kuvendit të Kosovës. Ligji në fjalë në brendinë e tij ka paraparë nene të cilat e lejojnë shndërrimin e Institucioneve Mikrofinanciare të regjistruara si Organizata Joqeveritare (IMF-OJQ) në shoqëri aksionare gjë e cila cenon rëndë lirinë e asociimit.

Përpyekjet për shndërrimin e IMF-OJQ në shoqëri aksionare nga aktorë të ndryshëm kishin ekzistuar edhe më herët gjatë procesit të amandamentimit të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. Mirëpo, pas një angazhimi intensiv dhe në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar në Kosovë, shoqëria civile kishte arritur që të ndalojë futjen e elementeve që dëmtojnë thelbin e ekzistencës së shoqërisë civile. Dhe, përkundër angazhimit të shoqërisë civile

---

<sup>120</sup> GJEDNJ, vendimi i datës 21 qershor 1988, aplikacioni nr. 10126/82,

<sup>121</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 43: „1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t’u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.“

<sup>122</sup> KEDNJ, Neni 11.

<sup>123</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 14, e datës 9 shtator 2011, Prishtinë.



për mos lejimin e një procesi të tillë, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.<sup>124</sup>

Pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve ligjor në dispozicion në kundërshtim të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare organizatat e shoqërisë civile i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, që të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtimin e kushtetutshmërisë së nenit 90, nenit 95, pika 1.6, nenit 110, nenit 111 dhe nenit 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.<sup>125</sup>

OJQ e lartpërmendura konsideronin se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare synon që të rregullojë funksionimin e IMF-OJQ nëpërmjet rregullimit të parimeve dhe procedurave të menaxhimit të tyre. Megjithatë, dispozitat (neni 90, neni 95, pika 1.6; neni 110; neni 111 dhe neni 116) të caktuara të këtij ligji trajtojnë edhe çështjen e subjektivitetit juridik të IMF-OJQ, dhe hapin mundësinë për transformimin e tyre nga subjekti juridik i OJQ-së në subjekt juridik si shoqëri aksionare.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile dhe të OJQ-ve, si pjesë esenciale e saj në zhvillimin e demokracisë, Avokati i Popullit konsideron se ky ligj mund të dëmtojë në mënyrë të pariparueshme jo vetëm themelin e ekzistencës së shoqërisë civile, por dëmton edhe zhvillimin e demokracisë. Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se si i tillë, ky ligj shkel parimet kushtetuese, shkel parimet ndërkombëtare të së drejtës jo-për përfitim dhe është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë që e rregullon fushën e lirisë së asociimit në OJQ, si dhe rrezikon të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi.

Avokati i Popullit vë në pah se parimi bazë universal i sektorit jo-për-përfitim që rregullon çështjet e tilla, në Kosovë është i rregulluar shprehimisht me ligj, i cili: *“Ndalon shpërndarjen e të ardhurave neto ose fitimeve për ndonjë person, si dhe përdorimin e pasurive, të ardhurave dhe fitimeve të një OJQ-je për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën”*.<sup>126</sup>

Ky parim nënkupton që OJQ-ja nuk ka pronarë ndërsa prona e saj nuk mund të trajtohet si pronë private, sepse *“Të gjitha pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e OJQ-së mund të shfrytëzohen vetëm*

<sup>124</sup> *Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit të Kosovës*, të mbajtur më 12 prill 2012, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans\\_s\\_2012\\_04\\_12\\_11\\_4155\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2012_04_12_11_4155_al.pdf) (18.02.2013). Kuvendi miratoi këtë ligj me 55 (pesëdhjetepesë) vota “për”, asnjë (0) “kundër” dhe 4 (katër) “abstenime”.

<sup>125</sup> Shkresa e datës 21 shkurt 2012 drejtuar kryetares së Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, shkresa e datës 29 mars 2012 drejtuar Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Legjislacion dhe shkresa e datës 19 prill 2012 drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës. Më 11 maj 2012, organizatat joqeveritare (OJQ): Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) si bartëse të kërkesës dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse të kërkesës.

<sup>126</sup> *Ligji Nr. 04/ L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare*, neni 4.1 dhe 4.3 dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/REC(2007) 14 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare mbi statusin ligjor të organizatave jo-qeveritare në Evropë, neni 9.

*për arritjen e misionit jofitimprurës për të cilën kjo OJQ është themeluar*”,<sup>127</sup> ndërsa në rast të shuarjes së një OJQ-je, “*pasuria e OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme*”.<sup>128</sup>

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit në cilësinë e palës së autorizuar kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që “*të shfuqizojë si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenin 90; nenin 95, pika 1.6; nenin 110; nenin 111 dhe nenin 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*”<sup>129</sup>

Për shkak të dëmit të pariparueshëm që mund të shkaktojë ky ligj, Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vënien e masës së përkohshme për pezullimin e zbatimit të këtij ligji deri në një vendim meritor për nenet e lartpërmendura.

Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit dhe vendosi të lejojë masën e përkohshme për pezullimin e zbatimit të neneve të lartpërmendura të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare deri në një vendim meritor të kësaj gjykate.<sup>130</sup>

Një fakt tjetër jashtëzakonisht shqetësues për Avokatin e Popullit paraqet rasti sulmit të disa grupeve të personave, kryesisht të rinj kundër organizimit dhe promovimit të revistës “Kosovo 2.0” nga organizata Joqeveritare “Libertas” më 14 dhjetor 2012 në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, i përcjellë me dhunë fizike, sulme verbale dhe dëmtim të infrastrukturës në hapësirën e caktuar për mbajtjen e tubimit. Avokati i Popullit ka përcjell nga afër ngjarjet që kishin ndodhur dhe publikisht ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me sulmet fizike dhe verbale, kërcënimet e drejtpërdrejta dhe demolimin e sallës ku mbahej aktiviteti i lartpërmendur.<sup>131</sup>

## **2.19. E drejta për zgjedhje dhe pjesëmarrje**

Në çdo demokraci, zgjedhjet janë të lira me votim të fshehtë, përkatësisht shprehja e lirë e mendimit të qytetarëve në kushte që sigurojnë vullnetin e qytetarëve që në mënyrë të pavarur t’i zgjedhin përfaqësuesit e tyre legjitim në institucionet shtetërore. Me këtë realizohet e drejta e qytetarëve që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të zgjidhen.

---

<sup>127</sup> *Po aty*, neni 4.2 dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/REC(2007)14 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare mbi statusit ligjor të organizatave jo-qeveritare në Evropë, neni 9.

<sup>128</sup> *Po aty*, neni 21.3 dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/REC(2007)14 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare mbi statusit ligjor të organizatave jo-qeveritare në Evropë, neni 56.

<sup>129</sup> IAP, Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese më 11 tetor 2012.

<sup>130</sup> *Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*, për Rastin KO 97/12, publikuar më 26 dhjetor 2012, në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_97\\_12\\_mp\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_97_12_mp_shq.pdf) (24.03.2013).

<sup>131</sup> IAP, *Komunikatë për mjetet e Informimit*, <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,1,a,666> (20.12.2012).

E drejta në zgjedhje dhe pjesëmarrje, si e drejtë themelore, realizohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,<sup>132</sup> Ligjit për zgjedhje të përgjithshme<sup>133</sup> dhe Ligjit për zgjedhjet lokale,<sup>134</sup> që janë në harmoni me KEDNJ-në.<sup>135</sup> Për realizimin e kësaj kategorie kushtetuese në kuptimin e vërtetë të fjalës kujdeset organi i pavarur, përkatësisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).<sup>136</sup>

KQZ gjatë vitit 2012 ka organizuar Zgjedhjet e jashtëzakonshme për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe kryetarin e komunës së Kaçanikut.

Në komunën e Ferizajt, zgjedhjet u mbajtën më 29 prill 2012, ndërsa në komunën e Kaçanikut, më 17 qershor 2012. Në të dy komunat pati balotazh për zgjedhjen e kryetarit të komunës. KQZ, me rastin e zgjedhjeve, ka konstatuar se nuk ka pasur ankesa apo ndonjë vendim nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (PZAP).

Në fund të procesit zgjedhor, nga ana e KQZ-së është konstatuar se nuk ka pasur shkelje më të mëdha të Rregullave zgjedhore, përkatësisht të drejtës për zgjedhje dhe pjesëmarrje. Janë identifikuar shkelje të vogla, kryesisht si në zgjedhjet e mëhershme, që kanë të bëjnë me adresat, ngatërrimi me rastin e gjetjes së votuesve në vendvotime, ka pasur emra të të vdekurve që kanë qenë ende në listat e votuesve. Në vendvotime (VV), po ashtu ka pasur probleme dhe gabime me rastin e dërgimit të formularëve në Qendrën për numërim dhe rezultate (QNR).

Numërimi është bërë në Qendrën për numërim dhe rezultate, nuk ka pasur probleme, përveç të disa problemeve të vogla të natyrës procedurale. Ka pasur më pak probleme krahasuar me problemet e mëparshme.

Për herë të parë është përdorur projekti i ri për rezultatet preliminare dhe për herë të parë është përdorur interneti si mënyrë e dërgimit të të dhënave në relacionin VV-QPR-KQZ. Në këtë mënyrë është eliminuar dallimi më i madh në prezantimin e rezultateve ndërmjet rezultateve preliminare dhe definitive.

KQZ, me rastin e proceseve zgjedhore ballafaqohet me sfida të ndryshme, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. KQZ, në këtë vit, kur nuk ka pasur zgjedhje, ka organizuar trajnime me temën e avancimit të regjistrave votues, e me qëllim të eliminimit të problemeve që e përcjellin regjistrin votues. Zëri më i rëndësishëm në këtë drejtim është azhurnimi i regjistrin votues, e para së gjithash, shlyerja e personave të vdekur, si dhe azhurnimi i adresave të votuesve, vendvotimeve e të ngjashme.

Për t'u siguruar se zgjedhjet po i përcjellin proceset demokratike dhe për t'iu prerë rrugën keqpërdorimeve gjatë votimit, për herë të parë, në zgjedhjet e kaluara, është filluar me procesiumin dhe sanksionimin e shkelësve të rregullave zgjedhore dhe të kodit penal, nga gjykatat komunale.

---

<sup>132</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45. Pika 1.

<sup>133</sup> Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, nr. 03/L-073.

<sup>134</sup> Ligji për zgjedhjet lokale, nr. 03L-072.

<sup>135</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Elementare, Protokollin I, Neni 3.

<sup>136</sup> Komisioni Qendror Zgjedhor, Kushtetuta e Kosovës, Neni 139.

Mirëpo, sanksionet nuk janë në harmoni me kontributin që shkelësit e veprave zgjedhore dhe penale të pengohen që në të ardhmen të mos bëjnë kundërvajtje zgjedhore dhe penale.

IAP është i brengosur për shkak të aktgjykimeve të tilla, që nuk janë në përputhshmëri me barrën e veprave penale, dhe si të tillë nuk janë të mjaftueshëm për të penguar shkelësit potencial të ardhshëm në shkeljen e rregullave zgjedhore. Avokati i Popullit konstaton që gjykatat duhet drejtë ta masin dënimin, i cili do të jetë në përputhje me veprën e kryer penale, për të cilat me ligj janë parashikuar dënime.

Ligjet e deritashme për zgjedhje të përgjithshme dhe lokale përmbajnë mjaft paqartësi dhe dykuptimësi në implementim. Është vendosur që ligjet ekzistuese të revidohen dhe në vazhdim e sipër është ndryshimi i ligjit zgjedhor nga komisioni për shikimin dhe ndryshimin e ligjit. Në këtë drejtim Avokati i Popullit prët që të dy ligjet zgjedhore do të përmbajnë dispozita më të qarta dhe precize, për zbatimin dhe interpretimin e tyre më të lehtë. Po ashtu pritet që të caktohet përzgjedhja ndryshe e anëtarëve të KQZ-së, që do të përbëhej nga persona të cilët nuk i përkasin partive politike.

Avokati i Popullit po ashtu vëren që nuk ka raporte të mjaftueshme për aktivitetet e KQZ-së, e të cilët duhet të jenë të postuar në uebfaqen e KQZ-së. Veçmas informata të tilla nuk ka në gjuhët e komuniteteve joshumicë, pra edhe në gjuhën serbe.

#### **Rekomandime:**

- *Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht të gjitha gjykatave kompetente në Kosovë, që drejt të masin dënimet që do të jenë në përputhje me veprën e kryer penale, kështu që si të tilla do të pengonin shkelësit e ardhshëm potencial të ligjeve zgjedhore.*
- *Kuvendit të Republikës së Kosovës, që sa më parë, gjithsesi para zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme në nivel lokal dhe nacional, të bëj revidimin e ligjeve zgjedhore, me dispozita më të qarta dhe më precize, me të cilën do të lehtësohej zbatimi dhe interpretimi i ligjeve zgjedhore.*
- *Komisionit Qendror të zgjedhjeve që sa më parë të zgjidhë problemet me azhurimin e regjistrave votues, e para së gjithash, shlyerja e personave të vdekur, si dhe azhurimin e adresave të votuesve, vendotimeve dhe të ngjashme, e po ashtu edhe mënjanimi i problemeve dhe gabimeve me rastin e dërgimit të formularëve Qendrës për numërim dhe rezultate (QNR).*
- *Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për azhurnimin e uebfaqes së KQZ-së me raporte dhe informata për aktivitetet e KQZ-së dhe institucioneve tjera përgjegjëse për zgjedhje, në veçanti në gjuhën serbe dhe në gjuhët e komuniteteve tjera joshumicë.*

## 2.20. E drejta e pronës

Edhe pse e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Protokollin shtesë të KEDNJ, bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, problemet pronësore-juridike në Kosovë edhe më tej vazhdojnë të mbeten pa ndryshime të dukshme pozitive, ashtu siç është theksuar në raportet vjetore paraprake të IAP-së.

Infrastruktura ligjore edhe më tej mbetet e mangët. Ashtu siç është cekur edhe në raportin vjetor paraprak të IAP, Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore, nuk ka një përkufizim të qartë për të gjitha të drejtat pronësore p.sh prona private, publike, shoqërore dhe të drejtën e shfrytëzimit të pronës shoqërore.

Problemet pronësore edhe më tej mbesin e evidente tek rastet e ndërtimeve. Në Kosovë vazhdohet me ndërtime të larta nëpër zona ku plani urbanistik është i përfunduar. Këto ndërtime nuk janë në përputhje me planet urbanistike dhe gjithashtu janë në kundërshtim me planin rregullues. Lejimi i këtyre ndërtimeve bën që banorët përreth të pengohen në shfrytëzimin e lirë dhe të papenguar të pronës së tyre.<sup>137</sup>

Problem shqetësues vazhdon gjithashtu të mbetet edhe kompensimi i pronarëve nga komunat lidhur me pronat e tyre të cilat janë të përfshira në plane urbanistike të qytetit. Pronat e qytetarëve përfshihen në plane urbanistike por ata nuk kompensohen nga komuna derisa fillon ndërtimi në atë pjesë. Në anën tjetër, pronarët nuk po mundën të pajisen me leje për ndryshim apo rindërtim të pronës së tyre nga ana e komunës, me arsyetimin se plani urbanistik është ndryshuar në atë pjesë të qytetit, ndërsa nuk kompensohen materialisht për pronat e tyre për të cilat komuna ka interesim për shpronësim.<sup>138</sup>

Ashtu siç është paraqitur në raportin paraprak vjetor të IAP, regjistrimi i pronave në regjistra kadastral për qytetarët e Kosovës mbetet problem.<sup>139</sup> Procedurat administrative kërkojnë që pronarët për regjistrimin e transaksioneve pronësore, duhet t'i paraqesin konfirmimet e pagesave të tatimeve dhe taksave tjera komunale të cilat lëshohen nga departamente tjera komunale, para se ata të regjistrojnë pronën në zyrën kadastrale komunale. Edhe më tej nuk ekziston ndonjë koordinim i departamenteve për kryerje të punëve që do të kursente kohën e qytetarëve për t'i regjistruar pronat e tyre në regjistra kadastrale.

---

<sup>137</sup> IAP, *rasti A. 257/2011*. Pala ankohet se pranë pronës se saj, nga të tri anët janë ndërtuar ndërtesa 10 katesh. Parashtruesja e ankesës është ankuar në Komunën e Prishtinës por nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për të mbrojtur të drejtën e saj për shfrytëzim papenguar të pronës së saj. Ndërtuesi i ndërtesës së lartë në fjalë nuk i ka zbatuar rregullat urbanistike dhe dritaret dhe ballkonet i ka të vendosura në anën e ngastrës kadastrale të ankueses.

<sup>138</sup> IAP, *rasti A. 109/2012*. Ankuesi pohon se që nga viti 2008 ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës leje për ndërtim në pronën e tij dhe Komuna e Prishtinës i është përgjigjur se me plan urbanistik prona e parashtruesit të ankesës është paraparë të shndërrohet në park. Më pas parashtruesi i ankesës ka bërë kërkesë për kompensim por asnjë herë nuk ka marrë përgjigje. Gojarisht i është thënë se duhet të pres deri sa të shfuqizohet plani urbanistik.

<sup>139</sup> IAP, *Raporti Vjetor 2011*. Nëntitulli 2.22, E drejta e Pronës, faqe 74.

Një shqetësim tjetër serioz përbën edhe fakti se të dhënat kadastrale shpesh janë të pasakta dhe të papërditësuara. Kjo paraqet vështirësi në identifikimin e mbajtësve legjitim të drejtave pronësore dhe vë në dyshim vlefshmërinë e certifikatës kadastrale, si dëshmi e titullit në atë pronë.

Bashkëpunimi në mes të zyrave të regjistrimit civil, gjykatave dhe zyrave kadastrale komunale, lidhur me rastet e raportimeve për personat e vdekur, edhe sot nuk funksionon në Kosovë. Dëshmitë për rastet e vdekjeve të familjarëve nga zyra e regjistrimit civil, vetë palët i prezantojnë në gjykatë për ta rregulluar çështjen e trashëgimisë. Kjo procedurë, zakonisht për palët është e mundimshme dhe u merr shumë kohë për shkak të zvarritjes së procedurave. Kjo bën që në të shumtën e rasteve qytetarët e rregullojnë trashëgiminë vetëm kur atyre u duhet urgjentisht për nevoja të tjera personale.

Edhe më tej qytetarët e Kosovës hasin në pengesa për të realizuar të drejtën e tyre në një proces të rregull gjyqësor për lëndët e tyre civile në lidhje me pronën. Edhe më tej është evidente zvarritja e procedurave në gjykatat e rregullta lidhur me to. Ankesa të tilla vazhdimisht regjistrohen në IAP.<sup>140</sup>

Qasja e sigurt dhe e papenguar nëpër hapësira publike, është një problem me të cilin qytetarët po ballafaqohen në përditshmërinë e tyre në tërë Republikën e Kosovës. Pothuajse të gjitha trotuarët nëpër rrugë, në të gjitha vendbanimet e Kosovës, sidomos ato urbane, janë të pakalueshme nga makinat e parkuara, andaj këmbësorët detyrohen të ecin nëpër rrugë. Kjo situatë po rrezikon jetën e qytetarëve të Kosovës. Nuk vërehet ndonjë përkushtim as i komunave apo policisë së Kosovës për të siguruar qytetarët t'i shfrytëzojnë trotuarët në mënyrë të lirë. Kjo dukuri është jashtëzakonisht shqetësuese dhe përbën rrezik shumë të madh sidomos përreth shkollave.

Rasti i cili ka ndodhur në muajin tetor në qendër të qytetit të Prishtinës në oborrin e shkollës fillore “Meto Bajraktari”, ku është goditur me automjet nxënësi i kësaj shkolle në pushimin e gjatë ditor, është vetëm njëra nga dëshmitë tronditëse. Këtë aksident përmes telefonit e ka edhe pohuar edhe drejtorja e shkollës në fjalë. Avokati i Popullit pas pranimit të informatave e ka ngritur këtë çështje tek zyrtarët e komunës së Prishtinës. Edhe pas intervenimit të IAP, nuk është vërejtur të jetë ndërmarrë ndonjë veprim nga komuna e Prishtinës për sigurinë e fëmijëve të kësaj shkolle. Për të qenë ironia edhe më e madhe, sidomos ndaj taksapagueseve të vet, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dëbohen nga zyra nga drejtori komunal i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, pas raportimit të rastit dhe kërkesës së Avokatit të Popullit për siguri të fëmijëve të kësaj shkolle për lëvizje dhe qasje të sigurt në objektin shkollor.

Ashtu siç është cekur edhe në raportet paraprake të IAP, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) vazhdon të mos e përmbushë misionin e vet ligjor, për të krijuar një skemë funksionale, për kompensimin e arsyeshëm për bartësit e të drejtës pronësore, të cilët pronat e tyre i kanë në pjesën veriore të Mitrovicës nën administrim të tyre. Edhe më tej, qytetarët e Republikës së

---

<sup>140</sup> IAP, Rastet: A. 477/2012, A. 447/2012, A. 454/2012. Parashtruesit ankohen lidhur me zvarritje të procedurave për lëndët e tyre civile nëpër gjykata të rregullta.

Kosovës, të cilët i kanë pronat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës, janë të penguar në posedim dhe shfrytëzim të lirë të tyre.

Dështimet komunale sipas ankesave të parashtruara në IAP shihen edhe të rastet e strehimeve për familjet, raste sociale. Edhe sot e gjithë kohën kuvendet komunale nëpër Kosovë, kanë dështuar të sigurojnë strehim për banorët me gjendje të rëndë ekonomiko sociale. Kjo vlen sidomos për vendbanimin “Fusha e Pajtimit” në Prishtinë. Ky kamp edhe tani, 12 vite pas lufte, është populluar me banorë të cilët sipas komisionit për ndarje të banesave për raste sociale të Komunës së Prishtinës, nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për të qenë shfrytëzues të tyre. Në IAP janë pranuar ankesat e banorëve të Prishtinës kundër Komunës së Prishtinës lidhur me parregullsi dhe shkelje të kriterëve nga komisioni për ndarjen e banesave sociale në KK të Prishtinës.

### **Rekomandime:**

- *Qeveria e Republikës së Kosovës krijojë një infrastrukturë ligjore funksionale për rregullimin e çështjeve pronësore, e cila është lehtë e zbatueshme.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe komunat e Kosovës, të mundësojnë dhe sigurojnë gëzimin e të drejtave pronësore, në mënyrë të plotë, të papenguar dhe pa diskriminim.*
- *Komunat e Kosovës të sigurojnë për banorëve të tyre shfrytëzimin e lirë, të sigurt dhe të papengueshëm të pronave të tyre private, në pajtim me ligjin.*
- *Të gjitha komunat e Kosovës së bashku dhe në koordinim me Policinë e Kosovës, sidomos në qendrat urbane të Kosovës, të sigurojnë për banorët e tyre qasjen dhe shfrytëzimin e lirë, të sigurt dhe të papengueshëm të pronave publike për secilin qytetar.*
- *Komuna e Prishtinës të bashkëpunoj me Institucionin e Avokatit të Popullit si dhe të marrë masa të parapara me ligj ndaj të gjithë zyrtarëve që nuk bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit.*
- *Agjencia Kosovare e Pronës të përmbushë misionin e vet ligjor, duke krijuar një skemë funksionale për kompensimin e arsyeshëm për bartësit e të drejtës pronësore, pa diskriminim në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe pjesën veriore të Mitrovicës.*

## 2.21. E drejta për arsimin

E drejta për arsimim, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRK) parasheh që “secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë,” të financuar nga fondet publike.<sup>141</sup> Kushtetuta përcakton detyrimin që institucionet publike t’i sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.<sup>142</sup> Po këtë e garanton edhe KEDNJ dhe Protokollat e saj.<sup>143</sup>

### 2.21.1. Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor është hallka e parë e sistemit arsimor dhe realizohet në institucionet parashkollore. Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme, në të cilën kombinohen procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit, lojës së fëmijëve dhe kujdesi profesional ndaj zhvillimit të tyre. Në këtë kontekst për edukimin parashkollor janë bërë hapa të rëndësishëm me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ (UA), Përkujdesja për fëmijëri të hershme dhe arsimim,<sup>144</sup> si dhe me hartimin e standardeve për zhvillimin dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme.<sup>145</sup>

Avokati i Popullit në raportin vjetor për vitin 2011, ka rekomanduar që, nëpërmjet ngritjes së kapacitetit të infrastrukturës fizike, të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët. Përkundër këtij rekomandimi, në vitin shkollor 2011/2012, kemi një institucion parashkollor më pak se vitin shkollor 2010/2011.<sup>146</sup> Në disa komuna institucionet parashkollore (IP) ballafaqohen me mungesën e infrastrukturës.

### 2.21.2. Arsimi parauniversitar

Arsimi parauniversitar në Republikën e Kosovës ofron shërbime për fëmijët e moshës 6-18 vjeç të cilët vijnë nga tri nivelet e shkollimit në vijim: shkolla fillore (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (klasat 6-9), këto dy nivele janë të obligueshme për të gjithë fëmijët,<sup>147</sup> dhe arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12/13).

---

<sup>141</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 47 paragrafi 1.

<sup>142</sup> *Po aty*, Neni 47 paragrafi 2.

<sup>143</sup> *Protokolli nr. 1 i KEDNJ*, Neni 2 “Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim...”

<sup>144</sup> *Udhëzimi Administrativ, 15/2012*, Përkujdesja për fëmijëri të hershme dhe arsimim, i datës 18.9.2012.

<sup>145</sup> *Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, 0-6 vjet*, MASHT, tetor 2011.

<sup>146</sup> *Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2010/2011 dhe 2011/2012*. Në [www.masht.gov.net/](http://www.masht.gov.net/) (22.03.2013).

<sup>147</sup> *Ligji për Arsimin Parauniversitar*, neni 9 paragrafi 2.



Sipas statistikave të MASHT-it, në vitin shkollor 2011/2012, në Republikën e Kosovës janë ndërtuar 11 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 4 shkolla të mesme të larta. Mesatarja e numrit të nxënësve në një paralele, për shkollat fillore të mesme të ulëta ka rënë nga 22.8 nxënës për paralele, në 22.1 nxënës, ndërsa në shkollat e mesme të larta mesatarja e nxënësve për paralele ka rënë nga 32.4 nxënës për paralele, në 31.1 nxënës për paralele.<sup>148</sup>

Mirëpo, manipulimi me të dhënat statistikore dhe mesataret krahasuese të nxjerra nga të dhënat e përgjithshme të MASHT-it, nuk pasqyrojnë realitetin në këtë aspekt. Varësisht nga rrjedhat demografike dhe pozita gjeografike, gjendja është megjithatë më e zymtë. Në shumë vendbanime rurale, sidomos fshatrat e largëta nga qendrat urbane, numri i përgjithshëm i nxënësve shkon duke u zvogëluar në mënyrë rapide, dhe shumë objekte shkollore mbeten të zbrazëta dhe të pashfrytëzuara, numri i nxënësve në një paralele është dukshëm më i vogël se mesatarja kombëtare e paraqitur nga MASHT-i.

Gjendje krejt e ndryshme është në shkollat në vendbanimet urbane, ku vërehet dyndje e madhe e nxënësve, mungesë e hapësirës shkollore dhe rritje jashtëzakonisht e madhe numrit të nxënësve në një paralele, që shpeshherë arrin dyfishin e mesatares kombëtare të paraqitur nga MASHT-i. Sipas të gjitha gjasave, kjo gjendje do të vazhdojë të mbretërojë edhe një kohë të gjatë në Kosovë.

### **2.21.3. Nxënësit me nevoja të veçanta**

Nxënësit me nevoja të veçanta vijnë në mësimin në shkollat speciale dhe njësitë që ofrojnë arsimim të veçantë. Avokati i Popullit në raportin vjetor për vitin 2011, ka rekomanduar që të sigurohen kushte sa më të mira për këto kategori të nxënësve. Për këtë qëllim në Qendrën Burimore “Lef Nosi” në Prizren është përfunduar aneksi i kësaj qendre, janë krijuar kushte më të mira mësimi, ushqimi dhe fjetje në konvikte të kësaj qendre burimore të arsimit në Kosovë. Mirëpo, në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë, edhe më tutje, objekti shkollor është shumë i vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për shkollë.<sup>149</sup> MASHT ka përcaktuar procedurat me të cilat bëhet vlerësimi i profesional për personat me nevoja të veçanta edukativo-arsimor.<sup>150</sup>

Në Kosovë mbetet ende një gjendje e rëndë në aspektin e sigurimit të infrastrukturës fizike për fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta, dhe sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vetëm një numër i vogël i shkollave në Kosovë ofrojnë mundësi teknike për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike për qasje në objektet shkollore.

<sup>148</sup> *Statistikat e Arsimit në Kosovë*, 2010/2011 dhe 2011/2012. Në: [www.masht-gov.net/](http://www.masht-gov.net/) (22.03.2013).

<sup>149</sup> *IAP. Rasti 414/2012, ex officio*, Shkolla speciale “Qendra Burimore Nëna Terezë” në Mitrovicë.

<sup>150</sup> *Udhëzimi Administrativ nr. 07/2012*, Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimor, i datës, 23.05.2012.

Një shqetësim të veçantë në lidhje me infrastrukturën në shkolla, paraqet fakti se në shumë shkolla mungojnë kushtet themelore sanitare dhe është vështirë të flitet për një mjedis të shëndetshëm fizik.<sup>151</sup> Në këtë drejtim, Avokati i Popullit me keqardhje konstaton se kanë dështuar drejtoritë komunale të arsimit, si dhe inspektorati sanitar nëpër komuna, pa përjashtuar këtu përgjegjësinë inspektuese të MASHT-it dhe përgjegjësinë kryesore të drejtorive të shkollave.

### **2.21.3.1. Braktisja e shkollimit**

Dukuria e braktisjes së shkollimit të obligueshëm, edhe më tutje mbetet dukuri shqetësuese. MASHT-i ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (UA), nr. 19/2012, të datës 04.10.2012, për Themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. Bazuar në këtë dokument, mbetet të shpresohet se do të formohen këto ekipe, të cilat do të ndikojnë në parandalimin e kësaj dukurie.

Kjo dukuri është më e theksuar në shumë pjesë rurale të Kosovës tek fëmijët shqiptarë, dhe sidomos në mesin e fëmijëve të komuniteteve ashkali, egjiptas dhe rom.

### **2.21.3.2. Dhuna në shkolla**

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), me qëllim të hetimit të rasteve të paraqitjes së dukurisë së dhunës në institucionet arsimore, nga data 2 maj 2012 deri më datën 23 nëntor 2012, ka hulumtuar dhe grumbulluar informata për rastet e dhunës në institucionet arsimore të Republikës së Kosovës.<sup>152</sup>

Në Shkollën Fillore të ulët “5 Dëshmorët e UÇK-së” në fshatin Pleshinë, komuna e Ferizajt, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, kishin ndërhyrë për t'i ndërprerë protestat e nxënësve dhe me këtë rast, sipas pohimeve të nxënësve ishte përdorur dhuna.<sup>153</sup> Lidhur me sjelljet e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës gjatë shpërndarjes së protestuesve (nxënësve), ka pasur ankesa kundër një pjesëtari të Policisë së Kosovës, rastin e të cilit është duke e hetuar Inspektorati Policor i Kosovës.

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose

---

<sup>151</sup> IAP, Rasti 15/2012, *ex officio*, Shkolla fillore “Zenun Çoçaj” në fshatin Gjonaj, komuna e Prizrenit.

<sup>152</sup> Raportet e punës, të datës 02.05.2012 dhe 23.11.2012.

<sup>153</sup> IAP, Rasti 414/2012, *ex officio*, Shkolla fillore e mesme e ulët “5 Dëshmorët e UÇK-së” në fshatin Pleshinë, Komuna e Ferizajt.

private.<sup>154</sup> Për krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të përshtatshëm, në institucionet arsimore, më 26.05.2008, MASHT-i ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Ky memorandum mirëkuptimi ka pasur kohëzgjatje prej katër viteve me mundësi të vazhdimit,<sup>155</sup> por i njëjti nuk është vazhduar.<sup>156</sup> Megjithatë, nga informatat e grumbulluara mund të konstatojmë se dhuna është e pranishme në institucionet arsimore. Kjo dukuri e rrezikshme dhe jashtëzakonisht shqetësuese, vazhdon të shfaqet në forma të ndryshme dhe me pasoja jashtëzakonisht të rënda.

### **2.21.3.3. Ekskursionet shkollore**

Avokati i Popullit në raportin vjetor për vitin 2011, ka rekomanduar që të forcohet karakteri edukativ dhe mësimor i ekskursioneve, të kyçen në vendimmarrje këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve. MASHT-i ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 30/2012, të datës 31.10.2012, për Aktivitetet jashtëshkollore, sipas të cilit sigurohet pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje.<sup>157</sup> Nxjerrja e këtij UA është një veprim i drejtë i MASHT-it dhe lë të shpresohet se, do të tejkalohen problemet me të cilat janë përcjellë ekskursionet e maturantëve në disa komuna.

### **2.21.4. Arsimi i lartë**

Me hapjen e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, si dhe me investimet në infrastrukturën e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit të Bujqësisë, Fakultetit Ekonomik si dhe në Universitetin e Prizrenit, Universitetin e Pejës dhe atë të Mitrovicës, investimi në infrastrukturën e Qendrës së Studentëve, janë krijuar kushte më të mira mësimi, ushqimi dhe fjetje në konvikte për student.<sup>158</sup>

Këtë vit shkollor, me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore, MASHT-i ka nxjerrë 7 akte nënligjore,<sup>159</sup> është harmonizuar statuti i Universitetit të Prishtinës dhe janë në procedurë të harmonizimit edhe universitetet tjera.<sup>160</sup>

Për të zbutur mungesën e teksteve universitare, janë blerë 158 tituj nga autorët më të mirë të botës për shkencat e natyrës, mirëpo edhe më tutje vërehet mungesa e teksteve universitare.<sup>161</sup>

---

<sup>154</sup> *Ligji për Arsimin Parauniversitar*, neni 4, paragrafi 2.

<sup>155</sup> Memorandum bashkëpunimi ndërmjet MASHT, MPB, MD, MPMS dhe KGJK, neni 11, paragrafi 1.

<sup>156</sup> Intervistë, z. Isni Kryeziu, drejtor i Departamentit Ligjor, MASHT.

<sup>157</sup> *Udhëzimi Administrativ nr. 30/2012*, Neni 1 paragrafi 1 pika 1.3, i datës, 31.10.2012.

<sup>158</sup> Intervistë, drejtori i Departamentit të Arsimit të Lartë, prof. dr. Naim Hasani.

<sup>159</sup> *Ligji Nr. 04/L-037 Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*, neni 35, paragrafi 1.

<sup>160</sup> *Po aty*, neni 35 paragrafi 2.

Një risi pozitive në procesin e ngritjes profesionale dhe të përgatitjes së njerëzve të rinj pas shkollimit të mesëm për tregun e punës, shënon Krijimi i Qendrave të Kompetencës në Kosovë, brenda sistemit kosovar të Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Kosovë, si institucione të reja të arsimit postsekondar.<sup>162</sup> Këto qendra kanë për qëllim ofrimin e punëtorëve të kualifikuar me njohuri dhe shkathtësi praktike që u përgjigjen nevojave të tregut të punës në Republikën e Kosovës.<sup>163</sup>

#### **2.21.5. Sistemi arsimor për komunitetet**

Mësimdhënia në Republikën e Kosovës zhvillohet në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake. Sa i përket të drejtës për arsimim të komunitetit serb, komunat kanë krijuar kushte për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.<sup>164</sup> Shkollat të cilat zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe ende vazhdojnë të punojnë me plan-programe të Republikës së Serbisë, pa u miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), të punësuarit e këtij komuniteti ende vazhdojnë të marrin paga të dyfishta.

Gjatë vitit 2012 në IAP janë hetuar 5 ankesa kundër MASHT-it, 3 ankesa kundër Universitetit të Prishtinës dhe 7 ankesa kundër Drejtorive Komunale të Arsimit(DKA).

Falë bashkëpunimit të mirë midis IAP dhe institucioneve përgjegjëse të arsimit, nga ankesat të cilat janë zgjidhur pozitivisht, vlen të përmendet ankesa e 1200 nxënësve të shkollave të mesme në komunën e Kaçanikut,<sup>165</sup> të cilët janë ankuar kundër DKA për shkak të çmimit të shtrenjtë të uniformave shkollore, me ndërmjetësimin e IAP dhe me një bashkëpunim të mirë me nxënësit si dhe DKA në Kaçanik, nxënësit janë pajisur me uniforma shkollore me një çmim të pranueshëm.

Po ashtu, me ndërmjetësimin e IAP, në bashkëpunim me MASHT-in, është zgjidhë edhe ankesa për njohje dhe vlerësim të diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës.<sup>166</sup>

#### **Avokati i Popullit rekomandon:**

- ***Të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët në arsimin parashkollor deri në moshën 6- vjeçare.***

---

<sup>161</sup> Shih në: [www.masht-gov.net/](http://www.masht-gov.net/), (22.11.2012).

<sup>162</sup> Arsimitimi postsekondar nga mosha tetëmbëdhjetë vjeçare.

<sup>163</sup> *Udhëzimi Administrativ nr. 05/2012*, i datës, 02.05.2012.

<sup>164</sup> *Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr .03/L-068*, Neni 12 paragrafi 12.1, 21.05.2008.

<sup>165</sup> *IAP, Rasti A. nr. 246/2012.*

<sup>166</sup> *IAP, Rasti Ankesa A. nr. 336/2012.*

- *Të plotësohet infrastruktura shkollore dhe të përmirësohet mirëmbajtja e objekteve, me theks të veçantë në kushtet higjienike dhe sanitare.*
- *Pasi që edhe përkundër rekomandimeve të mëhershme nga Avokati i Popullit,<sup>167</sup> rastet e dhunës vazhdojnë të ndodhin në institucionet shkollore, Avokati i Popullit kërkon nga MASHT-i dhe DKA-të, të marrin masa të menjëhershme për parandalimin e kësaj dukurie.<sup>168</sup> Në këtë kuptim, angazhimi ndërinstitucional dhe vazhdimi i memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet MASHT-it, MPB-së, MD-së, MPMS-së dhe KGJK-së, si dhe zbatimi i tij me përpikëri për parandalimin e dhunës në institucionet shkollore, është domosdoshmëri e pashmangshme.*
- *Avokati i Popullit kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sidomos nga MASHT, që të vazhdojë edhe më tutje implementimin e të gjitha strategjive dhe memorandumeve të miratuara deri më tani.<sup>169</sup>*

## 2.22. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>170</sup> dhe është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.<sup>171</sup> Kjo e drejtë, po ashtu është e rregulluar dhe mbrohet edhe me ligje bazike, të cilat i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.<sup>172</sup>

Realizimi i të drejtave të qytetarëve nga fusha e marrëdhënies së punës ka një rëndësi të posaçme për statusin e çdo individi dhe njëkohësisht është një indikator se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve të vetë.

Edhe në këtë periudhë raportuese, shkalla e lartë e papunësisë, në Kosovë, vazhdon të mbetet edhe më tutje si çështja sociale më serioze, me të cilën përballen qytetarët e Kosovës.<sup>173</sup>

Në bazë të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në vitin 2011, në Kosovë ishin të papunë 335'905 persona, nga ta 162.277 femra dhe 173.628 meshkuj. Ndërsa në

<sup>167</sup> IAP, Raporti vjetor 2011, faqe 82, Raporti vjetor 2010, faqe 74.

<sup>168</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar, Neni 4 paragrafi 1 dhe 2.

<sup>169</sup> Plani strategjik i arsimit në Kosovë – 2011 - 2016, Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë – 2005 - 2015, Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë – 2007 - 2017 dhe Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë – 2007 - 2017.

<sup>170</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

<sup>171</sup> Po aty, neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare].

<sup>172</sup> Ligji i punës nr. 03/L-212, i miratuar më 1 nëntor 2010; Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-145, në fuqi prej 28 maj 2010; Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147, në fuqi prej 13 maj 2010; Ligji për Këshillin Ekonomiko Social Nr. 04/L-008, në fuqi prej 21 korrik 2011.

<sup>173</sup> Raport i Pulsit Publik, mars 2012. Në [www.kosovo.undp.org](http://www.kosovo.undp.org) (29.03.2013).

vitin 2012, numri i përgjithshëm i punëkërkuësve të regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit është 256.546 persona. Nga ata 117.760 femra dhe 138.786 meshkuj.<sup>174</sup>

Në realitetin kosovar ndodhin shkelje të mëdha në tregun e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Avokati i Popullit vlerëson se Inspektorati i Punës si mekanizëm preventiv dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, duhet të kontrollojë në mënyrë unike të gjitha vendet e punës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Duhet të kontrollojë kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve në përgjithësi. Ai gjithashtu duhet të veprojë në mënyrë aktive për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit. Një kujdes i veçantë duhet kushtuar kushteve të punës në tregun privat, me fokus të shtuar në moshën e të punësuarve në tregun privat.

Bazuar në hetimet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit, konstaton se, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat ka shkelje të së drejtës nga marrëdhënia e punës - shkelje të procedurave të punësimit, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kohëzgjatjen dhe kompensimin jashtë orarit, mos shfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor.

### **2.22.1. Puna e ndaluar e fëmijëve**

Një shqetësim të jashtëzakonshëm përbën puna e fëmijëve të moshës jo madhore, të cilët punojnë punë të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin e tyre. Fëmijët e moshës jo madhore i hasim çdo ditë duke punuar me karrocë dore, duke kërkuar lëmshë nëpër restorante dhe sidomos në udhëkryqe të ndryshme të rrugëve më shumë të frekuentueshme, duke shitur cigare dhe punë të tjera.

Edhe pse kjo është e ndaluar dhe fëmijët gëzojnë mbrojtje ligjore si me legjislacionin vendor, po ashtu edhe me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës,<sup>175</sup> kjo dukuri vazhdon pa ndonjë ndryshim. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, kërkon nga institucionet relevante t'i respektojnë normat ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor i cili i mbron të drejtat e fëmijëve.

Në këtë drejtim është i domosdoshëm një bashkëpunim ndërinstitutional dhe ndërsektorial midis Inspektoratit të Punës, degëve përkatëse sektoriale të sindikatës, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Një rol me rëndësi në këtë bashkëpunim duhet të luajë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së bashku me drejtoritë komunale të arsimit, përmes përcjelljes së vazhdueshme dhe të disiplinuar të vijimit të mësimin nga nxënësit dhe nxënëset në arsimin para universitar.

---

<sup>174</sup> *Informatë e Tregut të Punës i DPP të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*, shtator 2012.

<sup>175</sup> *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës*, neni 32: “Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.”

### 2.22.2. Rastet e shkeljes së të drejtës në punë apo për punë

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në IAP janë paraqitur gjithsej 228 ankesa nga e drejta e punës dhe ushtrimi të profesionit, prej të cilave janë hapur 59 raste hetimi. Në ndërkohë janë regjistruar edhe 12 ankesa lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK).

Në rastet e identifikuar dhe të trajtuara nga IAP, vërehet se ka një hezitim të përgjithshëm i institucioneve publike për zbatimin e vendimeve të KPMK. Hezitimet në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me mosnjohjen e Ligjit për Shërbimin Civil dhe të kompetencave të KPMK. Herëherë, vërehet po ashtu edhe një shpërfillje totale e KPMK, e ligjit në fuqi dhe e vetë Kushtetutës nga institucione të caktuara publike.<sup>176</sup>

Mirëpo, hezitimi ka të bëjë edhe me natyrën e vendimeve domosdoshmërisht të obligueshme për zbatim të KPMK si organ jo gjyqësor. Në këtë drejtim, në raste të caktuara vërehet se shumë institucione kanë vërejtje serioze në mënyrën e trajtimit të njëanshëm të rasteve, hartimit të vendimeve me mangësi profesionale si dhe interpretimit ligjor jokompetent.<sup>177</sup>

Këto janë vërejtje të cilat duhet të merren dhe trajtohen shumë seriozisht, në radhë të parë nga vetë KPMK, e cila në këtë mënyrë do të mund të identifikonte lëshimet dhe mangësitë eventuale në punën e vet. Pastaj, nga Kuvendi i Kosovës duhet të trajtohet me shumë kujdes dhe seriozitet dhe të përcaktohen qartë, pa dykuptimësi dhe në mënyrë shprehimore fushat e veprimit,

---

<sup>176</sup> IAP, *Rasti nr. 154/2012*. Ankesë kundër komunës së Kamenicës, Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (DEFZH) për shkak të moszbatimit të vendimit të Këshillit Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMK). KPMK me ka obliguar organin e Punësimit-administratën komunale të Kamenicës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ankuesin ta kthejë në vendin e punës, duke kërkuar nga kryetari i komunës dhe udhëheqësi i personelit që të zbatojnë vendimin.

Për shkak të mos zbatimit të vendimit, ankuesi më 5 tetor 2011, i është drejtuar Gjykatës Komunale në Kamenicë me propozim për ekzekutim të vendimit të KPMK-së. Më 2 mars 2012, zyrtari përmbarimor i Gjykatës Komunale në Kamenicë, me qëllim të ekzekutimit të vendimit vizitoi Komunën e Kamenicës si debitor dhe kërkoi zbatimin e vendimit të KPMK-së. Më 13 mars 2012, zyrtari përmbarimor i gjykatës ishte përsëri në komunën e Kamenicës për të njëjtën çështje, me ç'rast Kryetari i Komunës deklaroi se *"Nuk i intereson vendimi i gjykatës dhe as i KPMK!"* Më 9 korrik 2012, Avokati i Popullit, i dërgoi një Raport me rekomandim kryetarit të komunës së Kamenicës, duke kërkuar të ndërmerren masa të menjëhershme për ekzekutimin e vendimit të KPMK-së. Deri në publikimin e këtij raporti, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga kryetari i komunës së Kamenicës, nëse është zbatuar vendimi i KPMK-së.

<sup>177</sup> IAP, *Rasti nr. 323/2012*. Ankesa kundër vendimit të kryetarit për ndalesën e të ardhurave personale në lartësinë prej 20 % për muajin mars 2012. Ky vendim kishte ardhur pasi që kryetari i komunës, pas një inspektimi në zyrat e Komunës, ankuesin nuk e kishte gjetur në vendin e punës gjatë orarit të punës. Ankuesi nuk kontestonte vërejtjen me shkrim, por ndalesën prej 20 % në të ardhura personale.

Më 22 tetor 2012, ankuesi e informoi përfaqësuesin e IAP-së se nga KPMK kishte pranuar përgjigje pozitive për ankesën e tij, por komuna e Skenderajt, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për kompensimin e ankuesit. Sipas ankuesit, pas pranimit të vendimit të KPMK-së, atij i është ndërruar vendi i punës përkundër vullnetit të tij dhe pa u pyetur fare. Meqenëse në këtë rast ka disa vendime pasuese, ndër të cilët edhe një veprim hakmarrës të Komunës me elemente viktimizimi, ankuesi është këshilluar nga IAP që t'i drejtohet gjykatës kompetente.

kompetencat<sup>178</sup> dhe përputhshmëria midis natyrës së KPMK si institucion i pavarur me të drejtë vendimmarrjeje kuazigjyqësore, me karakter të plotfuqishmërisë dhe pa të drejtë ankese.<sup>179</sup>

### **Rekomandimet e Avokatit të Popullit:**

- *Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të luajnë rol aktiv në zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK), duke kërkuar përgjegjësi konkrete nga institucionet dhe personat përgjegjës për mosrespektimin e tyre, në pajtim me ligjin në fuqi .*
- *Qeveria të përpilojnë aktet nënligjore të parashikuara nga ligjet përkatëse në këtë fushë dhe të rris buxhetin për zbatimin me përpikëri të Ligjit të punës në sektorin publik dhe privat.*
- *Qeveria të sigurojë që dispozitat në Kontratën Kolektive të zbatohen në mënyrë të plotë.*
- *Të shtohet numri i inspektorëve në Inspektoratin i Punës.*

### **2.23. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë**

Në Kosovë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve nuk janë shënuar përparime të dukshme pavarësisht përpjekjeve dhe veprimeve të ndërmarra në këtë drejtim nga institucionet e Kosovës. Korniza ligjore e vendit ofron bazë të mirë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mirëpo në praktikë edhe më tutje zbatimi i saj shpeshherë është i pamjaftueshëm, joadekuat apo edhe joefektiv. Në këtë drejtim edhe gjendja e rëndë ekonomike, sociale, varfëria dhe papunësia vështirësojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, përkatësisht, rrezikojnë mirëqenien e fëmijëve. Pra sot, fëmijët në Kosovë përballen me shumë vështirësi dhe probleme të natyrave nga më të ndryshmet. Parandalimi i shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, mbrojtja, fuqizimi dhe përmirësimi i jetës së fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve dhe se në këtë drejtim duhet dhe mbetet për tu bërë edhe

---

<sup>178</sup> IAP, Rasti nr. 387/2012. Ankuesi ankohet se më 2003 është larguar nga puna, ku kishte punuar prej vitit 1999, pa asnjë shpjegim. Në prill 2003 ai kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prizren, e cila nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim deri në gusht 2009, kur shpallet jo kompetente dhe çështjen e dërgon në KPMK.

Në shtator 2010, ankuesi paraqitet tek Avokati i Popullit duke dorëzuar kopjen e vendimit të KPMK-së, sipas të cilit ankuesit i është refuzuar ankesa për shkak të jo kompetencës, pasi që KPMK nuk ka mandat për shqyrtimin e rasteve të punëtorëve shëndetësorë. Ankuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila deri më sot nuk ka vendosur për këtë padi.

<sup>179</sup> Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 13:” Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit i cili e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”.



më shumë nga e gjithë shoqëria kosovare, në pajtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës<sup>180</sup>, përveç tjerash.

### **2.23.1. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve**

Sa i përket zbatimit të Strategjisë dhe Planit nacional të veprimit 2009-2013<sup>181</sup> institucionet e Republikës së Kosovës me gjithë aktivitetet e ndërmarra në fushat e përcaktuara si prioritare, ende nuk kanë arritur të përmbushin disa nga objektivat e përcaktuara nga fusha e qeverisjes, arsimit, mirëqenies sociale etj.

Kur flasim për fushën e qeverisjes, të përcaktuar si prioritare me Strategjinë dhe Planin nacional të veprimit, përkatësisht objektivit që i referohet funksionalizimit të Komitetit ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve,<sup>182</sup> mund të thuhet se ky komitet ende nuk është funksional. Në këtë kontekst, edhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ) në të gjitha nivelet edhe më tej nuk kanë staf të mjaftueshëm, përkatësisht nuk kanë një zyrtar për të drejta të fëmijëve që në orar të plotë do të mbulonte vetëm të drejtat e fëmijëve e jo edhe çështje të tjera. Një gjë e tillë nuk është në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2007<sup>183</sup> gjë që edhe vështirëson realizimin e Strategjisë dhe Planit nacional brenda afateve të përcaktuara kohore. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës do të duhej të ndërmarrë veprimet e nevojshme që Komiteti ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve të funksionalizohet, apo thjesht që edhe formalisht ta anuloj ekzistimin e tij si dhe të caktoj zyrtarë përkatës që do të punojnë vetëm në çështjet e të drejtave të fëmijëve.

### **2.23.2. E drejta e fëmijëve për shkollim**

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim cilësor, sigurimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla janë disa nga objektivat e përcaktuara nga fusha e arsimit edhe me Strategjinë dhe Planin nacional të veprimit për të cilat

---

<sup>180</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve e cila zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>181</sup> Strategjia dhe Plani nacional i veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 2009 me qëllim të sigurimit të zbatimit përkatës të kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve.

<sup>182</sup> Me vendimin nr. 086 të datës 25 tetor, 2006 dhe atë nr. 07/46 të datës 3 dhjetor 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve me qëllim që të ndihmojë përmirësimin e efektivitetit të mekanizmave institucionalë ekzistues dhe të garantojë zbatimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

<sup>183</sup> Shih, *Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2007 për Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës*, i nxjerr më 19 mars 2007, me qëllim të strukturimit dhe integritimit të Njësisve për të Drejtat e Njeriut në ministritë e Republikës së Kosovës.

institucionet e Kosovës duhet të angazhohen në vazhdimësi. Realizimi i këtyre objektivave përveç tjerash kërkon zbatim përkatës të legjislacionit, rritje dhe ngritje të kuadrit organizativ dhe profesional në arsimin gjithëpërfshirës, tekste përkatëse shkollore dhe ndarje të një buxheti të veçantë për asistentë për fëmijë, kur flitet për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Nga fusha e arsimit gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave. Lidhur me çështjen e përfshirjes në arsim të rregullt në një shkollë më afër vendbanimit të tyre, IAP ka pranuar një ankesë nga nëna e një fëmije me aftësi të kufizuar të moshës 9-vjeçare.<sup>184</sup> Me qëllim të ndërmjetësimit, përkatësisht zgjidhjes së rastit, një përfaqësuese e IAP është takuar me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) si dhe të dy shkollave të qytetit të Prishtinës. Fëmija tani është duke ndjekur mësimet në shkollën e cila është më afër vendbanimit të fëmijës.

IAP gjithashtu ka ndërmjetësuar, përkatësisht ka ndihmuar në zgjidhjen edhe sa i përket dy ankesave që kishin të bënin me të drejtën për përfshirje në arsim të mesëm të lartë si dhe lidhur me sigurim të transportit për vijim të mësimet në shkollat përkatëse.<sup>185</sup> Nga hetimi i këtyre ankesave dhe informatat e siguruar nga terreni del se me qëllim të përfshirjes më të gjerë të fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsim është e nevojshme që të punohet më shumë edhe në ngritjen e vetëdijes së prindërve, arsimtarëve si dhe të nxënësve në përgjithësi për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar e në veçanti për obligimin që atyre tu ofrohet trajtim përkatës, miqësor si dhe mundësi të barabarta edhe gjatë procesit mësimor.

Përmirësimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve në arsim, gjithashtu, kërkon edhe përmirësim të infrastrukturës fizike nëpër shkolla. Në këtë drejtim IAP gjatë kësaj periudhe raportuese sipas detyrës zyrtare u është drejtuar autoriteteve përkatëse publike edhe për kushte jo-përkatëse të mësimet në disa shkolla dhe ka kërkuar prej tyre të ndërmerren veprime përkatëse për përmirësimin e tyre.<sup>186</sup>

### **2.23.3. Parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla**

Parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkollë është objektivë tjetër e synuar nga fusha e arsimit për realizimin e së cilës institucionet e Kosovës duhet ti shtojnë aktivitetet e tyre. Nga informatat e siguruar nga përfaqësues të 15 drejtorive komunale të arsimit si dhe nga nxënës të disa shkollave fillore ka rezultuar se dhuna është ende e pranishme në shkollat publike të Kosovës. Një gjë e tillë është mjaft shqetësuese ngase ajo po merr forma të ndryshme: po përdoret nga mësimdhënësit kundër nxënësve, nga nxënësit ndaj nxënësve si dhe nga nxënësit ndaj mësimdhënëseve. Mirëpo, fatkeqësisht nga informatat e siguruar ka rezultuar gjithashtu se në

<sup>184</sup> Rasti i regjistruar në IAP A nr. 244/2012.

<sup>185</sup> Rastet e regjistruara në IAP A nr. 422/2012 dhe A nr. 521/2012.

<sup>186</sup> Rasti i regjistruar në IAP A nr. 414/2012.

disa shkolla disa prindër kanë sulmuar arsimtarë të shkollave përkatëse. Gjatë kësaj periudhe raportuese përkitazi me çështjen e përdorimit të dhunës në shkolla, IAP ka pranuar disa ankesa të cilat është duke i hetuar.<sup>187</sup>

Institucionet përgjegjëse me qëllim të zvogëlimit të kësaj dukurie, veç të tjerash, do të duhej të miratojnë dhe zbatojnë një dokument me të cilin do të përcaktoheshin qartë detyrimet e institucioneve përgjegjëse në parandalimin, luftimin si dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. Ato gjithashtu duhet të ndërmarrin aktivitete për ngritje të vetëdijes së shoqërisë, në veçanti të mësimitdhënësve dhe prindërve se përdorimi i dhunës është i dëmshëm, i kundërligjshëm dhe si i tillë nuk mund të tolerohet.

Në këtë kontekst është e domosdoshme që në të gjitha shkollat e Kosovës, përveç personelit tjetër shkollor të përfshihen edhe pedagogë dhe psikologë, që po ashtu do të ndihmonin në këtë drejtim. Gjithashtu, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit cilësor mësimor, institucionet përkatëse, veç të tjerash, do të duhej të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që ora e kujdestarisë të përfshihet detyrimisht në programet shkollore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar disa ankesa kundër Qendrave për Punë Sociale lidhur me çështjen e mosrealizimit të kontaktit të rregullt me fëmijë, mospagesës së ndihmës materiale për strehim familjar, si dhe lidhur me çështjen e mospagesës së alimentacionit. Përkitazi me këto raste IAP u është drejtuar autoriteteve përkatëse, nga të cilat ka kërkuar marrjen e veprimeve të duhura, të parapara me ligj.

Lidhur me një ankesë të paraqitur nga një nënë kundër Gjykatës Komunale në Gjilan, Policisë së Kosovës, Prokurorisë Komunale në Gjilan dhe Qendrës për punë Sociale në Gjilan, për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve adekuate ligjore për dhunë në familje dhe çështjen e besimit të fëmijës, IAP ka publikuar një raport me të cilin ka konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuseses për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, IAP me këtë rast ka konstatuar se ka pasur edhe shkelje të së drejtës për mjete efektive të garantuar me nenin 13 të po kësaj konvente.<sup>188</sup>

## **2.24. Përgjegjësia për mjedisin jetësor**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka rregulluar përgjegjësinë e të gjithë personave fizikë dhe juridik, për mbrojtjen e mjedisit, e njëherësh ka ftuar të gjitha institucionet, që të garantojnë pjesëmarrjen e të gjithëve në vendimmarrje.<sup>189</sup>

<sup>187</sup> Rastet e regjistruara në IAP A nr. 536/2012, A nr. 576/2012 dhe A nr. 487/2012.

<sup>188</sup> Rasti i regjistruar në IAP A nr. 442/2011.

<sup>189</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 52.

Për arsye të statusit të saj, Kosova vazhdon të mos jetë palë e shumë konventave, protokolleve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore.

Sido që të jetë, Kosova mbetet që të vazhdojë përshtatjen e legjislacionit me standardet mjedisore dhe klimatike të BE-së. Ndërsa ligjet për mbeturinat, ujërat, kemikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile, duhet adaptuar dhe kompletuar me legjislacion sekondar.<sup>190</sup> Ndërsa, institucionet tashmë të krijuara, që merren me zbatimin dhe sundimin e ligjeve mjedisore, si në nivel qendror edhe lokal, duhet përforcuar me ngritjen e kapaciteteve materiale dhe njerëzore.<sup>191</sup>

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte me ndikim të gjerë: në të drejtën për jetë, të drejtën e privatësisë, të drejtën familjare, të drejtën e pronës, shëndetin publik, duke vërejtur problemet e shumta mjedisore, ankesat e qytetarëve, IAP krijoi njësinë e veçantë, e cila merret me mbrojtjen e të drejtës për mjedis.

Edhe Policia e Kosovës, gjatë vitit 2012, në kuadër të krimeve të rënda, krijoi njësitin kundër krimeve mjedisore.

Ndotja e vazhdueshme e mjedisit, djegia masive e pyjeve, zgjerimi i pakontrolluar urban dhe ndërhyrjet abuzuese, ndërtimet e pa kriter, humbja e tokave bujqësore, ndotja e ajrit, ujërave, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, dëmtimi dhe shkatërrimi i biodiversitetit, mungesa e mjaftueshme e sistemeve monitoruese, e sistemit të informimit, dështimet në trajtimin e mbeturinave, zhurma enorme, vazhdojnë të jenë sfidë për Republikën e Kosovës. Të gjitha këto i vështirësoi, mos përfshirja e mbrojtjes së Mjedisit, në prioritetet e qeverisë, duke u ndarë vetëm 1.1%, nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës për ambientin për vitin 2012.

### **2.24.1. Ndotja e ajrit**

Ndotja e ajrit në mjediset urbane dhe ato industriale vazhdon të jetë problem i rëndë. Ndotësit kryesor të ajrit në Kosovë vazhdojnë të jenë: Termocentralet (Kosova A dhe B); Minierat e hapura të linjtit; Kompleksi industrial në Mitrovicë; Ferronikeli në Gllogoc; Fabrika e çimentos “Sharrcem” në Han të Elezit (e cila ka shënuar përmirësim gjatë vitit raportues), Sistemet e ngrohjes qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë). Përveç tyre, në këtë aspekt kontribut të madh kanë dhënë edhe përdorimi i mjeteve të vjetra të transportit, si dhe shfrytëzimi i karburanteve të cilësisë së ulët.

Në shumicën e rasteve, ndotja e ajrit është nga emetimet e dioksidit të sulfurit (SO<sub>2</sub>), oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), plumbit (Pb) dhe metalet tjera të rënda, monoksidit të karbonit (CO), tymit, grimcave, bashkëdyzimet organike të avullueshme (BOA), dioksinave dhe furaneve. Stacionet e vendosura të monitorimit nuk janë të mjaftueshme, andaj është e domosdoshme ndërmarrja e

<sup>190</sup> Shih në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf), fq.46. (20.03.2012).

<sup>191</sup> Po aty.

masave jo vetëm për të kontrolluar dhe monitoruar emetimet në mënyrë sistematike por edhe për t'i zvogëluar ato.

Nivelet e ndotjes së ajrit në Kosovë janë dukshëm mbi nivelet e parapara me direktivat e BE-së. Basenet e linjtit janë ndër ndotësit më të mëdhenj me pluhur, NO<sub>x</sub> and SO<sub>2</sub>, të cilat tejkalojnë për disa herë direktivat e BE-së dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), ndërsa cilësia e monitorimit nuk është e kënaqshme.<sup>192</sup>

Avokati i Popullit, pas pranimit të ankesës nga një banor i fshatit Dardhishtë, me qëllim të zhvillimit të hetimeve, së bashku me Inspektoratin e MMPH-së dhe përfaqësuesit e Institutit Hidrometeorologjik, morën mostrat lidhur me ndotjen e mjedisit. Meqenëse nga mostrat e marra u vërtetua tejkalim i elementeve ndotëse në ambient, sidomos fenolit, MMPH i është drejtuar gjykatës kompetente. Lidhur me rastin AP, ka reaguar nëpërmjet komunikatës për media.<sup>193</sup>

Duke vërejtur praktikën e djegies së gomave me rastin e 1 majit, djegies së hamulloreve dhe pyjeve, dhe efektit negativ në ndotjen e ajrit, Avokati i Popullit, me anë të komunikatës së lëshuar më 29 prill 2012, kërkoi ndërmarrjen e masave të organeve kompetente në parandalimin e kësaj dukurie, të cilësuar me pasoja të rënda afatgjate.<sup>194</sup> Shqetësimin e tij, lidhur me ndotjen e ajrit, Avokati i Popullit e paraqiti edhe me rastin e hetimit të menaxhimit të deponisë së mbeturinave në Gjilan, ku kishte djegie të vazhdueshme të mbeturinave, dhe lidhur me këtë kërkoi veprimin e inspektoratit mjedisor.<sup>195</sup>

#### **2.24.2. Dëmtimi i burimeve dhe ndotja e ujit**

Mosmenaxhimi i mirë, shfrytëzimi jo i mirë dhe i pabarabartë i ujërave, karakterizon gjendjen e vështirë me të cilën u ballafaqua Kosova këtë vit. Cilësia e ujërave në burim dhe në rrjedhjen e sipërme është e mirë. Kjo cilësi përkeqësohet në pjesën e mesme dhe të poshtme të ujërrjedhës, për shkak të shkarkimit direkt dhe të pa trajtuar të ujërave të ndotura nga zonat urbane, industrinë, bujqësia, transporti etj.

Monitorimi vazhdon të mbetet sfidues, nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, po ashtu edhe për përdorimin e tyre. Gjendja në trajtimin e ujërave të ndotura (zeza) është kritike në gjithë vendin. I vetmi impiant për trajtimin e ujërave të ndotura është ndërtuar në Komunën e Skenderajt.

Shkarkimi i ujërave të ndotura nga amvisëria, industria dhe ndotja nga bujqësia e transporti bëhet direkt në lumenj, pa asnjë trajtim paraprak.

---

<sup>192</sup> Në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf) (21.03.2012).

<sup>193</sup> IAP, Rasti A. 250/2011. Shih po ashtu në <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,552> (20.03.2012).

<sup>194</sup> Shih në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,566> (21.03.2012).

<sup>195</sup> Shih në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,566> (21.03.2012).

Avokati i Popullit, pas pranimit të informatës për ndotjet në lumin Morava në afërsi të Gjilanit, dhe pas zhvillimit të hetimeve në teren, në fshatrat përgjatë të cilave kalon ky lum (Uglar, Pogradje dhe Dobërçan), vërejti sasi të konsiderueshëm të peshqve të ngordhur. Më vonë një gjë e tillë është vërejtur edhe në basenin e lumit Drini i Bardhë, në Malësi të Vogël. Përmes komunikatës për media, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin duke ftuar mekanizmat përgjegjës që të ndërmarrin të gjitha masat për pengimin e një ndotjeje të tillë, si dhe për parandalimin e hedhjes së substancave dhe mbeturinave, të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik dhe organizmat ujorë.<sup>196</sup>

Një dukuri jashtëzakonisht shqetësuese në mbarë Kosovën, që shumë më e theksuar është në qendrat urbane të Kosovës, është humbja e ujit të pijshëm nga instalimet e vjetra, shfrytëzimi i pandërgjegjshëm i ujit të pijshëm për ujitje dhe pastrim të veturave dhe objekteve, dhe sidomos shkalla inkasimit shumë e ulët e shfrytëzimit të ujit të përdorur. Gati të gjitha vendbanimet e mëdha në Republikën e Kosovës ballafaqohen vazhdimisht me mungesën e ujit të pijshëm, me reduktime shumë të gjata dhe të mëdha sidomos gjatë muajve të verës.

Lëvizje pozitive është vërejtur me fillimin e implementimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/46, i datës, 2 Nëntor 2011, i cili ndalon eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, dhe fillimi i zbatimit të tij, që nga 2 janari 2012.

### **2.24.3. Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve**

Pakësimi i tokës bujqësore, ka vazhduar me intensitetin e njëjtë në Kosovë. Zvogëlimi i shpejtë i sipërfaqeve bujqësore, dhe ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore, erozioni i tokës, ndotja me ujëra të zeza, degradimi nga eksploatimi sipërfaqësor i linjitet për nevoja të furnizimit të KEK-ut, gurëthyesit e shumtë të pakontrolluar, janë disa nga veprimet me efekte shkatërruese të tokës. Në Kosovë janë identifikuar 30 vende, ku tokat janë kontaminuar nga metalet e rënda, produkte kimike, vajra të përdorura dhe ndotës tjerë.<sup>197</sup>

Mosrespektimi i planit hapësinor dhe planeve zhvillimore të komunave, mungesa e sistemit të monitorimit të tokës, mungesa dhe pasiguria e të dhënave kadastrale, të gjitha janë faktorë që ndihmojnë degradimin dhe mbrojtjen e tokës.

Këtë vit, Avokati i Popullit ka vërejtur probleme mjedisore, me ndikim të veçantë në të drejtat e njeriut, nga ndërtimet e pa kriter, nga mos respektimi i planeve hapësinore dhe rregulluese të komunave, gjë që kërkon balancim urbanistik.<sup>198</sup> Ndërtimet e larta, mos respektimi i hapësirave

<sup>196</sup> Shih në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,496>, (21.03.2012).

<sup>197</sup> Shih në: [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Gjendja\\_e\\_Mjedisit\\_ne\\_Kosove\\_2008-2010.pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Gjendja_e_Mjedisit_ne_Kosove_2008-2010.pdf) (21.03.2012).

<sup>198</sup> Shih në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf) (21.03.2012).

në mes të objekteve, tejkalimet në etazhitet, ndriçimi dhe ventilimi joadekuat, mungesa e shkallëve emergjente, dhe masave të sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri, si dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor,<sup>199</sup> gjithë këto janë pasojë e miratimit të vonshëm të ligjit të ri për ndërtimin, si dhe jo kompletimin e tij me legjislacionin përcjellës sekondar.

Këtë vit, si një ndër problemet më të mëdha mjedisore mund ta rendisim, djegien masive të 3700 hektarë të pyjeve të kualitetit më të mirë, dhe humbje të biodiversitetit pyjor. Edhe pse kjo situatë është duke u përsëritur prej vitit në vit, shqetësues është fakti për mos-përgatitjen e planeve të veprimtimit të organeve kompetente, si dhe mangësitë e trajtimit të këtyre rasteve emergjente me mjete bashkëkohore.

#### **2.24.4. Sigurimi i vendpunishteve – rrezik i drejtpërdrejtë për jetën**

Një shqetësim të veçantë me ndikim në mjedis, që përcillet me rrezik për jetën, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve dhe punëtorëve, Avokati i Popullit ka vlerësuar edhe mos sigurimin, mungesën e rrethojave të vendpunimeve, nga punëkryerësit. Kjo shpeshherë përcillet me vendosjen e materialit ndërtimor, dhe shpërndarjen e mbeturinave ndërtimore në trotuare dhe rrugë, duke shkaktuar cenim të lirisë së lëvizjes, dhe uzurpim të pronës publike.

Edhe pse qasja e publikut në informata është një nga mënyrat më efektive për trajtimin e problemeve mjedisore, e drejtë e garantuar në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Ligjin për Ndërtim, Avokati i Popullit ka vërejtur mosrespektimin e kësaj të drejte nga organet kompetente. Në këtë kontekst, IAP ka vërejtur mungesën e vendosjes së tabelave informuese në vendndërtim, si obligim ligjor i punëkryerësve. Mirëpo, po ashtu janë shënuar edhe shmangie të mëdha fizike nga planet në tabelat informuese. Për më keq, këtë e kanë bërë institucionet publike që janë të obliguara të zbatojnë ligjin.<sup>200</sup>

Në lidhje me këtë, veçanërisht në qendrat urbane, jashtëzakonisht të theksuara janë problemet si: mungesa e trotuareve; zënia e trotuareve për këmbësorë dhe karroca të personave me aftësi të kufizuara, por edhe për bartjen e fëmijëve të vegjël; mungesa e hapësirave të gjelbra; mungesa e infrastrukturës së duhur rrugore; mungesa e nënkalimeve dhe e mbikalimeve në rrugë urbane dhe regjionale me qarkullim të madh të automjeteve; mos kufizimi dhe mos sigurimi i hapësirave/trotuareve pranë shkollave; mungesa e parkingjeve të duhura në përpjesëtim me numrin e banorëve dhe banesave, etj. Të gjitha këto dukuri dhe probleme pamundësojnë drejtpërdrejtë qasjen e lehtë dhe lëvizjen e lirë, të qytetarëve. Të gjitha këto veprime përbëjnë

<sup>199</sup> Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim, neni 6.

<sup>200</sup> IAP, Rasti A. 354/2011. Ankesa ka të bëjë lidhur me cenimin e të drejtës për qasje në informata nga komuna e Prishtinës. Ankuesi kishte kërkuar informata lidhur me lejen e ndërtimit të një objekti publik (të MPB) në qendër të Prishtinës, meqë ai kishte vënë re tejkalimet në etazhitet të objektit në krahasim me tabelën informuese. Avokati i Popullit, lidhur me çështjen bëri raport me rekomandime, duke kërkuar nga komuna e Prishtinës lejimin e qasjes në informata, si dhe respektimin e procedurave ligjore. Në lidhje me këtë nuk mori përgjigje asnjëherë.

shkelje të së drejtës për ambient të shëndoshë, cenim i shëndetit, cenim i të drejtës së privatësisë dhe familjes, të drejtës së pronës, të drejtave të fëmijëve, lirisë së lëvizjes, të drejtës për jetë etj.

#### **2.24.5. Mosmbrojtja nga zhurma**

Situata lidhur me mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma vazhdon të jetë e keqe. IAP ka pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me zhurmën e emetuar nga kafiteritë dhe restorantet në qendra të qyteteve, nga aktivitete biznesi në zona banimi. Vërehet mos respektimi i ligjit në lagjet e reja të vendbanimeve, në ndërtim e sipër, në të cilat veprimtaria e ndërtimit me mjete të rënda zhvillohet edhe gjatë fundjavave dhe gjatë orëve të natës.

Nga përfaqësuesit e IAP-së është testuar disa herë përgjegjshmëria e organeve kompetente lidhur me zbatimin e ligjit për mbrojtje nga zhurma në disa mjedise urbane. Sikurse Inspektorati Komunal, po ashtu edhe Policia e Kosovës, kishin dështuar në zbatimin e ligjit në Prishtinë dhe në Gjilan.

Lidhur me problemin e zhurmës, që nga Avokati i Popullit cilësohet si çështje që ndikon negativisht drejtpërdrejt në të drejtën e privatësisë dhe familjes, në të drejtën e pronës dhe mjedisit të qetë, si dhe shkeljet e Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma dhe Mbrojtje të Mjedisit, gjatë vitit 2012 janë bërë dy raporte me rekomandime. Njëri ka të bëjë me ankesën e qytetarëve të një lagjeje në qendër të Prishtinës kundër zhurmës së shkaktuar nga vibrimet e aparateve për ajrosje të një biznesi.<sup>201</sup> Ndërsa rasti tjetër ka të bëjë me ankesën e qytetarëve po ashtu në një lagje të Prishtinës lidhur me aktivitetet ilegale të dru-prerjes dhe dru-shitjes, të përcjella me zhurmë të madhe.<sup>202</sup> Gjatë hetimit të këtyre rasteve është vërejtur se edhe pse ekzistojnë ankesa dhe kërkesa kolektive të qytetarëve, organet kompetente dështojnë të përgjigjen në kërkesat e tyre.

Gjendjen e rëndë mjedisore në Kosovë edhe më shumë e rëndon puna e Inspektorateve të nivelit lokal edhe qendror, neglizhenca dhe mos-përgatitja e tyre profesionale. Një ngritje të menjëhershme të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale e këtyre inspektorateve është më se e domosdoshme.

Një vështirësi dhe problem jashtëzakonisht shqetësues për qytetarët për të rritur bashkëpunimin dhe informimin e organeve kompetente nga qytetarët, paraqet shkelja e parimit të konfidencialitetit nga ana e inspektorateve dhe policisë. Kjo ndikon në cenimin e sigurisë së qytetarëve, sidomos kur dihet natyra e lidhjeve të ndryshme shoqërore në Kosovë. Këtë bashkëpunim e vështirëson edhe më shumë mungesa e telefonave direkt, dhe sidomos vonesat

---

<sup>201</sup> IAP, *Rasti A. 365 /2010*. Ankesë e grupit të banorëve të një objekti në bashkëpronësi në qendër të Prishtinës, në katin e parë të të cilit është vendosur aparati ajrosjes i një veprimtarie biznesi, nga i cili vazhdimisht emetohet zhurmë dhe vibrime.

<sup>202</sup> IAP, *Rasti A. 394/2011*. Ankesë e grupit të qytetarëve, banorë të një lagje banimi në Prishtinë, të cilët ankohen për shqetësimet dhe bezdinë e krijuar nga aktiviteti i drushitjes në atë lokacion.



jashtëzakonisht të mëdha për reagim në rast lajmërimi të rastit, kur qytetarët marrin guximin dhe kurajën të lajmërojnë rastet lidhur me ndërhyrjet në mjedis.

#### **2.24.6. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë**

Gjatë vitit raportues, IAP ka vërejtur probleme të mëdha lidhur me funksionimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës. Sistemi për menaxhimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje në shumë drejtime. Shkalla e grumbullimit të mbeturinave ende është e ulët, e po ashtu është problematike shkalla e inkasimit dhe sidomos mosaplikimi i parimit ndotësi pagan. Ndërsa riciklimi i mbeturinave ende nuk ka filluar në Kosovë.

Gjatë zhvillimit të hetimeve lidhur me ankesën e qytetarëve të Gjilanit, Avokati i Popullit ka hasur në parregullsi dhe keqmenaxhim të deponisë së mbeturinave në Gjilan nga ana e KMDK-ës. Duke e cilësuar si problem të madh me ndikim në mjedis dhe në të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit ndërmori të gjitha masat në kuadër të kompetencave të veta që kjo situatë të tejkalohet, duke kontaktuar drejtpërdrejtë organet përgjegjëse lokale dhe qendrore, dhe përmes deklaramit publik me komunikatë për media.<sup>203</sup>

Me një situatë përafërsisht të ngjashme janë ballafaquar edhe qendrat e tjera urbane në Kosovë sa i përket menaxhimit të deponive të mbeturinave. Kjo vlen sidomos me Prishtinën.

Mbrojtja e mjedisit në Republikën e Kosovës, edhe gjatë vitit raportues është karakterizuar me probleme dhe sfida jashtëzakonisht të mëdha, që kërkojnë ndërmarrjen e masave të menjëhershme jo vetëm nga MMPH, por edhe nga mbarë shoqëria.

Qeveria e Kosovës, duhet të fillojë që mbrojtjen e mjedisit ta trajtojë si çështje me prioritet, duke rritur buxhetin, ngritur përkushtimin dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve ekzistuese, duke ngritur angazhimin për hartimin e politikave të duhura dhe ndërtimin e mekanizmave dhe instrumenteve të duhura për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kualitetit të tij. Sado çmimi i lartë të ketë tani kostoja e mbrojtjes mjedisore, çmimi i riparimit dhe sanimit të degradimit në të ardhmen, do të jetë shumë më i lartë.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar ngritjes së ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kontekst, duhet vazhduar dhe përforcuar bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe OJQ-të e angazhuara në mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.

---

<sup>203</sup> Shih në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,566> (20.03.2013). Në brendësi të deponisë, përveç djegies së vazhdueshme të mbeturinave, u vërejt mostrajtim i duhur i mbeturinave të cilat përhapeshin në të gjitha hapësirat brenda vijave kufizuese të deponisë. Situata u përkeqësua tri ditë më vonë, kur KMDK, për arsye të inkasimit të ulët nga ana e kompanive regjionale për menaxhimin e mbeturinave, mbylli dyert e të gjitha deponive në Kosovë.

## 2.25. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave në Kosovë ka një bazë të fortë normative. Ajo është e garantuar me Kushtetutë<sup>204</sup> dhe KEDNJ dhe Protokollat e saj.<sup>205</sup> Megjithatë, për realizimin kësaj të drejte ligjore në praktikë, qytetarët vazhdojnë të kenë vështirësi të shumta, veçanërisht nga gjyqësori.

Edhe gjatë këtij viti gjyqësorin e vendit e kanë përcjellë vështirësi dhe probleme të natyrave të ndryshme. Mosfunksionimi i pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritja në vendosjen e lëndëve civile dhe penale; numri i lëndëve të pazgjidhura të trashëguara nga vitet paraprake; shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; parashkrimi i lëndëve gjyqësore, madje në mënyrë të qëllimshme në raste të caktuara; procese gjyqësore ndaj gjyqtarëve për korrupsion; moszbatimi në praktikë i KEDNJ, si dhe mos interpretimi i vendimeve të GJEDNJ në vendimet gjyqësore, janë vetëm disa nga vështirësitë dhe problemet më të theksuara.

Sistemi gjyqësor i vendit po kalon nëpër reforma të njëpasnjëshme me qëllim të funksionalizimit të tij në përputhje me standardet ndërkombëtare, por përkundër tyre, dhe disa përparimeve në këtë fushë, rezultatet ende janë të pamjaftueshme për qytetarin.

Ndër sfidat e veçanta të gjyqësorit, me gjithë garancitë kushtetuese për ndarjen e pushteteve, është pabarazia e gjyqësorit me pushtetet tjera, atë legjislativ dhe ekzekutiv. Kjo reflektohet posaçërisht me rastin e ndarjes së mjeteve buxhetore. As për vitin 2013 nuk janë miratuar kërkesat buxhetore të gjyqësorit nga dy pushtetet e tjera, që mbajnë monopolin politik mbi buxhetin. Edhe pse gjyqësori, me qëllim të zbatimit të ligjit për gjykata dhe reformën gjyqësore, kërkesën buxhetore e ka paraqitur me kohë në qeveri dhe Kuvend, i janë ndarë dukshëm më pak mjete se kërkesa. Kjo gjë vështirëson në masë të konsiderueshme kapacitetet e gjyqësorit për zbatimin e suksesshëm të reformës gjyqësore.<sup>206</sup>

Gjyqësori ballafaqohet me mungesë të stafit profesional, gjyqtarëve dhe të bashkëpunëtorëve. Mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare do të ketë ndikime negative sa i përket sigurisë së gjyqtarëve, veçanërisht të atyre në departamentet e krimeve të rënda, për të cilët është e nevojshme ekzistimi i masave adekuate të sigurisë. Kjo do të rezultojë drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjykatave dhe gatishmërinë e gjykatave dhe të gjykatësve individualë për të trajtuar rastet e rënda penale dhe sidomos të korrupsionit të nivelit të lartë.

Ligji mbi Gjykatat Nr. 03/L-199 ka filluar së zbatuari që nga 01.01.2013. Me këtë ligj përcaktohet një strukturë e re organizative e gjyqësorit, me ndikime në lëvizje të gjyqtarëve dhe

<sup>204</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 54: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

<sup>205</sup> *Po aty*, neni 22, p (2). *KEDNJ dhe Protokollat e saj*.

<sup>206</sup> Takimi i mbajtur më 9.01.2013 midis Avokatit të Popullit z. Sami Kurteshi me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Enver Peci.

të personelit administrativ, si dhe bartjes dhe regjistrimit të lëndëve gjyqësore. Kjo reformë pritet të ketë efekte pozitive në efikasitetin e gjyqësorit. Mirëpo, aktualisht ky proces i ndryshimeve të gjyqësorit po dëshmohet shumë i vështirë e kompleks, dhe momentalisht po përcillet me pasoja negative, sidomos me zvarritje për vendosjen e lëndëve gjyqësore, tollovinë e krijuar për shkak të ndryshimit të kompetencave të gjykatave dhe transferimit të lëndëve.

Ligji për gjykata, në disa komuna të reja, të krijuara rishtazi, ka themeluar gjykata, për të cilat duhet siguruar objekte përkatëse, gjykatës, personelin administrativ dhe mjete themelore për punë. Megjithëse neni 41 i këtij ligji parasheh që për zbatimin e ligjit Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mjete të mjaftueshme nga Buxheti i Republikës së Kosovës, kjo nuk është bërë, duke ndarë dukshëm më pak mjete se kërkesa buxhetore.<sup>207</sup>

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka arritur që deri në fund të vitit 2012 ta përfundojë procesin e emërimit të 111 gjyqtarëve për të gjitha nivelet e gjyqësorit. Tani në sistemin gjyqësor të vendit punojnë 351 gjyqtare dhe gjyqtarë. Por si vështirësi që e ka përcjellë këtë proces, ishte mos aplikimi i individëve nga komunitetet pakicë, sidomos nga komuniteti serb, për pozita të rezervuara për gjyqtar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>208</sup> Kjo dukuri po përcillet me ndikime negative në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore.

### **2.25.1. Ankesat për lëndët gjyqësore të pazgjidhura për shkak të mosushtimit të pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit**

Institucionet e Republikës së Kosovës, sikurse edhe gjyqësori edhe gjatë këtij viti nuk kanë arritur shtrirjen pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me gjithë deklaratimet e shumta politike të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për funksionalizimin e gjyqësorit, mbetet shqetësim i jashtëzakonshëm dhe plagë e hapur për Republikën e Kosovës.<sup>209</sup> Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale, Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale, Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë, Gjykata për Kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq, vazhdojnë të mbeten jashtë sistemit gjyqësor të Kosovës.

Lëndët penale dhe civile, mbi 11.700 lëndë në prokurori dhe 1.615 lëndë në gjykatat e lartpërmendura, rrezikohen të parashkruhen për shkak të kalimit të afateve të parapara ligjore. Po ashtu, shumë dokumente personale si letërnjoftime dhe pasaporta të konfiskuara nga policia si

---

<sup>207</sup> *Ligji për Gjykatat Nr. 04/L-199*, neni 41. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Nr. 79, 24 gusht 2010: “ Për zbatimin e plotë të këtij ligji Qeveria e Kosovës siguron fonde të nevojshme nga Buxheti i Republikës së Kosovës.”

<sup>208</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 103 përcakton 15% të vendeve të gjyqtarëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

<sup>209</sup> *Po aty*, neni 102, p. 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

prova, kanë mbetur në këto institucione. Kjo gjendje paraqet shkelje të rëndë të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjithë qytetarët që kanë lëndë gjyqësore dhe ky fakt vazhdon të mbetet një sfidë e madhe për autoritetet e Republikës së Kosovës, për të siguruar funksionimin e shtetit ligjor

Avokati i Popullit, bazuar në ankesat e qytetarëve në lidhje me mosfunksionimin e organeve të gjyqësorit në pjesën veriore të Mitrovicës, më 27 prill 2011 ka dërguar Raportin me Rekomandime institucioneve gjegjëse shtetërore,<sup>210</sup> përmes të cilit kërkoi që të merren masa të duhura dhe të sigurohet qasje e qytetarëve në shërbimet gjyqësore dhe ndarjen e drejtësisë. Por ky rekomandim ende nuk është zbatuar nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Në anën tjetër, ankesat e qytetarëve, megjithëse të zhgënjyer dhe demoralizuar nga mungesa e shtetit ligjor, vazhdojnë të arrijnë në vazhdimësi.

Avokati i Popullit, në të gjitha takimet me autoritetet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, por dhe në media, vazhdimisht e ka shprehur këtë shqetësim të qytetarëve/ankuesve, me qëllim të funksionalizimit të gjyqësorit. Pa asnjë përjashtim, të gjitha institucionet dhe autoritetet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, kanë dështuar plotësisht në vendosjen e shtetit ligjor në këto komuna të Kosovës.

### **2.25.2. Ankesat për lëndët gjyqësore të pazgjidhura dhe zbatimi i Strategjisë Shtetërore “Reduktimi i lëndëve të vjetra”**

KGJK, më 18 nëntor 2010, miratoi Strategjinë Shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra gjyqësore, e cila kishte si pikësynim të vetëm zvogëlimin e lëndëve gjyqësore që ishin të pranuar në punë prej fillimit të vitit 2000 deri më 31 dhjetor 2008, e të cilat nuk ishin zgjidhur/vendosur deri më 31 dhjetor 2010. Afati i zbatimit të Planit për Strategjinë për reduktimin e lëndëve të vjetra gjyqësore, ishte 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2012.

Numri i lëndëve të inventarizuara si të pa kryera, deri më 31.12.2010 ishte gjithsej 161.273. Në mesin e tyre kishte lëndë penale, civile por edhe ekzekutive të vendimeve gjyqësore. Nga raporti i KGJK, i datës 25 prill 2012, lidhur me progresin e arritur për punën e gjyqësorit në reduktimin e lëndëve të vjetra, vërehet se në nivel të përgjithshëm, gjyqësori i ka realizuar një zvogëlim të lëndëve të vjetra vetëm 49,57%.<sup>211</sup>

Sipas po këtij raporti, bazuar në numrin e gjyqtarëve, në veçanti në gjykatat komunale, është arritur progres i kënaqshëm në lëndët e lëmisë penale, ndërsa në lëndët e lëmisë civile ka ngecje dhe do të duhej angazhim edhe më i shtuar se gjatë vitit 2011.

---

<sup>210</sup> IAP, *Raport me rekomandime*, datë 27 prill 2011, drejtuar z. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, lidhur me mosfunksionimin e organeve të judikaturës në pjesën veriore të Mitrovicës.

<sup>211</sup> *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Raporti nr. 5/8-2012. Progresi i arritur për punën e gjyqësorit në Zbatimin e Strategjisë Shtetërore “Reduktimi i lëndëve të vjetra”.

Avokati i Popullit konstaton se përkundër sukseseve të arritura në zvogëlimin e lëndëve të vjetra gjyqësore, gjyqësori domosdoshmërisht duhet të angazhohet për zgjidhjen e të gjitha lëndëve, në mënyrë që të mos vjen deri te parashkrimi i lëndëve gjyqësore, sepse kjo paraqet shkelje të rëndë të drejtave dhe lirive të njeriut dhe dështim të plotë të synimit për shtet ligjor.

### **2.25.3. Ankesat për lëndët gjyqësore panele të përziera me gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 7 shtator 2012 miratoi ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Kosovës.<sup>212</sup> Ky veprim politik kishte për pasojë ndryshimin e 21 ligjeve sistimore me qëllim të ricaktimit të pozitës ligjore të personelit ndërkombëtar në institucionet vendore si dhe në sistemin e drejtësisë përkatësisht të gjyqësorit dhe prokurorisë.<sup>213</sup>

Këto ndryshime rezultuan me ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat dhe të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). Me këto ndryshime, komunat e reja të krijuara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunalë e që nuk kanë gjykatë themelore, mund të themelojnë gjykata me miratimin e KGJK-së. Po ashtu, përcaktohet që në sistemin prokurorial dhe në Gjykatën e Apelit të jenë së paku 15% e prokurorëve përkatësisht gjyqtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Edhe pas përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur ndërkombëtare sistemi gjyqësor dhe prokurorial i vendit vazhdon të mbështetet nga një kontingjent i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, të cilët janë të angazhuar në kuadër të misionit evropian për sundim të ligjit në Kosovë - EULEX, për të ndihmuar autoritetet gjyqësore vendore për zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë. Ata veprojnë në panele të përziera gjyqësore në fusha të caktuara të rezervuara: hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, gjenocidit, terrorizmit, krimin të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, vrasjeve, vrasjeve të rënda, krimet ekonomike dhe të krimeve të tjera të rënda. Ata po ashtu kanë kompetenca edhe për gjykimin e lëndëve civile të të gjitha natyrave dhe niveleve të gjyqësorit sipas ligjit mbi kompetencat.<sup>214</sup>

---

<sup>212</sup> Amandamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Nr. 25, 07 shtator 2012.

<sup>213</sup> *Ligji Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Nr. 04/L-115.* Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Nr. 25, 07 shtator 2012.

<sup>214</sup> *Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Nr. 03L 053, neni 5. p. 1.* Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Nr. 27, 03 qershor 2008.

KGJK nuk ka kurrfarë kompetenca mbi gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it. Ata emërohen/shkarkohen dhe i përgjigjen Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, si dhe shefit të prokurorëve të EULEX-it, i cili vepron nën urdhrat e shefit të Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it.

Gjatë këtij viti raportues Avokati i Popullit ka pranuar 11 ankesa të qytetarëve ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, për shkak të zvarritjes së procedurave hetimore, të zvarritjes së procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve, marrjes së vendimeve të paraburgimit, kërkesës për monitorim gjyqësor nga Avokati i Popullit, dyshimet për provat materiale të propozuara nga prokurori, kërkesës për marrjen e njoftimeve dhe të kontaktimit me të burgosurin, si dhe në disa raste palët e njoftojnë AP lidhur me parashtresat e paraqitura tek gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it.

Një pjesë e ankesave të qytetarëve ishte me kërkesën që lëndët e tyre gjyqësore të gjykohen nga gjyqtarët e EULEX-it dhe jo nga gjyqtarët vendorë. Palët këtë e bënin për shkak të dyshimeve të tyre në gjykimin objektiv të lëndës nga gjyqtarët vendorë dhe kjo ishte, si pasojë e humbjes së besimit në drejtësinë vendore.

Në disa raste ankesat kishin të bënin me masat ligjore lidhur me paraburgimin, duke konsideruar se për marrjen e masave të tilla nuk ka pasur arsye të forta ligjore, dhe se kanë mund të aplikohen format alternative të sigurimit në proceset gjyqësore të të akuzuarve dhe se u janë kufizuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në rastin e ankesës së avokatëve mbrojtës të Fatmir Limaj, Arben Krasniqi<sup>215</sup> dhe të tjerë në rastin e njohur si *Rasti Kleçka*, ndaj të cilëve ishte ngritur aktakuza për krime lufte ndaj popullatës civile dhe ndaj të burgosurve të luftës në vitin 1999, ata kërkuan monitorimin e rastit nga Avokati i Popullit. Ata pohuan se procedura hetimore ndaj klientëve të tyre është zhvilluar me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga ana e prokurorit të rastit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, të garantuara me nenin 30, [Të drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të rregullave procedurale të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Avokati i Popullit në shkresën e dërguar më 1.03.2012, Kryetarit të trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka shprehur shqetësimin në lidhje me pohimet/pretendimet e palës ankuese.

Avokati i Popullit në të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve u është drejtuar me shkresa gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, duke kërkuar informata lidhur me lëndët dhe në të gjitha rastet ka marrë përgjigje me shkrim. Avokati i Popullit ka hasur në mirëkuptim dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me gjyqtarët dhe prokurorët e misionit ndërkombëtar të EULEX-it, në hetimin e të gjitha ankesave të qytetarëve. Prandaj, me këtë rast Avokati i Popullit shfrytëzon momentin për të falënderuar komponentin e drejtësisë të EULEX-it për bashkëpunim të ndërsjellë dhe korrekt.

---

<sup>215</sup> IAP, *Rasti A. 309/2011*.

#### 2.25.4. Ankesat për lëndët gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS) për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), si pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas ligjit shqyrton dhe merr vendime lidhur me kundërshtimet ndaj vendimeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), si paraardhëse e AKP-së, si dhe kërkesave ndaj ndërmarrjeve shoqërore, nga panelet përziera të gjyqtarëve vendor dhe ndërkombëtarë.<sup>216</sup>

DHPGJS-ja, sipas shënimeve zyrtare të KGJK<sup>217</sup> ka në punë një numër të madh të lëndëve, të paraqitura nga qytetarët. Aty janë të deponuara deri më tani 8.240 parashtresa në shkallën e parë dhe të dytë. Prej tyre 4.823 janë ankesa në të ashtuquajturat, lëndët e listave të punëtorëve. Po ashtu sipas raportit vërehet se kemi një efikasitet të ulët vetëm prej 37 % në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore nga kjo gjykatë. Ky fakt është mjaft shqetësues duke pasur parasysh numrin e lëndëve që i ka në punë kjo gjykatë.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 22 ankesa të qytetarëve ndaj DHPGJS, për shkak të zvarritjeve të mëdha kohore në shqyrtimin e parashtresave të tyre. Në mesin e tyre ka pasur edhe ankesa të cilat kanë të bëjnë me detyrimin e qytetarëve për përkthimin e dokumentacionit në gjuhën angleze.<sup>218</sup> Ky shqetësim është ngritur edhe nga shoqëria civile me kërkesën për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e ligjshmërisë së ligjit i cili i detyron përkthimin e dokumenteve.<sup>219</sup>

Me qëllim të hetimit lidhur me ankesat e pranuar, përfaqësuesit e IAP më 24.4.2012 u takuan me Kryetarin e DHPGJS z. Sahit Sylejmani, për t'u njoftuar për vonesat në shqyrtimin e lëndëve gjyqësore, për shpërndarjen e 20 % nga shitjet e ndërmarrjeve publike dhe për çështjen e përkthimit të dokumenteve në gjuhën angleze nga qytetarët.

Sipas z. Sylejmani zvarritjet në zgjidhjen e lëndëve janë paraqitur për shkak të mos emërimit me kohë të gjyqtarëve ndërkombëtarë.<sup>220</sup> Kjo pamundëson procedimin e lëndëve me kohë. Ndërsa sa i përket përkthimit të dokumenteve, sipas z. Sylejmani ky është detyrim ligjor, pasi që panelet e gjyqtarëve janë të përziera (vendor dhe ndërkombëtar), por në shumicën e rasteve Gjykata i ka

---

<sup>216</sup> Ligji Nr. 04/L-033, Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, nr. 27, 22 shtator 2011.

<sup>217</sup> *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Raporti i 6-mujorit të parë 2012, Statistikat e gjykatave të rregullta, faqe 3 dhe 6, në: [www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org), (26.12.2012).

<sup>218</sup> IAP, *ex-officio nr. 12/2012*. Raporti kundër Dhomës së Veçanet të Gjykatës Supreme dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të detyrimit të qytetarëve për përkthimin e dokumenteve në gjuhën angleze.

<sup>219</sup> IAP, *Rasti A. 151/2012*. Kërkesa e organizata joqeveritare CLARD për dërgimin e ligjit në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë.

<sup>220</sup> Takimi më 24.4.2012 me DHPGJSK, z. Sahit Sylejmani me zëvendësin e Avokatit të Popullit, Isa Hasani.

miratuar kërkesat e qytetarëve për lirim nga përkthimi i dokumenteve dhe gjykata i ka përkthyer vetë ato.

Avokati i Popullit, pas analizimit të ankesave të qytetarëve, ka konstatuar se praktika e refuzimit të parashtrësive të qytetarëve nga DHPGJSK për shkak të mos përkthimit të dokumenteve në gjuhën angleze sipas nenit 25, paragrafi 8, 9 dhe 10 i Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJSK për çështjet në lidhje me AKP, është diskriminuese për qytetarët, ngase me këtë atyre iu mohohet e drejta për qasje në Gjykatë.

Prandaj, Avokati i Popullit i dërgoi Raport me Rekomandime<sup>221</sup> Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesën për fillimin e procedurave për ndryshimin e nenit 25 paragrafit 8, paragrafi 9 dhe paragrafi 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJSK për çështjet në lidhje me AKP, në mënyrë që ky ligj të jetë në harmoni me Kushtetutën. Po ashtu, Avokati i Popullit i rekomandoi DHPGJSK që të ndërpresë praktikën refuzuese dhe të kërkojë fuqizimin e shërbimeve të përkthimeve brenda gjykatës, në mënyrë që qytetarëve në asnjë mënyrë të mos u kushtëzohet qasja në gjykatë – drejtësi.

#### **2.25.5. Ankesat e qytetarëve për lëndët gjyqësore ndaj gjykatave të rregullta**

Avokati i Popullit, në bazë të Kushtetutës dhe nenit 15.6 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka kompetenca të kufizuara në hetimin e ankesave qytetarëve, në fushën e gjyqësorit. Në çdo rast, asnjë veprim i Avokatit të Popullit, nuk guxon të prekë apo rrezikojë pavarësinë e prokurorëve në zhvillimin e hetimeve dhe gjyqtarëve në marrjen e vendimeve gjyqësore.<sup>222</sup>

Avokati i Popullit, në rastet e hetimit të ankesave, vëmendje të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të gjykimit të drejtë, si dhe të drejtës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, të garantuara në nenin 6 të KEDNJ.

Numri më i madh i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP në vitin 2012 i përkasin gjyqësorit si palë përgjegjëse. Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

Kundër gjykatave si palë përgjegjëse, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 532 ankesa, ndërsa në vitin paraprak 2011 kemi pasur 365 ankesa. Vërehet një rritje e madhe e numrit të ankuesve ndaj gjyqësorit në raport me vitin paraprak.

---

<sup>221</sup> IAP, *Raport me Rekomandime*, 24 tetor 2012, dërguar Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

<sup>222</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, nenet 132-135; *Ligji për Avokatin e Popullit*, nr. 03/L-195, neni 15, p. 6. “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”



Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar 308 ankesa janë vendosur si të papranueshme, sipas nenit 19.1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit,<sup>223</sup> ndërsa për 216 ankesa është marrë vendim për të hapur hetime dhe 8 ankesa janë në pritje për shqyrtim.

Numri më i madh i ankesave është paraqitur kundër gjykatave komunale, të qarkut, Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe kundër DHPGJSK për çështjet në lidhje me AKP.

Në të gjitha rastet, kur kërkesat apo ankesat e qytetarëve në lidhje me gjyqësorin nuk kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, ata janë udhëzuar dhe drejtuar tek institucionet kompetente profesionale për ofrimin e shërbimeve juridike, si në Komisionin për Ndhimë Juridike dhe shoqatat joqeveritare, të cilat kryejnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Nga analiza e natyrës së ankesave të hetuara të qytetarëve, konstatohet se shumica e ankesave ka të bëjë me: zvarritje, herë-herë disavjeçare, të procedurave gjyqësore; parashkrimin e lëndëve gjyqësore; mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme; dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në vendosjen e lëndës si dhe përfaqësimit jo të mirë nga avokatët mbrojtës.

#### **2.25.6. Zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve**

Zvarritja e procedurave gjyqësore, para së gjithash është pasojë e numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake si dhe rritja e vazhdueshme e numrit të madh të lëndëve të reja gjyqësore nga sfera të ndryshme. Përkundër faktit që vitin e kaluar janë pranuar në gjykata 111 gjyqtarë të rinj, sa i përket zvarritjeve të lëndëve gjyqësore nuk është vërejtur ndonjë progres i konsiderueshëm në gjyqësor.

Sipas raportit vjetor 2011 të KGJK për gjykatat e rregullta, numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura në gjykata, në fund të 6-mujorit parë 2012 ishte 220'613 lëndë.<sup>224</sup> Ndërsa në fund të vitit 2011, në pritje për t'u vendosur ishin 213.037 lëndë.<sup>225</sup> Pra, kemi rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjyqësor.

Sipas shënimeve statistikore në Raport, vërehet se në gjashtëmujorin e parë gjykatat kanë zgjidhur 22.441 lëndë gjyqësore, ndërsa qytetarët i kanë parashtruar 23.512 parashtresa në gjykata. Gjyqësori ende pranon më shumë lëndë se sa mund të zgjidh. Ky është një fakt shumë shqetësues për Avokatin e Popullit, prandaj kërkon nga KGJK-ja që urgjentisht të angazhohet për gjetjen e një zgjidhje ligjore në këtë drejtim.

---

<sup>223</sup> Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 19, p. 1.3.: "Ankesa nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit".

<sup>224</sup> *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Raporti i 6-mujorit të parë 2012, faqe 6. Statistikat e gjykatave të rregullta, [www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org), (26.12.2012).

<sup>225</sup> *Këshilli Gjyqësor të Kosovës*, Raporti vjetor 2011. Statistikat e gjykatave të rregullta, [www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org), (26.12.2012).

Me gjithë gjendjen e këtillë në gjyqësor, Avokati i Popullit nuk gjen arsyetim për zvarritjen e procedurave që kanë të bëjnë me konteste pronësore, kur qytetarët janë të detyruar që vendimet t'i presin me vite të tëra.<sup>226</sup>

### **2.25.7. Parashkrimi i lëndëve gjyqësore nga gjykata**

Edhe pse në raportin e 6-mujorit të parë të vitit 2012, KGJK nuk paraqet të dhëna lidhur me parashkrimin e lëndëve gjyqësore, gjatë këtij viti raportues në IAP kanë ardhur ankesa për shkak të parashkrimit të lëndëve gjyqësore nga ana e gjykatave.

Parashkrimi i lëndëve mund të jetë rezultat i ngarkimit me lëndë gjyqësore dhe pamundësisë së vendosjes në afate kohore. Po ashtu, faktor me ndikim të përkohshëm negativ mund të jenë edhe reformat e vazhdueshme të gjyqësorit. Por, ajo që mund të dëshmohet dhe është jashtëzakonisht shqetësuese, është fakti se parashkrimi mund të vjen edhe si pasojë e neglizhencës apo të keqpërdorimit të detyrës së gjykatësit.<sup>227</sup>

Për Avokatin e Popullit parashkrimi i lëndëve gjyqësore paraqet një nga shkeljet më të rënda të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë, në një shtet ligjor!<sup>228</sup>

Avokati i Popullit, bazuar në ankesat e qytetarëve lidhur me parashkrimin e lëndëve gjyqësore, më 30 mars 2012 i dërgoi Raportin me rekomandime KGJK dhe kërkoi që të ndërmerr masat e nevojshme për zbatimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, në mënyrë që gjykatat të mos zvarrisin çështjet deri në parashkrimin e tyre.<sup>229</sup>

Avokati i Popullit vazhdimisht ka kërkuar, por edhe me këtë rast shfrytëzon rastin që, me theks të veçantë, të kërkojë nga Zyra e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që, në të gjitha rastet e parashkrimit veç e veç, të hetojnë shkaqet e parashkrimit të lëndëve dhe të iniciojë masa disiplinore ndaj të gjithë atyre që gjenden fajtorë për lëndët e parashkruara.

---

<sup>226</sup> IAP, Rasti nr. 403/2012. Ankesë kundër Gjykatës komunale në Prishtinë, lidhur me të drejtën pronësore. Ankuesi ka parashtruar padi për vërtetimin e se drejtës pronësore në vitin 2005, dhe deri më tani rast nuk është zgjidhur nga gjykata. Për shkak të zvarritjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore, Avokati i Popullit në shkresën e dërguar më 17.10.2012 kërkoi nga Gjykata komunale në Prishtinë që të vazhdojë procedimin në lidhje me këtë lëndë në afatin sa më të shkurtër, në përputhje me normat dhe standardet për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm.

<sup>227</sup> IAP, Rasti nr. 479/2012. Ankesë kundër Gjykatës komunale në Prizren. Pala ankohet për shkak të parashkrimit të lëndës nga ana e gjykatës. E pa kënaqur me aktvendimin e gjykatës, pala kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren. Pala ka kërkuar nga Avokati i Popullit që të monitorohet rasti i tij në gjykatë. Për këtë rast Avokati i Popullit ka hapur hetimet dhe lidhur me këtë rast.

<sup>228</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54: "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur."

<sup>229</sup> IAP, Rasti A. 308/2011. Raport me Rekomandime në lidhje me ankesën e qytetarit për rastin në fjalë, dërguar më 30 mars 2012, Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### **2.25.8. Mosekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore**

Gjatë vitit 2012 Avokati i Popullit ka pranuar numër të konsiderueshëm ankesash për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga gjykatat komunale. Në këto raste është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit, për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Ekzekutimi vendimeve gjyqësore në nivel të vendit është mjaft i ulët. Shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas KGJK-së, qëndrojnë në numrin e vogël të bashkëpunëtorëve për ekzekutim, mungesa e adresave të sakta etj. Por, sipas të gjithë gjasave, faktor tjetër me rëndësi në këtë aspekt është edhe mos koordinimi dhe bashkëpunimi i mangët ndërinstitucional midis gjyqësorit dhe ekzekutivit.

Në të gjitha rastet e ankesave të cilat janë në kompetencë të IAP-së, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka kontaktuar përmes letrave dhe takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të gjykatave komunale, të cilët janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Avokati i Popullit ka kërkuar arsyet për zvarritje të ekzekutimit të vendimeve. Në shumë raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit, gjykatat kanë ndërmarrë veprime për ekzekutimin e vendimeve, por ka pasur raste kur ato nuk janë ekzekutuar.<sup>230</sup>

### **2.25.9. Rastet e tjera të ankesave të qytetarëve**

Në shumë raste Avokatit të Popullit i janë parashtruar edhe ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit. Në këto raste Avokati i Popullit i ka këshilluar ankuesit që, nëse ende konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre nga procesi dhe vendimi gjyqësor, brenda afatit prej katër muaj pas marrjes së vendimit përfundimtar e kanë të drejtën e ngritjes së çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Po ashtu ka raste që nga Avokati i Popullit është kërkuar ngritja e çështjes së tyre individuale në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është edhe pasojë e mos informimit të duhur të qytetarëve për natyrën

---

<sup>230</sup> IAP, *Rasti nr. 386/2012*. Ankesa kundër Gjykatës komunale në Prishtinë, lidhur me zvarritjen e procedurës në gjykatë për mosekzekutim të vendimit për kompensimin e borxhit nga Ministria për Kthim dhe Komunitete e Republikës së Kosovës. Palës me aktgjykimin e plotfuqishëm i është njohur e drejta e kompensimit të borxhit nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, por edhe pse kishin kaluar mbi 3 vite vendimi nuk ishte ekzekutuar. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore për ekzekutimin e vendimit të plotfuqishëm nga Gjykata komunale në Pishinë, Avokati i Popullit në shkresën e dërguar më 25 shtator 2012, i kërkoi Gjykatës që të vazhdojë procedimin për ekzekutim në lidhje me këtë lëndë në afatin sa më të shkurtër, në përputhje me normat Kushtetuese dhe standardet për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm.

e rasteve që mund të ngriten në këtë gjykatë dhe personat e autorizuar sipas Kushtetutës. Avokati i Popullit nuk është kompetent për të dërguar një rast individual në Gjykatën Kushtetuese.

Në disa raste ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues. Nga Avokati i Popullit kërkohet që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në GJEDNJ në Strasburg. Në këto raste palët janë njoftuar për pamundësitë ligjore, pasi Republika e Kosovës nuk e ka nënshkruar dhe ratifikuar KEDNJ dhe qytetarët e vendit nuk mund të ngritin çështjet në këtë gjykatë.

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave, për shkak të mosdërgimit të vendimeve gjyqësore brenda afateve ligjore, si dhe për shkak të pamundësisë së palëve për qasje në lëndën e tyre në gjykatë. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të kësaj natyre, ka kontaktuar zyrtarët e gjykatave dhe në bashkëpunim me gjykatat, i ka zgjidhur ankesat e palëve. Palëve u janë dorëzuar vendimet gjyqësore apo ata janë informuar lidhur me gjendjen e lëndëve në gjykata.

Po ashtu, një numër i ankesave janë paraqitur edhe për shkak të mos përfaqësimit të mirë të ankuesve nga avokatët e tyre mbrojtës në seancat gjyqësore, qoftë kur ata i kanë zgjedhur vetë, apo edhe të caktuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Në të gjitha rastet palët janë njoftuar me të drejtën e tyre që të kërkojnë ndërrimin e avokatëve dhe për rastin e tyre ankesën ta paraqesin në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Shumë herë, qytetarët në ankesat e tyre drejtuar Avokatit të Popullit, kërkojnë monitorimin e rastit të tyre në gjykatë, por në disa raste kërkojnë edhe hartimin e parashtrësive të ndryshme dhe përfaqësimin e tyre në instancat e ndryshme gjyqësore.

Në të dyja këto raste, përveç kufizimit ligjor që ka Avokati i Popullit në lidhje me cilësinë në raportet ndërgjyqësore, ngase Avokati i Popullit nuk mund të marrë në asnjë rast anën e askujt në një procedurë gjyqësore apo administrative, janë edhe kufizimet me personel. Avokati i Popullit nuk disponon me numër aq të madh të personelit të punësuar, për të mundur të monitorojë të gjitha seancat gjyqësore. Prandaj IAP nuk mund të monitorojë të gjitha proceset gjyqësore sipas kërkesës së palëve.

Shumë nga këto veprime të qytetarëve, përveç që dëshmojnë mos informimin e mjaftueshëm të qytetarëve me misionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, në anën tjetër dëshmojnë edhe për besimin e shtuar të qytetarëve tek Avokati i Popullit, edhe pse Avokati i Popullit, bazuar në kompetencat ligjore, nuk mund të zëvendësojë avokatin mbrojtës para gjykatave. Por, fatkeqësisht shumë nga këto raste dëshmojnë humbjen e besimit në sinqeritetin dhe angazhimin e avokatëve mbrojtës, por edhe për humbjen e besimit në drejtësinë gjyqësore në vend në përgjithësi.

#### **2.25.10. Raportet me rekomandime të Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit pas hetimit të ankesave të qytetarëve të parashtruara ndaj gjyqësorit, në shumë raste ka konstatuar se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut nga gjyqësori. Prandaj, me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave dhe të rikthimit të të drejtave të tyre, por edhe të përmirësimit të legjislacionit në fushën e drejtave të njeriut, Avokati i Popullit i ka dërguar gjyqësorit 4 raporte me 12 rekomandime.<sup>231</sup>

#### **2.25.11. Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, kundër prokurorisë si palë përgjegjëse, qytetarët i kanë parashtruar gjithsej 18 ankesa. Prej tyre 10 janë vendosur si të papranueshme,<sup>232</sup> ndërsa për 8 ankesa është marrë vendim për të hapur hetime. Ankesat që kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, janë proceduar në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe janë ndërmarrë veprime të duhura hetimore.

Numri i parashtrësive të cilat kishin të bënin me realizimin e të drejtave para organit për ndjekje penale - prokurorive publike, ishte më i lartë në raport me vitin e kaluar, por më i vogël krahasuar me ato që kishin të bënin me gjykatat. Nga analizat e bëra rezulton se, shkak i një pjese të ankesave janë zvarritjet e procedurave hetimore nga prokuroritë publike, deri në marrjen e vendimit.

Në shumë raste, për shkak të nevojës për informata plotësuese për vendimin përfundimtar, sipas kallëzimeve penale, kërkohen informata të posaçme nga policia. Në këtë fazë të procedurës, si pasojë e pasivitetit dhe iniciativës së pamjaftueshme të prokurorëve publikë, shpeshherë vjen deri te gjecet në punën e prokurorit publik.

---

<sup>231</sup> IAP, *Raportet me Rekomandime. Raporti për rastin A. nr. 442/2011*, dërguar Gjykatës Komunale në Gjilan, më 10 shtator 2012. *Raporti ex-officio A. nr. 12/21012*, dërguar Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, më 24 tetor 2012. *Raporti për rastin A. nr. 395/2009*, dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës, më 5 qershor 2012. *Raporti për rastin A. nr. 308/2011*, dërguar Gjykatës Komunale në Prizren, më 30 mars 2012. Avokati Popullit, për raportet e dërguara me rekomandimet, *A. nr. 442/2011* dhe *A. nr. 12/2012*, ka marr përgjigje nga institucionet të cilëve iu janë drejtuar rekomandimet. Ndërsa për rastet *A. nr. 442/2011*, *A. nr. 12/21012*, nga Gjykata Komunale në Gjilan, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka marr ndonjë përgjigje.

<sup>232</sup> *Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195*, neni 19, p. 1.3. “Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej tridhjetë (30) ditësh vendos për pranueshmërinë si në vijim: 1.3. të hedh poshtë ankesën për shkak se, nuk është në kompetencën AP. sipas këtij ligji; ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga AP”.

Veprimet e tilla më së shpeshti rezultojnë me skadimin e afatit ligjor, brenda të cilit të dëmtuarit kanë të drejtë ligjore për të iniciuar ndjekje penale si paditës privat. Në këto raste vërehet se ka mungesë komunikimi midis të dëmtuarit, policisë dhe prokurorit, prandaj edhe janë shënuar raste që kallëzimi penal të hidhet poshtë, apo të pushojnë hetimet në procedurë penale sipas nenit 82 dhe 158 të Kodit Procedurës Penale.<sup>233</sup>

#### **2.25.12. Zvarritjet e procedurave hetimore në rastet e lëndëve penale**

Disa ankesa të qytetarëve të paraqitura në IAP, kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim dhe vonesat në ngritjen e aktakuzave nga prokuroritë, për shkak të vonesave në kryerjen e procedurave hetimore lidhur me rastet, por ka edhe raste të zvarritjes/shtyrjes së seancave penale, për shkak të mospjesëmarrjes së prokurorëve në seanca gjyqësore dhe në këto raste, të paraburgosurve u vazhdohet qëndrimi në paraburgim me arsyetimet e njëjta.

Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e pranueshme sipas kompetencave të tij, ka hapur hetime për ankesat e palëve dhe ka kontaktuar zyrtarët e prokurorive, duke kërkuar sqarime për zvarritjet e procedurave hetimore dhe të vonesave në ngritjen e aktakuzave. Në disa raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit, janë vënë në veprim organet për zhvillimin e hetimeve dhe përfundimin e tyre.

Disa ankesa të tjera të paraqitura në IAP, kanë të bëjnë me mospërfshirjen e personave të dëmtuar në aktin e prokurorit për ngritjen e aktakuzës. Ky veprim, personat e dëmtuar i vë në pozitë të vështirë sa i përket kthimit apo kompensimit material të pasurisë apo pronës së tyre të dëmtuar nga kryesit e veprës penale.

Në disa raste të ankesave kemi edhe dyshime në objektivitetin e hetimeve të ndërmarra nga prokurori, për shkak të zvarritjeve të mëdha hetimore. Në raste të tilla nuk mungojnë edhe kërkesat për ndërrimin e prokurorit në çështjen e tyre.

Në rastin e një qytetari kundër Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, ankesa kishte të bënte me zvarritje të procedurës penale/hetimore nga Prokuroria. Sipas pohimeve të ankuesit, djali i tij ka humbur jetën më 26.09.2007, në fatkeqësi komunikacionit, por deri më sot rasti ende nuk është

---

<sup>233</sup> *Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale*, neni 82: Prokurori i shtetit me aktvendim e hedh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshem se është kryer veprë penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen. 3. Prokurori i shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hedhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hedhjen e kallëzimit dhe arsyet për këtë.

proceduar nga ana e prokurorisë, përkundër faktit që shkaktari i aksidentit fatal është i njohur për organet.<sup>234</sup>

Avokati i Popullit me qëllim të hetimit të pohimeve të palës, më 7 dhjetor 2009 dhe 8 nëntor 2012 i dërgoi shkresë kryeprokurorit të Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, për t'u informuar në lidhje me fazën në të cilën ndodhet procedura hetimore në çështjen e ankuesit, dhe për veprimet e ndërmarra nga kjo prokurori që ky rast të procedohet brenda një afati të arsyeshem kohor, në pajtim me ligjin dhe nenin 6 të KEDNJ.

Prokuroria, me shkresën e saj të datës 27 nëntor 2012 e njofton Avokatin e Popullit se lënda e ankuesit është në procedim e sipër dhe se është në pritje të mendimit dhe të konstatimit të ekspertit të komunikacionit dhe se posa të sigurohet ajo, lënda do të procedohet.

Në këtë rast, hetimet jo efektive dhe mos procedimi i rastit për vendimmarrje nga ana e Prokurorisë janë të paarsyeshme dhe pa mbështetje ligjore. Kur faktet vendimtare të rastit janë të njohura për organet: viktima, kryesi i veprës penale, mjeti i kryerjes, vendi, koha dhe palët e pranishme në aksident. Avokati i Popullit konstaton se zvarritjet hetimore të paarsyeshme dhe jo efektive nga ana e prokurorisë mbi 5 vite, për një ekspertizë komunikacioni si në rastin konkret, paraqet shkelje të rëndë të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara ligj dhe me kushtetutë.<sup>235</sup>

Sipas njoftimeve të marra nga Prokurori i Shtetit, arsye kryesore për vonesat në zhvillimin e hetimeve penale dhe procedimin e tyre në gjykata, është numri i vogël i prokurorëve në të gjitha nivelet përkundër faktit që në vitin raportues numri i prokurorëve në të gjitha nivelet ka arritur në 125 prokurorë.

Me gjithë ngarkesat e shumta dhe mungesat e theksuara në burime njerëzore dhe të infrastrukturës së nevojshme, për Avokatin e Popullit, arsyetimet për vonesat në ngritjen e çështjeve penale në gjykata brenda afateve të parapara ligjore nga prokuroritë, por edhe për vetë Kryeprokurorin e shtetit, janë jo gjithmonë të besueshme dhe të justifikueshme.

### **2.25.13. Kallëzimet penale të trashëguara nga viti paraprak**

Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës, sipas Raportit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, nga viti paraprak ka trashëguar 12.941 kallëzime penale si të pa zgjidhura, ndërsa si lëndë të reja në vitin 2012 i ka pranuar 11.841 kallëzime-lëndë penale. Gjatë vitit 2012 janë zgjidhur

---

<sup>234</sup> IAP, *Rasti nr. 529/2009*. Ankesa e qytetarit kundër Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, lidhur me zvarritjen e procedurave hetimore që nga viti 2007.

<sup>235</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 54: "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur". *Kodi Nr. 04/L-123 i Procedures Penale*, neni 159: "Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet".

12.006 lëndë penale, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbetur si të pazgjidhura 12.402 kallëzime-lëndë penale.<sup>236</sup>

Nga kjo gjendje mund të konstatohet se prokuroritë kanë kryer përafërsisht po aq lëndë sa edhe janë të paraqitura në këtë periudhë raportuese, përkatësisht 145 lëndë më shumë sesa janë paraqitur. Ende mbetet jashtëzakonisht shqetësues fati i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak si të pazgjidhura, të cilat, me këtë intensitet të punës, nuk do të mund të procedohen brenda afateve kohore dhe rrezikohen të parashkruhen. Ndërsa në raportin vjetor të Prokurorisë mungojnë të dhënat për parashkrimin e lëndëve penale.

Pamundësia e realizimit të të drejtave të qytetarëve para organeve të drejtësisë, ka ndikime jashtëzakonisht negative në opinionin publik, zhvlerëson punën e gjyqësorit/prokurorisë dhe, krijon dyshime për korrupsion në punën e këtij institucioni. Zvarritjet e procedurave për vite të tëra, derisa lëndët të përmbyllen me aktgjykim, ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, sidomos në gjykata dhe prokurori.

Nga ankesat e qytetarëve të parashtruara, mund të konstatojmë se kemi shkelje të të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 31, 32 dhe 54 dhe të nenit 6 të KEDNJ. Qytetarët e vendit nuk kanë një mekanizëm ligjor për mbrojtjen e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm kohor, kur kjo e drejtë e tyre cenohet nga gjyqësori vendor.

Gjendjen e rëndon edhe më shumë fakti se në sistemin e përgjithshëm gjyqësor të Kosovës nuk ekziston institucioni i kompensimit material, për shkak të dëmit të shkakuar material, për zvarritje të procedurave gjyqësore, përkatësisht për shkelje të të drejtave të njeriut, ashtu siç është e zakonshme në vendet demokratike.

## **Rekomandimet e Avokatit të Popullit:**

### **Kuvendit dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës**

- *Të respektohet barazia e pushteteve sipas germës së Kushtetutës dhe Gjyqësorit t'i ndahen mjete buxhetore sipas kërkesës së paraqitur dhe nevojave të tij, për një funksionim të pavarur.*

### **Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

- *Shtrirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*

### **Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë**

---

<sup>236</sup> Raporti i gjashtëmujorit të parë 2012. Për punën e Prokurorisë Komonale, të Qarkut, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit.



- *Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për parashkrimin e lëndëve gjyqësore dhe për zvarritje të tepruar të procedurës gjyqësore.*

#### **Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

- *Që reforma e strukturimit të gjykatave, sipas Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199, që ka filluar të zbatohet nga janari 2013, të jetë funksionale dhe të mos sjellë zvarritje të reja në vendosjen e lëndëve.*
- *Ngritjen e efikasitetit për zbatimin e Strategjisë Shtetërore “Reduktimi i lëndëve të vjetra” për zvogëlimin e numrit të rasteve të papërfunduara gjyqësore.*
- *Për garantimin e sigurisë së gjyqtarëve, veçanërisht të atyre në departamentet e krimeve të rënda, të ndërmerr veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore për aplikimin e masave adekuate të sigurisë në objekte gjyqësore dhe jashtë tyre.*

#### **Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

- *Që të ndërpresë praktikën refuzuese dhe të kërkojë ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve të përkthimeve brenda Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë që qytetarët të mos kushtëzohen që t'i drejtohen asaj edhe në gjuhën angleze.*

#### **Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës**

- *Që masat për heqjen e lirisë - paraburgimit, privimit të lirisë së të pandehurit për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë procedurës penale, të shqiptohen vetëm në raste të domosdoshme dhe arsyeshme ligjore, dhe në vend të tyre të përdoren masat tjera alternative sipas nenit 173 të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123.*

#### **Zyrën e Prokurorit Disiplinor**

- *Që të hetojnë të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me parashkrimin e lëndëve të tyre dhe, në rastet e keqpërdorimit të detyrës, të propozon dhe ndërmarrë masat ligjore të parapara ndaj gjykatësve dhe prokurorëve për shkeljet eventuale të dëshmuara.*

#### **Gjykatat**

- *Për përmbarimin dhe zbatimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore në afatin e paraparë me ligj.*

#### **Prokuroritë**

- *Që në të gjitha rastet penale kur kallëzimet penale hidhen poshtë nga prokuroritë dhe nuk ngritet aktakuza, të njoftohen palët e dëmtuara për mundësinë e ngritjes së padive private.*

## Odës së Avokatëve të Kosovës

- *Të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare (ex officio) dhe, të rregullojë qartë dhe pa mëdyshje sigurimin e klientëve të avokatit, në raste të dëmtimit, lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit.*

### 2.26. Përdorimi i gjuhëve

Gjuha shqipe dhe serbe, si dhe alfabetet e tyre, janë gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kanë status të barabartë në institucionet kosovare. Gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë status të gjuhëve zyrtare në nivel komunal, sipas kushteve të parashikuara me ligj.<sup>237</sup>

Ligji për përdorimin e gjuhëve është një nga ligjet më të rëndësishme për komunitetet pakicë në Kosovë. Edhe pse është një nga ligjet më të përparuara sepse përmban të gjitha dispozita relevante që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, edhe më tutje është kontestues implementimi i tij. Siç edhe është theksuar në raportet paraprake vjetore të IAP-së, problemet rreth zbatimit të këtij ligji ende vazhdojnë. Ligji për gjuhët ende nuk zbatohet në tërësi dhe në mënyrën e përcaktuar, sepse zbatohet vetëm pjesërisht, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Edhe më tutje mungojnë resurset njerëzore dhe financiare, që paraqet pengesë dhe rrezikon qasjen në shërbimet shumëgjuhësore publike dhe pjesëmarrjen frytdhënëse të komuniteteve pakicë në jetën publike.

Edhe më tutje janë aktuale problemet rreth cilësisë së përkthimeve në gjuhët e komuniteteve pakicë të akteve ligjore e nënligjore, që nxjerrin institucionet kosovare në nivel qendror dhe lokal. Ato shpesh janë të pakuptueshme dhe kanë shumë gabime drejtshkrimore. Këtë problem duhet tejkaluar sepse këto janë dokumente që vijnë nga organet më të larta të pushtetit shtetëror. Në institucionet qendrore nuk ka lektorë të punësuar për gjuhën serbe dhe gjuhët e tjera. Në situatë të tillë, përdorimi i gjuhëve të komuniteteve pakicë, në numrin më të madh të rasteve konsiston në aplikimin formal të këtyre gjuhëve, pa kurrfarë mbikëqyrje apo verifikim profesional.

#### 2.26.1. Përdorimi i gjuhëve në nivel komunal

Në nivelin komunal ekzistojnë numër i madh i problemeve të ndryshme. Për shembull, edhe më tutje është problematike çështja e përkthimit për komunitetet pakicë. Edhe pse shumica e komunave kanë formuar njësitë e përkthimit, disa probleme të përbashkëta, siç është vëllimi i

---

<sup>237</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5; Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37; Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre nr. 03/L-047, neni 4.

madh i punëve, numri i pamjaftueshëm i përkthyesve dhe me kualifikime relevante, patjetër sjell deri tek përkthimet e cilësisë së dobët.

Mbishkrimet në gjuhët zyrtare apo gjuhët në përdorim zyrtar na ndërtesat publike edhe më tutje janë problematike. Edhe pse në disa komuna ka përmirësime, siç është rasti me komunën e Gjilanit, ku të gjitha godinat komunale kanë mbishkrime në hyrje, në më shumë gjuhë se një gjuhë zyrtare, komunat e tjera janë shumë larg nga respektimi i kësaj rregulle. Për shembull, në komunën e Malishevës, të gjitha godinat publike kanë mbishkrimet vetëm në gjuhën shqipe.

Po ashtu, në shumicën e komunave shenjat e komunikacionit nuk janë shkruar në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët në përdorim zyrtar në komunë. Megjithatë, ka disa përmirësime. Për shembull, në komunën e Dragashit, të gjitha shenjat në rrugë janë të shkruara në tërësi në gjuhët zyrtare. Në komunën e Podujevës, shenjat posa të vendosura në rrugë janë shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe. Shembull pozitiv është edhe komuna e Graçanicës, e cila gjatë periudhës raportuese ka vendosur shenjat e komunikacionit në të dy gjuhët zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese, në procesin e monitorimit të çështjeve që kanë të bëjnë me përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë, Avokati i Popullit vëren që Ligji për përdorimin e gjuhëve edhe më tutje nuk respektohet fare në komunat e veriut të Kosovës.

### **2.26.2. Përdorimi i gjuhëve zyrtare në shkolla**

Komunitetet në Kosovë kanë mundësi mjaft të vogla që, përpos gjuhës së vet amtare, të mësojnë ndonjë gjuhë tjetër zyrtare. Me rëndësi është inkurajimi i të rinjve në Kosovë që të mësojnë gjuhën e tjerëve, në mënyrë që të kuptohen pa përkthyes. Në sistemin arsimor në Kosovë nuk ka mundësi për nxënësit shqiptarë dhe serbë që të mësojnë gjuhët zyrtare, që në të ardhmen do të krijoj vështirësi edhe më të mëdha, në implementimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Mu për këtë, kjo është çështje me rëndësi dhe është përgjegjësi e Qeverisë që të punoj në ngritjen e vetëdijes dhe krijimit të kushteve e klimës së volitshme për mësimin e gjuhëve zyrtare dhe futjen e tyre në sistemin arsimor në Kosovë.

### **2.26.3. Politika shtetërore për zbatimin e Ligjit për gjuhët**

Si përgjigje në këto mangësi, e për të siguruar zbatimin efikas të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe krijimin e politikave praktike për përdorimin e gjuhëve, Qeveria ka miratuar Rregulloren 07/2012 për Zyrën e komisionerit për gjuhë, e cila ka hyrë në fuqi më 4 prill 2012. Me këtë Rregullore themelohet Zyra e komisionerit për gjuhë, e cila do të bëhet funksionale me themelimin e Këshillit për politikë gjuhësore, me përzgjedhjen dhe emërimin e komisionerit për

gjuhë, me punësimin e personelit të Zyrës së komisionerit për gjuhë, me sigurimin e hapësirës për zyre dhe të resurseve, si dhe me formimin e rrjetit të politikës gjuhësore.<sup>238</sup>

Këshilli për politikë gjuhësore, së bashku me Rrjetin e politikës gjuhësore, përbën një nga mekanizmat për përkrahje Zyrës së komisionerit për gjuhë. Këshilli është mekanizëm i rëndësishëm sepse ofron mbështetje institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe forcimin e politikave gjuhësore, ndërsa komisioneri është i obliguar që, përveç Qeverisë dhe Kuvendit, raportet për punën e vet t'ia paraqes edhe Këshillit.

Pasi u tregua se Komisioni për gjuhë,<sup>239</sup> që ishte themeluar në vitin 2007, nuk ishte funksional, e as që në mënyrë kualitative mundi t'u përgjigjet obligimeve të veta, qeveria iu qas reformimit të këtij komisioni, për çka Avokati i Popullit ka raportuar hollësisht në Raportin e tij vjetor paraprak për vitin 2011,<sup>240</sup> ndërsa ky proces ende nuk është kryer. Zyra e komisionerit për gjuhë, e cila do të funksionalizohet në nivel qendror, në kuadër të Kabinetit të Kryeministrit, tashmë është bërë operative,<sup>241</sup> por opinionin kryesisht ende nuk e di që ky komision ekziston dhe nuk është i njoftuar për mekanizmin e ankesave. Qeveria e Kosovës, gjatë periudhës raportuese nuk ka iniciuar kurrfarë fushate informative për të sqaruar obligimet e institucioneve qendrore dhe komunale, si dhe të drejtat e shfrytëzuesve të gjuhëve zyrtare të komuniteteve pakicë.

#### **2.26.4. Paraqitja e ankesave që kanë arritur në IAP lidhur me përdorimin e gjuhëve**

Gjatë periudhës raportuese IAP ka pranuar numër të madh të ankesave (25) që kanë të bëjnë me çështjen e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare, si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror në Kosovë.

Lidhur me këto ankesa në IAP, një rast, për shembull, kishte të bënte me pamundësinë e vënies së komunikimit në gjuhën serbe me personin e punësuar në Shërbimin e ofiqarisë në Prishtinë,

---

<sup>238</sup> Në mbledhjen e Këshillit për politikë gjuhësore që u mbajt më 01 nëntor 2012, u zgjodh kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Këshillit, të cilët në përputhje me Rregulloren për Zyrën e komisionerit për gjuhë, në Këshillin për politikë gjuhësore u propozuan nga ana e Këshillit konsultativ për komunitete, si përfaqësues për gjuhën serbe dhe turke. Mandati i kryesuesit dhe zëvendësit të tij do të zgjas dy vjet me mundësi për t'u rizgjedhur edhe një herë. <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,4,98> (15.02.2013).

<sup>239</sup> Komisioni për gjuhë ka për mandat të përcjellë aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga institucionet përgjegjëse dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe të këshillojë Qeverinë në kuptim të masave, të parashikuara me nenin 31 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, i cili thotë: *“Qeveria dhe institucionet Kosovare duhet aprovuar masa për promovimin e përdorimit dhe statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare, si dhe të siguroj mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare.”*

<sup>240</sup> Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011. Fq. 23.

<sup>241</sup> Informatat e marra nga web faqja e Zyrës së Kryeministrit për komunitetet. Në të vërtetë, pas dorëheqjes së komisioneres së posazgjedhur për gjuhë, të cilën Qeveria e emëroi në tetor të vitit 2012, Kabineti i Kryeministrit, në pajtim me Rregulloren 07/2012 për Zyrën e komisionerit, më 19 dhjetor 2012, emëroi Slavisha Mlladenoviçin në pozitën e komisionerit për gjuhë. Në <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,4,111> (15.02.2013).

lidhur me përmirësimin e mbiemrit të vajzërisë në certifikatën e kurorëzimit, me ç'rast ankuesja i ishte ekspozuar sjelljes jo profesionale nga ana e zyrtarit civil në këtë komunë.<sup>242</sup>

Lidhur me ankesën që ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për përdorimin e barabartë të gjuhës serbe, po ashtu në Shërbimin e ofiqarisë të komunës së Prishtinës, dhe mospasja e këtij shërbimi që në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, dokumentet personale të ankuesit t'i lëshoj në gjuhën dhe alfabetin serb, pas hetimeve të zbatuara lidhur me ankesën e parashtruar, IAP botoi raport me rekomandime dhe ia dërgoi palës përgjegjëse.<sup>243</sup>

Në të vërtetë, ky shërbim, të dhënat në dokumente i ka shkruar në mënyrë jo të drejtë në gjuhën dhe alfabetin serb, e në disa rubrika gjenden të dhënat e shkruara në gjuhën shqipe. Me kërkesën e ankuesit, zyrtari i këtij shërbimi të ofiqarisë, nuk dëshoi t'i përmirësojë gabimet e shfaqura. Në anën tjetër, lidhur me raportet e IAP, ky shërbim nuk ka dhënë kurrfarë përgjigjeje në afatin e paraparë ligjor, pas së cilës, Avokati i Popullit, palës përgjegjëse i dërgoi letër përkujtuese, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Shërbimi i ofiqarisë së komunës së Prishtinës, as pas letrës përkujtuese, nuk i ka përmbushur rekomandimet e dhëna në raportin e Avokatit të Popullit. Në përgjigjen që pasoi, pala përgjegjëse e arsyetoi mos suksesin e vet me pengesat teknike në sistemin kompjuterik, për arsye se zyrtarët nuk kanë mundësi të shkruajnë disa shkronja në gjuhën serbe.

Ky sqarim është i papranueshëm për Avokatin e Popullit. Problemet e përmendura mund të tejkalohen thjesht me instalimin e alfabetit serb në kompjuterët e Shërbimit të ofiqarisë të Komunës së Prishtinës, por edhe në të gjitha komunat tjera në Kosovë, që është dashur të bëhej menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, e po ashtu ekziston edhe mundësia e shfrytëzimit të shkronjave nga programet ekzistuese kompjuterike për gjuhët dhe alfabetin, që gjenden në çdo kompjuter të sotëm.

#### **2.26.5. Përdorimi i gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare në komunat e Kosovës**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit ka botuar një raport *ex-officio* me rekomandime, të cilin ua ka dërguar, përveç komunave përgjegjëse uebfaqet e të cilave i ka analizuar, po ashtu edhe të gjitha institucioneve përgjegjëse në nivelin nacional në Republikën e Kosovës. Përgjigjja e institucioneve përgjegjëse lidhur me raportin e përmendur përkitazi me rekomandimet e Avokatit të Popullit, pritet në periudhën e ardhshme.<sup>244</sup>

---

<sup>242</sup> IAP pozitivisht e ka zgjidhur rastin A. nr. 99/2012. Pas hetimit të zbatuar dhe paraqitjes së rastit palës përgjegjëse, rasti u zgjidh në afat të shkurtër, në pajtim me kërkesën e palës.

<sup>243</sup> Rasti në IAP, A. nr. 132/2012. Pas hetimit të zbatuar lidhur me ankesën e paraqitur, IAP botoi raport me rekomandime dhe ia dërgoi palës përgjegjëse.

<sup>244</sup> Rasti në IAP, Raporti *ex officio* nr. 275/2012 dhe të tjerët për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Lidhur me 12 ankesat që i ka parashtruar OJQ CLARD, e të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në uebfaqet

Avokati i Popullit, pas hetimeve të kryera dhe analizës juridike të fakteve të nxjerra në këtë raport, konstatoi se, mosbotimi i dokumenteve publike në gjuhët zyrtare në uebfaqet zyrtare të komunave, të cilat kanë qenë objekt i hetimit, paraqet shkelje të dispozitave Kushtetuese dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, me të cilat garantohet përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare në komuna, që njëherit paraqet edhe shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Nga sa u tha më sipër, mund të konkludohet që problemet rreth zbatimit të politikës gjuhësore dhe përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare, edhe më tutje po përsëriten dhe janë të pranishme në të gjitha nivelet dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

### **Rekomandime:**

- *Qeveria e Kosovës, në nivel qendror dhe lokal, të siguroj forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike, në mënyrë që në tërësi dhe në mënyrë kualitative të zbatohet Ligji për përdorimin e gjuhëve.*
- *Qeveria e Kosovës të ndërmerr masa konkrete dhe të mundësoj që Zyra e komisionerit për gjuhë, në kuadër të mandatit të dhënë, sa më parë të bëhet operative, si dhe të ndërmerr masa me qëllim të rritjes së vetëdijes për funksionet dhe rolin e Komisionit për gjuhët.*
- *Qeveria e Kosovës, së bashku me Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, të ndërmerr masa me qëllim të sigurimit të mësimit në cilëndo gjuhë të zgjedhur zyrtare me orë të detyrueshme nga gjuha tjetër, për nxitjen e përafrimit gjuhësor.*
- *Qeveria e Kosovës të siguroj trajnim të rregullt për zyrtarë publik, për t'u siguruar mësimi i të dy gjuhëve zyrtare, për t'u tejkaluar barrierat gjuhësore.*

### **2.27. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre**

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre janë të garantuara me nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave nga fusha e kulturës, ruajtjes së identitetit, arsimit, përdorimit të gjuhëve dhe alfabetit, qasjes dhe përfaqësimit në medie.

---

zyrtare të komunave në Kosovë, Avokati i Popullit e zgjeroi edhe në 10 komuna. Edhe lidhur me përdorimin e barabartë të gjuhëve në uebfaqet zyrtare të disa institucioneve në nivel qendror dhe ndërmarrje publike, është zhvilluar hetim komplet. Raportet ex-officio me rekomandime të Avokatit të Popullit, lidhur me këto çështje, do të botohen në një periudhë të ardhshme.

Përveç nenit 59, të drejtat e pakicave në Kushtetutë garantohen edhe me konventat kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale (konventat kornizë),<sup>245</sup> që ka për qëllim të avancojë barazinë e plotë dhe efikase të komuniteteve pakicë në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike e kulturore.

Në periudhën raportuese paraprake, IAP është koncentruar kryesisht në kulturë, arsim dhe qasje e përfaqësim në mediet e komuniteteve pakicë në territorin e Kosovës. Gjatë periudhës raportuese për vitin 2012, në këto fusha IAP nuk ka vërejtur ndryshime qenësore krahasuar me periudhën paraprake të raportimit. Në të vërtetë, me gjithë projektet e shumta, strategjive dhe planeve, pak nga kjo është realizuar në kuptim të kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur, punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, përmbushjes së kuotës prej 10% në institucionet shtetërore dhe qeverisjen lokale.

Edhe më tutje është aktual problemi i pronës së uzurpuar, si dhe joefikasiteti dhe ngadalësia e policisë, e në veçanti jurisprudenca tek zgjidhja e këtyre kontesteve, e po ashtu edhe ngadalësia e në punë e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) e cila drejtpërdrejtë merret me këtë problematikë dhe ka mandat për zgjidhjen e kërkesave të natyrës pronësore.<sup>246</sup>

### **2.27.1. Kthimi i të zhvendosurve dhe refugjatëve në Kosovë**

Në bazë të dhënave zyrtare të UNHCR-së, nga janari deri në shtator të vitit 2012, në Kosovë vullnetarisht në shtëpitë e tyre janë kthyer 662 persona dhe nga ky numër, 230 janë serb, 58 romë, 253 ashkali dhe egjiptas, 39 boshnjakë, 80 goranë dhe 2 kroatë.<sup>247</sup>

Ministria për kthim dhe komunitete (MKK) vazhdon t'i ofroj përkrahje të gjithë të kthyerve në Kosovë, andaj kështu, me partnerët e vet lokal dhe ndërkombëtar, në të gjitha rajonet e Kosovës i ka ndërtuar gjithsej 76 shtëpi, të cilat janë të pajisura me gjëra themelore të amvisërisë dhe janë dhënë në shfrytëzim gjatë vitit 2012.<sup>248</sup> Të gjithë të kthyerit, në periudhë prej gjashtë muajve pas kthimit në shtëpitë e veta marrin edhe ndihmë në ushqim nga komunat në të cilat është realizuar kthimi. MKK po ashtu ka përshkruar dhe formuar, gati në të gjitha komunat, zyrat komunale për kthim dhe komunitete (ZKKK) që për qëllim kanë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të komuniteteve pakicë. Qëllimi i formimit të këtyre zyrave është përkrahja personave të zhvendosur dhe refugjatëve e personave të riatdhesuar, si dhe koordinimi dhe promovimi i kthimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në shtëpitë e veta në Kosovë.

---

<sup>245</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22(4).

<sup>246</sup> Përfaqësuesit e IAP, me qëllim të përpilimit të këtij raporti kanë mbledhur informata nga e tërë Kosova, në biseda me bashkëbisedues të shumtë lokal (qytetarë, përfaqësues të komunave të cilët janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, OJQ lokale etj.).

<sup>247</sup> Zyra e shefit të misionit të UNHCR në Prishtinë, pasqyrë e të dhënave statistikore të azhurnuara nga fundi i shtatorit 2012.

<sup>248</sup> Të dhënat e marra nga MKK.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, kanë ekzistuar pengesa për asistim të gjithë personave të cilët kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer, sepse nuk ka pasur mundësi t'u ndihmohet të gjithëve në tërësi dhe t'u dilet në ndihmë të gjitha kërkesave dhe nevojave të tyre. Në të vërtetë, për shkak të mungesës së mjeteve materiale disa komuna është dashur të bëjnë zgjedhjen e shfrytëzuesve dhe kanë ndihmuar vetëm ata më të rrezikuarit që janë kthyer në shtëpitë e tyre.<sup>249</sup>

Me gjithë përpjekjet e MKK-së dhe akterëve ndërkombëtarë në Kosovë, kthimi i të zhvendosurve dhe refugjatëve ka qenë gati dyfish më i vogël krahasuar me vitin 2011, kur në Kosovë janë kthyer vullnetarisht 1143 persona. Shikuar përgjithësisht, për kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e veta në Kosovë, kurrsesi nuk mund të thuhet se është i kënaqshëm dhe i mjaft i qëndrueshëm. Zvogëlimit të numrit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në shtëpitë e veta i kontribuon edhe fakti se këta persona shpesh janë shënjestër e sulmeve në mjediset ku kthehen. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2012, kanë ndodhur një sërë incidentesh në komunën e Klinës dhe Istogut, ku ka pasur më shumë të kthyer.<sup>250</sup>

Në të vërtetë, kah mesi i majit të vitit 2012, në fshatrat e të kthyerve në komunën e Klinës janë shkruar parulla dhe mbishkrime në të cilat serbët e kthyer ftohen që të shpërngulen.<sup>251</sup> Kah fundi i majit 2012, janë djegur dy shtëpi të të kthyerve në fshatin Drenoc të komunës së Klinës.<sup>252</sup> Në gusht të vitit 2012, është gjuajtur me gur shtëpia e familjes së kthyer Drleviq në fshatin Zhaç të komunës së Istogut,<sup>253</sup> ndërsa në të njëjtin muaj ndodhi edhe sulmi ndaj serbit të kthyer në Pejë.<sup>254</sup>

Përveç incidenteve të përmendur, në kthimin e të zhvendosurve ndikon edhe fakti se edhe më tutje ekziston numër i madh i pronave të uzurpuara të personave të zhvendosur dhe refugjatëve, kërkesat e natyrës pronësore-juridike të të cilëve edhe më tutje dërgohen në AKP. Ankesat që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave në AKP janë dorëzuar edhe në IAP gjatë vitit 2012. Mirëpo, në IAP edhe më tutje ka ankesa të pazgjdhura të paraqitura viteve të mëparshme, në të cilat ankuesit kanë kërkuar nga AKP që prona e tyre të lirohet nga uzurpuesit, që me të mund të disponojnë lirshëm dhe/ose eventualisht të kthehen në pronat dhe shtëpitë e tyre.<sup>255</sup>

---

<sup>249</sup> Me rastin e bisedës së IAP me shefin e ZKKK në komunën e Parteshit-Pasjanit, është marrë e dhëna se për vitin 2013 janë paraqitur 90 familje të cilat kanë shprehur dëshirën që të kthehen në shtëpitë e tyre, por për shkak të kufizimeve në buxhet për të kthyerit, komuna nuk ka mundësi t'u ndihmoj të gjithëve, por në bazë të buxhetit do të bëhet përzgjedhja e shfrytëzuesve që kthehen. Në takim po ashtu u theksua se nga kjo komunë, gjatë 10 vjetëve të fundit janë shpërngulur 150 familje, kryesisht njerëz të rinj, të cilët lëshuan shtëpitë e tyre për shkak të pamundësisë për t'u punësuar.

<sup>250</sup> Burim MKK.

<sup>251</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,437>

<sup>252</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,436>

<sup>253</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,447>

<sup>254</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,449>

<sup>255</sup> Ankesat e qytetarëve të parashtruara në IAP, për shkak të moszgjidhjes së kërkesave të tyre pronësore nga AKP: 338/2009, 258/2009, 64/2010, 338/2010, 7/2011, 30/2011, 42/2011, 131/2011, 153/2012, 388/2012, 405/2012, 514/2012 etj.



## 2.27.2. Ripranimi dhe riatdhesimi nga Evropa Perëndimore

Kur flitet për ripranimin dhe riatdhesimin, gjatë vitit 2012, nga vendet nikoqire, kryesisht nga Evropa Perëndimore, gjithsej me dhunë janë kthyer 1'753 persona, prej të cilëve Shqiptarë 1'206, ndërsa pjesëtarë të komuniteteve pakicë 547.<sup>256</sup> Përkundër asaj që ekziston Strategjia dhe plani aksional i riintegrit, të cilin Qeveria e Kosovës e ka nxjerrë në vitin 2009, zbatimi i tij në praktikë edhe më tutje është problematik, e në veçanti në nivelin komunal. Nuk ka përparim në shumë fusha të rëndësishme, siç janë: regjistrimi i qytetarëve, arsimimi, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, punësimi, çështjet banesore dhe vendosja. Gati në të gjitha rastet, joefikasiteti i zbatimit të kësaj strategjie është, përveç mungesës së vullnetit politik në nivelin qendror, edhe mosekzistimi i mjeteve të qëndrueshme komunale, që ka për pasojë pagesën joefikase të mjeteve financiare për riintegrim, sepse deri tek personat e riatdhesuar në formë të ndihmës direkte vjen vetëm një përqindje e vogël e këtyre mjeteve.<sup>257</sup>

Përveç gjithë kësaj që u tha, duhet theksuar edhe faktin që, edhe pas 13 vjetësh nga konflikti dhe gati 9 vjet nga trazirat e marsit nga viti 2004, një pjesë e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë jeton në lagjet me kontejnerë dhe qendrat kolektive në tërë Kosovën. Situata e tillë lë përshtypjen se këta njerëz janë harruar, si nga sistemi, ashtu edhe nga shoqëria në tërësi. IAP është i mendimit që kjo çështje duhet zgjidhur urgjentisht, si nga institucionet që merren me këtë problematikë, ashtu edhe nga anëtarët e dalluar të shoqërisë civile në komuna, nga të cilat janë zhvendosur këta persona. Koj çështje po ashtu duhet të zgjidhet në mënyrë që të sigurohet kthim i sigurt dhe i qëndrueshëm i të gjithë të zhvendosurve në shtëpitë e tyre.<sup>258</sup>

Gjithë që u tha lidhur me problemet me të cilët ballafaqohen të kthyerit dhe personat e riatdhesuar, në masë të madhe ndikon, jo vetëm në perceptimin e tyre të sigurisë personale dhe të përgjithshme, si të atyre që janë kthyer, ashtu edhe të atyre që e planifikojnë këtë gjë, e përveç kësaj edhe në procesin e qëndrueshmërisë së kthimit të këtyre personave.

Në periudhën paraprake raportimi i IAP-së, rreth çështjes së komuniteteve pakicë, është koncentruar në komunitetin serb dhe komunitetet tjera në kapituj të veçantë, ndërsa në këtë raport të gjitha komunitetet njësoj janë përfaqësuar në kapitujt që janë objekt i raportimit për vitin 2012. Situata, shikuar në mënyrë të përgjithshme, për asnjë komunitet në Kosovë nuk ka

<sup>256</sup> Zyra e shefit të misionit të UNHCR në Prishtinë, pasqyrë e të dhënave statistikore e azhurnuar nga fundi i shtatorit 2012.

<sup>257</sup> Raporti i OSBE-së për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, botim i tretë, korrik 2012 dhe informatat e marra nga OJQ "Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve" dëshmojnë situatën e vështirë dhe veprimin joadekuat dhe mosgatishmërinë e shumë komunave në Kosovë, që të ballafaqohen me këtë problem.

<sup>258</sup> Shembujt janë me sa vijon: dy lagje me kontejnerë në Graçanicë, lagjja me kontejnerë për personat e zhvendosur në fshatin Uglar, komuna e Graçanicës, lagjja me kontejnerë në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit, qendra kolektive në pjesën veriore të Mitrovicës, qendra kolektive në Leposaviq, qendrat kolektive në Brezovicë, komuna e Shtërpçës, etj.

ndryshuar qenësisht, krahasuar me vitin 2011.,<sup>259</sup> andaj me këtë rast vetëm do të elaborohet situata në të cilën gjenden komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptasve, si komunitet që janë më së shumti të marginalizuar në Republikën e Kosovës.

### 2.27.3. Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas

Theks të veçantë, në kuadër të këtij raporti, IAP do t'i kushtoj komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptasve, që njëherit janë komunitete më të rrezikuara dhe më të marginalizuara në Kosovë. Mjerisht, edhe më tutje, pjesëtarët e këtyre komuniteteve trajtohen ndryshe krahasuar me komunitetet tjera dhe nuk i kanë të drejtat e njëjta dhe qasjen e njëjtë institucioneve, si të tjerët.<sup>260</sup>

Problemet aktuale me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, në kuptim të kushteve joadekuate jetësore dhe banesore në të cilat jetojnë, arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve, situatës socio-ekonomike, për shkak të përqindjes më të madhe të papunëve në kuadër të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, si dhe integritimit të tyre në shoqërinë kosovare.

Problem i veçantë viteve të kaluara, por edhe në këtë periudhë raportuese janë kampet për romët e ashkalinjtë e zhvendosur në veri të Kosovës. Kampi “Lugu i Çezmës“ në pjesën veriore të Mitrovicës, definitivisht u mbyll dhe u rrënuar, kah fundi i vitit 2010. Pas mbylljes së këtij kampi, shumica e banorëve të këtij kampi u vendos në „Lagjen Rome“, të saponduar në Mitrovicën jugore, ndërsa një pjesë ishte e vendosur përkohësisht në kampin “Osterode”, po ashtu në Mitrovicën e veriut.

Kampi “Osterode” për romët dhe ashkalinjtë e zhvendosur u mbyll më 13 dhjetor 2012 dhe të gjithë banorët e tij u zhvendosën, po ashtu në “Lagjen e Romëve“, ku iu ndanë shtëpi, përkatësisht banesa në ndërtesat e banimit. Në lagjen e saponduar punon edhe ambulanta, e cila ofron kujdesin primar shëndetësor për banorët e kësaj lagjeje, e në veçanti atyre që kanë probleme shëndetësore për shkak të tokës së kontaminuar me plumb, ku ishin të ngritur kampet e përmendura.<sup>261</sup> Projekti i ndërtimit të “Lagjes Rome” u realizua në saje të përpjekjeve dhe mjeteve të MKK, komunës së Mitrovicës dhe Organizatës ndërkombëtare joqeveritare “Mercy Corps”, nën patronatin dhe përkrahjen e Zyrës për lidhje të Komisionit Evropian (ECLO) dhe USAID-it.

---

<sup>259</sup> Për më shumë informata për komunitetet pakicë në Kosovë shih Raportin e IAP për vitin 2011. ([http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/4263\\_RAPORTI%202011%20serbisht.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/4263_RAPORTI%202011%20serbisht.pdf) apo [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/91976\\_RAPORTI%202011%20shqip.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/91976_RAPORTI%202011%20shqip.pdf))

<sup>260</sup> Një nga konkluzionet e Tryezës së rrumbullakët që me rastin e ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, më 10 dhjetor 2012, u organizua nga IAP në Prishtinë.

<sup>261</sup> Në kampin „Lugu i çesmës“, për 10 vjet ishin të vendosur romët dhe ashkalinjtë, ndërsa kampi ishte i ngritur në tokën e ndotur me plumb dhe si pasojë e kësaj një numër i madh i banorëve të këtij kampi ishte i helmuar me plumb, në veçanti pasojat e tokës së ndotur me plumb u shprehën në shëndetin e fëmijëve që kanë qëndruar atje. Për këtë problem IAP ka raportuar në raportet e mëparshme vjetore dhe *ex officio* (<http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=2,0,151,156>, apo <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=2,0,151,156,a,0>).

MKK po ashtu, me qëllim të integrimit të qëndrueshëm të banorëve të kësaj lagjeje, ka financuar edhe disa projekte sociale-ekonomike.<sup>262</sup> Edhe pse kampet për romët dhe ashkalinjtë e zhvendosur në Mitrovicën e veriut janë mbyllur, edhe më tutje mbetet shqetësimi për institucionet kompetente, si dhe çfarë të ndërmerret, lidhur me kampin rom për të zhvendosurit në Leposaviq, i cili edhe më tutje është në funksion. Projekti për mbylljen e këtij kampi dhe ndërtimin e lagjes së re, si “Lagjja rome” në Mitrovicën e jugut, për romët e zhvendosur në Leposaviq ekziston më tepër se shtatë vjet, por për realizimin e të njëjtit nuk është bërë asgjë konkrete.<sup>263</sup>

Strategjia tashmë e përmendur për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas (2009-2015) dhe Plan i saj aksional për zbatim, në mënyrë të hollësishme elaboron shqetësimet dhe problemet me të cilët ballafaqohen këto tre komunitete. Ky plan propozon dhe thekson masat konkrete që duhet të ndërmerren, si në nivelin qendror, ashtu dhe në atë lokal, në mënyrë që të fillohet me zgjidhjen e problemeve dhe integrimit më të mirë të këtyre komuniteteve në kuadër të shoqërisë kosovare. Në kuadër të kësaj strategjie dhe Planit të saj janë dhënë kahet, si dhe vlerësimi i buxhetit për realizimin e qëllimit të fundit deri në fund të vitit 2015. Mirëpo, institucionet shtetërore nuk ia arrijnë që të gjejnë kohë për ta nisur realizimin e kësaj Strategjie dhe për të krijuar kushte për integrimin e komuniteteve rom, shkali, egjiptas.<sup>264</sup>

Edhe pse pati lëvizje pozitive në drejtim të kthimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në shtëpitë e tyre, si dhe sferën e kulturës dhe arsimit, për zbatimin e Strategjisë dhe Planit aksional të përmendur, nuk ekziston vullnet politik, koordinimi është mjaft i dobët në nivel qendror, si edhe ndërmjet organeve qendrore dhe lokale të pushtetit, ndërsa është evidente edhe mungesa e mjeteve financiare, që të mundësohet zbatimi efikas i të njëjtëve. Në këtë drejtim, qëndron edhe fakti se këta hapa pozitiv në një pjesë janë arritur edhe në saje të pjesëmarrjes së organizatave ndërkombëtare qeveritare e joqeveritare, për realizimin me sukses të shumicës së projekteve që kanë të bëjnë me kulturën dhe arsimimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.<sup>265</sup>

---

<sup>262</sup> Burim MKK, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,483>

<sup>263</sup> Në arkivin e IAP ekziston kopja e projektit të tërësishëm që është bërë me qëllim të zgjidhjes së përhershme për banorët e kampit për persona të zhvendosur në Leposaviq, i bërë nga ana e Institucioneve të atëhershme të përkohshme të qeverisjes në Kosovë (IPQ) dhe OJQ-ve lokale nga Leposaviqi.

<sup>264</sup> Me qëllim të të kuptuarit më të mirë të këtij problemi, ndërsa për nevoja të këtij raporti, IAP lidhur me Strategjinë dhe Planin aksionar dhe realizimin e të njëjtëve, ka biseduar me përfaqësuesin e komunitetit rom dhe drejtorin e OJQ „Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve“.

<sup>265</sup> Informatat e marra nga OJQ „Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve“.

#### 2.27.4. Arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë

Krahasuar me periudhën paraprake raportuese, sa i përket arsimimit, situata në thelb nuk ka ndryshuar. Si edhe deri më tani, edhe më tutje ekzistojnë dy sisteme të arsimit, sipas planit dhe programit të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë të Kosovës (MASHT) dhe planit e programit të Ministrisë së arsimit të Serbisë. Të dy këto sisteme funksionojnë pavarësisht nga njëri tjetri.

Mundësia e mësimin të gjuhëve zyrtare, gjuhës shqipe dhe serbe, varet nga sistemi arsimor që e vijojnë nxënësit në Kosovë. Komuniteti turk, boshnjak, shumica e komunitetit të ashkalinjve dhe egjiptasve dhe një pjesë e komunitetit rom, mësimin e vijojnë sipas planit dhe programit të MASHT-it. Njëkohësisht, pjesëtarët e komunitetit serb, kroat,<sup>266</sup> malazias, goran dhe një pjesë e komunitetit rom, vijojnë mësimin sipas planit dhe programit i cili aplikohet në Serbi. Hë për hë, vijimi i mësimin të gjuhës shqipe është i mundur për pjesëtarët e komuniteteve pakicë të cilët mësojnë sipas sistemit kosovar të arsimit, ndërsa gjuha shqipe nuk ekziston as si opsion zgjedhor për nxënësit të cilët mësojnë sipas sistemit arsimor të Serbisë. Përjashtim nga kjo është shënuar në komunën e Dragashit, ku në disa shkolla në të cilat goranët vijojnë mësimin sipas sistemit arsimor serb, në ofertë ekzistojnë orët e gjuhës shqipe. Ky program i mësimin të gjuhës shqipe, si gjuhë e dytë, është bërë nga OEBS-i dhe MASHT-i. Për këtë qëllim, nga fundi i vitit 2011, është përgatitur dhe botuar teksti „Gjuha shqipe si gjuhë e dytë“, mirëpo, në MASHT nuk ka ekzistuar iniciativa për program të ngjashëm edhe për gjuhën serbe.<sup>267</sup>

Sa i përket gjuhës rome, MASHT-i ka miratuar planin e programin për gjuhën, kulturën dhe historinë rome, nga klasa e 2-të deri në të 9-ën të shkollës fillore, por edhe më tutje nuk ekzistojnë tekste. E as kadri i kualifikuar mësimor, në mënyrë që të fillohet me realizimin e këtij programi në tërë territorin e Kosovës. Tani për tani, mësimi në gjuhën rome, në kuadër të MASHT-it, zhvillohet vetëm në Prizren. Po ashtu, lënda gjuha dhe kultura rome ekziston dhe aplikohet në shkollat të cilat punojnë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë.<sup>268</sup>

Problem më të madh në fushën e arsimit, që e përkeqëson situatën edhe ashtu të keqe, për komunitete rom, ashkali dhe egjiptas, paraqet shkalla e lartë e braktisjes së shkollave nga fëmijët dhe atë kryesisht pas kryerjes së klasës së 4-të të shkollës fillore. Problemi i braktisjes së shkollave, para së gjithash i vajzave, është pasojë e situatës së keqe sociale-ekonomike të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Në të shumtën e rasteve prindërit janë të detyruar që t' çregjistrojnë fëmijët nga shkolla dhe t'i dërgojnë të kërkojnë lëmoshë apo mbledhin lëndë sekondare, për t'u ushqyer disi. Përveç kësaj, duhet theksuar edhe problemin e diskriminimit në

---

<sup>266</sup> Në fshatin Janjevë, komuna e Lipjanit.

<sup>267</sup> Informatat e marra nga OJQ “Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve” vërtetojnë situatën e vështirë dhe veprimi joadekuat dhe jo gatishmërinë e shumë komunave në Kosovë, që të ballafaqohen me këtë problem.

<sup>268</sup> Të dhënat dhe informatat e marra nga OJQ “Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve”.

shkolla ndaj këtyre pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, si nga nxënësit, pjesëtarë të komuniteteve tjera, ashtu edhe nga vetë arsimtarët.<sup>269</sup>

Iniciativat pozitive në ofrimin e shkollës fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptas kanë ndërmarrë organizatat joqeveritare lokale (OJQ) të këtyre komuniteteve, me ndihmën e donacioneve ndërkombëtare. OJQ-të e përmendura për fëmijët pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, organizojnë mësimin fakultativ jashtëshkollor, gjatë të cilit kryesisht me fëmijët kryhen detyrat e shtëpisë dhe iu ndihmohet këtyre fëmijëve që sa më mirë ta kuptojnë planin e programin shkollor. Po ashtu, sektori i OJQ punon edhe në ngritjen e vetëdijes tek prindërit dhe fëmijët për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e arsimimit. Aktivitetet e këtilla i kontribuojnë zvogëlimit të numrit të nxënësve që e braktisin shkollën, por po ashtu kanë mbijetuar dhe janë realizuar vetëm në saje të donacioneve të organizatave ndërkombëtare.<sup>270</sup>

Kur është fjala për komunitetet e boshnjakëve dhe turqve, të cilët vijojnë mësimin në gjuhën e vet, e sipas planit e programit të MASHT-it, problemin më të madh, si edhe viteve paraprake, paraqet mungesa e teksteve në gjuhët e këtyre pakicave. Komunitetet e përmendura edhe më tutje ballafaqohen me përkthimin jo adekuat të teksteve, si dhe me mungesën e një numri të teksteve për shkollat profesionale, andaj gjinden në mënyra të ndryshme që mos të pësoj mësimi dhe atë, duke u furnizuar me tekste nga Republika e Bosnjë e Hercegovinës dhe Turqisë, që kurrsesi nuk paraqet zgjidhje, por vetëm se shtyhet problemi për kohë të pacaktuar dhe injorohet ekzistimi i të njëjtit nga institucionet kompetente. Problemi i përmendur, gjithsesi mund të shkaktoj pasoja të mëdha në kuptim të arsimimit jo kualitativ dhe qasjes së njëjtë arsimimit nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë, të cilët shkollohen në gjuhën amtare.

#### **2.27.5. Kultura**

Kultura, si një nga veçoritë e të gjitha komuniteteve, individualisht paraqet një nga fushat që, si me Kushtetutë, ashtu edhe me ligje është vlerë e mbrojtur e një populli, e për të cilën ekziston nevoja e kultivimit dhe ruajtjes plotësuese. Promovimi i trashëgimisë fetare dhe kulturore i të gjitha komuniteteve edhe më tutje nuk është në nivel të lakmueshëm. Përveç problemit me realizimin dhe regjistrimin e zonave të veçanta nën mbrojtje me rëndësi kulturore dhe fetare, janë vërejtur edhe lëvizje pozitive në kuadër të kësaj fushe. Në të vërtetë, u miratua Ligji për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligji për qendrën historike të Prizrenit,<sup>271</sup> me qëllim të mbrojtjes së karakteristikave tradicionale të Hoçës së Madhe dhe qendrës historike të Prizrenit, ashtu siç është paraparë me Ligjin për zonat e veçanta nën mbrojtje.<sup>272</sup> Në këtë kontekst duhet përmendur edhe

---

<sup>269</sup> Po aty.

<sup>270</sup> Po aty.

<sup>271</sup> Të dy këto ligje i ka miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 prill 2012.

<sup>272</sup> Nenet 8 e 9 të Ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta nën Mbrojtje, 15 qershor 2008.

funksionimin e Bogoslllovisë “Shën Qirili dhe Metodije” në Prizren, ku arsimohen priftërinjtë e ardhshëm të Kishës Ortodokse Serbe (KOS).<sup>273</sup>

Në nivel lokal mjaft pak promovohet kultura e komuniteteve pakicë, në veçanti e pakicave siç janë ashkalinjtë dhe egjiptasit. Është evidente edhe ajo se, edhe nëse për këtë qëllim merret përkrahja nga organet lokale të pushtetit, kjo bëhet vetëm pas marrjes së iniciativës nga pjesëtarët e vet komuniteteve. Në këtë drejtim duhet përmendur edhe rastin pozitiv të qeverisjes lokale në tërë Kosovën, të cilat kanë ndarë mjete për shënimin e Ditës botërore të romëve, në prill të vitit 2012 dhe me atë rast janë përkrahur manifestime të shumta kulturore të komunitetit rom.

### 2.27.6. Mediet

Kur është fjala për mediet, në këtë fushë pati disa ndryshime të vogla pozitive krahasuar me periudhën paraprake raportuese të IAP. Shërbimi publik medial i Kosovës Radio Televizioni i Kosovës (RTK), në bazë të Ligjit për RTK-në<sup>274</sup> ka obligim që më së paku 15 % të programit të vet t’ia ndaj komuniteteve pakicë në gjuhët e tyre amtare. Gjatë kësaj periudhe raportuese erdhi edhe deri tek zbatimi dhe respektimi i këtij obligimi ligjor, ashtu që u rritë emetimi i programit në gjuhët jo shqiptare. Në pajtim me këtë, në shërbimin publik të Kosovës, për çdo ditë (nga e hëna në të premten) emetohen lajmet 10-minutëshe dhe emisioni njëjavor në gjuhën rome.

Mirëpo, komunitetet ashkali dhe egjiptas nuk kanë rast që në shërbimin publik të Kosovës të promovojnë komunitetet e tyre dhe përmes këtij mediumi t’i paraqesin problemet me të cilët pjesëtarët e këtyre komuniteteve ballafaqohen për çdo ditë.<sup>275</sup> Shikuar në mënyrë të përgjithësuar, komuniteti boshnjak, turk, goran, e në veçanti komunitetet ashkali dhe egjiptas, janë të pakënaqur me përfaqësimin e tyre në mjetet e informimit publik, e në veçanti në shërbimin publik të Kosovës.

Sa i përket medieve të shkruara, shumica e komuniteteve pakicë nuk kanë shtypin ditor në gjuhën e vet.<sup>276</sup> Të vetmit medime të shkruara që dalin në Kosovë, e që dalin në gjuhët e pakicave, dalin vetëm periodikisht, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Një nga shembujt e rrallë pozitiv, në nivel lokal, është komuna e Gjilanit, ku botohet mujori dygjuhësor në gjuhën shqipe dhe serbe, të cilin e financon Ambasada e SHBA, ndërsa e redakton OJQ-ja lokale.<sup>277</sup>

<sup>273</sup> Bogoslllovia në Prizren nuk ka punuar nga qershori i vitit 1999, ndërsa në trazirat e marsit të vitit 2004 ishte dëmtuar dukshëm. Punës ia filloi sërish pas restaurimit në vitin 2011.

<sup>274</sup> Neni 6 (6) i Ligjit nr. 02/L-047 për Radio Televizionin e Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, 2006/14, dt. 11 prill 2006, si dhe Ligji nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, prill 2012.

<sup>275</sup> Informatat e marra nga OJQ „Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptasve“.

<sup>276</sup> IAP i mungojnë shënimet për mediet e shkruara në gjuhën turke dhe boshnjake.

<sup>277</sup> Raporti i OEBS për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, botimi i tretë, korrik 2012.

Komuniteti serb, mediet e shkruara kryesisht i merr nga Serbia, ndërsa e vetmja gazetë që dilte që para qershorit të vitit 1999 në Kosovë “Jedinstvo”, shtypet në Serbi dhe, një herë në javë, gratis distribuohet në viset në Kosovë që janë të banuara me shumicë të pjesëtarëve të këtij komuniteti. Në Prizren del një revistë në gjuhën rome, të cilën e financon OJQ-ja lokale, ndërsa pjesëtarëve të këtij komuniteti që jetojnë në komunat tjera, kjo revistë nuk u shpërndahet.

Kur është fjala për radio stacionet dhe stacionet lokale TV, situata është e pandryshuar krahasuar me atë të vitit të kaluar.<sup>278</sup> Ekziston numër i madh i radio stacioneve që emetojnë programe në gjuhët e të gjitha komuniteteve pakicë dhe mbulojnë të gjitha aspektet e jetës së pakicave në Kosovë, por shumica e këtyre radio stacioneve janë të natyrës komerciale dhe kryesisht emetojnë program zbavitës. Ekzistojnë disa radio stacione që me politikë më serioze redaktuese merren me problemet e pakicave në Kosovë, siç është për shembull „KiM“ nga Çagllavica, „Radio Peja“ nga Peja, radio “Kontakt plus” nga Mitrovica e veriut, radio „Graçanica“ nga Graçanica. Sa i përket stacioneve lokale TV, janë këto: TV “Most” nga Mitrovica e veriut dhe TV “Herc” nga Shtërpca.

Në prill të vitit 2012, u nxor Ligji për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në të cilin është parashikuar themelimi i kanalit të dytë të RTK-së në gjuhën serbe, por deri në fund të periudhës raportuese, RTK-ja nuk ka filluar me emetimin e programit në këtë kanal televiziv.<sup>279</sup>

Në të gjitha fushat e përmendura, edhe më tutje është i nevojshëm përkushtimi më energjik i institucioneve, si në nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal, për tu plotësuar, si standardet vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare, për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në praktikë. Përkundër asaj se është përcaktuar korniza gjithëpërfshirëse juridike për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, duhet të bërë shumëçka konkretisht në praktikë, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e vërtetë e të drejtave të komuniteteve pakicë.

---

<sup>278</sup> Për më shumë informata shih raportin vjetor të IAP për vitin 2011. ([http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/4263\\_RAPORTI%202011%20serbisht.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/4263_RAPORTI%202011%20serbisht.pdf), [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/91976\\_RAPORTI%202011%20shqip.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/91976_RAPORTI%202011%20shqip.pdf))

<sup>279</sup> Ligji nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, prill 2012.





### 3. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.<sup>280</sup> Vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Por, në praktikë, ka raste kur vendimet e saj nuk zbatohen nga institucionet shtetërore.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar 8 kërkesa nga qytetarët dhe shoqata joqeveritare, për ngritjen e çështjeve për shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre nga autoritete publike, në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit, pas analizimit të kërkesave individuale, ka konstatuar se për disa kërkesa nuk është person i autorizuar për t'i ngritur në Gjykatën Kushtetuese, por janë vetë individët të autorizuar, në bazë të nenit 113, paragrafi 7, që shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, t'i ngrenë në Gjykatë. Këto kërkesa Avokati i Popullit i ka shpallur si të papranueshme, pasi që nuk janë në kompetencën e tij.<sup>281</sup>

Disa ankesa të shoqatave joqeveritare për ngritjen e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese, pas analizimit të tyre kanë rezultuar të jenë paraqitur pas afatit ligjor, prandaj janë shpallur si të papranueshme.<sup>282</sup>

Avokati i Popullit, pas pranimit dhe analizimit ligjor të rastit të organizatave joqeveritare (OJQ) të cilat kërkuan që të ngritet në Gjykatën Kushtetuese vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, bazuar në kompetencat e tija kushtetuese dhe ligjore, procedoi këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit, në procesin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga ana Gjykatës Kushtetuese, ka pranuar tri pako të amendamenteve kushtetuese për vlerësimin dhe komentimin nëse ndryshimet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Gjatë këtij viti raportues, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit ka marr pjesë në seancë shqyrtuese, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) dhe ka paraqitur opinionin e Avokatit të Popullit në lidhje me kushtëzimet për ofrime të shërbimeve komunale, që u bëhen qytetarëve të Kosovës në disa komuna të Republikës së Kosovës, me pagesën e faturave të ujit dhe mbeturinave. Rasti ishte ngritur në Gjykatë nga disa qytetarë të komunës së Gjilanit, Vitisë

---

<sup>280</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 1124 [Parimet e përgjithshme], Neni 116 [Efekti juridik i vendimeve].

<sup>281</sup> *Ligji për Avokatit e Popullit nr. 03/L-195*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë viti V/nr.80/27, gusht 2012. Neni 19. 1.3.1 “nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji” ankesa hidhet poshtë si e papranueshme.

<sup>282</sup> *Ligji Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121*. Neni 30, parasheh “Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej g jashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

dhe Mitrovicës, të cilët konsideronin se me vendimet e komunave për kushtëzime u shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë.

### **3.1. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese**

#### ***Moszbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin e Sindikatës së fabrikës së çelikut “IMK” Ferizaj***

Sindikata e fabrikës së çelikut “IMK” Ferizaj, e kishin ngritur te Avokati i Popullit çështjen e moszbatimit të Aktgjykimit Nr. KI 08/09 të Gjykatës Kushtetuese, i datës 17 dhjetor 2010.<sup>283</sup> Ky vendim ende nuk është zbatuar nga autoritetet shtetërore të obliguara sipas aktgjykimit - Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin Nr. KI 08/09, e shpall të pranueshme kërkesën e Sindikatës së fabrikës së çelikut “IMK” Ferizaj dhe konsideron që ka pasur shkelje të nenit 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 (E drejta për gjykim të drejtë) dhe 13 të KEDNJ (E drejta për mjete efektive ligjore). Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj, kishte kërkuar zbatimin e vendimit të gjykatës komunale, i cili obligon kompensimin material për 900 punëtorë, me vlerë mbi 25 milion euro.

Më 14.06.2012, Avokati i Popullit i dërgoi letër Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe AKP, me qëllim të hetimeve për rastin e ankesës së punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “IMK” Fabrika e Gypave në Ferizaj, me kërkesën e informimit se cilat veprime janë ndërmarrë apo planifikohet të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës dhe AKP, në mënyrë që ky rast të procedohet në pajtim me ligjin dhe në pajtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ.

Më 21.09.2012, Avokati i Popullit pranoi një përgjigje nga AKP, nga e cila nuk jepen shpjegime të duhura lidhur me arsyet e moszbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, por jepen shpjegime lidhur me likuidimin e ndërmarrjes, e cila që moti është privatizuar, ndërsa Qeveria e Kosovës nuk ka dhënë përgjigje në shkresën e dërguar.

Në muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2012 ish punëtorët e “IMK” Fabrika e Gypave në Ferizaj, para Gjykatës Kushtetuese dhe Qeverisë së Kosovës, kanë mbajtur protesta publike paqësore, duke kërkuar zbatimin e vendimit të gjykatës dhe kompensimin e pagave për periudhën 1990-1999, të cilët ishin larguar nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të dhunshme.

---

<sup>283</sup> IAP, *Rasti*, nr. 197/2012, Qorolli dhe të tjerët kundër AKP, ish-AKM dhe Qeverisë Republikës së Kosovës. Kërkesë për zbatimin e vendimit të gjykatës.

### 3.2. Rastet e ngritura në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit

#### *Kërkesë Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin përputhshmërisë me kushtetutën të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare Nr. 04/ L-093*

Më 11 maj 2012, organizatat joqeveritare (OJQ): Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) si bartëse të kërkesës dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse të kërkesës i janë drejtuar IAP, që në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë të cilat i janë dhënë me Kushtetutë, të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtimin e kushtetutshmërisë së nenit 90, nenit 95, pika 1.6, nenit 110, nenit 111 dhe nenit 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.<sup>284</sup>

Avokati i Popullit, sikurse edhe OJQ-të e lartpërmendura, konsideron se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare shkel rëndë tri nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: nenin 44 – Liria e Asociimit, nenin 46 – Mbrojtja e Pronës dhe nenin 10 – Ekonomia. Përveç shkeljeve kushtetuese, ky ligj shkel edhe parimet ndërkombëtare të së drejtës për jopërfitim të OJQ-ve, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë që e rregullon fushën e lirisë së asociimit në OJQ, si dhe rrezikon të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi.

Avokati i Popullit, pas pranimit të kërkesës së lartshënuar dhe analizimit të saj mbi bazën e fakteve ligjore, më 11 tetor 2012 e ngrit në Gjykatën Kushtetuese çështjen e Papajtueshmërisë së nenit 90; nenit 95, pika 1.6; nenit 110; nenit 111 dhe nenit 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të shfuqizojë si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenin 90; nenin 95, pika 1.6; nenin 110; nenin 111 dhe nenin 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese aplikimin e Masës së Përkohshme për pezullimin e zbatimit të këtij ligji, përderisa Gjykata nuk merr një vendim meritore në lidhje me këtë çështje.<sup>285</sup>

---

<sup>284</sup> IAP, rasti, nr. 232/2012,. Kërkesë për Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare Nr. 04/ L-093, publikuar më 11 maj 2012, Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës.

<sup>285</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rasti nr. K097/12. Vendim për masë të përkohshme, 24 dhjetor 2012. Në: <http://gjk-ks.org/> (26.12.2012).

## ***Qëndrimi i Avokatit të Popullit për kushtëzimet e disa komunave të Republikës së Kosovës për ofrime të shërbimeve komunale qytetarëve***

Avokati i Popullit, në cilësinë e *amicus curiae* të gjykatës, ka marr pjesë në seancë shqyrtuese në Gjykatën Kushtetuese dhe ka paraqitur opinionin e vet në lidhje me kushtëzimet për ofrime të shërbimeve komunale, që u bëhen qytetarëve të Kosovës në komunat Gjilanit, Vitisë dhe Mitrovicës.<sup>286</sup> Qytetarët pretendojnë se me kushtëzimet për shërbime komunale me kryerjen e detyrimeve financiare ndaj kompanive publike, nga komunat u shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Republika e Kosovës është e organizuar në 36 komuna, të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Disa nga këto komuna kanë nxjerrë vendime, me të cilat i kushtëzojnë qytetarët për ofrimin e shërbimeve komunale.

Ndërmarrjet publike komunale, si shoqëri aksionare, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Në këtë kuptim ato do të duhej të funksiononin mbi bazën e këtyre ligjeve dhe për shërbimet e ofruara të bëjnë edhe inkasimet (mbledhjen) e borxheve.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Neni 17, pika f) komunat janë të obliguara për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, menaxhimin e mbeturinave. Si do të realizohet ky mandat ligjor?

Për Avokatin e Popullit është shqetësues fakti se si komunat – ndërmarrjet publike - do të mund të kryejnë këtë obligim ligjor karshi qytetarit, kur ai nuk i paguan shërbimet që i ofrohen. A do ta përkeqësonte aftësinë e këtyre ndërmarrjeve për kryerjen e shërbimeve për qytetarët të cilët janë pagues të rregullt të shërbimeve? A është pesha e shkeljes së të drejtave të njeriut me rastin e kushtëzimit nga komunat për ofrimin e shërbimeve komunale, më e rëndë sesa mos përmbushja e obligimit ligjor për ofrimin e këtyre shërbimeve ndaj të gjithë qytetarëve? Pikërisht këto janë çështje që duhet shtruar dhe duhet trajtuar ligjërisht.

Avokati i Popullit konsideron se është shqetësuese gjendja në të cilën janë kompanitë publike për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe ne jemi dëshmitarë të ndërhyrjeve të herë pas hershme të Qeverisë dhe Komunës, duke ndarë fonde shtesë për të mbajtur në funksion këto kompani, të cilat ofrojnë shërbime për të mirën e përgjithshme. Dhe, mos aftësia e këtyre ndërmarrjeve për t'i ofruar këto shërbime, respektivisht furnizimin me ujë dhe heqjen e mbeturinave, pashmangshëm do të rrezikojë mirëqenien e të gjithëve.

Avokati i Popullit konsideron se kushtëzimi i gjithë qytetarëve me shlyerjen e borxheve ndaj kompanive publike për ofrimin e shërbimeve komunale, për shkak se disa qytetarë, të cilët duke u nisur nga parimi i maksimalizimit racionalist të interesit material individual, presin që të përfitojnë nga shërbimet publike të përgjithshme në kurriz të tjerëve pa i kryer ato vetë, nuk

---

<sup>286</sup> Seanca publike e mbajtur më 02.12.2012 në Gjykatën Kushtetuese.

kryejnë obligimet e tyre financiare ndaj kompanive publike, sidomos të ujësjellësit dhe për largimin e mbeturinave, megjithatë nuk mund të arsyetohet ligjërisht.

Është e ditur që kompanitë publike që ofrojnë shërbime publik kanë mundësi që ndaj individëve që nuk i kryejnë obligimet financiare ndaj kompanisë, të marrin masa adekuate individuale, duke mos ofruar shërbimet e tilla, deri në shkyçje individuale. Po ashtu, kompanitë mund të ndjekin rrugën gjyqësore dhe të kërkojnë realizimin e borxheve nga personat që nuk i kryejnë këto detyrime ndaj kompanisë.

Po ashtu, në anën tjetër, kushtëzimet selektive të qytetarëve vetëm nga disa komuna, i vë në pozitë të pabarabartë me qytetarët tjerë të Republikës së Kosovës, dhe në këtë mënyrë cenohet parimi kushtetues i barazisë para ligjit. Në Nenin 3, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton që *“Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*

Një element tjetër me rëndësi që ndikon në ashpërsimin e këtij problemi e që duhet pasur parasysh, është se politikat e këtyre ndërmarrjeve ofruese të shërbimeve publike për caktimin e tarifave janë të larta, jo transparente, arbitrare, dhe nuk përkojnë me gjendjen sociale në vend. Në një krahasim edhe me vendet më të pasura, shuma e caktuar paushalle prej 3 deri në 4,50 Euro për muaj, për heqjen e mbeturinave për familje, është jashtëzakonisht e lartë dhe e papërballueshme. Përveç kësaj, kjo mënyrë e caktimit të çmimit/pagesave në mënyrë paushalle, pa marrë parasysh asnjë kriter tjetër, sidomos kuantitativ, nuk është i pranueshëm, madje është i padrejtë dhe i paarsyetueshëm.

Avokati i Popullit konsideron se kushtëzimi që disa komuna aplikojnë për qytetarët për ofrimin shërbimeve komunale, në formën dhe mënyrën e tashme, është i papranueshëm dhe se cenon, apo në rastin më të mirë, pakëson të drejtat e njeriut. Kjo aspak nuk liron asnjë qytetar nga obligimi për shlyerjen e borxheve ndaj kompanive publike që ofrojnë këto shërbime, në rast të shfrytëzimit të shërbimeve.

### **3.3. Amendamentet mbi ndryshimet kushtetuese të dërguara nga Gjykata Kushtetuese**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në procesin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjatë këtij viti kalendarik IAP i kishte dërguar tri pako të amendamenteve kushtetuese me qëllim të dhënies së vlerësimit dhe të komenteve për ndryshimet e propozuara kushtetuese, nëse ndonjë nga këto ndryshime nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës.

Avokati i Popullit pas shqyrtimit të pakove të amendamenteve kushtetuese ka ofruar propozime konkrete dhe përmbajtësore, në afatin ligjor bazuar në kompetencat ligjore dhe kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mbështetur në përvojën dhe të gjeturat e deritanishme të Avokatit të Popullit në lidhje me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të një shteti të mirëfilltë ligjor dhe fuqizimit të rolit të gjykatës në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Avokati i Popullit:

### **Rekomandon**

- *Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit për zbatimin e menjëhershëm të Aktgjykimit Nr. KI 08/09 të Gjykatës Kushtetuese, datë 17 dhjetor 2010, në të mirë të ish - punëtorëve të Fabrikës së çelikut “IMK” Ferizaj.*
- *Gjykatën Kushtetuese për krijimin e mekanizmave ligjor dhe institucional efektivë dhe të përshtatshëm për përmbartimin dhe zbatimin e vendimeve të saj në afatin ligjor.*

#### 4. Komunikimi me mediat

Krijimin e identitetit më të fuqishëm publik IAP e sheh në kuadër të përmbushjes së misionit kushtetues e ligjor, në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2012, ka qenë i pashmangshëm dhe i domosdoshëm komunikimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit me mediat.

Duke e shfrytëzuar median si një nga mjetet e komunikimit si me qytetarin edhe me institucionet, IAP ka vënë në plan të parë: mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si bërthama e misionit të IAP-së; fuqizimin në publik të rolit dhe imazhit të IAP-së, si mbrojtës dhe avokues të të drejtave të qytetarit; ofrimin e informacionit të nevojshëm për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e IAP-së, si dhe presionin medial për të ndihmuar në zgjidhjen e rasteve.

Gjatë vitit 2012 janë realizuar 100 paraqitje publike përmes mediave elektronike dhe shtypit të shkruar (intervista, prononcime, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve debate etj.).<sup>287</sup>

Me iniciativën e IAP-së, si projekt i veçantë, i emërtuar "Roli i AP-së në mbrojtjen e të drejtave të njeriut", është realizuar cikli prej 11 emisionesh në RTK (gjatë periudhës shtator - dhjetor 2012).

Të hapura për mediat kanë qenë edhe 11 tryeza të rrumbullakëta, në të cilat janë diskutuar tema nga fusha të caktuara ku nevoja e përmirësimit dhe progresit kërkohet më me urgjencë.

PARAQITJET MEDIALE TË SHPËRNDARA SIPAS MEDIUMEVE	
<b>BIRN / Jeta në Kosovë</b>	<b>7</b>
<b>Epoka e Re</b>	<b>1</b>
<b>Express</b>	<b>1</b>
<b>Gazetarë të pavarur ( të huaj)</b>	<b>2</b>
<b>Indeksonline</b>	<b>1</b>
<b>KIM Radio</b>	<b>3</b>
<b>KLAN Kosova</b>	<b>9</b>
<b>Koha Ditore</b>	<b>3</b>
<b>Kosova Live / M- Magazine</b>	<b>2</b>
<b>Kosova Press</b>	<b>3</b>

<sup>287</sup> Shifra prej 100 paraqitjeve mediale nuk përfshin shpërndarjen apo riprodhimin e të njëjtave.

<b>Kosova Sot</b>	<b>12</b>
<b>KTV</b>	<b>10</b>
<b>Lajm</b>	<b>4</b>
<b>Politika Press</b>	<b>1</b>
<b>Radio Dukagjini</b>	<b>1</b>
<b>Radio KFOR</b>	<b>1</b>
<b>RROKUM</b>	<b>5</b>
<b>RTK</b>	<b>13</b>
<b>RTV 21</b>	<b>8</b>
<b>SETimes</b>	<b>1</b>
<b>Tribuna Shqiptare</b>	<b>3</b>
<b>TV AS</b>	<b>1</b>
<b>TV Puls</b>	<b>1</b>
<b>VoA</b>	<b>1</b>
<b>Zëri</b>	<b>6</b>

Gjatë viti 2012, në uebfaqen e IAP-së dhe për media janë plasuar 60 komunikata, njoftime, raporte etj (shih tabelën e mëposhtme). Gjithashtu gjatë këtij viti IAP ka publikuar Raportin vjetor dhe dy buletine, si përmbledhje ekzekutive të punës, statistikave dhe strukturës funksionale të institucionit.

	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor	Total
2002	1	2	2	1	2	1			3	1	2	2	17
2003	1	3	5	5	2	2		1	1				20
2004	1	1						2					4
2005									3	1			4
2006		1	2	3	1	1				1	1	1	11
2007		1			2	3	4	2	4	4	1	4	25
2008	3	6	4	4	5		1	1					24
2009									1		1	2	4
2010				1		1	2			2	1		7
2011			5		2	5	8	1	4	7	10	8	50
2012	8	5	3	6	3	6	3	1	5	2	10	8	60



## **5. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit**

### **5.1. Bashkëpunimi me institucionet vendore**

Gjatë vitit 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka pasur bashkëpunime me institucione vendore siç janë: bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës/ministritë, komunat, institucionet dhe agjencitë e pavarura si dhe gjykatat.

IAP-ja ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjatë tërë vitit janë realizuar shumë takime e gjithashtu janë dërguar raporte e rekomandime, megjithëse nuk kemi marrë përgjigje nëse ato janë marrë parasysh apo është ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me to. IAP është mirënjohëse për bashkëpunimin dhe mbështetjen e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili përveç se e vizituar IAP-në për t'u njohur më nga afër për funksionimin dhe vështirësitë në realizimin e mandatit të tij, ai gjithashtu ka pranuar edhe ftesat për pjesëmarrje lidhur me aktivitete të ndryshme të organizuara nga IAP-ja, gjë të cilën e vlerësojmë lartë. IAP ka marrë pjesë edhe në punën e Komisioneve të Kuvendit. Mund të theksohet që IAP ka një bashkëpunim shumë të mirë sidomos me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione me të cilin ka pasur aktivitete të ndryshme gjatë tërë vitit.

Edhe këtë vit IAP-ja ka paraqitur para Kuvendit raportin vjetor, i cili u konsiderua shumë përmbajtësor duke përshkruar të gjitha shkeljet dhe padrejtësitë që i bëhen qytetarëve të Republikës së Kosovës. Megjithatë, edhe këtë vit raporti i Avokatit të Popullit u votua nga deputetet, praktikë kjo e cila është e pakuptimtë dhe nuk duhet të aplikohet. Avokati i Popullit në raportin e tij vjetor paraqet gjendjen e të drejtave të njeriut dhe rekomandimet se si mund të përmirësohet ajo. Raporti i IAP-së nuk ka nevojë për votim, por në të kundërtën për diskutimin i të gjeturave dhe përpjekjen që atyre t'u ofrohet zgjidhje.

Bashkëpunimi me Qeverinë e Republikës së Kosovës, është përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar, mirëpo lë ende për të dëshiruar. Ne gjatë vitit kemi dërguar letra dhe rekomandime për hetimin e ankesave, por jo në të gjitha rastet kemi marrë përgjigje se janë zbatuar rekomandimet e IAP-së. Gjatë vitit 2012, janë rritur kontaktet dhe aktivitetet me Zyrën për Qeverisje të Mirë, ku jemi ftuar në disa aktivitete të organizuara nga kjo zyre për çështje të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut. Mirëpo, nuk mund të thuhet njëjtë edhe për Agjencinë për Barazi Gjinore, e cila nuk na ka ftuar në ngjarjet e organizuara e as ne përpilimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore, ku kanë marr pjesë rreth 30 aktorë të ndryshëm nga institucionet dhe shoqëria civile. Ne konsiderojmë që si institucion i vetëm kombëtar për të drejtat e njeriut, me mandat që të trajtoj edhe ankesat që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave në baza gjinore, është e pashmangshme ftesa dhe kontributi ynë në plane të tilla që prekin direkt të drejtat e qytetarëve të Kosovës.

IAP ka pasur bashkëpunim edhe me komunat. Zëvendësit e Avokatit të Popullit bëjnë vizita të rregullta mujore nëpër të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, më qëllim të jenë sa më afër qytetarëve për pranimin e ankesave të tyre. Në këtë rast, vlen të përmendet edhe bashkëpunimi me Njësitë për të Drejtat e Njeriut nëpër komuna, me të cilat kemi takime dhe bashkëpunim të rregullt. Ndërsa, Avokati i Popullit dy herë në muaj personalisht pret qytetarët në Zyrën Qendrore në Prishtinë.

Në anën tjetër ka vazhduar edhe bashkëpunimi më gjyqësorin, ndaj të cilit janë adresuar ankesat më të mëdha të qytetarëve, janë dërguar letra, raporte dhe ka pasur kontakte të shumta me gjykata të ndryshme. Edhe përkundër këtyre ankesave të shumta, vërehet një gatishmëri për bashkëpunim me IAP-në. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese, IAP ka bashkëpunuar në çështjet e ngritura nga IAP dhe qytetarët.

## **5.2. Bashkëpunimi me OJQ-të vendore**

Bashkëpunimi me shoqërinë civile është shumë i rëndësishëm për Institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim të sigurimit të një sistemi efektiv për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Puna e përbashkët e IAP-së me shoqërinë civile mundëson përmirësimin e sistemit të të drejtave të njeriut në Kosovë, e cila rezulton në zvogëlimin e shkeljeve që mund t'u bëhen qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Një bashkëpunim shumë i mirë ka vazhduar edhe në këtë vit në mes të IAP-së, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ-së) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT-së) më të cilët kemi Memorandum të Bashkëpunimit për monitorimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria. Një marrëveshje tjetër është edhe ajo më OJQ CLARD, e cila ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së duhur të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke e lehtësuar kontaktin me Institucionin e Avokatit të Popullit për të gjithë personat të cilët konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit me mbështetjen e Zyrës së Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) në Kosovë, po ashtu më 2 nëntor 2012 organizoi një tryezë të rumbullakët me temën "Bashkëpunimi i IAP-së me OJQ-të në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut". Tryeza ofroi mundësinë e diskutimit rreth bashkëpunimit të deritanishëm në mes të IAP-së dhe OJQ-ve në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, u diskutua për mundësitë dhe format e bashkëpunimit në të ardhmen, me ç'rast u theksua se niveli i bashkëpunimit duhet të forcohet dhe zgjerohet edhe me tutje, duke konkretizuar dhe bashkërenduar aktivitetet. Nga kjo tryezë dolën disa rekomandime, ndër të tjera: Të rritet dhe forcohet niveli i bashkëpunimit të IAP-së me OJQ-të, të nënshkruhen memorandume bashkëpunimi me qëllim të konkretizimit aktivitetëve të përbashkëta, zgjerimin e kontakteve dhe

bashkëpunimit të IAP-së me OJQ-të, Raporti vjetor i IAP-së të paraqitet dhe të diskutohet edhe në hapësirat universitare, si dhe me OJQ-të dhe shoqërinë civile.

### 5.3. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare

Bashkëpunimi proaktiv në nivel ndërkombëtar është një nga prioritetet e IAP-së. Me këtë qëllim, IAP i ka kushtuar rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në takime e konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përmes pjesëmarrjes aktive dhe shkëmbimit të përvojave, IAP në mënyrë të drejtpërdrejt kontribuon në zhvillimet më të fundit në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare jashtë vendit është shumë i mirë. Ne ftohemi të marrim pjesë në mënyrë aktive në të gjitha takimet e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, e sidomos me Komitetin Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (KNN- eng. International Coordinating Committee for NHRIs), që është organizatë ndërkombëtare e institucioneve që merren më të drejtat e njeriut. Ajo promovon dhe fuqizon këto institucione, në mënyrë që të jenë në pajtueshmëri me Parimet e Parisit<sup>288</sup> dhe vepron si lider i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në kuadër të punës së saj, kjo organizatë këtë vit pati takimin e 25-të të saj, në të cilin IAP-ja u përfaqësua me dy bashkëpunëtor dhe zhvilloi disa takime me përfaqësues të vendeve të ndryshme. Gjithashtu u mbajt edhe konferenca ndërkombëtare “*Të drejtat e grave dhe vajzave; Barazia Gjinore; Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*” mbajtur në Aman të Jordanisë, ku mori pjesë Avokati i Popullit dhe dy bashkëpunëtor të tij. Kjo konferencë ofroi një platformë e mundësisë për diskutim të situatës aktuale, sfidave dhe avancimeve lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave në dritën e standardeve relevante për të drejtat e njeriut. Si rezultat i punimeve të kësaj konference doli edhe *Deklarata e Amanit dhe plani i veprimit të saj*, e cila u përpilua nga grupet e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe organizatave ndërkombëtare/joqeveritare, duke përfshirë edhe Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.

IAP gjithashtu raportoi për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në këtë kontekst përmendim pyetësorin e dërguar për Reporterin Special për situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut<sup>289</sup>, i cili do të raportoi para Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë.

IAP-ja gjatë vitit 2012, u anëtarësua në Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, i cili është themeluar në vitin 1978 dhe është e vetmja organizatë për bashkëpunim të mbi 150 institucioneve të ombudsmanëve në mbarë botën. Përmes konferencave të ndryshme periodike ai realizon shkëmbimin e informatave dhe përvojave si dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve

---

<sup>288</sup>Për informata më të detajuara për Parimet e Parisit, ju lutem vizitoni këtë uebfaqe: <http://www2.ohchr.org/english/law/parisprinciples.htm>

<sup>289</sup> Pyetësori i Reporterit Special për situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, i dërguar më 22 tetor 2012.

që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.<sup>290</sup> Përveç kësaj IAP, është i anëtarësuar edhe në Institutin Evropian të Ombudsmanëve që ka nën ombrellë institucione të ombudsmanëve të regjionit të Evropës.<sup>291</sup>

IAP vazhdon të ketë bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Edhe këtë vit, Misioni i OSBE-së ka mbështetur IAP-në si institucion të vetëm kombëtar për të drejtat të njeriut në Republikën e Kosovës, përmes këshilltares së misionit të OSBE, e cila ndihmon punën e përditshme të IAP.

Përveç kësaj OSBE-ja ka mbështetur financiarisht realizimin e disa aktiviteteve të IAP-së në kuadër të përmirësimit të marrëdhënieve me publikun duke përfshirë: mbajtjen e nëntë tryezave të rrumbullakëta me tematika specifike të fushës së të drejtave të njeriut, pastaj katër punëtori, dy trajnime, një konferencë, si dhe ka financuar pjesëmarrjen e 6 punonjësve të IAP-së në dy takime jashtë vendit. Gjithashtu, ka dhënë donacion për blerjen e disa pajisjeve të teknologjisë informative të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së IAP-së.

IAP ka bashkëpunim të mirë edhe me Këshillin e Evropës (KE). Përveç aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta, IAP-ja është përfituesi kryesor i projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës” *Avancimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë*”. Ky projekt ka filluar së implementuari në qershor të vitit 2012 dhe do të zgjasë 18 muaj. Qëllimi kryesor i tij është përmirësimi i implementimit të standardeve në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet dhe të gjeturat e Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimit Çnjerëzor apo Degradues dhe Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve.

Me 14 nëntor, Avokati i Popullit u ftua nga Komisioni për Çështje Politike dhe Demokraci i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës me qëllim të raportimit për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë në kuadër të përgatitjes së raportit nga Z. Bjorn von Sydow, i cili është raportues i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Nga ky takim doli edhe rezoluta me rekomandime, ku ndër të tjera shprehimisht kërkohet që: 1) Të zbatohen rekomandimet e IAP-së dhe t’i sigurohen burime të mjaftueshme për funksionim; 2) Inkurajon Kuvendin e Kosovës që të përmirësojë komunikimin me institucione të pavarura, siç është IAP, dhe të sigurojë që ato kanë të alokuara mjetet e nevojshme për zbatimin e mandatit.<sup>292</sup>

Vlen të përmendet edhe projekti” *Avancimi i drejtësisë gjinore*”, me fokus në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, i cili financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës, ndërsa implementohet nga UNDP-ja në Kosovë. Ai pritet të zgjasë dy vite dhe ndër përfituesit e tij kryesor janë: institucionet e drejtësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe shoqëria civile.

---

<sup>290</sup> Për më shumë informata rreth Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe: [www.theioi.org](http://www.theioi.org).

<sup>291</sup> Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe: [www.eoi.at](http://www.eoi.at).

<sup>292</sup> Komiteti propozon intensifikimin dhe zgjerimin e dialogut me Kuvendin e Kosovës, 14/12/2012, Këshilli i Evropës, Çështjet politike dhe demokracia., Për të parë rezolutën dhe rekomandimet në tërësi, ju lutem vizitoni këtë link: [http://assembly.coe.int/ASP/NewsManager/EMB\\_NewsManagerView.asp?ID=8267&L=2](http://assembly.coe.int/ASP/NewsManager/EMB_NewsManagerView.asp?ID=8267&L=2)

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do të bashkëpunojë me institucione vendore, shoqëri civile dhe organizata ndërkombëtare me shpresën që do të vazhdojë mbështetja edhe më e madhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të ketë zbatim më të madh të rekomandimeve të IAP-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe bashkëpunim më të madh nga shoqëria civile edhe në të ardhmen, me qëllim që së bashku të punohet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

#### **5.4. Ngritja e kapaciteteve të IAP-së**

Sikurse edhe në vitet paraprake, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) i ka kushtuar rëndësi ngritjes së kapaciteteve të stafit.

Punonjësit e IAP-së kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), përkatësisht, trajnime në fushën lidhur më zhvillimin e politikave publike, procesi i negociatave për anëtarësim në BE, komunikimi dhe hartimi i shkresave, barazia gjinore, ligji për qasje në dokumente publike etj.

Edhe për vitin për të cilin raportohet, vlen të përmendet mbështetja e vazhdueshme e OSBE-së në ngritjen e kapaciteteve. Ajo ka organizuar disa trajnime në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut, siç janë: “Lobimi dhe Avokimi”, “Teknikat hetimore – ndërveprimi me mekanizma të traktateve dhe procedurat e raporteve speciale” dhe “Aftësitë organizative dhe komunikimi”.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve IAP, ka pasur mbështetje edhe nga Këshilli i Evropës në organizimin e trajnimit: “Trajnim për trajner në fushën e të drejtave të njeriut”. Po ashtu IAP ka pasur mbështetje edhe nga Kombet e Bashkuara për Zhvillim të Programeve (UNDP), ku janë organizuar trajnimet “Referimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese”, si dhe trajnimin për ndërmjetësim.

UNICEF në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit ka organizuar trajnim lidhur me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin, për Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijët.

Me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve, IAP edhe në të ardhmen do t’i kushtojë rëndësi të veçantë ngritjes së kapaciteteve varësisht prej nevojave të punonjësve.



## 6. Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit

### 6.1. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) është themeluar me qëllim që me kujdes të veçantë t'i mbikëqyrë, t'i mbrojë dhe t'i hetojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF gjatë vitit 2012 përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, në drejtim të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

“Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual” ishte temë diskutimi në takimin tematik të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore (CRONSEE)<sup>293</sup> anëtar i të cilit është edhe IAP, i cili u mbajt në Podgoricë, më 16-18 mars 2012.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve, lidhur me temën, pjesëmarrësit në takim u pajtuan se për mbrojtje adekuate të fëmijëve përveç tjerash është e nevojshme që organet kompetente të shteteve pjesëmarrëse të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e regjistrave për evidentimin e kryesve të veprave penale kundër integritetit seksual, me qëllim të eliminimit të mundësive që ata pas vuajtjes së dënimit të angazhohen në punë me fëmijë. Duke u nisur nga nevojat dhe interesat e fëmijëve, pjesëmarrësit gjithashtu u pajtuan se organet kompetente duhet të ndërmarrin edhe masa të tjera përkatëse për zbutjen e pasojave, gjegjësisht përmirësimin e gjendjes dhe ri-integrimit të fëmijëve viktime, për informimin dhe edukimin e tyre dhe të personave profesionalë për rreziqet nga shfrytëzimi seksual dhe për mënyrën e njohjes së tyre, si dhe për të drejtat e fëmijëve për ndihmë dhe mbështetje.

“Mbrojtja e fëmijëve nga keqpërdorimi përmes internetit” ishte temë tjetër diskutimi e CRONSEE në konferencën e shtatë vjetore, e cila u mbajt më 12-14 shtator 2012 në Budvë (Mali i Zi). Konkluzion i konferencës ishte se fuqizimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave dhe interesave të tyre veçanërisht për mbrojtjen nga të gjitha format e shfrytëzimit, përfshirë edhe keqpërdorimin përmes internetit, kërkon intervenime të vazhdueshme dhe angazhim të përbashkët të të gjitha autoriteteve dhe subjekteve të ndryshme të shoqërisë. Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga keqpërdorimi përmes internetit u konkludua se shtetet pjesëmarrëse, përveç tjerash do të duhej:

- *Të ndërmarrin veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim të sigurimit të arsimimit të vazhdueshëm të fëmijëve (që nga mosha e hershme), si dhe të personave që punojnë drejtpërdrejt me fëmijë, për efektet e dëmshme të internetit dhe rreziqet që teknologjitë e përparuara telekomunikuese sjellin me vete.*

---

<sup>293</sup> Shih në: [www.cronsee.org/](http://www.cronsee.org/) (25.03.2012).

- *Të ndërmarrin veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim të përfshirjes së programit për përdorim të sigurt të internetit në kuadër të lëndëve të rregullta shkollore që mbulojnë mësimet e informatikës dhe teknologjisë kompjuterike.*

GDF mori pjesë në konferencën për publikimin e raportit të Hartëzimit dhe Vlerësimit të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Republikën e Kosovës, e cila u mbajt në Prishtinë më 2 tetor 2012. Publikimi i këtij raporti ishte pjesë e promovimit dhe e dokumentimit të Reformave të Drejtësisë për Fëmijë i udhëhequr nga Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë (KMDF), i organizuar nga Zyra e Kryeministrit me përkrahjen e Bashkimit Evropian dhe UNICEF.<sup>294</sup>

Më 23-24 tetor 2012, në Tiranë, u mbajt konferenca me titull “Forcimi i kompetencave të ndërmjetësuesve dhe ombudsmanëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” e organizuar nga Asociacioni i Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësuesve Frankofonë, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të IAP. Në këtë konferencë përveç tjerash u diskutua për Konventën për të drejtat e fëmijës, rolin dhe fuqizimin e ombudsmanëve në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe për nevojën e vetëdijesimit të fëmijëve dhe të rinjve për të drejtat e tyre.

Po në muajin tetor, përkatësisht më 22-24 tetor 2012, IAP në kuadër të KMDF mori pjesë edhe në punëtorinë e organizuar nga Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me UNICEF dhe Qendrën për Arsim të Kosovës, me qëllim të rishikimit të dokumentit “Protokollin për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar”. Me këtë protokoll synohet që të përcaktohen detyrimet e institucioneve qeveritare dhe organizatave joqeveritare në parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në shndërrimin e shkollave në mjedise të sigurta dhe miqësore për fëmijë.

Rishikimi vjetor i planit të punës 2012-2013 dhe planifikimi i planit dy vjeçar të punës për vitin 2013-2014, të UNICEF-it u bë në punëtorinë e 3 dhjetorit 2012, në të cilën mori pjesë edhe GDF. Në këtë punëtori u diskutua për aktivitetet e ndërmarra, të parapara me planin e veprimit për vitin 2012-2013 si dhe për sfidat e hasura gjatë ndërmarrjes së tyre. Po ashtu, në këtë punëtori u diskutuan edhe aktivitetet që do të ndërmerren nga ana e KMDF për vitin 2013, të cilat do të mbështeten nga ana e UNICEF-it.

Gjatë këtij viti, IAP në bashkëpunim me Save the Children International në kuadër të projektit rajonal “Avancimi i Pozitës së fëmijës me qëllim të mbrojtjes nga të gjitha format e shfrytëzimit”, ka zhvilluar hulumtimin me temë “Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në Kosovë”. Qëllimet e përgjithshme të hulumtimit të çështjes së shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Kosovë kishin të bënin me përcaktimin e nivelit të të kuptuarit e nocionit të shfrytëzimit seksual të fëmijëve viktimë, përcaktimin e gjendjes në fushën e parandalimit si dhe në fushën e mbrojtjes së viktimave fëmijë.

<sup>294</sup> Këshilli është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 gusht 2011. Mandati i Këshillit ka të bëjë përveç tjerash edhe me definimin e prioriteteve dhe përcaktimin e masave të nevojshme që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të situatës në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. Ai përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e Këshillit në cilësinë e anëtarit vëzhgues.



Qëllimi kryesor i hulumtimit kishte të bënte me përparime për luftimin adekuat të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Kosovë dhe në fushën e mbrojtjes së fëmijëve viktime. Pas kryerjes së këtij hulumtimi, IAP me qëllim të përmirësimit të punës në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e paraqitjes dhe fuqizimin e luftës kundër shfrytëzimit seksual, e në veçanti për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve viktime të keqpërdorimit seksual dhe shfrytëzimit, ka nxjerrë rekomandime të cilat ua ka drejtuar organeve përgjegjëse dhe të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij problemi (shih ueb faqen e IAP).<sup>295</sup>

Edhe këtë vit, me qëllim të shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, GDF ka realizuar shumë takime me nxënës të shkollave fillore, në disa nga fshatrat e komunave të regjionit të Mitrovicës, Prizrenit, Pejës dhe Gjilanit. Në këto takime ata kanë informuar nxënësit e këtyre shkollave lidhur me misionin e IAP përkatësisht të GDF në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Në këto takime është diskutuar edhe për situatën e të drejtave të fëmijëve në shkollat përkatëse dhe mënyrën e adresimit të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve në shkolla.

Nga diskutimet e bëra rezultoi se në disa nga shkollat e vizituara nxënësit janë pak të informuar për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, disa shkolla nuk kanë kushte adekuate për mësim, përkatësisht se kanë nevojë për më shumë mbështetje në realizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Ndërsa, në Prishtinë, po me rastin e shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, fëmijë të shkollave fillore të komunës së Prishtinës kanë vizituar Zyrën Qendrore të IAP, janë takuar me Avokatin e Popullit dhe janë njohur për së afërmi me punën që bëhet në këtë institucion, me misionin dhe angazhimin e IAP në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

## **6.2. Aktivitetet e Grupit për Mosdiskriminim**

Ankesat e paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të trajtuara nga Grupi për mosdiskriminim (GMD) edhe gjatë këtij viti raportues kanë të bëjnë me diskriminim në sferën sociale, shëndetësore, pronësore, marrëdhënie pune, ankesa nga persona me aftësi të kufizuara.

GMD gjatë periudhës raportuese ka realizuar vizita nëpër spitale, shkolla, organizata dhe përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara dhe vendbanime të banuara kryesisht me komunitetet joshumicë dhe ka marrë pjesë në disa debate me qytetarët në komuna të ndryshme, ku për së afërmi është njoftuar me problemet e qytetarëve në terren.

Gjatë kësaj periudhe GMD ka zhvilluar takime edhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë, koordinatore për të drejta të njeriut në nivel lokal dhe qendror.

---

<sup>295</sup> Shih në: <http://www.ombudspersonkosovo.org>.

Gjatë vizitave nëpër shkolla fillore në komunën e Prishtinës, e cila konsiderohet si pjesa e parë e hetimit, përfaqësuesit e IAP i kanë njoftuar nxënësi/et me Ligjin kundër diskriminimit, si dhe misionin kushtetues dhe ligjor të IAP. Gjatë kësaj fushate, në mënyrë anonime janë pranuar ankesat e nxënësve të cilat kishin të bënin me situatën ku ata diskriminohen në baza të ndryshme.

Gjatë fushatës, nëpër shkolla, gjithashtu është hetuar edhe dhuna fizike dhe psikike, gjithpërfshirja në procesin mësimor, çështja e sigurisë brenda dhe jashtë shkollës, si dhe mbrojtja shëndetësore. Pas përfundimit të fazës së parë të këtij hetimi, që është duke vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe, më 1 qershor 2012, Avokati i Popullit ka organizuar një tryezë me temën “Stop diskriminimi i fëmijëve” dhe ka publikuar të gjeturat për 6 shkolla fillore të Prishtinës.

Nga GMD janë publikuar 2 raporte. Raporti *ex officio* me numër 275/2012, i cili ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve zyrtare, ndërsa Raporti me rekomandim lidhur me rastin A. 395/2009 kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, ka të bëjë me zvarritje të procedurës. Në këtë rast parashtruesi i ankesës ankohet në diskriminim ekonomik-social.

Përveç këtyre aktiviteteve, GMD gjatë vitit 2012, ka marrë pjesë në shumë aktivitete të tjera të nduarnduarshme, në takime e tryeza të rumbullakëta:

- 14 maj 2012, në Prishtinë, u mbajt debat publik i organizuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me Ligjin kundër diskriminimit, në të cilin përfaqësuesi i IAP, prezantoi propozimin për ndryshim apo amendamentimin e ligjit në fjalë, ashtu siç Avokati i Popullit e ka cekur edhe në raportin vjetor paraprak.
- Më 7 mars 2012, u mbajt debat publik i organizuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i njoftoi të pranishmit me formimin e departamentit kundër diskriminimit në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe grupet e ndara brenda këtij departamenti. Gjithashtu u prezantua puna e deritashme e IAP si dhe raportet e publikuara me gjetjet diskriminuese. Gjithashtu nga përfaqësuesi i IAP u ngrit si shqetësim mos bashkëpunimi i Qeverisë së Kosovës si dhe Kuvendit të Kosovës me IAP, e me theks të veçantë në mospërgjigjet e tyre në rekomandimet e Avokatit të Popullit.
- Më 19 shtator 2012, përfaqësues të GMD kanë marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Rrjeti strategjik i Kosovës, në Prishtinë me temë “Sfidat dhe problemet me zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare”.
- Më 12 dhe 13 dhjetor 2012, përfaqësues të GMD për herë të parë kanë marrë pjesë në një seminar të organizuar nga Këshilli i Evropës në Beograd, lidhur me rolin e ombudsmanëve për monitorimin e situatës e personave të zhvendosur dhe shtytjes për përmirësim të kësaj situatë.

- Më 12 dhe 13 shtator 2012, në Prishtinë, GMD ka qenë pjesë në panel, në tryezën e organizuar nga OSBE me temë “Së bashku kundër diskriminimit”.
- Më 2 tetor 2012, në Prishtinë GMD ka qenë pjesë e panelit në tryezën me temën “Rishikimi i mirëfilltë i ligjit kundër diskriminimit“, të organizuar nga OHCHR në bashkëpunim me organizatën Youth Initiative for Human Rights (YIHR)
- Më 7 nëntor 2012, në Prishtinë, GMD ka marrë pjesë në takim me OJQ Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim (IRD), lidhur me problemet dhe mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT.
- Më 23 nëntor 2012, në Prishtinë, në konferencën e organizuar nga IAP, GMD ka qenë pjesëmarrëse në konferencën me temën: Eliminimi i dhunës ndaj gruas.
- Më 11 dhjetor 2012, në Prishtinë organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, GMD ka qenë pjesëmarrëse në tryezën me temën “Sistemi Pensional në Kosovë”.

Gjatë vitit raportues, përfaqësues të GMD kanë qenë pjesëmarrës në gjashtë emisione televizive me tema të ndryshme si: personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e pensionistëve në Kosovë, të drejtat pronësore, zbatimin e ligjit kundër diskriminimit, të drejtat ekonomiko-sociale, si dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare në Kosovë.



## 7. Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) është institucion i pavarur publik, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.<sup>296</sup> Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-it i sigurohet buxhet i nevojshëm “Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera”.<sup>297</sup>

### 7.1. Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës

Mbështetur në legjislacionin për pavarësinë buxhetore dhe financiare të IAP-së dhe duke u bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit i ka parashtruar kërkesën e vetë buxhetore për vitin 2012, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2012, është bazuar në planin e punës dhe të aktiviteteve të planifikuara të IAP-së. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës Buxhetore për vitin 2012, nga organet vendimmarrëse, nuk është aprovuar Buxheti i IAP-së sipas Kërkesës Buxhetore të parashtruar nga IAP. Kërkesa Buxhetore e IAP-së është paraqitur në tabelën në vijim:

Nr.	Kategoritë ekonomike	Kërkesa buxhetore për vitin 2012	Buxheti i aprovuar për vitin 2012	Buxheti për vitin 2011
1.	Paga dhe mëditje	639,073.00 €	361.080.00 €	361.080.00 €
2.	Mallra dhe shërbime	334,000.00 €	238.239.00 €	224.239.00 €
3.	Shpenzime komunale	30,000.00 €	30.000.00 €	44.000.00 €
4.	Shpenzime kapitale	95,000.00 €	7.000.00 €	0.00 €
Gjithsej		1,098,073.00 €	636.319.00 €	629.319.00 €

*Tabela 1. Kërkesa Buxhetore e IAP-së dhe buxheti i miratuar për vitin 2012*

<sup>296</sup> Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 34, par. 2.

<sup>297</sup> Po aty.

Për shkak të kufizimeve buxhetore nga organet vendimmarrëse me rastin e ndarjes së buxhetit për vitin 2012, me gjithë pavarësinë e garantuar normative me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, IAP-së i është kufizuar dhe vështirësuar përmbushja e obligimeve dhe realizimi i mandatit dhe misionit të vetë kushtetues dhe ligjor.

#### **7.1.1. Rishikimi gjashtëmujor i buxhetit dhe implikimet në funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit**

Gjatë rishikimit gjashtëmujor të Buxhetit, IAP ka parashtruar kërkesë për rishikimin buxhetor organeve vendimmarrëse të Republikës së Kosovës, me datën 28.5.2012.

Duke u bazuar në vlerësimin e mungesës buxhetore, në mënyrë të përgjithshme dhe sipas kategorive ekonomike, IAP në kërkesën për rishikimin buxhetor 2012, ka kërkuar ndarje/ mjete shtesë buxhetore në shumën prej gjithsej 44,991.47 €, dhe atë:

- Për kategorinë buxhetore *paga dhe mëditje*, shumën prej 22,698.47 €,
- Për kategorinë buxhetore *mallra dhe shërbime*, shumën prej 22,293.00 €.

#### **7.1.2. Buxheti i domosdoshëm për kategorinë mallra dhe shërbime - qira**

Buxheti i aprovuar nën kodin ekonomik (*14110 Qiraja për ndërtesa*) për vitin 2012, ka qenë në shumë prej 45,000.00 €, shumë kjo e pamjaftueshme për pagesën e qirasë.

Në bazë të llogaritjes së obligimeve të kontraktuara për qira për zyret e punës të selisë së IAP-së në Prishtinë, Graçanicë dhe në Mitrovicë, deri në fund të vitit 2012, detyrimet e IAP-it për qira për zyre, në bazë vjetore, kapin shumën prej 67,293.30€, kurse buxheti i ndarë prej 45,000.00 € ka qenë i pamjaftueshëm për shlyerjen e këtyre detyrimeve kontraktuale për qira.

#### **7.1.3. Buxheti i domosdoshëm për paga dhe mëditje**

Buxheti i miratuar për kategorinë buxhetore *paga dhe mëditje*, për vitin 2012, ka shumën prej 361.080,00€, për 48 pozita/vende të lejuara në IAP. Në gjashtëmujorin e parë në IAP kanë qenë të punësuar 44 punëtorë dhe, për mungesë të theksuar të buxhetit, IAP ka qenë i kufizuar për plotësimin e 4 vendeve të punës, përkatësisht punësimin e 4 nëpunësve civilë. Mungesa e buxhetit për *paga dhe mëditje* drejtpërdrejt ka ndikuar në mosplotësimin e 4 pozitave të punës dhe atë, tri pozita për këshilltarë ligjorë (prej tyre 2 në Prishtinë dhe 1 në zyrën në Pejë) dhe një pozite të zyrtarit për shpenzime dhe pasuri.

NR	Kategoria Ekonomike	Buxheti fillestar 2012	Rishikimi gjashtëmuor	Buxheti Final 2012
1.	Paga dhe mëditje	361.080.00 €	22,698.00 €	383.778.00 €
2.	Mallra dhe shërbime	238.239.00 €	22,293.00 €	260.532.00 €
3.	Shpenzime komunale	30.000.00 €		30.000.00 €
4.	Shpenzime kapitale	7.000.00 €		7.000.00 €
Gjithsej		636.319.00 €	44.991.47 €	681.310.00 €


*Tabela 2. Gjendja në Buxhet dhe Rishikimi gjashtëmuor i Buxhetit 2012*

Siç mund të vërehet nga tabela 2, gjatë rishikimit gjashtëmuor të buxhetit, IAP-së i është rritur buxheti në shumën 44.991.47 €, që ka ndikuar në plotësimin e nevojave minimale dhe plotësimin e numrit të personelit të aprovuar për vitin 2012.

#### **7.1.4. Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2012**

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti	Alokimet	Të shpenzuara	Të pashlyera	Mjete të lira
1.	Paga dhe mëditje	383.778.00 €	383.778.00 €	369.771.61 €	0.00 €	14.006.39 €
2.	Mallra dhe shërbime	260.532.00 €	260.532.00 €	236.904.67 €	22.713.93 €	913.40 €
3.	Shpenzime komunale	30.000.00 €	30.000.00 €	18.713.69 €	5.132.70 €	6.153.61 €
4.	Shpenzime kapitale	7.000.00 €	7.000.00 €	0.00 €	7.000.00 €	0.00 €
Gjithsej		681.310.00 €	681.310.00 €	625.389.97 €	34.846.63 €	21.073.40 €

*Tabela 3. Shpenzimi i buxhetit në vitin 2012*



*Buxheti i shpenzuar i IAP-së është gjithsej 625.389.97 €, ose 91.79 %*

## 7.2. Financimi nga donatorët

Gjatë vitit 2012, IAP është përkrahur financiarisht nga donatorët si: Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Turqisë, OSBE, UNDP dhe OJQ Save the Children. Rëndësia e donacioneve për IAP-në, për këtë periudhë raportuese, ka qenë shumë domethënëse dhe ka mundësuar arritjen e objektivave të paraparë nga aspekti i ngritjes profesionale të personelit, në njërin anë, si dhe në aspektin e krijimit të mundësive të nevojshme për realizimin e shumë aktiviteteve të IAP-it. Këto objektiva vështirë se do të ishin arritur pa përkrahjen financiare edhe të donatorëve, duke pasur parasysh kufizimet nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës.

NR	Donatori	Kategoria ekonomike	Buxheti	Mjete të shpenzuara	Mjete të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi
1.	Mbretëria e Norvegjisë	Mallra dhe shërbime	7.204.83€	6.176.16€	441.00€	587.67€	85.72 %
2.	Republika e Turqisë	Mallra dhe shërbime	2.374.08€	0.00€	0.00€	2.374.08€	0.00 %
3.	Save the Children	Paga dhe meditje	3.340.00€	3.168.75€	0.00€	171.25€	94.87 %
4.	Save the Children	Mallra dhe shërbime	10.420.00€	3.535.08€	4.757.00€	2.127.92€	33.92 %
Gjithsej			23.338.91€	12.879.99€	5.198.00€	5.260.92€	55.18 %

**Tabela 4. Financimi i IAP-së nga donatorët, në vitin 2012**



## 8. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2012

Nga 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2012, në IAP janë paraqitur 1670 raste, në selinë e tij në Prishtinë dhe në zyrat rajonale, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. Prej tyre në 377 raste këta persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit, gjatë “Ditëve të hapura” të mbajtura në periudhën raportuese.

Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht lidhur me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, barazinë para ligjit, etj.

Në tabelat e mëposhtme paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2012, numri i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2012 (ku përfshihet edhe numri i rasteve të regjistruara para vitit 2012 e të mbyllura gjatë këtij viti), numri i raporteve dhe rekomandimeve të publikuara nga IAP, dështimet dhe vonesat e autoriteteve përgjegjëse për t’u përgjigjur në letrat e IAP-së, autoritetet që nuk kanë zbatuar rekomandimet e IAP-së, etj.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP (1 janar 2012 – 31 dhjetor 2012)

	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP</b> (një ankesë mund të përfshijë më shumë se një ankues dhe mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	1670
<b><i>Përkatësia etnike e ankuesve</i></b>		
	Shqiptarë	1464
	Serb	125
	Boshnjak	26
	Rom	24
	Turq	18
	Të tjerë	13
<b><i>Gjinia e ankuesve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP</i></b>		
	Meshkuj	1328
	Femra	342

<b>Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP</b> (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Gjykatat	521
	Ministritë	368
	Komunat	298
	Të tjera	220
	Policia	103
	Ndërmarrjet publike	98
	AKM	53
	Kompanitë private	37
	AKP	24
	Prokuroritë Publike	22

Tabela 2: Ankesat e shpallura të papranueshme, nga ankesat e paraqitura gjatë vitit 2012

	<b>Numri i ankesave të shpallura të papranueshme</b>	1113
<b>Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin e Avokatit të Popullit</b>		
	Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 20, pika 1.4	619
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 20, pika 1.3	187
	S'ka shkelje, keqadministrim - neni 20, pika 1.1	121
	Jashtë juridiksionit - neni 19, pika 1.3.1	115
	Mosinteresim, dështim i palës - neni 20, pika 1.2	56
	Të tjera	15

Tabela 3: Rastet e hapura për hetim IAP (1 janar 2012 – 31 dhjetor 2012)

	<b>Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (ex officio)</b>	33
<b>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</b>		
	Shqiptarë	446
	Serbë	78

	Boshnjakë	12
	Romë	10
	Turq	7
	Të tjerë	4
<b><i>Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga IAP</i></b>		
	Meshkuj	425
	Femra	132
<b><i>Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP</i></b> (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Gjykatat	215
	Komunat	137
	Ministritë	105
	Të tjera	40
	Ndërmarrjet publike	36
	Policia	34
	Agjencia Kosovare për Privatizim	17
	Agjencia Kosovare e Pronës	12
	Prokuroritë publike	10
	Kompanitë private	4

Tabela 4. *Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë*  
(një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	163
	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	89
	E drejta për mjete juridike	77
	Mbrojtja e pronës	74
	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	63
	Barazia para ligjit	44
	Liria e shprehjes	25

	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	21
	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	16
	E drejta për arsimin	15
	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	13
	Të drejtat e fëmijës	12
	Liria e lëvizjes	12
	E drejta e martesës dhe familjes	11
	Raste për ndërmjetësim	9
	Dinjiteti i njeriut	8
	E drejta e qasjes në dokumente publike	8
	E drejta e lirisë dhe sigurisë	5
	Të drejtat e të akuzuarit	4
	E drejta e privatësisë	4
	E drejta për jetën	3
	Liria e mediave	3
	Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	3
	E drejta e integritetit personal	1
	Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	1
	Liria e tubimit	1
	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	1
	Liria e artit dhe e shkencës	1

Tabela 5: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2012

(jo vetëm rastet e vitit 2012, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

	<b>Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura</b>	538
<b>Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin e Avokatit të Popullit</b>		
	I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 19, pika 1.5.	276
	I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 20, pika	89

1.2		
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - neni 20, pika 1.1		82
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 20, pika 1.3		51
I papranueshëm, mos shfrytëzim i mjeteve juridike - neni 20, pika 1.4		25
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - neni 19, pika 1.3.1		4
I papranueshëm, keqpërdorim i të drejtës së ankesës – neni 19, pika 1.3.4.		4
I mbyllur me raport		7

Tabela 6: Autoritetet përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara nga IAP

<b>SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL</b>		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	28
	Gjykata Komunale në Prizren	25
	Gjykata Supreme e Kosovës	22
	Gjykata e Qarkut në Prishtinë	18
	Gjykata Komunale në Gjilan	14
	Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme	13
	Gjykata e Qarkut në Prizren	12
	Gjykata Komunale në Pejë	10
	Gjykata Komunale në Vushtrri	8
	Gjykata Komunale në Ferizaj	5
	Gjykata Komunale në Mitrovicë	5
	Gjykata e Qarkut në Mitrovicë	5
	Gjykata Komunale në Istog	5
	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	4
	Gjykata Komunale në Kamenicë	4
	Gjykata e Qarkut në Gjilan	4
	Gjykata Komunale në Suharekë	4
	Gjykata Komunale në Viti	4

	Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë	3
	Gjykata Komunale në Gjakovë	3
	Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë	2
	Prokuroria Publike Komunale në Prizren	2
	Gjykata Komunale në Dragash	2
	Gjykata e Qarkut në Pejë	2
	Gjykata Komunale në Rahovec	2
	Gjykata Komunale në Klinë	2
	Gjykata Komunale në Lipjan	2
	Gjykata Komunale në Skenderaj	2
	Gjykata Komunale në Drenas	2
	Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë	2
	Gjykata Komunale në Podujevë	2
	Të tjera	7
<b>AUTORITETET QEVERTARE</b>		
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	17
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	14
	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës	13
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	13
	Ministria e Punëve të Brendshme	9
	Ministria e Shëndetësisë	8
	Zyra e Kryeministrit	4
	Ministria e Infrastrukturës	4
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	4
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3
	Administrata Tatimore e Kosovës	3
	Ministria e Administratës Publike	2
	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport	2

	Të tjera	9
<b>PUSHTETI LOKAL</b>		
	Komuna e Prishtinës	25
	Komuna e Gjilanit	14
	Komuna e Prizrenit	11
	Komuna Mitrovicës	11
	Komuna e Gjakovës	9
	Komuna e Pejës	6
	Komuna e Graçanicës	6
	Komuna e Lipjanit	5
	Komuna e Vitisë	5
	Komuna e Ferizajt	4
	Komuna e Vushtrrisë	4
	Komuna e Skenderajt	4
	Komuna e Klinës	3
	Komuna e Rahovecit	3
	Komuna e Obiliqit	3
	Komuna e Shtërpcës	2
	Komuna e Ranillugut	2
	Komuna e Drenasit	2
	Komuna e Kamenicës	2
	Komuna e Kaçanikut	2
	Komuna e Suharekës	2
	Komuna e Klllokotit	2
	Komuna e Shtimes	2
	Të tjera	8
<b>TË TJERA</b>		
	Policia e Kosovës	34

	Korporata Energjetike e Kosovës	20
	Agjencia Kosovare për Privatizim	18
	Agjencia Kosovare e Pronës	12
	Trepça	5
	Autoritetet e huaja	4
	Universiteti i Prishtinës	4
	Kuvendi i Kosovës	4
	Palë private	4
	EULEX	3
	PTK	3
	Ujësjellësi Rajonal në Prishtinë	3
	Doganat e Kosovës	2
	Të tjera	27

Tabela 7: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së

<b>SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL</b>		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	3
	Dhoma e veçantë e Gjykatës Supreme	3
	Gjykata e Qarkut në Prishtinë	3
	Gjykata Komunale në Vushtrri	3
	Gjykata Komunale në Prizren	2
	Gjykata Komunale në Gjilan	2
	Gjykata Komunale në Pejë	1
	Gjykata Supreme e Kosovës	1
	Prokuroria Komunale në Prishtinë	1
<b>AUTORITETET QEVERTARE</b>		
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2
	Ministria e Infrastrukturës	2



	Ministria e Financave	1
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
	Ministria e Punëve të Brendshme	1
	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës	1
	Administrata Tatimore e Kosovës	1
	Zyra e Kryeministrit	1
<b>PUSHTETI LOKAL</b>		
	Komuna e Prishtinës	10
	Komuna e Prizrenit	2
	Komuna e Vitisë	2
	Komuna e Obiliqit	2
	Komuna e Gjakovës	2
	Komuna e Mitrovicës	1
	Komuna e Dragashit	1
	Komuna e Lipjanit	1
	Komuna e Kamenicës	1
	Komuna e Shtërpcës	1
<b>TË TJERA</b>		
	Universiteti i Prishtinës	4
	Policia e Kosovës	3
	Zyra e Rregullatorit për Energji	2
	Agjencia Kadastrale e Kosovës	1

Tabela 8: *Vonesat e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së*

<b>SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL</b>		
	Gjykata Komunale në Prizren	3
	Gjykata Komunale në Prishtinë	2

	Gjykata Supreme e Kosovës	1
<b>AUTORITETET QEVERTARE</b>		
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	4
	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës	2
<b>PUSHTETI LOKAL</b>		
	Komuna e Prishtinës	3
	Komuna e Shtërpçës	1
<b>TË TJERA</b>		
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	1
	Agjencia Kadastrale e Kosovës	1

Tabela 9: Raportet dhe rekomandimet e publikuara nga IAP

	Raportet mbi rastet	12
	Raportet <i>ex officio</i>	4
	Rekomandime në raportet e publikuara	44


Tabela 10: Autoritetet përgjegjëse që nuk kanë implementuar rekomandimet e IAP-së

	Komuna e Prishtinës	7
	Ministria e Punëve të Brendshme	5
	Këshilli Gjyqësorë i Kosovës	4
	Administrata Tatimore e Kosovës	3
	Ministria e Infrastrukturës	2
	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1
	Gjykata Komunale në Gjilan	1
	Komuna e Skenderajt	1
	Komuna e Kamenicës	1
	<b>Gjithsej rekomandime të paimplementuara</b>	<b>26</b>




Figura 1: Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2012 - 31 dhjetor 2012


Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2012




Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2012




### Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2012




### Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2012




### Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara



### Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP




Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë



Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2012

(jo vetëm rastet e vitit 2012, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)







## **9. Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit**

### **9.1. Gjendja e personelit**

Për përmbushjen e misionit kushtetues, përbërja dhe numri i të punësuarve përbën faktorin themelor për funksionimin e IAP-së. Numri i lejuar i vendeve të punës për vitin 2012 ka qenë 48, numër i njëjtë sikurse edhe në vitin paraprak. Me këtë numër dhe përbërje të punonjësve për vitin 2012, IAP ka pasur pengesa dhe kufizime në punë për realizimin e misionit, obligimeve dhe përgjegjësive në punë.

Numri i pozitive të miratuara prej 48 punonjës, sipas kategorisë së zyrtarëve, ndahet si në vijim: gjashtë (6) zyrtarë publik, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe dyzetë e dy (42) zyrtarë - nëpunës civil.

Për shkak të këtij kufizimi për personel shtesë, IAP ka qenë e kufizuar për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në punë. Rritja e numrit të ankesave, obligimet shtesë që rrjedhin nga shumë ligje të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, si dhe miratimi i ligjeve të reja që caktojnë obligime dhe përgjegjësi ligjore për menaxhimin dhe funksionimin e administratës, përcaktojnë përgjegjësi të drejtpërdrejta shtesë për IAP, të cilat mund të kryhen vetëm me angazhim shtesë të burimeve njerëzore.

Përkundër kërkesës së IAP-së për rritjen e numrit të personelit për vitin 2012, sikurse në dy vitet paraprake, nuk është miratuar asnjë pozitë e re e vendeve të punës për shërbimin civil. Buxheti i IAP-së për paga dhe mëditje për vitin 2012 ka qenë i pamjaftueshëm, madje edhe për pozitave të miratuara për 48 punonjës. Me buxhetin e miratuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, IAP ka pasur mundësi të punësojë vetëm 44 punonjës. Ndërsa 4 pozita tjera IAP nuk ka mundur t'i aktivizojë për mungesë buxheti. Në gjashtëmujorin e dytë, përmes rishikimit buxhetor të vitit 2012, IAP-së i është ndarë buxhet shtesë, në bazë të kërkesës së IAP për rishikim buxhetor, me qëllim të aktivizimit të 4 pozitive të miratuara të vendeve të punës.

Kufizimet në burime njerëzore si dhe mungesa e buxhetit, gjatë vitit 2012 IAP-së i kanë shkaktuar pengesa për kryerjen e shumë obligimeve dhe përgjegjësive në punë si dhe të aktiviteteve të shumta në realizimin e mandatit kushtetues. Me gjithë rritjen e efikasitetit në punë dhe ristrukturimit organizativ, mungesa e burimeve të mjaftueshme humane e financiare ka ndikuar dukshëm për mos realizimin e përgjegjësive të deleguara, mos funksionimin e disa sektorëve, etj.

## 9.2. Lëvizjet e personelit

Çështje me rëndësi e cila ndikon në funksionimin IAP-së, është lëvizja e personelit, ndërprerja e marrëdhënies së punës në mënyrë vullnetare. Kjo ndikon negativisht dukshëm në kualitetin e punës dhe në realizimin e obligimeve kryesore të punës së IAP-së.

Shkaqet kryesore për lëshimin vullnetar të marrëdhënies së punës, pas përgatitjes profesionale afatgjatë janë: akomodimi në vende tjera të punës, në pozita më të avancuara apo ku të ardhurat personale janë më të larta me kushte shumë më të favorshme të punës se në IAP. Gjatë kësaj periudhe raportimi, vullnetarisht kanë ndërprerë marrëdhënien e punës 2 punonjës shumëvjeçar, kurse janë punësuar 4 punonjës të rinj.

Lëshimi vullnetar i marrëdhënies së punës në IAP është një fakt shqetësues, meqë kuadrot e përgatitura profesionale dhe të specializuara, nuk mund të avancohen dhe të shpërblehen për punën efikase dhe profesionale të tyre, dhe atyre nuk mund t'u mohohet e drejta e lëshimit vullnetar të marrëdhënies së punës.

Një fakt pozitiv që vlen të theksohet është se tendenca e largimit të kuadrit profesional të përgatitur nga IAP është dukshëm më e vogël se në vitet paraprake. Kjo në radhë të parë për shkak të mirëkuptimit, koordinimit dhe bashkëpunimit korrekt të institucioneve ndërkombëtare të angazhuara në Kosovë me IAP, për mos angazhimin e bashkëpunëtorëve të IAP pa pëlqimin dhe konsultimin me IAP, por edhe për shkak të reduktimit të stafit në Kosovë dhe rrjedhimisht të kërkesave më të mëdha për punësim se në vitet e kaluara.

## 10.Shkurtesat

<b>AKM</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>AKMM</b>	Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Pronës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CEDAW</b>	Convention on the Elimination of Discrimination Against Women (Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas)
<b>CLARD</b>	Center for Legal Aid and Regional Development (Qendra për Ndihmë Juridike Falas dhe Zhvillim Regjional)
<b>CRONSEE</b>	Ombudsmanët për Fëmijë të Evropës Juglindore
<b>DKA</b>	Drejtoritë Komunale të Arsimit
<b>DPP</b>	Departamenti i Punës dhe Punësimit
<b>DHPGJS</b>	Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës
<b>ENOC</b>	European Network of Ombudspersons for Children (Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë)
<b>EULEX</b>	European Union Rule of Law Mission (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit)
<b>GDF</b>	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GMD</b>	Grupi për Mos-diskriminim
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>IRD</b>	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim
<b>IMF-OJQ</b>	Institucioneve Mikrofinanciare të regjistruara si Organizata Joqeveritare
<b>KDI</b>	Instituti Demokratik i Kosovës
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës

<b>KMDF</b>	Këshilli për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë
<b>KMDK</b>	Kompania për menaxhimin e Deponive të Kosovës
<b>KMDLNJ</b>	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
<b>KOS</b>	Kisha Ortodokse Serbe
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial të Kosovës
<b>KPK</b>	Kodi Penal i Kosovës
<b>KPMK</b>	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
<b>KPPK</b>	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
<b>KRK</b>	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
<b>LQDP</b>	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
<b>LGBT</b>	Lesbian Gay Bisexuals Transsexuals
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MKPT</b>	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>NJBGJ</b>	Njësia për Barazi Gjinore
<b>NJDNJ</b>	Njësitë për të Drejtat e Njeriut
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OHCHR</b>	Office of the High Commissioner for Human rights (Zyra e Komisariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut)
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PTK</b>	Postë-Telekomi i Kosovës
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>QKSGJ</b>	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës

<b>QP</b>	Qendra e Paraburgimit
<b>QPM</b>	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë
<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>RCT</b>	Rehabilitation and Research Centre for Torture Victims (Qendra për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës)
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>TIK</b>	Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>UNDP</b>	United Nations Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
<b>UNICEF</b>	United Nations International Children's Emergency Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)
<b>YIHR</b>	Youth Initiative for Human Rights (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut)
<b>WHO</b>	World Health Organization (Organizata Botërore e Shëndetësisë)